

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

81H.09

B.82.

KYR  
flasim për  
poezinë

RAZI  
BRAHIMI

891.P.83.09.  
B82

S

RAZI BRAHIMI

R

KUR  
FLASIM  
PER  
POEZINE

*Shënime kritike*)



SHTËPIA BOTUËSE  
«NAIM FRASHËRI»

## KUR FLASIM PËR POEZINË

### I

Qenka e vështirë të shkruash për poezinë edhe kur je, edhe kur nuk je poet. Sot është zor të gjesh ndonjë prej vjershëtarëve tanë, pa përjashtuar edhe më të rinjtë, që të mos ketë folur në vjershat e veta dhe, drejtpërdrejt ose tërthoraz, të mos ketë polemizuar me të tjerët për probleme të përgjithshme e të veçanta të poezië, pa harruar të përmëndë, me të tallur ose me inat, kritikët e vërtetë apo të imagjinuar. Në gjykime të kësaj natyre ka edhe gjëra të thëna me mënçuri, sa herë që pasionet — aq të zakonshme për poetët — nuk kanë errësuar arësyen e fortë dhe nuk e kanë kthyer polemikën poetike në një arenë dëshirash për t'u imponuar, për t'u autore-klamuar dhe për të bërë të paqenën të qenë. Dhe, kur lexonjësi ndeshet me gjykime subjektiviste apo me deklarata patetike për vlera që nuk janë atëhere ai qesh e tallet me poetët, më keq nga ç'qeshin e tallen këta me njëri-tjetrin dhe me kritikët. Po nuk është rasti të zgjatemi shumë me këto hollësi, prej të cilave ç'është me vlerë do të mbetet, kurse të tjerat ose do të sheshohen, siç sheshon era grumbujt e rërës, ose do të kujtohen për të qeshur. Do të përpinqemi vetëm të parashtrojmë disa mendime për poezinë, duke përfituar prej diskutimit që ka çelur gazeta «*Drita*»<sup>1)</sup>, në një kohë të qetë, prandaj

1) Është fjala për diskutimin e çelur nga gazeta «*Drita*» në vitin 1964, kushtuar problemeve të poezië. Artikulli «Kur flasim për poezinë», që u shkrua për këtë diskutim, botohet i ripunuar.

mund të ndodhë, që shumë prej arësyetimeve të këtij artikulli t'i kujtojnë lexonjësit atmosferën e zjarritë të diskutimeve të ashpra, që u zhvilluan parvjet ndërmjet poetëve tanë të njojur. Në ato diskutime u thanë shumë mendime të çmueshme dhe u duk dëshira e përgjithshme që poezia jonë t'i shërbejë sa më mirë çështjes së revolucionit socialist, të ketë një fytyrë të përcaktuar kombëtare, të cilohet prej ruginës, të theksojë karakterin e vet novator dhe të mënjanjojë rrezikun e ndikimeve dekadente e formaliste. Krahas këtyre shqetësimeve të natyrshme e të drejta, në diskutime pati edhe njëanësi dhe subjektivizëm, që shpunë në përpjekje për të absolutizuar vlerat e një praktike krijonjëse dhe për të mohuar e përçmuar — edhe duke i parodizuar — vlerat e praktikave të tjera. Një gjë e tillë vërtet i ndezi më shumë diskutimet, po edhe i kufizoi deri në një farë shkalle në anë formale, që mohoheshin e rekomandoeshin në mënyrë të prerë dhe pa asnje tolerim, pa menduar që forma artistike (aq më tepër elementet metrike), në fund të fundit, janë vetëm një mjet që ndihmon komunikimin me lexonjësit, të cilit i jepet, nëpërmjet vargjeve, një brendi e caktuar ideo-emocionale, që buron nga vetëjeta, nga realiteti objektiv, që ndez frymëzimin dhe nxit fantazinë e poetëve. Në këtë kuptim, çështja e parë me rëndësi, që do të meritonte vëmendje, nuk do të ishte metrika (vargjet e rregullta klasike apo vargjet e lira), po burimi i poezisë dhe i brendisë së veprave poetike, prej të cilave përcaktohet edhe forma artistike, si konkretizim i tyre. Jeta, realiteti objektiv dhe bota e brendshme e njeriut përmban jo vetëm momentet poetike që frymëzojnë, po edhe elementet e ndikimit artistik, që për poezinë janë gjuha, muzikaliteti i shprehjes, ritmi dhe bazën logjike e psikologjike të gjithë kategorive të stilistikës poetike. Prandaj, që të gjykohet drejt për poezinë dhe që të kuptohen e të shtrohen siç duhet problemet e saj, do të ishte e udhës të niseshim, jo nga poezia në vetvete, të marrë si diçka të shkëputur, bile, gjër në një farë mase, të feti-

shizuar, po nga raportet e saj me jetën dhe me shkallën e zhvillimit shoqëror e artistik të njerëzimit, prej të cilave lind dhe përcaktohet.

Thuhet, për shembull, që «*akësh vepër ka brendi të shëndoshë, po çalon nga forma*» ose «*ka formë të bukur, po çalon nga përbajtja*». Nga pikëpamja formale këto karakterizime, që mbështeten në ndarjen shkollore të brendisë e të formës, duket sikur janë të drejta, ndërsa, në të vërtetë, mbështeten në ndarjen shkollore të brendisë e pa rëndësi, ato mohojnë karakterin unik të veprës artistike, në të cilën brendia ekziston vetëm nëpërmjet formës (jashtë formës nuk mund të ketë asgjë, pra, as poezi), forma është mishërim i brendisë dhe këto dy komponentë, me lidhje të brendshme dialektike ndërmjet tyre, ndikojnë njëri-tjetrin, përcaktohen prej njëri-tjetrit dhe, kur bien në kontradiktë, e kapërcejnë njëri-tjetrin. Cilësia e re lind për shkak të brendisë së re, që e ndjen veten ngushtë brenda caqeve të formave të vjetëruara dhe kërkon të shpërthejë, të gjejë forma më të përshtatshme të manifestimit të vet, të cilat përcaktohen kryekëput nga karakteri i brendisë, nga idealet shoqërore të poetit, nga predispozitat shpirtërore të tij, nga pikëpamjet estetike dhe nga lexonjësi, të cilat i drejtohet.

Brendia politike dhe ideologjike e veprave përcakton vlerën shoqërore të krijimtarisë poetike, po që të kthehet në poezi, nuk mjafton vetëm të zgjidhen fjalë të bukur, figura stilistike të goditura dhe rima të rralla, siç ndodh kur kemi të bëjmë me përpjekje stilizantësh, po, në radhë të parë, të kërkohen dhe të zbulohen momentet poetike të realitetit, që përbëjnë objektivitetin e poezisë dhe përcaktojnë manifestimet e jashtme të saj, të konceptohen ato në mënyrë të figurshme emocionale dhe pastaj të konkretizohen në vargje, natyra e të cilave nuk mund të jetë në kundërshtim me themellet objektive mbi të cilat ngrihet. Kështu, brendia e një vepre nuk mund të jetë «*poetike*», në qoftë se poeti nuk ka zbuluar momentet poetike të realitetit dhe forma e një vepre nuk mund të quhet shoqërisht e bukur dhe e mirë, në qoftë se, si mbartëse e një brendie dekadente, ushtron ndikim

depresiononjës e çoroditës te lexonjësit. Ndërsa përmbytja ideologjike dhe politike është elementi më i rëndësishëm, që përcakton dobinë apo dëmin shoqëror të poeziës, sipas karakterit pozitiv ose negativ të ndikimit të saj, specifika emocionale e brendisë poetike përbën hallkën themelore të lidhjeve dialektike të përbajtjes me formën, është shprehëse e karakterit unik të veprës artistike. Moskuptimi i kësaj të vërtete shpie në ndarjen artificiale të brendisë nga forma në kritikë, kurse në krijuartari, mosnisja nga pozita të tilla, ka shpënë gjithnjë në krijimin e një poezië artificiale dhe me prirje stilizante.

Që t'u shmangemi teorizimeve, le të marrim si shembull poemën «*Sinfoni pune*» të Kolë Jakovës. Si brendi, — në kuptimin më të përgjithshëm të fjalës, — vepra nuk ka të sharë. Në të janë reflektuar edhe urrejtja për të kaluarën e zezë, edhe transformimet socialiste, edhe perspektiva historike dhe të gjitha këto janë përshkruar drejt, bile në të kanë gjetur të pasqyruar edhe jetën shqiptare, karakterin tonë kombëtar. Po të nisemi kështu, poemën «*Sinfoni pune*», vargjet e së cilës janë në rregull edhe metrikisht, do ta quanim një vepër shumë të mirë, ndërsa, sikur të synojmë që në veprat poetike të gjejmë poezinë, atëhere do të ndërronim mendim, mbasi realiteti në këtë poemë, megjithëse është reflektuar nga pozita të drejta, nuk është konceptuar e pasqyruar në mënyrë poetike emociononjëse, po në mënyrë të jashtme deskriptive, me logjikë, me zanat. Një gjë e tillë ka ndodhur se poeti nuk ka gjetur ato momente estetike të jetës dhe ato raporte emocionale të njerëzve ndaj realitetit, prej të cilave buron dhe përftohet poezia, si një formë e vëçantë e mishërimit të të vërtetave shoqërore e politike. Duke munguar një konceptim i tillë artistik, puna krijuonjëse e poetit është kufizuar vetëm në gjetjen dhe në zgjedhjen e figurave stilistike dhe në limimin e vargut për të paraqitur fakte e për të shprehur mendime, që janë paraqitur e janë shprehur edhe prej të tjerëve, me të tjera figura.

Ndryshe është poema «*Endërr industriale*» e Ismail Kadaresë, të cilën e kujtojmë në këtë çast, jo vetëm si

një realizim të vërtetë poetik, po edhe se është e frymëzuar nga i njëjtë realitet me poemën «Sinfoni pune» dhe ka të njëjtën temë me të. «Ëndërr industriale» është bazuar në ato momente me rëndësi të realitetit tonë, që shprehin në mënyrë më emocionale zhvillimin socialist, luftën e të kundërtave dhe ngadhnjimin e së resë mbi të vjetrën dhe janë konceptuar këto në formë të figurshme poetike. Poeti ka zbuluar poezinë e jetës sonë dhe, ndërsa në rastin e parë kemi një përsëritje të vargëzuar të disa të vërtetave të njoitura, të cilat i pranojmë si të tillë, në rastin e dytë, megjithëse e vërteta e përgjithshme është e njojur, jeta në poemë është reflektuar me emocionin e një zbulimi dhe ne ndjejshmë se si vetë poeti përzihet në të vërtetat e jetës, kërkon, pohon dhe mohon, lufton dhe arrin të na japë një përfytyrim unik e të fuqishëm të transformimit socialist, nëpërmjet industriaлизimit.

Si përfundim, mund të themi se me zbulimin e momenteve poetike të jetës, nis poezia. Këto momente poetike janë të shumta dhe kanë karakter objektiv, po ky karakter objektiv i tyre, për t'u kthyer në vepër poetike, kalon nëpër ndërgjegjen e poetit, e cila nuk mund të jetë pasive ndaj ngacmimeve të jashtme, po tërhoqet prej atyre momenteve objektive, që pajtohen më mirë me natyrën e saj shoqërore. Poeti e sheh jetën *me sy shoqëror*, klasor dhe me këtë sy edhe e pasqyron dhe e interpreton. Në këtë aspekt ai nuk ndryshon nga sociologu. Nga ana tjetër, ndryshimi ndërmjet poetit dhe sociologut nuk nis me mjetet e shprehjes (të shkruarit në vargje, figurat stilistike, etj.), po me diçka më primare, më objektive, që përbahet në vlerat estetike të vetë realitetit jetësor dhe, pastaj, në aftesinë për ta njojur e reflektuar këtë realitet në mënyrë emocionale e të figurshme, gjë që gjithashtu ka karakter shoqëror, megjithëse duket si manifestim i thjesht personal i individualiteteve të ndryshme poetike. Emocionet, sidomos emocionet artistike, nuk mund të janë të shkëputura nga përkatësia klasore, nga botëkuptimi dhe nga shkalla e zhvillimit të njerëzve.

Po a ka ndonjë kuptim ndarja e veprave poetike në

përmbajtje dhe në formë? Po të shohim rastet kur përdoret një ndarje e tillë, në artikujt kritikë do të vrejmë se bëhet fjalë përgjithësisht për dobësitë stilistike në krijimet e poetëve tanë, për thurjen e vargjeve, për gjuhën dhe sintaksën poetike, për figurat e fjalës, etj. Këto merrin si vlera ose si dobësi të formës, dhe, megjithëse nuk janë më kryesoret, ato janë elemente të formës dhe, si të tilla, ndikojnë në lindjen e kënaqësisë apo të pakënaqësisë estetike te lexonjësi. Ndërsa zbulimi, konceptimi dhe pasqyrimi poetik i realitetit kanë të bëjnë me shkallën e talentit, këto elemente kanë të bëjnë me njohjen e mjeshtërisë, me kulturën e të shkruarit, në qoftë se përjashtojmë rastet ekstreme të manierizmit formalist, kur përsosmëria e formës kthehet në mani të sëmurë ose të pseudomodernizmit, që ka disa herë për qëllim shkattrimin e formës, duke iu kundërvënë me kast aspiratave njerëzore për bukurinë.

Në një libër me vjersha ndeshëm në këto vargje:

«*Vokabolar'* — i izmave ja dha vargut tim këtë ritëm (!) — që, ku rrjedh vrrullshëm, ku ecën zvarrë. — *Barbar* — le të jem për metrikën, — do të më falë mësuesi im i parë, — por, për njerëzit, qofsha gjithmonë pishtar...»

Këto vargje, pavarësisht nga sa janë pasqyrim i vërtetë i pikësynimeve artistike të vjershëtorit, shprehin një koncept shumë të dëmshëm, bile, të rrezikshëm për poezinë, koncept që e gjejmë të shprehur ose të reflektuar edhe në disa poetë të tjera të rinj, të cilët të lënë përshtypjen se e quajnë kulturën e të shkruarit një «vjetërsirë» që u dashka flakur, një «pengesë borgjeze» për «shpërthimet» e tyre gjoja revolucionare. Dhe vihet re që ndër ne shkruhen shumë vjersha e poema, botohen vëllime me shumë faqe, bëhen disa herë reklamime të bujshme e pa baza. Po është e nevojshme të kuptohet se si poet nuk mund të jetë askush «pishtar për njerëzit», në qoftë se talentit apo aftësive naturale të tij nuk i shton punën e madhe e të mundimshme të artistit të fjalës, atë punë të lodhshme e shqetësonjëse, që kërkon mishërimi artistik i motiveve të jetës dhe që është vetë *natyra e*

*jashtre* e poezisë. Dihet që gjysma e njerëzve, sipas përfundimeve të Pavllovit, janë artistë nga predispozitat naturale, po numri i artistëve nuk është aq i madh. Pa kulturë dhe pa punë të ndërgjegjshme nuk mund të shkruhet poezi e vërtetë. Ajo që shkruhet në mënyrë «barbare», edhe në qoftë se përmban poezi jete, humbet aftësinë komunikonjëse dhe vlerën e ndikimit estetik dhe edukativ.

Poezia jonë ka pasur mjeshtra të njohur të vargut. Në këto shënime do të përmëndnim Nolin — këtë mjeshtër të përsosur të harmonizimit të trajtës me brendinë poetike. Le të krahasojmë, pér shembull, «*Marshi i Krishtit*» me «*Marshi i Barabait*» ose «*Dragoi i Dragobisë*» me «*Syrgjin gjallë e syrgjin vdekur*». Dy vjershat e para, të njëjtë në ndërtimin metrik, janë në kontrast me njëra-tjetrën, jo vetëm në kuptimin e tyre, në frymën hymnizonjëse të njerës e në karakterin demaskonjës të tjetrës, po edhe në tingullin e fjalës, në efektet akustike të vargut, me ndihmën e të cilave poeti ka theksuar brendinë e krijuar me tē veta, i ka dhënë asaj trajtën që do ta shprehte në mënyrën më të plotë, më të efektshme, më ndikonjëse. Në vjersha të kësaj natyre *fjala-kuptim* e zgjedhur me mjeshtëri është një me *fjalën-tingull*, brendia poetike ka gjetur mishërimin e plotë stilistik. Ose dy vjershat e tjera. Ndërsa «*Dragoi i Dragobisë*», jo vetëm me kuptimin, po edhe me ritmin e vargut dhe tingullin e fjalës jep portretin e luftëtarit dhe theksion natyrën luftarake të vjershës, «*Syrgjin gjallë...*», edhe me elementet formale, të krijon pér bukuri portretin e intelektualit dhe duket sikur edhe kadanca e vargut, edhe tingulli i fjalës duan të nën-vizojnë dhembjen pér jetën në syrgjyn dhe pér vdekjen në syrgjyn të Luigj Gurakuqt.

Morëm si shembull këto katër vjersha, që mund të krahasohen me njëra-tjetrën, se përndryshe do të përmëndnim të gjitha krijimet e mrekullueshme të Nolit: «*Rent, or marathonomak*» e «*Anës lumenjve*», «*Krishti me kamzhikun*» e «*Moisiu në mal*», «*Plak topall e ashik*» e çdo tjetër. Po t'i vëmë veshin ritmit të «*Moisiut në mal*», do të ndjejmë ngjitjen përpjetë malit të shkretë, etj. U

zgjatëm me Nolin në këto shënime për poezinë e sotme, se kemi përshtypjen që poetët tani — qoftë ata që ngrihen kundër «robërisë» së metrikës, qoftë ata që e respektojnë atë, — rrallë na kënaqin me vepra ku mund të shohim gjithë aftësitë shprehëse të gjuhës sonë të pasur, gjithë muzikalitetin dhe ëmbëlsinë e saj, gjithë ato mundësi të shprehjes së figurshme e të ndërtimit të harmonishëm të veprave. Shkruhet shumë, po nuk janë të shumta ato krimjime poetike që do të dëshironim t'i mësonim përmendsh e t'i merrnim me vete. Sigurisht këtu s'kemi të bëjmë vetëm me vlerat formale të poeziës, po, nga ana tjeter, nuk mund të mohojmë rëndësinë e tyre ndikonjëse, bile, edhe edukative do të thoshnim. Se, në qoftë se e shkruajmë bukur gjuhën amtare, a nuk e shton kjo dashurinë për të, për popullin, për Atdheun, a nuk na edukon estetikisht?

Nuk është puna këtu, siç mendojnë disa, te «vargjet e lira» dhe te «vargjet e matura», po te mishërimi sa më ndikonjës i ndjenjave dhe i mendimeve në trajta të gjetura me mjeshtëri, te transplantimi në vargje të bukura i vlerave estetike të realitetit, se poezië ekziston, jo vetëm se ekzistojnë anët dhe momentet poetike të jetës, që janë primare, po se ekzistojnë edhe mundësitë dhe mjetet e veçanta të shprehjes poetike, që e dallojnë poezinë nga gjinitë e tjera letrare.

Edhe disa fjalë për brendinë poetike. Zhdanovi ka thënë dikur se «çdo gjë gjeniale është e thjeshtë, po jo çdo gjë e thjeshtë është gjeniale». I përmendëm këto fjalë, se edhe në këtë drejtim, diskutimi i sotëm për poezinë dhe vetë praktika letrare na lë përshtypjen se po konkretizohen dy tendencia të kundërtë ekstreme e të gabuara, pikërisht se duan të përjashtojnë e t'i kundërvihen kategorikisht njëra-tjetrës. *Tendenca e parë*, që është edhe më e vjetra dhe më e përhapura, është *tendenca e thjeshtëzimit*, sipas së cilës, gjoja në emër të karakterit popullor të poeziës, thjeshtësia, nga një vlerë estetike kthethet në një vulgaritet, përligj varférinë e brendisë poetike të veprave, mungesën e frymëzimit, ndjekjen epigonale të traditës, standardet dhe shablonet letrare, artificialitetin e

shprehjes, etj. Në diskutime, kjo tendencë është kritikuar nga ana formale dhe kritika është denigruar në çështje të vogla si vargu e rimat. Në të vërtetë, rutina duhet kërkuar në brendinë poetike të veprave, të cilat nuk nisen nga jeta e gjallë, po nga modele të njohura letrare, vërtiten në një rreth të kufizuar motivesh të padetajuara, e pasqyrojnë jetën shumë ngushtë e në mënyrë primitive, rrahin me fshehë mungesën e fryshtimit prapa një stil i deklarativ plot ekslamacione dhe, dashur padashur, e shndërrojnë poezinë në zanat. Kjo poezi absolutizon traditat, duke u zvarritur pas tyre dhe ulet në nivelin e shtresës së prapambetur të lexonjësve, në vend që t'i përtërijë vlerat e së kaluarës, nëpërmjet një kuptimi të thellë e krijonjës të tyre dhe të ngrihet mbi nivelin e lexonjësve më të zakonshëm dhe t'i udhëheqë shijet e tyre, t'u çelë atyre horizonte të reja, t'u tërheqë vëmendjen në problematikën e re e të pasur të jetës dhe të mos i ushqejë me ninullat e së kaluarës.

*Tendencia e dytë*, që kërkon t'i kundërvihet së parës, mohon vulgaritetin dhe varfërinë e brendisë poetike, kërkon një përtëritje të thellë ideore dhe formale të poeziës, rreh ta pajtojë plotësisht me jetën aktuale, ta fuqizojë, të zgjerojë rrethin e interesimeve e të motiveve të saj, po a priori mohon lidhjet me traditat kombëtare dhe shkëputet prej nivelit të lexonjësve të sotëm popullorë. Mbi këto baza është paraqitur teoria e «*errësimëve të domosdoshme*» si një karakteristikë e «poezië moderne», që edhe është munduar të konkretizohet në ndonjë poemë të kohëve të fundit.

Kjo tendencë e dytë është e re dhe nuk ka gjetur përhapje të madhe, po, sidqoftë, meriton vëmendje, se poezia nuk është rebus, që lexonjësit të mbështetin bërrylet në tryezë e të vrasin mendjen të kuptojnë ç'ka dashur të thotë poeti. Brendia e thellë ideo-emocionale nuk është në kundërshtim me qartësinë e motiveve dhe thjeshtësinë e bukur të shprehjes poetike. Përkundrazi. Thjeshtësia dhe qartësia janë shenja të asimilimit të plotë të materialit jetësor, shprehje të unitetit ideor të poetit me lexonjësin, mjete të ndikimit sa më të gjërë të poeziës.

Të shtrosh nevojën e «errësimeve të domosdoshme» do të thotë të kalosh në manierizëm dhe të lakmosh jo komunikimin me njerëzit, po vështirësimin artificial të mundësive komunikonjëse të poezisë.

Nga ana tjetër nuk na duket e vërtetë që poezia moderne qenka e errët dhe lakmuaka «errësimet e domosdoshme». Prej një vështrimi më të vëmendshëm dhe më kritik do të vërenim se ata që lakmojnë «errësimet» nuk janë poetët prej të cilëve duhet të mësojmë. Në poezinë e madhe brendia e thellë dhe e pasur — një qëllim që duhet pasur gjithnjë, — ka qenë e qartë, e kuptueshme dhe e dashur për popullin, ka qenë realizim i idealeve estetike të tij. Prandaj jemi të mendimit që rruga nuk mund të jetë as zvarrisja shterpë pas traditave, as mohimi i këtyre kategorik, po një qëndrim krijonjës e kritik ndaj tyre, që niset ngajeta e sotme dhe vështron përpara, drejt së ardhmes. Brendia e re gjen mishërimin e vet më të përshtatshëm në një poezi novatore, e cila nuk mund të jetë uniforme dhe standarde, po do të përfshijë prirjet dhe natyrat më të mira e më të ndryshme personale, ku poeti i vërtetë popullor gjen vend nderi krahas përfaqësonjësit më të pavarur realist revolucionar të poezisë moderne. Mbi bazat e poezisë popullore mund të krijohet një poezi e pasur moderne, në qoftë se lidhjet e poezisë së sotme me poezinë popullore do të kuptohen në mënyrë krijonjëse, revolucionarizonjëse.

Tradita botërore, gjithashtu, nuk është e huaj përpoezinë tonë, po sikurse në traditën kombëtare, çështja është, jo në duhet të mbështetemi apo të mos mbështetemi në të, po se në ç'traditë duhet të mbështetemi dhe ç'duhet të marrim prej saj, duke njojur këtu edhe afinitetet personale të poetëve. Në tradita ka gjëra që duhen marrë, që vlejnë të përpunohen e të përtërihen, ka edhe gjëra që duhen hedhur poshtë e duhen luftuar. Në vija shumë të përgjithshme, mund të themi, se nga pikëpamja ideore vlejnë si mbështetje gjithë ato elemente që do të shërbenin për forcimin e brendisë revolucionare, kurse nga pikëpamja formale — ato që do të pajtoheshin me

natyrën e poezisë sonë të realizmit socialist. I njëjti qëndrim do të ishte i vlefshëm edhe për eksperiencën e sotme të artit botëror.

## II

Me gjithë diskutimet që mund të bëhen dhe kundërshtimet që mund të ketë, në tërësinë e vet, poezia jonë e realizmit socialist është një poezi e lidhur me jetën dhe, brenda caqeve të letërsisë sonë kombëtare, është një poezi novatore, gjë që nuk përjashton as prirjet e ndryshme krijonjëse, as kundërshtimet dhe as luftën ndërmjet praktikave letrare, që mbështeten në koncepte jo të njëjta artistike.

Lidhja me jetën dhe platforma e njëjtë ideologjike përbëjnë bazën e bashkimit e të unitetit të shkrimittarëve tanë dhe janë ato elemente kryesore që i japid tonin shoqëror diskutimeve e kundërshtimeve, në të cilat askush nuk do të ishte mirë të pretendonte në vlerën absolute të eksperiencës e të rezultateve vetake, gjë që do të shpinte, — siç mund të duken edhe tani disa shenja, — në shhangje prej diskutimeve parimore, në largim prej gjërave të rëndësishme e themelore, në mohime a priori të praktikave të ndryshme krijonjëse e të rezultateve të tyre, në mohime kategorike të eksperiencës së grumbulluar gjatë njëzet vjetve dhe në lindjen e iluzioneve se vetëm tani po lindka poezia shqipe. Ky është subjektivizëm. Subjektivizëm është, nga ana tjetër, edhe përpjekja për të absolutizuar eksperiencën e grumbulluar dhe për ta përdorur si një kufi të prerë, jashtë së cilës nuk mund të ketë gjë të mirë e të bukur, si një mjet për të konsideruar sakrilegj çdo përpjekje të guximshme për ta shpënë poezinë përrpara, siç ka ndodhur me disa artikuj kushtuar vëllimit «*Shekulli im*» të Ismail Kadaresë, që, me gjithë të metat e tij, ishte si një erë e fortë në atmosferën tonë letrare. Ndërsa nënçmimi i eksperiencës shpie në mohimin e së kaluarës dhe të mbësh-

tetjes në truallin tonë, nënçmimi ose edhe përcëmimi i përpjekjeve të reja përtëritëse shpie në mohimin e zhvillimit, krijon amulli letrare dhe fsheh rrezikun e vënjes së poeziës në kundërshtim me vetë përparimin e shoqërisë, ngritjen e nivelit kultural të lexonjësve dhe të shijeve estetike të tyre.

Poëtët tanë, për më të mirat krijime të tyre, kanë pasur burim frymëzimi revolucionin e thellë e të gjithashëm që po kryejnë masat punonjëse të udhëhequra nga partia. Dhe, sa herë është ndier pulsi i jetës, sa herë ka rrahu zemra në çdo varg, poëtët tanë kanë krijuar vepra, që janë bërë të dashura për popullin, si këngë të frymëzuara revolucionare, si mbështetje për sukseset e sotme e të nesërme të letërsisë së realizmit socialist.

Në vitet e para pas çlirimit, bile, që gjat Luftës nacionalçlirimtare, poëzia i çeli rrugën letërsisë së realizmit socialist. Poëtët tanë të parë (Sh. Musaraj, F. Gjata, Dh. Shuteriqi, A. Çaci, A. Varfi, Ll. Siliqi, P. Marko, etj), krijuan vepra me vlerë, që e ruajnë edhe sot forcën ideologjike. Në përgjithësi, nga idetë dhe pasqyrimet, vërejmë një kapercim të theksuar në krahasim me letërsinë tonë të mëparshme, në trajtimin artistik të motiveve, duke kaluar në pozitat e realizmit socialist, vërehet një afinitet i natyrshëm me kërkimet artistike të letërsisë përparimtare të viteve '30 që, meqë u ndërprenë nga lufta, u kthyen shpejt në traditë. Forma e poeziës së asaj kohe, që të shprehemi në mënyrë të përgjithshme, ishte më moderne, nga ajo e viteve '50, me gjithë veprat me rëndësi që u krijuan edhe në këto vite, po që mendojmë se u dëmtuan prej një kuptimi të thjeshtëzuar të frymës popullore dhe të mbështetjes në traditat. Kjo është një prej arësyeve që vepra si «*Epopeja e Ballit Kombëtar*», «*Ashtu Myzeqe!*», «*Prishtina*», «*Enverit*», «*Nën tingujt e revolucionit*» etj. janë më të afërtë me lexonjësit e sotëm nga ç'janë disa vepra të shkruara më vonë me «stil popullor». Po, a e ka fajin stili popullor për një gjë të tillë? «*Epopeja e Ballit Kombëtar*» është shkruar me stil popullor, po edhe sot nuk tingëllon e vjetëruar. Edhe ky shembull i vetëm do të ishte i mjaftë për të provuar se

nuk është çështja thjeshtësishët te mbështetja në traditën e poëzisë popullore, siç lihet të nënkuptohet disa herë, po te zvarritja pas folklorit, te pasqyrimi i ambienteve të vjetra në mënyrë të vjetër, te mosthellimi në proceset jetësore e psikologjike të kohës, te rutina stilistike, që ka shpënë edhe në kufizime e në anakronizëm ideor, te qëndrimi dhe pasqyrimi i jashtëm e deskriptiv i realitetit në mënyrë pompoze e jo realiste. Edhe më vonë janë shkruar vepra me karakter stilistik popullor, si «*Devoll, Devoll!*», që mund të merren si shembuj të poëzisë sonë të sotme, prandaj vështrimi negativ i mbështetjes në traditën e poëzisë popullore mendojmë se është i gabuar.

Lidhur me mbështetjen në traditën popullore, ka lidur edhe çështja e të ashtuquajturës «*poemë me subjekt*», e cila po hidhet poshtë në mënyrë kategorike, duke u nisur nga disa vepra të dobëta, po dihet, që të hedhësh poshtë parimet, duke u nisur nga rezultatet, nuk është gjë e mençur, se në rezultatet ndërhyjnë kurdoherë motivet subjektive, aftësitë krijonjëse, konceptet artistike, etj. Nga ana tjetër, edhe praktika jonë letrare (e vjetër dhe e re) nuk na mëson ta shohim «*poemën me subjekt*» si një formë primitive e të keqe. Të gjitha poemat e De Radës, për shembull, janë me subjekt, po kjo karakteristikë e tyre nuk i ka dëmtuar. Përkundrazi, ato artistikisht edhe sot tingëllojnë të freskëta. Ndryshe janë poemat e bejtexhinjve, në të cilat sundon narracioni i thatë dhe pasqyrimi deskriptiv i ngjarjeve historike ose i subjekteve me karakter moral e fetar. Proza e ngushton sferën e veprimit të poëzisë në këtë drejtim, po historia e letërsisë ka treguar se nuk e mohon mundësinë e egzistencës së «*poemave me subjekt*», në të cilat përshtypjet ngajeta, ndjenjat e mendimet reflektohen nëpërmjet të një ngjarjeje realiste poetike dhe të një apo të disa heronjve, që mund të janë ose të mos janë zëdhënës të poetit. Çështja, pra, është te kuptimi i sotëm i «*pëmës me subjekt*» dhe te kriteret artistike, që na udhëheqin në krijimin e tyre. Në letërsinë tonë të sotme, njihen shumë «*poema me subjekt*», të cilat zunë kreun e vendit, sidomos në vitet '50, kur u shkruan «*Heronjtë e*


*Vigut*» dhe «*Gjeto Plaku*», «*Gjaku i falun*» dhe «*Zarika*», «*Erë pranverore*» dhe «*Mësuesi*» dhe shumë të tjera. Edhe më vonë u shkruan poema të tillë, si «*Këngë e re për dashurinë e vjetër*», «*Ngjarje në pushime*», «*Vdekja e turistikët*», «*Poema e udhës*», «*Proletarët*» etj. Nga gjithë kjo pasuri letrare, që do të meritonte një studim të posaçëm. Po sidoqoftë nuk mund të injorohet, mund të nxirret si përfundim i përgjithshëm që «poema me subjekt» ka zënë vend me rëndësi në zhvillimin tonë letrar dhe ruan ende mundësitë e qenjes, si një formë e veçantë e pasqyrimit poetik të realitetit, në trajtën e një subjekti unik ose të kompozimit të aspekteve dhe episodeve të ndryshme me platformë të përbashkët ideo-artistike. Edhe letërsia e sotme botërore ka dhënë shembuj të bukur të kësaj natyre, prandaj problemi është, se sa poetike janë subjektet e këtyre poemave dhe në ç'shkallë e trajtë artistike janë shkruar. Narracioni deskriptiv edhe në prozë është i dëmshëm, jo më në poezi, ku mungesa e frysëzimit dhe e mendimeve do të shpjerë patjetër, sidomos në «poemat me subjekt» në vargëzime të thata, ku zanati zë vendin kryesor dhe prolikositë është nga të këqiat më të dukshme, siç mund të vihet re edhe në mjaft prej veprave që përmendëm më lart.

«Poemës me subjekt» ka tentuar t'i kundërvihet teorikisht dhe në praktikën letrare e ashtuquajtura «*poezi e figurshme*». Themi e ashtuquajtura, mbasi gjithë poezia është e figurshme dhe gjithnjë ka pasur poetë më të figurshëm se të tjerët. Në kritikë, këtë poezi kemi gjetur ta quajnë *poezi refleksive* dhe ky term na duket më i saktë. Edhe pretendimi se kjo poezi ka lindur vitet e fundit, nuk na duket i vërtetë. Le të kujtojmë «*Liria*» të Mqedës, «*Poema e mjerimit*» të Migjenit apo edhe «*Parada e të uriturve*», «*Ashtu Myzeqe!*» dhe «*Prishtina*» nga letërsia e sotme, që të bindemi se edhe në këtë drejtim nuk jemi pa një traditë të mirë, që u përtërit me një forcë të re kohët e fundit prej Ismail Kadaresë, Fatos Arapit etj. dhe u përfaqësua me vepra të bukura, si poemat «*Ëndërr industriale*», «*Shënimë për brezin tim*», «*Përse mendo-*

*hen këto male» etj.* Në veprat më të mira të kësaj natyre, mendimi dhe ndjenjat shkrihen me pasqyrimin realist të jetës dhe realiteti objektiv reflektohet, jo vetëm si diçka më vete dhe as si një shkak për filozofime të përgjithshme poetike, por si një mishërim e konkretizim i idealeve shoqërore e estetike, si burim e si shprehës objektiv i filozofisë, ndërsa poeti vetë përzihet me këtë realitet dhe është pjesmarrës i proceseve të transformimit revolucionar. Këto janë edhe veprat më të mira, që qëndrojnë larg subjektivizmit ideor e artistik dhe shtrojnë rrugën për një poezi të fuqishme realiste, ndryshe nga rastet kur pseudofilozofimet mytin poezinë e vërtetë dhe krijojnë zhurma të kota, ose nga prirjet për një konceptim e reflektim simbolik të jetës.

Përpjekja që kjo trajtë e shprehjes poetike t'i kundërvihet «poemës me subjekt» shpie drejt mbivlerësimit të një praktike letrare dhe mohimit të formave të ndryshme të pasqyrimit poetik të realitetit, duke u nisur nga disa rezultate të veçanta e të zgjedhura me tendencë; se, po të merremi me vepra të dobëta, do të vërejmë që edhe poema refleksive, sadoqë më pak e zhvilluar, që tanika filluar të tregojë shenja të shthurjes stilistike dhe të prirjes për pseudofilozofime, pra, të një qëndrimi spekulativ ndaj realitetit. Siç shihet, çdo formë e pasqyrimit poetik të jetës ka mundësitet e veta specifike, që e bëjnë më të përshtatshme për trajtimin e disa aspekteve të realitetit e të disa mënyrave të këtij trajtimi, të cilat varren nga talenti i poetëve në do të jatin rezultate pozitive apo negative, në do të shfrytëzohen mundësitet objektive, apo do të kthehen ato në manierë.

Poëtët tanë, në format më të ndryshme realiste, kanë mundur të zbulojnë poezinë e revolucionit e të jetës socialistë. Në veprat më të mira të poezisë sonë, realiteti i jetës është parë drejt në sy, është marrë ashtu siç është në procesin e zhvillimit revolucionar dhe është pasqyruar me vërtetësi, pa zbukurime të kota, pa lajle e lule dhe vlerat poetike të realitetit, bukuria e jetës janë kërkuar e janë gjetur, jo në mohimin e luftës e të vështirësive, po në luftën për kapërcimin e vështirësive, në heroizmin po-



pullor, në manifestimet më tipike të realizimeve e të idealeve revolucionare. Ideal i bukurisë për poezinë tonë ka qenë revolucioni: revolucioni — shembje dhe çrrënjosje e botës së vjetër dhe e kalbësirave e njollave të saj; revolucioni — çlirim i plot dhe zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të njeriut; revolucioni — përpjekje e përgjithshme popullore për organizimin socialist të jetës dhe realizimin e lumturisë; revolucioni — realitet egzistonjës dhe perspektiv. Në veprat më të mira, janë shprehur mendimet, ndjenjat dhe aspiratat e njeriut revolucionar. Mesyt e tij është parë jeta, janë gjykuar fenomenet shoqërore, janë pasqyruar brengat e gëzimet, vuajtjet dhe heroizmat, lumturia popullore. Revolucioni është burimi kryesor i poezisë sonë dhe njeriu i revolucionit — heroi kryesor i saj.

Disa herë, duke u nisur nga të metat dhe nga vepra të dobëta, ne harrojmë atë që është më e rëndësishme, qoftë për poezinë në tërësi, qoftë edhe për poetë të vëçantë, po është fakt që poezia jonë e realizmit socialist ka njëzetë e ca vjet që ka lindur, zhvillohet e përparon dhe, poetët tanë, (natyrisht sipas shkallës së aftësive individuale) kanë krijuar vepra, pa të cilat nuk mund të kuptohen as zhvillimi i sotëm, as perspektivat. Krijimtaria jonë poetike nuk është e paktë dhe do të ishte vështirë të analizohej qoftë edhe shkurtas veprintaria e gjithë poetëve tanë, vlerat e veçanta të secilit dhe problemet që dalin prej veprave, ndaj do të mundohemi të marrim si shembull vetëm disa, që na duket se, nëpërmjet veprës së tyre, do të na ndihmonin të tregojmë, në vija të përgjithshme, zhvillimin e poezisë, individualitetet kryesore dhe problemet, që tërheqin më tepër vëmendjen në diskutimet e tanishme.

Po nisim me Petro Markon. Sadoqë ky nuk ka shkruar vjersha këto dhjetë-pesëmbëdhjetë vjetët e fundit, krijimtaria e tij poetike na ngjan se vlen të mbahet parasysh si një prej manifestimeve të para të poezisë sonë revolucionare socialiste si dhe për shkak se, në krijimtarinë poetike të ditëve tona, po vërehen prirje që përtërijnë atë mënyrë krijonjëse, që ishte karakteristike për Petro Markon në

periudhën e luftës së fundit. Për një kohë, sidomos pas viti 1940, poezia e Petro Markos, në krahasim me të kaluarën letrare të këtij shkrimtari, karakterizohet prej dy tiparesh me rëndësi: së pari, prej depërtimit të ideve revolucionare socialistë, pasurimit ideor dhe zgjerimit të dia-pazonit tematik, që merr theks proletar dhe, së dyti, prej kërkimeve të reja formale, që e largonin nga gjurmët e ndikimit të poezisë popullore e nga kërkkesat e rrepta të metrikës klasike dhe e shtynin drejt trajtave të lira paksa të shthurura të shprehjes, sidomos nën ndikimin e futurizmit, që ishte i modës në letërsinë perëndimore (shih, për shembull, «*Horizonti në kuletë*»). Kjo prirje vërehet si në konceptimin e tërësishëm të veprës edhe në stilistikën poetike, në natyrën e krijimit të figurave. Ka ndodhur në të kaluarën, siç ndodh edhe sot në shumë vende të Perëndimit e të Lindjes, që poetë dhe artistë të ndryshëm, të përpinqen të rrëfejnë «revolucionarizmin» e tyre, jo aq me temat dhe me brendinë e veprave, sa me trajtën e shthurur e manieriste, me pretekstin se kështu po revolucionarizokan artin. Të gjitha tendencat e djeshme e të sotme «avanguardiste», që shpesh quhen «moderne», e kanë hequr dhe e heqin veten për revolucionare. Te Petro Markua, ky ndikim kaloi shpejt e pa lënë gjurmë të thella. Në vepra si «*Parada e të uriturve*», «*Ushtrisë së Kuqe*» dhe «*Parada e fitimtarëve*», pa u kthyer te filimet e veta letrare, ai u largua edhe prej ndikimeve moderniste, që i gjejmë edhe në letrarë të tjera të viteve '30. Qartësia ideologjike, karakteri i përcaktuar i motiveve poetike dhe synimi që t'iu drejtohet masave të revoltuar, i dhanë poezisë së tij, gjatë luftës, një formë më realiste e më të përbajtur, dhe theksuan karakterin aktiv pozitiv të qëndrimit emocional ndaj jetës dhe luftës, nën ndikimin e poezisë revolucionare botërore (shih, për shembull, tekstet e këngëve të përshtatura).

Në poezinë tonë të viteve 1944-1960, mund të themi se vendin kryesor e ka zënë krijimtaria e Llazar Siliqit, pa nënçmuar kontributin që kanë dhënë në këtë kohë edhe Andrea Varfi, Dhimitër Shuteriqi, Aleks Çaci, Mark Gurakuqi, Luan Qafëzezi, etj., si dhe përpjekjet e para

serioze të brezit të dytë të poetëve të realizmit socialist. Krijimtaria poetike e Llazar Siliqit është shumë e gjerë. Vetë poeti, duke zgjedhur për botim krijimet e veta më të mira, u ka dhënë lexonjësve një vëllim relativisht të madh me vjersha e poema. Rruga krijonjëse e këtij poeti nuk ka qenë pa lëkundje në kërkimet artistike, po dy karakteristika kryesore të saj duket se kanë mbetur të pandryshuara dhe përbëjnë fisionominë e poezisë së tij: *karakteri politik* dhe *natyra himnizonjëse*. Konceptimi poetik politik i motiveve sublime dhe i momenteve solemne të realitetit dhe reflektimi i tyre në një mënyrë përgjithësisht të ekzaltuar, vërehet pothuajse në të gjitha krijimet e rëndësishme të Llazar Siliqit. Me një fjalë, qëndrimi emocional i poetit ndaj jetës e ndaj revolucionit është shprehje e afirmimit të këtyre të plotë dhe entuziast. Ai niset prej anëve të ndritura të tyre, duke pasqyruar, si të thuash, rezultatin pozitiv të luftës dhe jo vetë luftën, dhe merr prej jetës çastet e afirmimit më të plotë të idealeve dhe jo aq përpjekjet pér realizimin e këtyre idealeve. Tentimet e poetit pér t'iu shhangur kësaj natyre, herë duke u përpjekur të jetë sa më konkret dhe «i ditës» (cikli pér sheqerin, poema pér Lumalasin, etj.), here duke i lënë vend narracionit («Mësuesi», «Erë pranverore»), deri tani nuk kanë dhënë ndonjë rezultat pozitiv, përkundrazi, e kanë dëmtuar vlerën e krijimeve të tij. Si himnizim i jetës dhe i rinisë («Erë pranverore») dhe i heroizmit e i vetëmohimit («Mësuesi») do të kishin qenë të një vlere më të madhe ideo-artistike, sikur autori të mos kish shkarë prej vetëvetes, duke u nisur nga dëshira dhe kërkesat skolastike të kritikës standarde pér t'u dhënë veprave poetike me doemos karakter epik e pér t'i ndërtuar në mënyrë dramatike, megjithëse narracioni, në poezinë e Llazar Siliqit, rrallë herë është i drejtpërdrejtë.

Një eksperiencë interesante gjejmë në dy poemat e fundit të këtij autorit («Ringjallja» dhe «Kangë entuziasste»), sidomos në përpjekjen që të shkrijë e të gërshtetojë përgjithësimet poetike me episode, prej të cilave do të rridhnin këto përgjithësime.

Në përgjithësi, poeti, në krijimet e Llazar Siliqit, është njeri i jashtëm, që vëren, arësyeton e gjykon për jetën e për njerëzit, po nuk shkrihet me ta, saqë disa herë poezia e tij është e ftohtë, me gjithë ritmet e zhdërvje-llëta dhe vlerat e tjera formale që mund të ketë. Momen-tet poetike të realitetit dhe qëndrimet emocionale ndaj tyre nuk jepen *në vetëvetë*, si vlera të plotfuqishme, të afta të shprehin vetëveten e të ndikojnë te lexonjësit, po komentonhen, arësyetohen dhe herë-herë u humbet fres-kia poetike dhe mbyten prej eksklamacioneve, kur mun-gojnë sensacionet e gjalla e të drejtpërdrejta ngajeta, nga bota materiale, gjë që vërehet edhe në një pjesë të poezi-së sonë.

Ndërsa poetët e tjerë kanë gjetur vetëveten dhe i qëndrojnë besnikë vetëvetes, Ismail Kadareja na duket si një «fenomen» në zhvillim. Duke qenë një poet i for-muar, ai duket se është vazhdimi-sht në kërkim dhe çdo herë, — me çdo përpjekje poetike që bën, — është dhe s'është ai: është po ai talent, që ka kërkuar e ka gjetur diçka të re, që e ka plotësuar, po nuk e ka përfunduar portretin e vet, që ende nuk është shprehur plotësisht. «*Ëndërrimet*», «*Shekulli im*» dhe përbledhja poetike «*Përse mendohen këto male*», janë secila nga një fazë në krijimtarinë e poetit, etapa të ndryshme dhe intere-sante, kërkime të ndërgjegjshme, këmbëngulëse e me di-njitet artisti. Një prej sukseseve më me rëndësi të Ismail Kadaresë është se ai ka dalë «prej vetëvetes», prej asaj moshe e periudhe, kur bota i ngjante se qe stisur prej ndjenjash e mendimesh dhe ka kuptuar poezinë e mate-rialitetit të botës, poezinë e realitetit objektiv. Ndërsa në «*Ëndërrimet*» bota reale shërbente vetëm si një element, në të cilën mbështeteshin ëndërrimet e ndjenjat dhe vle-rësohej në raport me to, në krijimet e mëvonshme, ajo del e madhërishme dhe e pavarur, ndërsa ndjenjat e me-ndimet — si rrjedhime të saj. Ky rezultat është themeli i koncepteve realiste në poezi.

Në vëllimin «*Shekulli im*», që ngjalli aq diskutime të zjarra dhe thirrje aprovonjëse e mosaprovonjëse, poezia e Ismail Kadaresë, krahas guximit në trajtimin e moti-

veve, në zgjerimin e interesimeve, karakterizohet edhe prej frysës luftarake sulmonjëse me mendime të thella e të freskëta — ndonjëherë edhe të gabuara, — prej shpërthimeve të një spontaneiteti të fuqishëm poetik dhe prej figurave që përfshijnë aspekte të gjera të jetës. Në poemën «*Përse mendohen këto male*» (ndonëse pyetjes së titullit nuk i është dhënë përgjegjja e plotë) thellësia e mendimit është në pajtim me gjerësinë e pasqyrimit dhe analiza shoqërore është shkrirë me frysën patriotike.

Po ndërmjet vëllimit «Shekulli im» dhe poemës «Përse mendohen këto male» poeti pati një tërheqje prej vru-lleve poetike, u bë më i shtruar, më i menduar dhe vendlind e pasqyrimeve realiste e të figurave të forta romantiqe e zunë kërkimet për subjekte konvencionale e për simbole, siç mund të vërehet në poemat «*Lokomotiva*», «*Kinema e vjetër*» dhe «*Poema e blinduar*», në të cilat ai tenton të thellohet në mendime, duke pasur pikëmbështetje elemente jetësore me vlerë simbolike konvencionale. Këto kërkime e rezultate janë interesante, po tërheqja nga balli i përpjekjeve për një poezi realiste dhe vështirësimi i komunikimit me lexonjësit nuk mund të quhen pozitive.

Dritëro Agolli është një tjetër personalitet i poezisë sonë të sotme, natyra artistike e krijimtarisë së të cilit dallon prej gjithë poetëve të tjera. Me një stil të thjeshtë, bindës e të gjallë popullor, — rezultat i afinitetit me gjuhën, me poezinë dhe me jetën e popullit, — ai na ka dhënë krijime poetike të bukura, sidomos për fshatin, ku spikatin dy ndjenja të fuqishme: dashuria për tokën dhe dashuria për lirinë, të cilat përshkojnë pjesën më me rëndësi të krijimeve poetike të tij. Heroi lirik i poezisë së Dritëro Agollit është njeriu i thjeshtë i punës e i revolucionit, që mbart me vete gjithë dramat dhe madhështinë e historisë sonë të aférme, me një koncept të gjërë, të natyrshëm e të shëndoshë për jetën, shqiptar në fizionomi, i besueshëm dhe i dashur për lexonjësin. Lidhja me jetën popullore dhe përpjekja e vazhdueshme për të reflektuar sa më me vërtetësi botën shpirtërore të njërzve të thjeshtë të popullit e kanë shpëtuar poezinë nga

filozofimet e kota. Brendia ideo-emocionale e krijimeve poetike të tij përbahet në vetë aspektet jetësore që pas-qyrohen. Në vjershat e tij, edhe nëpërmjet një rasti të vecantë e, në dukje, të zakonshëm, krijojen përgjithësime poetike të bucura e të thella. Ai sjell në poezi jetën e gjallë dhe është poeti me «fletorkën e shënimave» në xhep, që e gjen burimin e frymëzimit në gjirin e madh të jetës së popullit, dhe sjell në letërsi mbresa të gjalla e të freskëta, ndjenja të sinqerta dhe mendime të mprehta, pa ekuvokë dhe pa stërhollime intelektuale, ndonëse do të ishte e nevojshme të ishte edhe më kërkimtar dhe më i kujdeshëm në përpunimin e vargjeve, sidomos në hartimin e poemave, të cilat, si vepra të mëdha, kanë nevojë edhe për një «individualizm» të theksuar artistik, që do t'i dallonte nga njëra-tjetra, në pajtim me brendinë ideo-emocionale të tyre.

I afërt me Dritëro Agollin nga motivet që ka trajtuar, është Vehbi Skënderi, vjershat e poemat e të cilit të tërheqin me përshtypjet e gjalla ngajeta dhe të shpien në ambiente e rrëthana jetësore reale, të zgjognë mallin për bukurinë e natyrës dhe sundohen nga një atmosferë lirike — karakteristike për krijimet e tij të frymëzuara e spontane. Motivet më të dashura për të kanë qenë motivet ngajeta e fshatit dhe motivet e Luftës nacionalçlirimtare, por, megjithëse e ka tërhequr jeta e fshatit, poezia e tij, nga ana formale, nuk është e afërt me poezinë populllore. Ai është përpjekur të përdorë me sukses formën klasike të vjershërimit, një gjuhë të përpunuar pa nuanca populllore. Edhe heroi lirik i poezisë së tij është më tepër fshatari i zbritur në qytet apo qytetari, që mendon për fshatin. Në vëllimet poetike të Vehbi Skënderit të bën përshtypje aftësia për zbulimin e momenteve poetike të realitetit dhe gjetja e motiveve interesante, të pashura në mendim e në emociione, po nuk të lë kurdoherë të njëjtën përshtypje të mirë trajtimi i këtyre motiveve. Dobësitë, mungesat dhe pakujdesitë thjesht formale, që kanë të bëjnë me kulturën e të shkruarit, shpesh të ngjalin pakënaqësi estetike.

Interesante për poezinë tonë të sotme është edhe ek-

speriencia, sado e paktë, po e veçantë e Fatos Arapit, i cilí me vëllimin «*Shtigje poetike*», aty për aty, zuri vend në poezinë tonë të realizmit socialist, si poet i sotëm me temperament shqiptar. Ai është poet i hoveve lirike, i atmosferës revolucionare shqiptare, i ngjyrave të ndezura dhe i shprehjeve të figurshme. «*Drashovica*» dhe shumë prej krijimeve të përfshira në vëllimin e përmendur, reflektojnë me fryshtësim e me mjeshtëri romantikën e luftës revolucionare, duke synuar që, nëpërmjet aspektave konkrete, të bëjë përgjithësime artistike të forta.

### III

Diskutimi i parvjetshëm pati si moto «frymën e kohës» dhe kuptimin e traditave e të novatorizmit në poezinë e sotme. Këto probleme u shtruan edhe sivjet në artikullin e Andrea Varfit, botuar në gazeten «Drita». Siç dihet, këto probleme janë shumë të gjera, të përhershme dhe aktuale, që mund të shpjegohen teorikisht, po kanë edhe anën praktike, konkrete dhe ndërhyjnë gjallërisht si në krijimtarinë e poetëve, edhe në diskutimet teorike dhe në gjykimet kritike.

Formula gjenerike «*fryma e kohës*», që ka hyrë dhe përdoret shpesh e më shpesh në kritikën e ditës, na ngjan se është e pasaktë dhe e keqpërdorur. Pse? Në radhë të parë, se nuk mund të ketë në epokën tonë një «frymë të kohës» të njëjtë për të gjithë njerëzit, pra, edhe për të gjithë shkrimtarët e artistët. Ajo që përfaqësonjësit e rrymave moderniste borgjeze quajnë «*frymë e kohës*» është e huaj për shkrimtarët realistë revolucionarë, sidomos për botëkuptimin dhe estetikën marksiste-leniniste. Edhe shkrimtarët e artistët dekadentë, nga ana e tyre, janë kundër përbajtjes që do t'i jepnim ne konceptit «*frymë e kohës*», prandaj «në mes» kanë dalë teoricienë revisionistë, që reklamojnë një «*frymë të kohës*» të përgjithshme, po malli i reklamuar është fiktiv, demagogjik e tradhëtar, se ata, në të vërtetë, synojnë të minojnë bazat ideologjike dhe estetike të realizmit socialist. Pra, termi

«frymë e kohës», siç na provon eksperienca, përdoret nga çdo grup a klasë shoqërore që të përligjë e të përgjithësojë mentalitetin, mënyrën e jetesës, shijet artistike, etj. edhe kur ato bien në kundërshtim me interesat e shoqërisë dhe luftohen prej saj. Në këtë kuptim edhe poezia, si refleks i jetës shoqërore dhe i mendimeve ekzistonjese, duke synuar t'i përshtatet «frymës së kohës», disa herë vihet në shërbim të grupeve të parëndësishme dhe dëmtion kështu vetëveten, sidomos në aspektin e vlerës edukative që duhet të ketë. Më së fundi, siç ka ndodhur në diskutimet tona, «fryma e kohës» është shtrirë edhe në metrikën e përdorur nga poetët, duke absolutizuar kështu dy-tri mënyra të shkruari, dy ose tre individualitete poetike, kurse të tjerët, ose janë quajtur anakronikë, ose u është ngjitur etiketa «ekstravagant».

Poezia jonë ka pasur dhe do të ketë frymë revolucionare komuniste dhe për këtë frymë vlen të bisedohet, kur flitet për brendinë ideologjike të veprave tona, ndërsa në aspektin estetik «fryma e kohës» shprehet për bukurinë parimet krijonjëse të realizmit socialist. Një «frymë kohe» të njëjtë për këdo dhe të pranueshme nga kushdo, pavarësisht nga botëkuptimi dhe parimet estetike që ka, nuk ka pasur ndonjëherë dhe nuk do të ketë, gjersa ekziston shoqëria me klasa.

Në jetën e popullit tonë kanë ndodhur ndryshime rrënjosore me karakter revolucionar socialist. Transformimet e mëdha politike dhe ekonomike, zhvillimi i ekonomisë dhe i kulturës populllore, hyrja e marksizëm-leinizmit në të gjitha rrembat e jetës së vendit, kanë sjellë me vete ndryshime me shumë rëndësi dhe në psikologjinë, mentalitetin dhe mënyrën e jetesës së njerëzve. Shoqëria jonë, e çliruar prej antagonizmave klasore, mbështetet në unitetin moral e politik të dy klasave mike, në bashkëpunimin e tyre, nën udhëheqjen e klasës punëtore e të partisë, për ndërtimin e socializmit e të komunizmit dhe në këtë proces zhvillimi historik, që drejtohet në mënyrë të ndërgjegjshme nga partia, gjejnë zgjidhje të gjitha kontradiktat e vjetra dhe kontradiktat e reja që lindin. Në pasqyrimin me vërtetësi të jetës së popullit kanë

rëndësi të dorës së parë dy momente kryesore me karakter ideoologjik: *momenti njohës*, prej të cilët buron frymëzimi dhe sigurohet «lënda e parë» e veprës artistike dhe *pozita* nga niset shkrimtarë kur gjykon fenomenet e jetës shoqërore. Po ndalemi më parë në këto dy momente, që të flasim më poshtë edhe për momentin e tretë: për *formën e pasqyrimit*.

Momenti njohës, për të cilin bëhet fjalë sa herë flasim për lidhjen e ngushtë të letërsisë me jetën e popullit, është një moment aktiv në veprimtarinë e shkrimtarit. Poeti i realizmit socialist niset nga fakti se në jetë ka një rrjedhë të madhe, të fuqishme, kryesore që shkon drejt të ardhmes dhe së cilës i përket e ardhmja, ka edhe korrënte të tjera, që vijnë nga e kaluara dhe, sadoqë mund të *mbahen* me kryeneçësi, do të përfshihen prej rrjedhës *kryesore* të zhvillimit historik dhe, megjithëse sot kanë vend e mund të ndikojnë, nesër do të zhduken patjetër. Po të pyesim se cila prej këtyre rrjedhave duhet të terti heq vëmendjen e poetëve tanë, përgjegjja më e qartë dhe më e saktë do të ishte vetë historia e poezisë sonë të re. Burimi kryesor i frymëzimit për poetët tanë ka qenë jeta e popullit, preokupimet e ndërtonjësve të socialistit, ndaj veprat e tyre kanë shprehur ndjenjat e menzilizmit, ndaj shpirtin e sakrificës në luftë e në punë, përbuzjen ndaj shpirtvogëlsisë mikroborgjeze dhe ndaj jetës meskine, prirjen drejt një jete kuptimplotë, poezinë e punës, dashurinë për jetën e për njerëzit, për natyrën, shqetësimet për fatet e njerëzimit dhe besimin në të ardhmen e tij.

Kërkesa e parë për të pasur një poezi me frymë revolucionare është *afirmimi* i luftës revolucionare, i realitetit socialist dhe i idealeve komuniste. Në këtë kuptim, poezia jonë është e re dhe novatore, që zbulon dhe estetizion një realitet të ri jetësor, gjë që dëshmon lidhjet shpirtërore të poetëve me luftën, punën dhe jetën e popullit. Ky afirmim, në një poezi realiste, mund të arrihet vetëm nëpërmjet pasqyrimit me vërtetësi të kontradicioneve të jetës, mbasi dihet që zhvillimi e përparimi bu-

rojnë prej luftës së të kundërtave dhe e reja kurrë nuk ka ngadhnjyer mbi të vjetrën pa luftë e pa përpjekje, sado që duket sikur ky problem nuk ka të bëjë me poezinë e, sidomos, me poezinë lirike. Pa e thjeshtëzuar çështjen, mund të themi se kjo përshtypje është e għabar, se edhe poezia, në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo të tērthortë, do të jetë shprehje e tendencave të zhvillimit shoqëror. Edhe afirmimi në poezinë lirike, që nuk paraqet ndeshje të të kundërtave, mbështetet në kuptimin dhe thelbin shoqëror tē kësaj lufte, gjë që pasqyrohet në tendenciozitetin ideor të poetit, në kuptimin që u jep ai fenomeneve shoqërore nga është frymëzuar. Në këto raste lufta e të kundërtave, edhe kur nuk shprehet, nën-kuptohet. Në vjershën «*Mëngjes votimesh*» të Dhimitër Shuteriqit, fjala vjen, kemi një pohim entuziast të një momenti politik të jetës sonë, pohim që nuk do të kup-tohej, bile, as do të ishte i nevojshëm, sikur dje tek ne e sot në botën kapitaliste të mos ndeshnim në një realitet të kundërt. Po kështu në vjershën «*Vetmia e nanës*» të Llazar Siliqit, afirmohet lufta revolucionare dhe vetë-mohimi në luftë, dhembja dhe krenaria e nënës, humbja e djaloshit partizan dhe pérjetësia e kujtimit të tij. Vjerشا pëershkohet nga një atmosferë trishtimi, që vjen duke u davaritur, gjersa mposhtet prej gazit të festët pranverore. Siç shihet në këtë rast vjersha është ngritur mbi kontrastin e gjendjeve shpirtërore e të ndjenjave të kundërtta, në ndjenja që lindin ndërmjet jetës e vdekjes, dhembjes e dashurisë, fatkeqësisë personale dhe lumturisë së përgjithshme popullore. Ndryshe nga këto poemë, «*Lokomotiva*» e Ismail Kadaresë mbështetet në kontrastin e «*fatit*», në vënjen përballë të së kaluarës militariste e të sotmes paqësore, të rrugëve të luftës agresive, që shpinin ushtarët drejt vdekjes dhe të rrugëve bregdetare, që shpien rini në gazmore në plazh. Kurse, në poemën «*Drashovica*» të Fatos Arapit, kontradikta është ndërmjet «*yjve të kuq*» dhe «*kryqeve të thyer*», luftës popullore pér liri, që afirmohet dhe luftës agresive imperialiste, që demaskohet. Edhe në trajtimin e motiveve ngajeta e sotme, afirmimi i vërtetë revolucionar është dhënë nëpërmes,

mjet pasqyrimi ose njohjes së kontradiktave e të kontrasteve shoqërore, ndonëse nuk janë të rralla rastet, kur pasqyrimi i realist revolucionar ja ka zënë vendin një poezi enfatike e pompoze stilizante, pa nerv jete e pa gjallëri ndjenje e mendimi. Ndeshja ndërmjet të resë e të vjetrës dhe fitoria e të resë mbi të vjetrën janë reale e tipike në kohën tonë. Lufta për ndërtimin e socializmit nuk është vetëm punë për ndërtim fabrikash e uzinash, po edhe një luftë e ashpër dhe e gjatë për të fituar mbi psikologjinë, mentalitetin, zakonet dhe marrëdhënjet e trashëguara nga shoqëria e vjetër. Dhe, kur flasim për afirmim të luftës revolucionare, kemi parasysh si pasqyrimin realist të saj në të gjitha dukuritë, ashtu dhe afirmimin e anës së re, përparimtare, socialiste. Nuk janë të rralla rastet në poezinë tonë të sotme, kur pasqyrimi i realist të jetës — brenda mundësive dhe veçorive artistike të poezisë — ja zë vendin një frymë enfatike e vjetër dhe e re, që u zë frymën motiveve poetike me stilizime të modës së kaluar, ose me deklarata pompoze «të sotme». Në këtë rast — qoftë në poema të manierës së dikurshme, qoftë në krijime të së ashtuquajturës «poezi e figurshme», megjithëse afirmimi është i hapur dhe i qartë, ai humbet forcën artistike emociononjëse, mbetet brenda caqeve të disa motiveve të përgjithshme, nuk depërton në të gjitha rrëmbat e momenteve poetike, është më tepër deskriptiv dhe shpesh shumë vargje nuk janë zbulim i momenteve të reja, apo i anëve të reja të motiveve poetike, po marrin karakter poetikisht të thatë komentonjës, ndonëse mund të jenë të stolisura me figura të huajtura nga poezia e dikurshme popullore. Bile, stolisja e vargjeve bëhet e domosdoshme, kur s'kemi zbulim të vërtetë dhe konceptim të plotë poetik të realitetit jetësor dhe heronjtë (kur veprat janë me heronj), mbajnë fjalime të gjata, në stilin e vjershërimit të dikurshëm kalorësiak ose poetët bëjnë një zhurmë filozofike, që të vret veshin me tonin pretendonjës dhe më zbrazësinë ideo-emocionale. Po dihet: pa zbulim emocional të realitetit, pa konceptim dhe pasqyrim emocional të tij, nuk mund të ketë *afirmim artistik* të retalitetit, nuk mund të ketë poezi. Dhe,

pastaj, që kjo poezi të jetë revolucionare, vetë qëndrimi ideo-emocional i poetit duhet të jetë i tillë.

Një çështje tjetër, që ka të bëjë me afirmimin e luftës revolucionare e të realitetit socialist, është edhe pasqyrimi realist luftarak i qëndrimit aktiv të pjesës më të përparuar të shoqërisë ndaj fenomeneve që reflektohen në vepra. Ndodh që në disa krijime poetike me karakter shoqëror e politik, poeti niset nga jeta e gjallë dhe mban qëndrim të drejtë në gjykimin e fenomenit dhe, prapë-serapë vjersha a poema nuk ka tingull revolucionar dhe nuk është pasqyrim realist i jetës, për shkak se autori i saj injoron ose nënveftëson një element me rëndësi të jetës socialist: luftën e vendosur e të ndërgjegjshme ndaj çdo gjëje të kalbur, të shëmtuar e të prapambetur. Qëndrimi i drejtë ideo-emocional i poetit ndaj fenomenit që reflekton, është gjë me rëndësi, po në qoftë se flasim për pasqyrimin realist të jetës nga pozita revolucionare socialist, atëhere ky qëndrim ideo-emocional është i pamjaftueshëm dhe, në kundërshtim me pikësynimet e autorit, mund të japë si rezultat një pasqyrim të mangët e të shtrembëruar të realitetit.

Në letërsinë e mëparshme përparimtare, ne edhe mjaftohemi me qëndrimin e revoltuar të shkrimitarit, duke u nisur prej natyrës negative të rendit të atëhershëm shoqëror dhe prej kufizimeve në botëkuptimin e poetëve, që nuk arrijnë të zbulojnë forcat e vërteta lëvizëse të shoqërisë. Në poezinë e sotme, pa nënveftësuar rëndësinë e mendimit të gjallë afirmonjës ose kritik, duke u nisur prej natyrës së rendit tonë shoqëror dhe prej botëkuptimit marksist-leninist, bëhet e domosdoshme, — në pajtim me realitetin, — që qëndrimi ideo-emocional të përfshijë luftën shoqërore, pohimin ose mohimin e ndërgjegjshëm shoqëror. Një gjë e tillë ka rëndësi të posaçme, sidomos kur pasqyrohen në vepra fenomene negative, të cilat nuk kanë të bëjnë me natyrën e rendit socialist, po janë në kundërshtim me të, ndaj edhe luftohen në mënyrë aktive e të ndërgjegjshme.

Le të marrim për shembull, vjershën «*Mjegullinë*» të Lazar Siliqit, në të cilën poeti ngrihet me ashpersi

kundër bestytnive e paragjykimeve fetare. Si pasqyrim, vjersha është e vërtetë dhe tronditëse. Me të drejtë poeti ka marrë prej jetës një rast të dhimbshëm, se vetëm në këtë mënyrë mund të tërhiqet vëmendja e njerëzve e të vizatohet me ngjyra të theksuara ftyra përbindëshe e paragjykimeve fetare. Mirëpo cila është zgjidhja? Vjersha përfundon me thirrjet tronditëse të poetit, që tingëllojnë gati fataliste. Ndryshe prej poetit, qëndrimi emocional i të cilit është i drejtë, po i mangët, vetëjeta i ka dhënë rrugë fenomenit të pasqyruar, prandaj, për të qenë deri në fund realist revolucionar, afirmimi i jetës duhet të përmbajë në themel afirmimin e luftës revolucionare kundër së keqes dhe jo pasqyrimin e së keqes në vetëvete.

Afirmimi i luftës revolucionare dhe i realitetit socialist nuk mund të kuptohet dhe as që mund të arrihet pa një shkrirje organike e unitet të plotë të realizmit me romantizmin revolucionar socialist. Kjo shkrirje nuk ka të bëjë, siç mund të duket, me ndonjë tezë teorike arbitrale, po rrjedh prej vetë natyrës së zhvillimit revolucionar të shoqërisë, prej qartësisë së perspektivës historike dhe prej botëkuptimit materialist-dialektik. Romantika është një element me rëndësi në jetën e njeriut e të njerëzimit. Pa èndërrim, pa parafytyrim të së ardhmes, pa besim në perspektivën e përpjekjeve e të luftës, pa idealizim të prirjes së përjetshme drejt të ardhmes, njeriu do të ishte një qenje fatkeqe dhe e mjerë dhe letërsia do të rrëshqiste në pozitat filozofike të skepticizmit e të cinizmit, si refleks i individualizmit borgjez. Të qëndrosh në pozita revolucionare dhe të mohosh romantizmin në jetë e në krijimtari është e pamundur dhe, në qoftë se pretendohet se është arritur diçka e tillë, kjo vështirë të jetë një pozitë e vërtetë, një realizim unik pa kontradikta ideore e artistike. Një mësim të tillë mund ta nxjerrim edhe prej eksperiencës së degradimit ideologjik të letërsisë e të artit në disa vende, nën ndikimin degjeneronjës të revizionizmit.

Në letërsinë tonë, romantika revolucionare lidhet drejtpërdrejtë me krenarinë kombëtare, me kuptimin e

drejtë të luftës kundër vështirësive, me optimizmin që buron prej vrullit revolucionar të popullit, me besimin e patundur në të ardhmen e ndritur të Atdheut e të njerëzimit, me gadishmérinë për të mbrojtur të sotmen e të ardhmen tonë, pa ngurruar para çdo sakifice. Romantika është element i vetë lëvizjes revolucionare dhe s'ka si të mos reflektohet edhe në letërsinë e revolucionit.

Karakteri i romantikës në jetë e në letërsi përcaktohet nga pozita shqërore dhe idealet e njerëzve si dhe nga formimi i tyre artistik, nga ndikimet. Në poezinë e sotme, krahas romantikës revolucionare të poeziës së Lazar Siliqit, Ismail Kadaresë, Dritëro Agollit, Fatos Arapit, etj., janë vërejtur edhe tendenca romantizante në krijime poetike të lidhura me përfytyrime të vjetëruara të jetës, me elemente patriarkale dhe të një romantizmi të ngushtë mikroborgjez, që ka gjetur fole, sidomos në poezinë me motive intime. Këto nuk kanë të bëjnë me romantizmin revolucionar të letërsisë së realizmit socialist, mbasi as keqardhja për të kaluarën, as kuptimi mikroborgjez i dashurisë nuk kanë të bëjnë me qëndrimin revolucionar ndaj jetës. Poezia idilike, që duke u shkëputur nga trualli i jetës, ka përfunduar në një krijimtari stilizantësh të varfër, është pseudoromantike dhe mund të kënaqë vëtëm shijet e njerëzve, që rrojnë ende në fillimet e shekullit, në Shqipërinë e barinjve e të lëndinave, të ngastrave të vogëla e të fshatrave të dikurshëm, që poetët shterpë të asaj kohe e idealizonin dhe e stolisnin me manushaqë e me bilbila.

Kur flasim për afirmim të luftës revolucionare dhe të realitetit socialist, krahas mbrujtjes së veprave me ide të mëdha, me ideale të larta e me ndjenja të fuqishme pozitive, kemi parasysh edhe rëndësinë e tyre si zbulime të vlerave estetike të realitetit, si depërtime të poetëve në thellësitë e jetës e të shpirtit njerëzor, kemi parasysh vepra të pasura me hollësi jetësore, me sensacione poetike.

Para se të shkruaja këto shënimë, m'u desh të këndoja përsëri «*Milosaon*» e De Radës. Një nga vlerat e mëdha estetike të kësaj vepre të pakrashueshme përmbarhet në sensacionet e shumta dhe në hollësitë poetike po

aq tē shumta e tē freskëta tē shkrira natyrshëm nē subjektin e veprës, nē fatin e heronjve dhe nē ndjenjat e mendimet e poetit, sa që ato përbëjnë vetë një nga themellet dhe mishërimet e brendisë poetike tē poemës. Në çdo këngë tē «Milosaos» nxirren nē pah një mori vlerash estetike tē botës materiale dhe lexonjësi, duke ndjekur fatin e heroit, duke depërtuar nē shpirtin njerëzor, i lidh ato me diçka që e ka parë pa vëmendje nē jetë dhe poeti ja zbulon nē trajtë poetike, duke e përqëndruar nē bukurinë e tyre, duke ja bërë tē dashura dhe, nē këtë mënyrë, e pasuron atë shpirtërisht, i delikaton ndjenjat, e ndihmon tē bëhet më i pastër, më i mirë, më njerëzor.

Po, duke theksuar këtë anë me rëndësi tē përceptimit dhe tē pasqyrimit poetik, na duket i shpejtuar dhe i njëanshëm mendimi i Dritëro Agollit, që thotë se «*Poema moderne mbështetet nē detajet*», mbasi nē një trajtim tē tillë tē çështjes nuk mbahen parasysh që hollësitë, sado tē bucura e me rëndësi, janë nē funksion tē pasqyrimit tē gjithanshëm tē jetës, plotësojnë dhe konkretizojnë brendinë poetike, janë elemente tē saj, po nuk mund tē jenë gjithshka. Le tē kujtojmë, për shembull, poemat «*Devoll, Devoll*» dhe «*Poema e udhës*», nē tē cilat gjejmë shumë hollësi poetike tē bucura e tē freskëta nga jeta, që e pasurojnë dhe e bëjnë tē besueshme brendinë poetike, i japid asaj karakter dhe gjërsi, po nuk mund tē zëvendësojnë krejt kuptimin e motiveve poetike e tē mendimeve që përshkojnë poemat. Sidoqoftë, duhet pranuar që një nga tē metat e poezisë sonë tē sotme është pikërisht mungesa e sensacioneve dhe e përshtypjeve tē freskëta nga jeta, mbivlerësimi i mendimeve tē përgjithshme, i subjekteve dhe i ndjenjave tē padetajuara, tē shkruarit me intuitë e «në përgjithësi», që janë pasoja tē drejtpërdrejta tē shkëputjes nga jeta e gjallë dhe tē lidhjeve tē dobëta shpirtërore me tē. Në ndonjë rast edhe kur motivi poetik është konkret, si te poema për Lumasin e Lazar Siliqit, realiteti shihet siç është paramenduar, pa freski dhe pa konkretësi poetike. Të shkruarit me intuitë e «në përgjithësi», pa kërkim nē jetë e në art, ka dënuar, fjala vjen, krijimtarinë poetike tē Mark Gu-

rakuqit, i cili, kohë më parë, ka hedhur një ndër hapat fillestare në zbulimin e hollësive poetike të jetës, me ciklin «*Vullnetarë*».

Prej disa diskutimeve, krijohet përshtypja se kjo e metë është e lidhur me formën klasike e popullore të vjershërimit, duke u nisur nga disa vepra të kësaj natyre, që janë të varfëra e të dobëta. Kjo përshtypje nuk është e vërtetë. Ka mjaft krijime me pretendime lirike-filozofike të shkruara në «mënyrë moderne», që janë të ngarkuara me arësyetime për filozofinë e jetës e të vdekjes, për shekullin e njëzetë (që është bërë modë të shkruhet me shifra romake), për planetin, për dashurinë e për gjithfarë gjérash, që të bien në kokë si rrahje daullesh, po nuk gjen në to as hollësi të freskëta jetësore, as mendime poetike të detajuara. Po, duke u nisur nga krijime të tilla të dobëta, që mbushin faqet e organeve të shtypit, nuk do të ishte me vend të thoshnim se e keqja përmbahet në natyrën e vargëzimit. Si në rastin e parë, edhe në të dytin, e keqja është subjektive dhe ka të bëjë me lidhjet e dobëta me jetën e popullit, me mungesat profesionale në kulturën e të shkruarit dhe (pse të mos e themi?), disa herë, edhe me talentin e kufizuar të poetëve. Prandaj edhe përfundimi i Luan Qafëzezit se «*vargu i lirë duhet konsideruar si një fenomen negativ*» apo argumentat e Andrea Varfit për ta vënë vargun e lirë në kundërshtim me natyrën e gjuhës sonë e të traditave letrare kombëtare, nuk na duken të drejta e serioze. E keqja është në moskuptimin e poeziës dhe të së vërtetës së ditur që pa zbulim nuk ka art, po ka zanat.

Si përfundim mund të nxjerim se: që të kemi poezi të kohës, është e domosdoshme që të kemi një poezi revolucionare të realizmit socialist, të lidhur me jetën, që e pasqyron jetën me realizëm, që përban romantikën e luftës revolucionare që ka për hero njeriun e përparuar të kohës sonë me profil moral komunist, që afirmon luftën revolucionare dhe realitetin socialist, që mbruhet me idetë revolucionare të kohës, që e pasqyron jetën thellë, gjerë dhe drejt. Me një fjalë, në kuptimin tonë, «poezi moderne» do të thotë poezi e realizmit socialist.

Kérkesa tjetër themelore që të kemi poezi të kohës, ka të bëjë me trajtat e shprehjes poetike, që nis prej fjalorit, sintaksës dhe stilistikës poetike, e arrin deri te format e përceptimit e të pasqyrimit. Në këtë terren, dy vjet më parë, janë zhvilluar beteja të ashpra dhe janë thënë shumë gjëra, po ende ka vend për diskutim.

Në poezinë tonë të re ka mjaft individualitete poetike. Kjo është një prej shenjave të zhvillimit të mbarë e të plotë të poesisë sonë të realizmit socialist. Individualiteti artistik në letërsinë tonë përcaktohet prej tërësisë së veçorive stilistike të shkrimtarit e prej pëlqimeve tematike të tij mbi bazën e botëkuptimit marksist-leninist e të parimeve krijonjëse të realizmit socialist. Është e natyrshme dhe e kuptueshme, që këto individualitete poetike të përcaktohen prej formimit ideo-estetik të shkrimtarëve dhe të ndikohen nga të dhënat shoqërore e psikologjike të tyre, prandaj është e përligjur dhe pozitive qenja e tyre, bile edhe qenja e grupimeve artistike në platformën e përbashkët të realizmit socialist. Kështu, për shembull, në letërsinë tonë të sotme, do të dallonim, sipas pëlqimeve dhe natyrës së realizmit artistik, poemat «Heronjtë e Vigut» e «Flladi i tectorit», «Gjeto plaku» e «Gjaku i falun», si një prirje artistike më vete nga poemat «Erë pranverore» e «Mësuesi», «Mjeku i rojes» e «Proletarët» dhe këto prej krijimeve të tilla si «Shënime përbrezin tim», «Ëndërr industriale», «Përse mendohen këto male» etj. Këto prirje poetike, të mbështetura në tradita të njobura të poesisë kombëtare e botërore, që ndikohen në lindjen e në zhvillimin e tyre edhe prej kategorive të ndryshme të lexonjësve, në vetëvete janë të gjitha të pranueshme dhe nuk do të ishte punë me mend, po të bëheshin përpjekje për t'u imponuar vetëm një përvjohje krijonjëse. Nga ana tjetër, do të ishte gabim të mendohej se veçoritë stilistike të tyre janë të dhëna njëherë e përgjithmonë, mbasi, po të nisemi nga një pozitë e tillë, praktika e deritanishme ka provuar se krijohet një rutinë e padurueshme, që e shkëput poezinë ngajeta, e lidh atë me prapambetjen, e bën modë, i jep një karakter artificial dhe, në një farë kuptimi, formalist. Nga ana tje-

tër, krahas luftës kundër anakronizmit, që është e keqja më e përhapur dhe ka dëmtuar jo vetëm formën, po edhe brendinë e poezisë sonë, në emër të «frymës së kohës», nën ndikimin e korrenteve të ndryshme moderniste, po duken aty-këtu edhe shenja të një shthurrjeje të poezisë, që herë nga paaftësia e poetëve, herë nga ndikimet e kë- qia mbi ta, rreh të nëvleftësojë vlerat estetike të të shkruarit bukur, mohon larminë e formave të krijimit, shkallmon çdo kriter vjershërimi, që e quan «robërim». Është interesante të shënojmë se rutina e shablonizmi në këtë farë poezie u krijua shpejt, mbasi në këtë mënyrë të shkruari u aktivizuan menjëherë shumë vetë, duke pandehur se talentit dhe mjeshtërisë u iku koha, u bënë *de mode*. Dhe botohen qindëra e mijëra vargje pa vlerë, që notojnë në të njëjtat ujëra, që flasin për stuhi e shkrepëtima, për gjokse poetësh e për kataklizma, që ngarkohen me figura kozmike e me rrapëllima fjalësh kakofo-nike. Kjo, gjithashtu, është rutinë, një rutinë e re, që dallohet prej asaj tjetrës, ngaqë, ndërsa ajo lidhet me koncepte që mohojnë zhvillimin, kjo ka të bëjë me mohimin e vet poetikës.

Anakronizmi në poezi, për t'u kamofluar, ngatërrohet keq e kot me traditat tonë letrare dhe këtë ngatërrim e bëjnë edhe poetë, që nuk janë anakronikë, sa herë shkruajnë artikuj për poezinë.

Bazën e anakronizmit, si dhe të shumë të këqijave të tjera në poezi, do ta gjemjë, para së gjithash, në shkëputjen e disa shkrimitarëve prej jetës, duke kuptuar me shkëputje prej jetës, së pari, mosnjohjen e gjerë e të thellë të realitetit, të transformimeve revolucionare, të ndryshimeve në mentalitetin dhe psikologjinë e njerëzve dhe, së dyti, njojjen e paktë të lexonjësve, të formimit të tij kultural, të shijeve të tij estetike aktuale, etj. Mosnjohja e gjerë dhe e thellë e kohës sjell me vete shablonizëm në brendi e në formë, parafytyrim dhe pasqyrim të jetës, duke u nisur prej modeleve letrare të së kaluarës, apo duke u përpjekur të imitojen në mënyrë të verbër vepra e autorë që kanë pasur sukses. Le të marrim, për shembull, përfytyrimin e fshatit në poezi. Sa ndryshe

ma e traktorit, ku djemtë e vajzat nuk takohen më te  
është ai prej fshatit të vërtetë, ku koriet janë kthyer e po  
kthehen në toka buke, ku këngën e bilbilit e mbyt zhur-  
«kroi» tradicional, po në punë, në shtëpinë e kulturës e  
në mbrëmjet e vallëzimit! A është poetik ky realitet? Po  
të nisemi nga jeta, ky realitet është i bukur dhe poetik,  
ndërsa po të nisemi nga modelet letrare të së kaluarës,  
nuk do të na duket i atillë dhe, ndërsa jeta do të rrje-  
dhë e vrullshme në shtratin e vet, poezia do të bëhet  
gjithnjë më anakronike dhe nga skllavërimi formal do të  
kalohet në koflikt me vetë jetën, në idealizim të së ka-  
luarës, në keqardhje pér të vjetrën që shembet, siç ndodh  
me patriarkalizmin, në nostalqji pér jetën e dikurshme  
të prapambetur e primitive, që disa herë na e reklamojn-  
në si manifestim të «karakterit kombëtar». Sot, para sy-  
ve tanë, po ndodhin ndryshime rrënjosore e të vrullsh-  
me, prandaj lind pyetja: a duhet të ndodhin ndryshime  
të tilla edhe në poezi, apo poezia bën të sajën dhe jeta të  
sajën? Dihet që nuk shkon jeta pas poeziës, po poezia pas  
jetës, prandaj edhe përpjekjet pér një kompromis midis  
mendimeve të reja dhe përshtypjeve të vjetëruara pér jet-  
ën, të realitetit të ri dhe të formave të dikurshme të  
konceptimit e të pasqyrimit poetik, nuk mund të shpien,  
veçse në anakronizëm, në zvarritje shterpore pas tradi-  
tave dhe jo në përvetësim krijonjës e zhvillim të mëtej-  
shëm të tyre.

Përmenden shpesh emrat e poetëve tanë të mëdhenj  
dhe shfaqet shqetësimi se po braktiset tradita e tyre e  
mirë. Po ç'do të thoshnim ne, sikur Naimi të mos ishte  
ai që është, po të kish ndjekur traditën e Dalip Frashë-  
rit e të bejtexhinjve të tjerë? Pse e quajmë si një prej  
meritave të mëdha të Naimit shkëputjen e tij nga poezia  
e bejtexhinjve? Po t'i qëndrojmë të njëjtit kriter logjik,  
Naimi duhej kritikuar pér këtë «sakrilegj». Traditat, ci-  
latdo qofshin, vlejnë gjithnjë në raport me kohën dhe  
me idealet tonë. Gjithnjë diçka vjetërohet e braktiset e  
diçka lind e zhvillohet dhe ndërmjet asaj që braktiset dhe  
asaj që zhvillohet, gjithnjë ka luftë, herë në mënyrë të  
hapur, sidomos në periudha kthese, herë në formë la-

tente. Arti nuk mund t'i shpëtojë kësaj dialektike të jetës.

Ana tjetër e çështjes është poezia e antenave të televizorëve dhe e ferrobetonit, e kultit të teknikës. Ndryshimet në art nuk prekin thelbin ideo-estetik të artit, as objektin e tij, që ka qenë e mbetet njeriu, as funksionet themelore të tij. Disa herë edhe ky problem trajtohet në mënyrë të njëanshme e të gabuar. Në një recension të botuar në gazeten «Drita» është shprehur mendimi se tanj u ka ikur koha qelesheve e jataganëve. Në këtë mendim që mohon të drejtën e artit të merret me të kaluarën, njëjësitet objekti i fryshtimit me këndin e të vështruarit dhe me trajtën e pasqyrimit. Dhe këtu mendojmë se nuk kemi të bëjmë vetëm me çështjen e trajtimit të motiveve historike, po me një dëshirë për të kufizuar horizontin tematik të poezisë, se, në të vërtetë, siç e provojnë edhe mjaft rezultate të poetëve tanë, mund të ndodhë që e vjetra të trajtohet në mënyrë të re dhe e reja të trajtohet në mënyrë të vjetër dhe një gjë e tillë nuk përcaktohet prej motiveve në vetëvete, po, në radhë të parë, prej vështrimit të ri revolucionar të jetës. Pikërisht këtu e ka burimin novatorizmi i poezisë sonë që konkretizohet pastaj me ato elemente artistike të domosdoshme për t'u shprehur në mënyrë poetike. Mohimi absolut i traditave ose ekzaltimi i pakontrolluar i tyre nuk mund të konsiderohen serioze dhe mund të sjellin vetëm dëm në praktikën letrare.

Si përfundim mund të themi se pa luftuar me vendosmëri rutinën në të gjitha shfaqjet e saj, nuk mund të bëhet fjalë për poezi të kohës dhe as mund të arrihet që poezia të jetë pasqyrë besnikë dhe e denjë e revolucionit tonë të madh socialist. Nga ana tjetër, lufta pa ngurrim kundër rutinës e anakronizmit mund të kryhet me sukses, vetëm nga pozitat e poezisë së realizmit socialist, që luftron njëkohësisht edhe çdo pseudomodernizëm e çdo manikrijonjëse, që do ta largonte poezinë prej popullit e prej fryshtës revolucionare.

Këto do të ishin disa probleme aktuale të poezisë e të qëndrimit ndaj saj, që janë diskutuar e do të meritonin të diskutoheshin akoma. Edhe këto shënimë një qëllim të tillë kanë pasur.

## POEMAT E PARA

(Në fillimet e letërsisë  
sonë të realizmit socialist)

### I

Edhe letërsia jonë e realizmit socialist nisi me poezinë, me vjershën e thjeshtë, me tekstet e këngëve partizane, me thurjet e bukura popullore për trimëritë e Luftës nacionalçlirimtare dhe për heronjtë e saj.

Këngët lindën nga lufta. Ato qenë këngë të reja dhe, sikurse lufta që i lindi, sillnin në letërsinë e kohës një frymë të re popullore e të partishme dhe vinin kështu gurët e parë themeltarë të letërsisë së realizmit socialist, të cilën e thirri jeta të dilte në skenë si shprehëse të idealeve revolucionare të masave punonjëse, të botëkuptimit e të vijës politike të Partisë Komuniste, si pasqyronjëse të luftës çlirimtare dhe si realizime të shijeve e të idealeve të shëndosha estetike të masave punonjëse. Lufta nacionalçlirimtare — etapë me rëndësi e revolucionit popullor, pjesëmarrja e vetëdijshme e masave në këtë luftë dhe qenja e Partisë Komuniste në udhëheqje të saj, qenë kushtet kryesore për lindjen e letërsisë së realizmit socialist në vendin tonë, letërsi që u mbështet edhe në traditën më të mirë kombëtare e botërore dhe që ishte paralajmëruar prej disa shkëndijave të mëparshme letrare të lidhura me lëvizjen punëtore e komuniste të paraluftës.

Populli, me krijimet e veta poetike, mori pjesë aktive në hedhjen e hapave të para të letësisë së re, në celjen e shtigjeve të reja ideo-tematike të saj. Kënga populllore gjatë luftës pati një përtëritje të vërtetë. Duke ruajtur

fizionominë e formuar gjatë shekujve e të lidhur me karakterin e melodive popullore, kjo këngë u pasurua me elemente të reja ideo-artistike, u bë më luftarake, më energjike, më e qartë e më e hapur në tendenciozitetin e vet klasor, mori një theks të dukshëm e të përcaktuar politik, gjeti në luftë heroin e vet të ri, — komunistin dhe partizanin. Autorë të kësaj letërsie të gjerë popullore, *krahas qindra poetësh anonimë*, janë edhe heroi komunist Memo Meto, komandanti partizan Shevqet Peçi, fshatari patriot Selim Hasani etj.

Edhe në letërsinë e shkruar, poezia e viteve të luftës, në të shumtën e herës, ka qenë e lidhur me muzikën. Shumica e vjershave të shkruara e të njoitura në atë kohë kanë qenë tekste këngësh partizane dhe, nëpërmjet melodive janë përhapur në popull dhe kanë ushtruar ndikimin e tyre edukativ dhe artistik. Ndër poetët e parë, që thurën këto këngë lufte ishin: Petro Markua, me përshtatje nga këngët e njoitura revolucionare, Fatmir Gjata, që është autor i një pjese të mirë të këngëve partizane, Andrea Varfi, etj. U shkruan edhe vjersha e poema të shkurtëra (Dhimitër Shuteriqi, Llazar Siliqi) po ato u njoën e u përhapën më vonë.

Si rezultat i këtij zhvillimi të poezisë në kohën e luftës dhe me shtimin e interesimeve poetike, të kushteve shoqërore e të mundësive të botimit, menjëherë pas çlirimit, bile, edhe pa u çliruar plotësisht Shqipëria, u shkruan poemat e para të letërsisë së realizmit socialist, të frymëzuara nga lufta e popullit, nga përbysja vendimtare e kryer nëpërmjet revolucionit popullor dhe nga manifestimet e para të jetës së lirë në Shqipërinë e re, të shkatërruar prej pushtonjësve, po të gjëzuar prej fitores, me vështrimin përpëra drejt caqeve të reja historike të ndritura nga partia.

Ky fakt spjegon edhe më mirë vazhdimësinë historike të zhvillimit të letërsisë sonë të re, vë theksin në kushtet konkrete shoqërore e politike, që e bënë realizmin socialist një *domosdo* objektive dhe shpjegon gadishmérinë e menjëherëshme të forcave tona letrare për t'ju përgjegjur kërkessave të reja të kohës, problemeve të rë-

ndësishme, që dilnin prej zhvillimit e thellimit të revolucionit popullor.

«*Epopeja e ballit kombëtar*» e Shevqet Musarajt, «*Prishtina*» e Llazar Siliqit dhe «*Ashtu Myzeqe!*» e Aleks Çaqit ishin ndër poemat e para, që krijuan atmosferën letrare në vitet e para pas çlirimt dhe, doemos, ushtruan një ndikim me rëndësi në orientimin e letërsisë sonë drejt realizmit socialist, në pajtim me revolucionin dhe me ideologjinë e me vijën e përgjithshme politike të partisë. Ato i çelën letërsisë sonë kombëtare shtigje të reja dhe e ngritën krijimtarinë e kohës së luftës në një nivel të ri më të lartë ideologjik e artistik.

## II

Krijimi i organizatës tradhëtare të Ballit Kombëtar ishte një lojë e rrezikshme e pushtonjësve fashistë dhe e klasave sundonjëse të vendit, që bashkëpunonin me ta. Populli ynë kish luftuar gjithnjë kundër pushtonjësve të huaj, forcave qeveritare dhe bejlerëve e çifligarëve, po reaksiuni politik dhe tradhëtarët e lidhur me të huajt asnjëherë nuk kishin krijuar një organizatë «të pavarur», që përfaqësonë, gjoja, interesat kombëtare, ndërsa, në të vërtetë, u shërbente të huajve, që të mbaheshin më këmbë sa më gjatë dhe u siguronte sundimin klasave shtypëse, duke përhapur në popull parulla demagogjike të çdo lloji. Kjo ishte një gjë e re në historinë tonë kombëtare dhe fashizmi u detyrua ta bënte këtë lojë, që të krijonte një «forcë politike» e cila do t'i kundërvihet Luftës nacionalçlirimtare, që po merrte karakter të gjerë popullor dhe Frontit Nacional Çlirimtar të udhëhequr nga Partia Komuniste, që po bashkonte në radhët e veta gjithë shtresat patriotike të vendit. Prandaj ishte detyrë të demaskohej Balli Kombëtar, t'i hiqej maska demagogjisë dhe të zbulohet fytyra e vërtetë antipopullore dhe antikombëtare e tij si nëpërmjet debateve politike, po në radhë të parë, nëpërmjet luftës, në fushën e së cilës provohet cilat genë qëllimet e vërteta.

Lufta demaskoi plotësisht Ballin Kombëtar dhe e ho-

dhi, siç pritej, në barrikadat e kundërtë me ato të popullit, në llogore të njëjta me ato të pushtonjësve fashistë. Kjo histori pati anën e vet dramatike, se Balli kreu shumë krimë në kurriz të popullit dhe mori në qafë shumë njerëz, po pati edhe anën komike, që mishërohej në pozitat e gënjeshtërtë të tij dhe në ndodhjen para vështirësive të pakapërcyeshme politike e ushtarake përballë Luftës nacionalçlirimtare të udhëhequr nga Partia Komuniste, që, për herë të parë në histori, e bënë të pamundur dhe e diskretituan politikën me dy faqe të klasave sundenjëse e të pushtonjësve të huaj.

Balli Kombëtar dhe ballisti shumë shpejt u bënë figura qesharake në sytë e popullit. Populli tallej me ta, i qeshte dhe i përgeshte. Kjo tallje tregonte epërsinë e plotë të popullit mbi tradhëtarët dhe klasat sundonjëse, si në sferën morale e politike, edhe në fushën e betejës. Panfletet politike dhe fejtonet, këngët satirike dhe skeçet, anekdotat gazmore dhe shprehjet proverbiale tallëse të kohës së luftës shprehën pikërisht epërsinë e masave popullore dhe mprehtësinë e tyre në gjykimin e situatave që krijuar e të personaliteteve që dilnin në skenë. Këtë mprehtësi politike masave punonjëse ua dhe Partia Komuniste. Në dokumentat e asaj kohe dhe në shkrimet e shokut Enver gjejmë shumë fshikullime ironike e sarkastike kundër Ballit Kombëtar, sidomos kundër krerëve të tij, të cilët pandehnin se do të luanin edhe kësaj radhe në kurriz të popullit, siç kishin bërë në kohën e vjetër, kur populli luftonte, ndërsa ata ziheshin e plekseshin si karavidhet në shportë për pozita e për kolltukë, gjersë të thyenin qafën bashkë me pushtonjësit fashistë.

Në një këngë popullore humoristike të kohës së luftës, jepet ky karakterizim i Ballit:

«*A e dini, o shqiptarë, — se kush është Balli Kombëtarë? — Ca katila, ca kopukë, — njerëz për lekë e për kolltukë...*»

«*Epopeja e Ballit Kombëtar*» e Shevqet Musarajt është një vepër që u krijua si një nevojë politiko-artistike e kohës mbi bazën e humorit e të satirës popullore të luftës, duke u mbështetur në karakterizimet ideologjike e

politike, që i kish bërë Partia asaj organizate tradhëtare dhe shërbue që Balli të përcillej pér në theqafje me të qeshura e me daulle, si çdo vjetërsirë tjetër. Koha e politikanëve të vjetër kish mbaruar. Kishte ardhur koha kur politikën, sikurse luftën, e bënte vetë populli, i udhëhequr nga komunistët.

Në vështrim të parë, «Epopeja e Ballit Kombëtar» duket si një poemë e thjeshtë kronologjike, në të cilën vendin kryesor e zë demaskimi politik i Ballit, po, në të vërtetë, duke i pasur këto dy karakteristika: thjeshtësinë dhe karakterin politik, ajo është një vepër shumë më e gjërë nga ç'mund të duket në të parë dhe, pikërisht se është e thjeshtë, vlerat ideo-artistike të saj janë më të mëdha, më të sigurta e më të natyrshme. Ajo është vepër e madhe e poezisë sonë, megjithëse nuk rreh të krijojë një përshtypje të tillë në mënyrë të jashtme, po i përmban vlerat në vetëvete. Me veprat artistike ndodh si me njerëzit: ato që kanë vlerë nuk kanë nevojë pér zhurmë e bujë, po janë të thjeshta dhe thjeshtësia nuk u vjen nga mungesa e mendimit dhe e meritave artistike, po nga siguria e tyre, ngaqë ato kanë gjetur shkrirje të plotë në momentet e paraqitura dhe në shprehjen e saktë të ndjenjave e të mendimeve në mënyrë të kuptueshme pér të gjithë. Nga kjo pikëpamje është me të vërtetë e mahnitshme kur dëgjon në këtë poemë me formë fare të thjeshtë e me një ndërtim të përgjithshëm pothuajse linear aq shumë zëra të ndryshëm, që përfaqësojnë kategori të veçanta shoqërore e personazhe të çdo lloji, që zgjerojnë horizontin e pasqyrimit realist të jetës, sidomos në aspektin politik dhe zbulojnë mendimet e kundërtë ose të përafërta të tyre, në pajtim me situatat konkrete në të cilat ndodhen. Në poemë ne dëgjojmë zërin e popullit e të poetit, zërin e Daj Cenit, që nuk duhet identifikuar me atë të popullit, zërin e krerëve të Ballit në fazat e ndryshme të «epopesë» së tyre, zërin e zonjave e të fallxhores, të shkrimtarëve ballistë e të «bishtprerëve» të Ballit. Në vepër kalohet nga humori në satirë, nga momentet komike në lirizëm, nga talljet në paraqitjen e aspekteve tragjike të luftës, pa i humbur asnjëherë veprës tonin e përgjithshëm hu-

moristik. Këta zëra të ndryshëm janë dhënë në mënyrë vetore dhe pavetore për të karakterizuar persona të vëçantë ose kategori të gjera shoqërore e politike, dhe marrin nuanca të ndryshme demaskonjëse ose autodemaskonjëse, në unitet të plotë me momentet e paraqitura, që edhe vetë janë shumë shprehëse e karakterizonjëse.

«Epopeja» e vërtetë e Ballit Kombëtar nis që me krijimin e kësaj organizate, por Shevqet Musaraj ka zgjedhur si fillim të poemës, jo krijimin e Ballit, po gjendjen e tij në prak të kapitullimit të Italisë fashiste. Vepra nis menjëherë, gati në mënyrë të papritur, po të përcaktuar mirë politikisht e poetikisht:

*«U mbyt gjemia — me federalë, — o burra, çpejto, —  
kush mund të dalë.*

*Paçet e fashizmit — e vinçeremos — se iku koha —  
e baba Qemos.*

*Se me avazin — glories romane, — vate dhe çorba —  
musoliniane».*

Ky moment është zgjedhur me vend për fillimin e poemës, se është i pari moment me rëndësi në «epopenë» e Ballit, që e vë atë në gjendje plotësisht për të qeshur, e tall dhe e demaskon. Ndërsa më parë do të duhej retoriqa dhe komenti për ta vënë në lojë organizatën tradhëtare, tani është vetëjeta, vetë gjendja e krijuar, që e bën atë qesharake, qoftë nëpërmjet ndërrimit të qëndrimit ndaj «mikut të djeshëm», qoftë edhe nëpërmjet ankimeve kundër tij, pretendimeve antifashiste, frikës së popullit, thirrjeve patriotike dhe orvatjeve për të mos ngelë pa pjesë në Shqipërinë e pasluftës. Thelbin e fizionomisë politike të krerëve të Ballit e përbëjnë pikërisht interesat klasore të tyre, veshjen politike — demagogjia, ndërsa anën komike të gjendjes në të cilën vihen — kontradikta ndërmjet qëllimeve të vërteta dhe fjalëve të bujshme, dredhive për të dalë nga gjendja politike e mjerueshme dhe mënyra e vjetër e nxjerrjes së gështenjave nga zjarri me duart e popullit, pa e kuptuar, që as Daj Cenit nuk ja hidhnin dot kësaj radhe.

Në formë pavetore, pra, përgjithësonjëse, hallet më të mëdha të krerëve ballistë dhe fizionomia e tyre klasore është dhënë me vargjet:

- «Do na mbulojnë — plehrat e tokës — do ngrihen këmbët — t'i bien kokës.  
— Do dalë djalli — nga fundi i dheut, — do ngrihet bujku — t'i thotë beut:  
— Ç'bëre zotrote, — bej efendi, — kur unë luftonja — për Shqipëri?  
— Pa do nxjerrë — kushdi ç'defterë! — Zjarri xehne-mit — mi ne do bjerë».

Urrejtja dhe përbuzja ndaj popullit, po edhe frika prej tij përzihet, në pjesën e parë të poemës, me shpresën se do të ndërrohej fleta, sa s'ishte vonë dhe, duke i shpëtuar urrejtes e zemërimit populor, politikanët e vjetër do të mundnin të ndronin kolltukët dhe të shpëtonin çifligjet.

Më vonë, kur politika e Ballit pëson fiasko dhe populli ynë nuk ja vë më veshin, qëndrimi i krerëve tradhëtarë merr formën e pendimit, jo për tradhëtinë e kryer, po se nuk u treguan aq energjikë në veprimtarinë shtypëse. Një ndërrim i tillë qëndrimi (nga përpjekjet përtu hequr miq të popullit në pendimin që nuk përdorën forcën, po dhëlpërinë) është dhënë në poemë, nëpërmjet fjalëve të Mitat Frashërit:

- «E humpmë kartën — për ne gjë s'mbeti, — në duar, të popullit — po bje pushteti.  
— Dhe mirë na gjeti, — se aq ment patmë, — punët si duhet — dje nuk i matmë...  
— Desh bërë Shqipëria — det e tërmët, — që t'vin në vete — ky djall millet.

Kur jepet alarmi i fundit dhe rreziku troket te dera, atëhere heronjtë komikë të Ballit Kombëtar marrin pamje tragjike dhe shohin me llahtarë që:

«Bolshevizmi — ja ku po vjen — dhe ç'gjen përparrë — shëmp e rrëmbejn, gjersa vjen vërtet koha kur populli, siç shprehet daj Ceni në fund të poemës, i fshin «plehnat me mshesë».

Këto pikëpamje klasore reaksionare krerët e Ballit Kombëtar i shfaqin ndërmjet tyre ose në formën e një monologu të brendshëm të shqetësuar. Faqe botës tregojnë një tjetër fytyrë dhe këtu poeti, pa i shtrembëuar fare pikëpamjet e qëndrimet e tyre të njoitura politike, ka zbuluar një prej anëve më qesharake të tyre, që theksohet ngaqë në mes është populli i vetëdijshëm përrugën që ka zgjedhur dhe vigjilent kundrejt pehlivanëve të politikës me dy faqe. Dhe demagogjia metamorfizon krahas ndërrimit të situatës dhe i përshtatet gjendjes së vetë Ballit. Në fillim, kur ishin shpresat se do të qëndron-te kungulli mbi ujë, Ali Këlcyrë flet me pompozitet:

«Luftë për Atdhe, — se sot Atdheu — pret shumë nga ne...»

— Ngrihi t'i biem — jezitit plak, — se Shqipëria — s'lint dot pa gjak».

Pastaj, kur taktika e heqjes së patkonjve kalit të ngordhur nuk u pi ujë dhe as «bashkimi» nën flamurin me kryq të thyer s'realizohet, krerët e Ballit, me duar të përlyera me gjak, kthehen e akuzojnë rininë dhe e bëjnë fajtore për gjithshka, në mënyrë që të shfajësohen para botës dhe të nxjerrin prej kësaj manovre të re ndonjë përfitim politik:

Se djemtë e çmendur — të vendit tënë — sofër të botës — Shqipérinë e bënë.

U ngopën pare — bijt' e pabesë — e sot Atdheut — s'ja kanë për pesë gjersa edhe vetë demagogjia humbet çdo kuptim dhe Telhai bën thirrje haptas:

Shkruam e folmë — na zu veremi, — po s'na kuptojnë — sa hakë kemi

Nashti: «t'u biem!» — Kjo është fjala — ç'nuk bëri shkrimi — ta bëjë palla.

Sic shihet, poema nuk është një tallje e lehtë dhe dosido kundër Ballit Kombëtar, po ajo, me thjeshtësinë e gjuhës së pasur e të vargut të natyrshëm popullor, zbulon thelbin klasor e politik të Ballit dhe trajtat që mori demagogjia e tij e neveritshmë për të mashtruar masat punonjëse dhe për të dalë në krye duke shfrytëzuar situatat, që i dukeshin të favorshme. Bile, në poemë,

nuk kanë gjetur vend as shumë elemente groteske të qëndrimit të ballistëve, siç qenë grabitjet ordinere, etj., që ruhen ende në gojdhënët e në kujtimet e fshatarësës së sonë dhe do të qenë lakuar prej ndonjë humoristi të lehtë. Shevjet Musaraj, duke qenë i kursyer edhe në ndërhyrjet tallëse të autorit, ka arritur që ta diskreditojë Ballin Kombetar, duke na përshkruar në mënyrë qesharake momentet kryesore komike të «epopesë» së tij. Këto momente komike pararendin deklaratat demagogjike, që përmendëm më lartë ose vijnë fill pas tyre. Kështu, për shembull, pas përpjekjes së parë të madhe demagogjike me të cilën ndeshim në fillim të poemës, shohim «trimat e Ballit» që marrin malin për të luftuar.

*Pa kur t'i shohësh — derven' dervenë — në vënt të pushkës — gota dhe enë.*

— *Jaka të ngrira, — bastun, ombrella, — pantofla, gante, — pixham, kapela.*

— *Do bëjmë luftë, — de more de, — si lum ti, popull, — mezi na ke.*

Këto momente, që shprehin në mënyrë ekspressive karakterin qesharak — në kuptimin tonë, popullor, — të «epopesë» së Ballit, ndjekin rendin kronologjik të «evenimenteve» në jetën politike të organizatës së tradhëtisë. Siç mund të kuptohet prej vetë «arratisjes» në male, do të pritej pas saj edhe një skenë tjetër po aq qesharake, kur «heronjtë» do të kthehen prapë në qytete. Dhe poeti tallet:

«*C'po afron vjeshta — s'frym më zefir: — Kthehen lejlekët — për në Misir.*

— *Kthehen ballistët — prap në qytet, —jeta në male — s'ka më lezet, — ndërsa zonjat e tyre qahen, duke na bërë neve të qeshim:*

— *Qahen madamat: — Ky mal' i shkretë, — ibret na i bëri — burrat e djemtë.*

— *Pa shiko, motër, — mos hapësh fjalë, — se dhe që kthyen — janë ilegalë.*

Shpejt vjen koha kur këta «ilegalë», pasi ka rënë perdja e dhëpërisë politike, vihen në gjendje tjetër qe-

sharake, kur bëjnë deklarata të bujshme atdhetarie, ndërsa te dera i ruajnë felgendarët gjermanë:

— Në prak të derës — gjerman për roje, — flet bir i botës — pa pikë droje:

— Ne jemi forca — thjesht kombëtare — të huaj nuk duam — në tokë shqiptare.

Po shpejt bien pendët. Lufta nacionalçlirimtare, duke goditur për vdekje pushtonjësit e tradhëtarët, i vë ata në një pozitë edhe më komike, mbasi tani, pasi janë zbrazur gjithë fishekët, nuk pi më ujë demagogjia, prandaj këndezët e Ballit bëhen pula:

— Një kupë verë, — garson, në dac! — Sot më të lultur — dje me kërbaç.

Dhe grindja hyn edhe në familjet e tyre:

— Ç'bëni ju, burrat? — U humptë vula! — Harram i paçi — byrekë e pula.

— Lena, të thashë, — për kokën tënde, — ata po vinë... — Ti na shet mende...

Të kësaj natyre komike janë edhe momente të tjera më pak të rëndësishme të «epopesë», siç është rasti me fallxhoren, kur «madamat» duan të parashohin fatin, ose kur ballisti i dikurshëm lëpihet e përgjërohet për të marrë një deklaratë mirësjelljeje, duke mallëkuar Ballin, i «penduar» për rrugën që ka ndjekur, etj.

Fjalët e krerëve të Ballit, sidomos kur janë dhënë në formë pavetore, shpesh kalojnë vetvetiu në vlerësimin objektiv të situatave dhe, fare pa u ndier, del në plan të parë autori me gjykimet e veta ose shprehët, po në mënyrë pavetore, mendimi i popullit, qëndrimi i tij ndaj fjalëve të Ballit, herë duke u ruajtur toni i mëparshëm i vargjeve, herë duke u dhënë këtyre tonalitete të reja poetike, që u kundërvihen të parave, siç ndodh, për she mbull, në këto vargje:

— Do bëjmë luftë, — de more de, — si lum ti, popull, — mezi na ke...

— Do bëjmë luftë, — do tunden malet... — Dhe fshati qeshet — dhe bota tallet.

— Dhe vendi pyet: — Ç'vapor i solli? — Ku ish gjer dje — kjo farë sokoli? ..

Në strofën e parë humori përbahet në vetë fjalët e krerëve të Ballit, sado që «de more de», megjithëse thuhet prej tyre, duket si një parantezë e mendimeve të autorit, kurse në dy strofat e tjera kalohet menjëherë në vlerësimin popullor të parullave demagogjike të tyre. Këto kalime disa herë nuk ruajnë karakterin e përgjithshëm humoristik të veprës, po marrin nota lirike e dramatike, pa rënë në kundërshtim me platformën ideo-artistike të veprës, po duke e plotësuar atë. Nëpërmjet kalimeve të tilla poeti ka mundur t'i kundërvejë Ballit Kombëtar jo vetëm gjykimin popullor, po edhe luftën popullore, e cila, megjithëse nuk i kushtohen aq shumë vargje për paraqitjen e drejtpërdrejtë, krijon gjithë atmosferën e veprës dhe është e përgjithshme, kurse «epopeja e Ballit» shtjellohet gjithnjë në raport me të. — Megjithkëtë — dhe kjo është nga vlerat kryesore ideo-artistike të poemës, — në mjaft raste autori ka ndjerë nevojën edhe për një paraqitje të drejtpërdrejtë të luftës së popullit e të masakrave të forcave fashiste e balliste. Pikërisht në këto raste vargjet marrin ngjyra lirike e tragjike. Ja dy shembuj:

— Pëllëmbë e gjak — andej matanë, — luftojnë e s'tunden — bijt' partizanë...

— As bukë, as ujë, — as rreckë veshur, — këpucët çqyer, — po armët ngjeshur.

— Nga lufta kthehen — shkëmbinjsh debojë, — me gaz në buzë — me këngë në gojë...

Ose:

— Me thikë mi popull, — mi foshnja e gra, — çndërim, masakër, — terror, hata! ..

— Ja dhe qytetet — u mbushnë gjak, — pa klithmë e drithmë — nuk mbeti prak...

— Po trimat s'tunden! — Det e tërmët, — në kokë t'armiqve — grushti kërcet...

Përveç fjalëve të Ballit, pëershkrimit të situatave komike dhe karakterizimeve të tjera demaskonjëse ose autodemaskonjëse, qëndrimi politik ndaj Ballit Kombëtar në poemë është dhënë edhe nëpërmjet ndërhyrjeve, kundërshtimeve e polemikave të vetë poetit, qëndrimeve të

popullit e të partizanëve dhe figurës e fjalëve të daj Cenit, që zë vend të veçantë në vepër.

Fjala e poetit përdoret sidomos për karakterizimin e përgjithshëm politik të përbërjes e të qëndrimeve të Ballit Kombëtar dhe, qoftë nga mënyra e shprehjes, qoftë nga argumentet që trajton, është më e ngritur, se vlerësimet e tjera, është mishërim i fjalës dhe i qëndrimit të vetë Partisë Komuniste. Duke karakterizuar Ballin pas kapitullimit të Italisë fashiste, poeti jep këtë vlerësim të përbërjes e të taktikës së tij:

— *Ca avokatë, — ca profesorë, — gjithë po na dalin — heronj... therorë!*

— *Të gjith' të pushkës, — të gjith' të malit — nashi ti që i ranë — patkonjtë kalit.*

Ose, duke ju drejtuar shkrimitarëve të Ballit:

— *Dale, bre çuna, — se s'ishit ju — ata që e shpunë*

— *gjakun në gju.*

Ndërsa, për të karakterizuar propagandën antikomunistë të të gjitha forcave reaksionare, jepet ky vlerësim konçiz e i saktë:

— *Kor i kurdisur — njësoj kudo — që nga Regjencë — në Gestapo...*

Në poemë ~~parakalojnë~~ shumë syfete të Ballit Kombëtar, persona historikë si Mitat Frashëri, Ali Këlcyra, Abaz Ermeni, Hasan Dost, etj., po edhe figura të trilluara të paraqitura pa emër e, disa herë si portrete kolektive si: ballisti, që kërkon një gotë verë, zonjat e krerëve të Ballit, etj. Këto figura, megjithëse theksi është vënë jo në diskreditimin e tyre, po në demaskimin politik të organizatës tradhëtare që përfaqësojnë, pra, janë marrë në raporte të përcaktuara e jo në mënyrë të gjith-anshme, prapë, aty-këtu, kanë edhe ndonjë karakterizim personal të jashtëm ose biografik qesharak: Mitat Frashëri «me jak të ngrirë — prej diplomati», Hasan Dost, që mezi ministër vanë dhe e vunë, Abaz Ermenji «trim që vjen nga malii» etj.

Përballë këtyre syfeteve janë vënë populli, partizanët, kamerieri, fallxhorja e, në mënyrë të veçantë, daj Ceni, i vetmi personazh pozitiv i veprës.

Eshtë thënë se daj Ceni përfaqëson popullin në vepër. Ky përcaktim nuk eshtë aq i vërtetë e i drejtë, mësasi, siç e kemi përmendur, populli dhe qëndrimi popullor në poemë eshtë dhënë në mënyrë shumë të gjerë. Bile, ka raste, kur autori, krahas daj Cenit, e ka paraqitur në mënyrë të qartë qëndrimin popullor, duke bërë dallimin për të cilin flasim:

— *Dhe fshati qeshet — dhe bota tallet...*

— *Dhe vendi pyet: — Ç'vapor i solli? — Ku ish gjer dje — kjo farë sokoli?*

Fill pas këtij qëndrimi të përgjithshëm popullor, poeti i drejtohet personazhit të vet:

— *Ç'thua ti, daj Ceni? — S'di gja, o vlla! — M'babet janë bullica — n'tevdil hava.*

Po në këtë mënyrë eshtë dhënë edhe qëndrimi i partizanëve.

— *Pa dale, shokë, — dëgjohet zhurmë, — ku vete vallë — ky vark, kjo turmë?*

— *Na qenka Balli! — Dale, pa dale, — e ç'kërkon Balli — kaq vonë në male?...*

Po t'u shtojmë këtyre edhe qëndrimet e autorit dhe përshkrimet në vepër të qëndresës popullore ose thënjet për të nga vetë kërret e Ballit, del më se e qartë që identifikimi i daj Cenit me popullin nuk eshtë me vend.

Po ç'është daj Ceni, ç'përfaqëson ai?

Daj Ceni si personazh eshtë konceptuar dhe realizuar në formën e njohur të personazheve të folklorit, që u kundërvihen të pasurve e të fuqishmëve me zgjuarsinë e tyre natyrore dhe me aftësinë për të vënë ata në lojë. Ai eshtë njeri i popullit, fshatar i varfër, që ka instinktin e klasës, përvojën e hidhur të jetës dhe, nga vetë lufta, po fiton edhe ndërgjegjen politike. Në disa raste, mbetesh me përshtypjen e fortë, se poeti e ka futur daj Cenin e pashkollë në poemë, që t'i kundërvihet plotësisht kaporionëve ballistë dhe për të theksuar se e vërteta e Luftës nacionalçlirimtare dhe e Partisë kishin depërtuar deri në shtresat më të prapambetura të popullisë, të cilat nuk donin më të nxirrnin gështenjat nga zjarrri për politikanët e njëqind flamurëve e për klasat su-

ndonjëse. Nga pikëpamja ideore, fjalët e daj Cenit, siç e kemi vënë re, janë vetëm një aspekt i qëndrimit ndaj Ballit, e plotësojnë këtë qëndrim, kurse, nga pikëpamja artistike, ai është përdorur me qëllim që t'u qëndrojë përballë politikanëve të njojur e me pretendime, duke i vënë në lojë e, në këtë mënyrë, me komentet e veta të shtojë humorin e veprës e të ngjallë te lexonjësi kënaqësinë që provojmë gjithnjë kur ndeshemi me persona-zhe të kësaj natyre në përrallat popullore apo në veprat e letërsisë së shkruar. Komentet e daj Cenit, në pajtim me këtë natyrë të përgjithshme të tij, nuk janë gjë e re për veprën. Ato, zakonisht, janë përsëritje të karakterizimeve që i jepen Ballit nga autorë, po në një mënyrë të veçantë, me psikologjinë, gjuhën dhe humorin karakteristik fshatarak. Ja dy shembuj:

Autori:

— *Na ngordhi kali, — i ranë thonjt, — ç'po vrapon Balli — t'i heqë patkonjt...*

Pas tij daj Ceni:

— *E bane luftën — me pulastrena — tash duen dhe frenat...*

Ose:

— *Të gjithë të pushkës, — të gjithë të malit, — nash-ti që i ranë — potkojtë kalit...*  
thotë autorë, kurse daj Ceni:

— *Sa shpejt, bre burra, — kthyet nga Qabeja? — Na dogjëm duart, — ju vrap n'gështeja...*

Në pjesën e dytë të poemës, ku situata ndërlidonitet dhe problematika e veprës merr karakterin e një debatë të hollë politik, daj Ceni me të drejtë është mënjanuar nga autorë, po kjo nuk do të thotë se në këtë pjesë s'është paraqitur qëndrimi popullor ndaj manovrave, demagogjisë dhe masakrave të Ballit.

Në pjesën e tretë, daj Ceni del përsëri në skenë, si një plotësim i nevojshëm i atmosferës që krijohet dhe poeti, duke i lënë atij të drejtën e fjalës së fundit, sikur thekson edhe më mirë mendimin e shprehur se:

— *Sot dhe foshnja — të sjell vërdallë — t'i njeh nga rrënjet — dhëmb' e dhëmballë...*

Kështu, me figurën e daj Cenit, na është dhënë zgjimi politik edhe i shtresave më të thella të popullit, si një fitore me rëndësi e revolucionit dhe e udhëheqjes së tij — Partisë. Nga kjo pikëpamje, megjithëse mendimet e daj Cenit janë një përsëritje në mënyrë popullore e gjykimeve të mëparshme, figura e tij nuk është humbet rëndësinë dhe mbetet e freskët dhe e dashur deri në fund të poemës.

Edhe nga ana formale, daj Ceni nuk dallon shumë prej tërësisë së veprës, e cila është shkruar fund e krye me një gjuhë të thjeshtë e të pasur popullore, plot shprehje proverbiale e të thëna të huajtura nga folklori, me një sintaksë poetike të thjeshtë dhe të sigurt popullore, të afta për të transmetuar predispozitat shpirtërore dhe humorin e gjallë të masave të gjera. Ndryshimi i vetëm është, se ndërsa autori përdor arsenalin e frazeologjisë popullore të Labërisë dhe, herë-herë, stil i tij bëhet edhe intelektual, daj Ceni mbështetet në frazeologjinë e krahanës së Tiranës dhe qëndrimi i tij gjithnjë ruan natyrën fshatarake. Edhe fakti që poeti e ka marrë personazhin e vet nga fshatrat e Tiranës, ku prapambetja ka qenë më e theksuar, nuk është pa vlerë e pa kuptim.

«Epopeja e Ballit Kombëtar» është e lidhur me ngjarje të caktuara historike, bile edhe me persona të njohur historikë, që, sikurse vetë Balli, kanë dalë me kohë nga skena e historisë që kur populli i fshiu plehërat me fshe-së, po ajo e ruan edhe sot freskinë poetike e politike, si një dokument artistik me vlerë i asaj kohe, që, duke pasur karakter konkret e të përcaktuar, është edhe një përgjithësim artistik i diskreditimit të politikës me dy faqe. Ajo, duke qenë ndër veprat e para të letërsisë së të realizmit socialist, mbetet edhe sot një nga veprat kryesore të kësaj letërsie.

### III

Ndërsa Shevqet Musaraj, në fund të vitit 1944, shkroi epopenë komike të Ballit Kombëtar, Llazar Siliqi, dy vjet më pas, shkruan poemën «Prishtina», që i kushtohet epo-

pesë heroike të popullit dhe sakrificave të tij për të fituar lirinë. Në poemë, nëpërmjet reflektimit të kujtimeve të dhimbshme e krenare të vuajtjeve e të qëndresës në kam-pin e përqëndrimit nazist dhe të evokimit të luftës në fillim të veprës, janë trajtuar të shkrirë me njëri-tjetrin motivet e krenarisë revolucionare, të urrejtjes kundër barbarëve fashistë, motivi i dashurisë për Partinë e për shokun, i gjelimit të fitores dhe i luftës antiimperialiste për paqe.

«*Shkëlqimi i diellit tonë — po i verbon*» — me këtë pohim të qetë, të shkurtër, që duket si një mendimi i shkëputur, po që është një përfundim i gjithë motiveve të trajtuar, nis poema dhe prej këtij pohimi gati të ftohtë merr hov vala e frymëzimit të poetit, që mishërohet në një prej krijimeve poetike më spontane e më të gjalla të poezisë së Lazar Siliqit, i cili, kur ka shkruar veprën, që të mos i vinte fre dufit të papërbajtur të ndjenjave të fuqishme, duket sikur ka ndalur edhe frymëmarrjen, gjë që ndodh edhe me lexonjësin kur i vihet leximit të poemës. Në një ndërtim të harmonishëm, logjikisht e historikisht të përligjur, që bie në sy më mirë në variantin e përpunuar të veprës (shih: «*Kangët nuk mbeten kurë të pakëndue*»), tri këngët e poemës: kënga e luftës, kënga e «dhimbjes krenare» dhe kënga e fitores, ndonëse poema nuk ka as natyrën as pretendimin e paraqites epike të Luftës nacionalçlirimtare, na japin një përfytyrim konkret e të përgjithësuar të heroizmit e të sakrificave që u desh të bëheshin për të arritur fitoren mbi fashizmin dhe të rolit historik të Partisë Komuniste, që udhëhoqi me trimëri e zgjuarësi luftën revolucionare të popullit, duke fituar dashurinë dhe admirimin e tij, duke u bërë ndërgjegjja revolucionare e luftëtarëve të saj revolucionarë.

Në vitet e para të pasluftës së dytë botërore imperialistët amerikanë dhe anglezë ndërmorën shumë veprime dhe bënë shumë zhurmë shurdhonjëse luftënxitëse. Ata, bashkë me forcat reaksionare e shoviniste të Greqisë e të Italisë, bënë shumë shantazhe e provokacione kundër vendit tonë, duke shpifur kundër Luftës nacionalçlirimtare

dhe kundër realitetit të ri shqiptar. Ata nuk e pëlqenin dhe nuk e duronin Shqipërinë e Lirë, që kish nisur rru-gën e vet socialiste. Shkëlqimi i diellit tonë po i verbon-te, prandaj vërvshëllenin si gjarpinjtë, rrëmonin si hijenat «për t'ngjall' kufomat — që popujt groposën» dhe kapi-tali ngrinte prapë dorën «që gjak po kullon». Përballë tyre poeti vë «duert puntore e fshatare — dy gremça të hekurt — si dana, — ja këpusin damarët», vë «fushat, qytetet, — e lumenj't e brigjet, — e kodrat e malet» të flasin dhe të tregojnë të vërtetën e madhërishme të luftës sonë, duke vënë kështu përballë shantazheve, shpifjeve e provokacioneve, heroizmin e popullit, që prapë mund të përsëritez po qe se dikush do të zgjatte duart mbi Shqi-përinë. Dhe, i revoltuar prej mohimit, shpërthen:

«Po t'ngrihej — sot zani i të vramve, — njëzetetet-mijesh — një kor i stuhishëm, — nën kambë do të dri-dhej gjithë dhei — dhe britma shpërthyese nga gjokset e çjerrun — ku, vallë, s'do dëgjohej? ..

... Po t'ngjitej sot flaka — e shpijave... — n'pafund do t'naltohej, — krejt qiellin do t'digje... — dhe flaka e zjarrit — do ngrohte — do ndizte ndër deje: — urej-tjen...»

Kjo është njëra anë e luftës — barbarizmi fashist. Ana tjetër është lufta popullore dhe heroizmi në luftë, që, megjithëse në themel të veprës janë vënë elementet dramatike të jetës në kampin e përqëndrimit, zënë vendin kryesor në të dhe i jatin tonin e përgjithshëm optimist, luftarak e revolucionar poemës. Tani, kur sjellim ndër mend shumë e shumë krijime të shkrimitarëve re-visionistë për këtë temë, me të cilat ata diskreditojnë pa turp luftën antifashiste të popujve, përdhosin figurën e lavdishme të heronjve dhe ngrenë në piedestal meskinitetin kundërrrevolucionar, kjo anë e poemës së hershme të Lazar Siliqit sikur freskohet e përtërihet nga koha dhe merr kuptimin e një shembulli në trajtimin e temës së luftës revolucionare në letërsinë e realizmit socialist.

Mbi sakrificat e dhembjet në poemë ngrihen me fu-qinë e një simboli të gjallë figurat madhështore të heronjve të thjeshtë komunistë:

— Dëgjoni Perlatin, — po thërret: — Ende jemi gjallë! — N'sa toka e qelli në zjarr jan'tue u kallë! — Dhe n'shekuj kto fjalë — do t'ushtojnë: — Ende jemi gjallë!

Kjo vlerë e madhe ideore e poemës bie në sy akoma më mirë në këngën e dytë, që i kushtohet kampit të përqëndrimit, ku, nga një anë, elementet dramatike e tragjike bëhen më të theksuara e, nga ana tjetër, mundësitet e kundërshtimit e të luftës aktive janë shumë të kufizuara. Herroizmi këtu merr tjetër trajtë, po nuk e humbet kuptimin, gjersa është shprehje e veticë të larta moralo-politike dhe fryshtohet e udhëhiqet nga ideale të mëdha revolucionare, është shprehje e dashurisë për liri, e urrejtjes për pushtonjësit e kriminelët fashistë, gjersa mban gjallë optimizmin revolucionar dhe besimin në fitoren, gjersa ruan e zbulon në mënyrë lapidare dinjitetin e luftëtarit revolucionar.

Kënga e parë e poemës ka dinamizmin dhe ritmin e shpejtë të një polemike lirike-politike dhe është shfrim i dufit të zemërimit të poetit. Ajo, për këtë arësy, ka karakter retorik, gjë që shquan edhe në tingëllimin e përgjithshëm të veprës. Kënga e dytë, ndryshe nga e para, nis me një ndalesë të menjëherëshme:

«Prishtinë!» — ky është vargu i parë i kësaj kënge, që të lë përshtypjen se poeti ndalon në fjalën që ka zënë në gojë siç do të ndalonim para portave të kampit të përqëndrimit, i pushtuar prej kujtimeve personale, prej dhimbjes pér shokët e rënë, siç ndal njeriu para një brengë të madhe, jo se nuk ka ç'të thotë pér të, po se ka shumë gjëra që i rëndojnë në shpirt e në mendje, gjëra që, edhe pa i thënë, e tronditit me dramacitetin e tyre të theksuar. Dhe, pas kësaj ndalese dramatike, hyjmë edhe ne në kampin e përqëndrimit të Prishtinës të rrënqethur kur, nëpërmjet vargjeve, shohim luftëtarët e internuar:

«Të zbetë, — të ndytë, — të smutë, — me kokat e qethuna, — në dorë me tasa — të gjetun ndër plehna, — të ndryshkun, — mbrena lang neverie».

Drama e tyre është drama historike e gjithë popullit, e gjithë popujve të pushtuar prej fashizmit, është drama e luftëtarit, që e kanë shkëputur nga llogoret e luf-

tës aktive, që e kanë rrrethuar telat me gjemba, që perkushtohet, pra, një dramë e madhe e luftëtarit të vetëdijshëm dhe jo e meskinit, që mendon për lëkurën e vet. Kjo dramë merr theks rrënqethës tragjik, kur i internuari mendon me maraz, që është i detyruar të punojë për armiqjtë e tij, kundër dëshirave dhe idealeve të veta:

«*Dhe çelim llogore, — ku kokën do mbrojë xhelati!*  
— *Dhe mbajmë municione — që vleznit tonë do vrashin!* — *Dhe çelim, — me duert tona, — varret e shokëve. . .*

Autorë të këtyre krimeve të tmerrshme çnjerëzore janë nazistët gjermanë, të cilët, të gatuar prej militarizmit prusian dhe prej ideologjisë kriminale të Hitlerit, në veprën e tyre barbare kalojnë deri në sadizëm të urejtshëm e të neveritshëm, që në poemë është reflektuar me forcë të veçantë dhe përbën një prej vlerave ideo-emocionale më me rëndësi të saj. Në vargjet e poemës ne shohim qartë tipin e kriminelit sadist:

«*Me gjak të stërpikun — ndër rrobe, — stërpik në fytyrë, — me duer që gjak u kullojnë!* — *Dhe sytë — e motrave tona lotojnë. . . — Me dhambë shkerbeshë, — që zbardhin n'errsine, — me sytë e përgjakun, — xhelati shtrin duert — dhe qesh! . .»*

Përpara këtyre valëve të tërbuara të egërsisë fashiste dhe valëve të reja të etheve luftënxitëse të imperializmit, poeti sjell ndër mend shokët e rënë dhe, nëpërmjet reflektimit të ndjenjave e kujtimeve personale, me të cilat nis kënga e dytë, bëhet zëdhënës i të vuajturve, të persekuarve, i heronje:

«*Do ngrihem po unë për juve: — do thrras për njat gjakun e kuq, — për vuejtjet — e tmerrin — e vdekjen — do flas. . .*»

Me gjithë këto, poema nuk është vajtim. Vuajtja dhe dhimbja nuk sundojnë asnjëherë. Mbi to ngrihen valët e zemërimit, vetëdija e luftëtarit, stoicizmi i njerëzve që dinë pse luftojnë dhe pse vdesin, prandaj edhe lexonjësi nuk dëshpërohet, po revoltohet, frymëzohet për akte trimërie e qëndruese burrërore, gatitet si luftëtar i mëkuar me urretje të thellë kundër imperializmit dhe pjellës së tij — fashizmit gjerman. Në poemë mbi dhem-

bjen shkëlqen urejtja, mbi keqardhjen meskine — da-shuria luftarake, mbi lotët — krenaria dhe mbi vuajtjen — heroizmi revolucionar, që i japid tonin veprës dhe e bëjnë më militante.

*Ndër stalla... — të rrasun t'gjithë njani me tjetrin... — të lodhun, — të lagun — t'untuem...*

*«Në dhomë njerëz të shuem? — Jo! — Një depo me zjarr e barot! — Se zemrat — na ndizen plot flakë e urejtje — nga zjarri që n'gjoksa na vlon!»*

Ndërsa në këngën e parë të poemës heroizmi jepet nëpërmjet reflektimit të luftës revolucionare aktive, sulmeve partizane, qëndresës me armë në dorë, shpërthimi mit të ndjenjave luftarake edhe përpara vdekjes me bindjen se «*dritën që lind nga gjaku i dëshmorëve, s'do mundet njeri me e mohue*», në këngën e dytë dhe të tretën manifestimet e heroizmit masiv (poema nuk ka personazhe) janë të një natyre tjetër, më të brendshme, më të thella, dhe më pak ekspressive, po jo më pak sublime e tronditëse, jo më pak edukonjëse.

*«Me ditë — me javë — me muej — e pritëm — me zemër të fortë — na vdekjen»*, një vdekje të sigurt, që edhe po të mos vinte nga plumbi, do të vinte ngadalë prej vuajtjes, lodhjes e urisë. Qëndresa para një vdekjeje të tillë është gjithashtu heroizëm, një heroizëm pa bujë, mbase edhe jo aq aktiv, po që të mbush me frymëzim dhe me krenari për njeriun e revolucionit, një heroizëm në të cilin shfaqen vetitë e larta morale, dëshira për të luftuar dhe dashuria për jetën, një dashuri tronditëse, po jo zvarranike, se kur vjen çasti i fundit, ata që kanë ditur të jetojnë si revolucionarë, dinë edhe të vdesin më këmbë. Poeti u këndon pikërisht heronjve të tillë:  
*«... që vdesin me zemrën në dorë — si trimat me pushkë në dorë, — që shohin në varrin e tyre — agimin e ditës së re, — që rrezet lëshon sot mbi ne».*

Burimin e kësaj qëndrese heroike poeti e ka gjetur jo vetëm në vetitë morale të të internuarve, në forcën shpirtërore të tyre, po edhe në lidhjen e episodit të kampit të përqëndrimit me tërësinë e Luftës nacionalçlirimtare, e cila sjell nga larg jehonën e fitoreve dhe dritën

e agimit që po ngadhnjen mbi natën fashiste. Këto të internuarit nuk i lexojnë në komunikatat e qarkorëve të Partisë dhe nuk i dëgjojnë në bisedat e komisarëve politik:

«*Por hapin — e ushtarit të kuq të Stalinit, — që afrohej, — por krismën e pushkve — t'Enverit — dëgjojshim, — kur «tigrat» na kqyrshin — përherë ma me mni...»* Prandaj: «*Tortura e vuejtja e vdekja — s'na lodh — s'na dëshpron — nuk na then».*

Kënga e tretë e poemës, duke ekzaltuar qëndresën, është kryesishët këngë e fitores. Toni i saj është optimist dhe i gjëzueshëm si vetë afrimi i çlirimt të shumëpritur. Vargjet, që në dy këngët e para qenë të mbrujtura me dhembje e me zemërim, tanë bëhen të hareshme e plot drithë. Poeti ekzaltohet. Në këtë këngë tingëllon i fuqishëm motivi i Partisë. Këto vargje janë plot forcë dhe vërtetësi ndjenje dhe, për vendin që zënë në poemë, janë ndër vargjet më të bukurat të Lazar Siliqit.

«*Parti! — E shtrenjtë Parti! Sa shpresë e guxim — edhe zjarr — na ngjalle — na ndezë — në gjii!*..

...*Rrethue — nga telat me gjemba — të kampit t'mallkuem, — që zemrën na shpojnë, — larg vatrës — larg shokësh, — ti nanë edhe motër — ti vlla edhe shok — edhe e dashun — Parti!*»

Entuziazmi luftarak i këngës së fundit të poemës nuk është i papërgatitur dhe i papritur. Ai është vërtetë një shpërthim, po elemente të tij gjemjë që në vargjet e para të veprës dhe, në qoftë se në fund na lënë përshtypje më të madhe, kjo do të thotë se poeti ka arritur të na japë një vepër, që vjen gjithnjë duke u ngritur, gjersa arrin në një shpërthim entuziast, që përfundon me vargjet festive, që mbyllin poemën.

«*Prishtina*» është e para vepër e rëndësishme poetike e Lazar Siliqit, që pak kishte botuar para saj dhe ndër të parat poema me rëndësi të letërsisë sonë të realizmit socialist. Ajo solli një frymë të re në poezinë tonë të pasluftës, qoftë me temën dhe fuqinë spontane të frymëzimit, qoftë edhe me formën e vargëzimit, që ishte e panjohur në botimet tona të mëparshme. Vargu i thyer

që ka zgjedhur poeti, i përshtatet plotësisht karakterit lirik-retorik të poemës dhe formës evokonjëse të shtjetimit të motiveve dhe episodeve, të cilat, pa u shtrirë në hollësi të mëdha, nuk janë të pakta dhe, në qoftë se nuk tërheqin edhe aq vëmendjen, kjo ndodh se i janë nënshtruar tingëllimit të përgjithshëm të veprës **dhe janë** shkrirë natyrshëm me tërresinë patetike të saj. Vargu i thyer sikur i përshtatet edhe ashpërsisë së subjektit, po vende-vende, butësia e natyrës poetike të Lazar Siliqit, ndofta edhe pse është përpjekja e parë për të përdorur një varg të tillë, duket se bie në kundërshtim me të e, në raste të tillë, vargu nuk ka muskuj, është i lëshuar. Po një gjë e tillë nuk e prek vlerën e përgjithshme ideo-emocionale të poemës, e cila edhe një çerek shekulli pasi është shkruar ruan akoma freskinë dhe rëndësinë e dikurshme si një vepër e frysmezuar, me forcë ideo-emocionale të dukshme, si një pioniere e guximshme dhe e sigurt e letërsisë sonë të realizmit socialist.

#### IV

Aleks Çaći është ndër poetët e parë, që trajtoi, në letërsinë tonë temën aktuale të pasluftës dhe e trajtoi me një entuziazëm politik e poetik të plotë. Vepra e tij e parë me rëndësi, që pati jehonë kur u botua dhe mbeti si një nga veprat kryesore të fillimeve të realizmit socialist, është poema «*Ashtu Myzeqe!*», botuar më 1947. Poema mbylljet me këto vargje:

«*Agimi ka rënë — dhe fusha po qesh... — E nisen betejën për jetën e re, — punojnë bashkuar — njëzet pendë qe, — Ashtu, Myzeqe!*»

E filluam me citimin e mbylljes së poemës, se mendojmë që, megjithëse motivi i vargjeve të përmendura nuk zë shumë vend në vepër, ai ka qenë shtytësi kryesor, që e ka detyruar poetin të marrë penën e të shkruajë. Tani ideali i poetit, — *punojnë bashkuar njëzet pendë qe,* — që atëhere ishte një *ideal*, në kuptimin më të plotë e më të saktë të kësaj fjale për gjithë jetën e fshatarësisë

punonjëse dhe shkëndija e parë apo qe ndezur në Myzeqe, — është kapërcyer plotësisht dhe realiteti i sotëm i fshatit tonë të kooperuar, që po modernizohet e mekanizohet gjithnjë e më tepër, është shumë më i përparuar se idealitet fillestare, ndërsa idealet e reja, që lind vetë jeta e që janë konkretizuar në orientimet dhe parashikimet programatike të Partisë, as që mund të krahasohen me fillestarin e tyre, po, nga ana tjetër, gjëzimi që «punojnë bashkuar njëzet pendë qe», është guri themeltar i gjithë zhvillimit tonë të mëvonshëm dhë një revolucion i vërtetë në marrëdhënjet e pronësisë e të prodhimit, të psikologjisë e të mentalitetit të fshatarësisë sonë të pararevolucionit. Prandaj, megjithëse zë pak vend në poemë — dhe më tepër vend mund të kishte zënë — motivi i kollektivizimit është një motiv kryesor i poemës së Aleks Çaqit dhe, gjithë ç'është shkruar në vepër, kur e mbaron së lexuari, është vënë në funksion të këtij motivi, si kur është përdorur kontrasti (ndërmjet pjesës së parë dhe dy pjesëve të tjera), ashtu edhe kur jepet zhvillimi, kalimi nga një etapë e luftës dhe e lirisë në tjetrën (në dy pjesët e fundit të poemës).

Poema ka ndërtimin e një vepre sinfonike me tri tema: vuajtja, lufta dhe çlirimi, të cilat ndjekin njëratjetren, duke kaluar prej notave të zymta e trishtonjëse, në notat e forta të luftës e në entuziazmin e jetës së re, që lind prej kësaj lufte dhe i kundërvihet në mënyrë absolute e në gjithshka së kaluarës. Prandaj, kur mbarojmë së lexuari poemën, ne dëgjojmë akoma tingujt e rëndë të fillimit të saj dhe, siç ishte në të vërtetë, i japim rëndësi historike faktit të thjeshtë që në një fshat të Myzeqesë punojnë të bashkuar njëzet pëndë qe.

Aleks Çaqi është ndër letrarët, që e ka nisur veprimtarin e vet poetike, që në vitet '30, ose, siç thuhet ndryshe, është ndër letrarët e brezit të tridhjetë e pesës. Atë, siç e dëshmon edhe përbledhja poetike «*Endrat e mia*» botuar vitet e fundit, që në hapat e para të krijimtarisë e ka tërhequr tema e vuajtjeve të popullit e të fshatarësisë. Në Myzeqe ai gjeti gjurmë të thella të shtypjes e të mjerimit, po edhe të një zgjimi të ri të fshatarësisë

punonjëse, që më parë ishte e huaj në tokat e veta. Sistem i feudal shtypës e parazitar, më tepër se në çdo krahinë tjetër të Shqipërisë, në Myzeqe kish pasur dhe ruante deri në fund të luftës tiparet më të përbindshme antipopullore, çnjerëzore dhe obskuraniste. Beu ishte zot mbi gjithshka: edhe mbi tokën, edhe mbi njerëzit, edhe mbi fikun, që mbinte prej farës që lëshonin zogjë. Dhe, atje ku shtypja është shumë e rëndë e vazhdon për një kohë të gjatë ose lind revolta e fuqishme revolucionare, ose skllavërimi ekonomik e politik ngjall nënshtrimin dhe skllavërimin shpirtëror. Në Myzeqe kanë ndodhur të dyja. Revolta revolucionare, që ka shpërthyer disa herë e që është mishëruar edhe në figura revolucionare, si ajo e Naun Priftit, gjeti rastin të manifestohej plotësisht gjatë Luftës nacionalçlirimtare, kur «foli Partia», siç thuhet në poemë. Atëherë figura e tmerrshme e beut dhe e xhandarit e humbën hijen e tyre të rëndë e të frikshme dhe në zemra lindi besimi, që, në vend të frikës e të nënshtrimit, mbolli besimin dhe etjen për liri. Për këto arësy, frymëzimi i poetit ngajeta e fshatit të Myzeqesë është me vend dhe ka karakter tipik për përcaktimin e monstrozitetit të shtypjes feudale dhe të rrugës së ndjekur nga gjithë fshatarësia jonë për çlirim e për një jetë të denjë njerëzore.

Mjerimi, lufta dhe çlirimi në veprën e Aleks Çaatit, duke iu shmangur edhe të vërtetës historike të zhvillimit të luftës revolucionare në vendin tonë, është dhënë *kretësisht* në plan klasor, si një luftë me armë e të shtypurve kundër shtypësve në formën klasike të kuptimit të saj. Në pjesën e dytë të poemës, në të cilën me të drejtë është vënë theksi në formimin e Partisë Komuniste dhe në luftën partizane, është mënjanuar plotësisht karakteri *nacionalçlirimtar* i luftës, pushtimi fashist i vendit dhe gjershetimi original i luftës për çlirimin kombëtar ekonomik e shoqëror, si një hallkë që u zgjidh nëpërmjet Luftës *nacionalçlirimtare*. Pra, nuk kemi një përkim të plot të së vërtetës artistike me të vërtetën historike, përkim që mund të qe arritur pa iu shmangur dhe pa i humbur përesinë aspektit klasor, që ka shqetësuar poetin, po do t'i

jepte atij, krahas vërtetësisë logjike, edhe vërtetësinë historike, se në fund të fundit, çdo fenomen shoqëror shfaqet në forma të caktuara historike, të cilat, duke përbajtur esencën, i jepin nuanca të ndryshme fisionomisë së tij, sipas rrethanave në të cilat shfaqet. Edhe lëvizja për çlirimin e fshatarësisë, duke ruajtur ngaherë karakterin demokratik të çlirimit prej prangave të feudalizmit, ndryshe paraqitet në rastet e lëvizjeve e të kryengritjeve fshatare, ndryshtet kur bën pjesë në revolucionin proletar të tipit klasik dhe ndryshtet kur zgjidhja arrihet nëpërmjet Luf-tës nacionalçlirimtare, që ka edhe karakterin e revolucionit popullor.

Kjo shhangje nga e vërteta historike nuk ka ndikuar në shtjellimin e përgjithshëm të temës së poemës dhe mbetet, si të thuash, një dobësi e pjesës së dytë të saj.

Poema nis me një parakalim të trishtuar e rrënqethës të heronjeve të vet:

«*Kalojnë me radhë — fytyra të nxira, — të vrara, — me sytë që duken si yje — të lyer me dritë të zbetë, — me çape të rënda — të zbatohur, — të qveshur, — si hie të natës.*»

Këto vargje, megjithëse të shkurtëra, kanë një ritëm të brendshëm ideor të ngadaltë e të rëndë, si çapet e fshatarëve në baltë. Ato nuk mund të lexohen as shpejt, as me zë të lartë. Atmosfera e krijuar menjëherë, nëpërmjet paradës së fshatarëve myzeqarë, është e dhimbshme, si tablo me ngjyra të zymta e një jete plot vuajtje e mjerim. Në të parë ngjan sikur në këtë tablo të errët si nata sundon vetëm një notë, po kjo është vetëm një përshtypje — dhe përshtypje e mirë, që krijohet prej spontanitetit poetik dhe prej shkrirjes së plotë në një unitet ideo-emocional të momenteve të ndryshme ekonomike e shoqërore, që përcaktojnë dhe përbëjnë tablonë e që, në vargjet e fillimit të poemës, vetëm sa ka nisur të zbulohet para nesh nëpërmjet një ekspozimi konstatonjës. Fill pas tyre, hyjmë në thellësi dhe, nga vështrimi i jashtëm i jetës, depërtojmë në ligjet e brendshme të saj, në shkaqet e jetës së rëndë të fshatarit. E përbindshme del para nesh figura e egër e beut, simbol i varfërisë, i mjerimit, i shtypjes dhe i prapambetjes. Ai është bërë tmerri i fshatarit të

patokë, mbi të cilin rëndojnë gjithë shpirtligësia dhe tërbimi i tij, aq sa: «*dhe dheu — bën vija të thella*, — «*ja beu!*»

Nëpërmjet figurës së beut, poeti na ka dhënë me forcë sugjestiononjëse dhe në mënyrë të urrejtshme tiparët çnjerëzore të feudalizmit, në të cilat asgjë e mirë dhe e bukur nuk mund të kërkohej e të gjendej. Kthethrat e tij zgjaten kudo dhe lakmia e pronës dhe e pasurimit arrin gjer në absurditetin që karakterizon gjithë etjen e klasëve shfrytëzonjëse e shtypëse për të shtënë në dorë gjithshka, deri edhe shpirtin e skllevërve. Kjo lakmi e pangopur e absurde arrin kulmin kur edhe «*një kumbull, një fik*» që mbin prej farës, që lëshoi laraska «*në tokën e zezë*» fshatarët «*me sy i shkojnë — që rriten, që piqen, — po beu bërtet: — «Janë timet!»*

Ky është tipari i parë i egërsisë feudale, që vazhdoi në Myzeqe, më tepër se kudo, deri pas luftës. Poezia të impresionon e të trondit, me anë të paraqitjes së koncentruar të një gjëje të tillë, po, sado që tanë mund të duket edhe e çuditshme, sidomos për brezin e ri, ekzagjerimi, bile, edhe theksimi emocional poetik i këtij momenti nuk është i madh. Dhe kjo nuk është e vëtmja e keqe e bejlerëve dhe e çifligarëve. Ata, si parazitë në kuptimin më të plotë të kësaj fjale, ashtu siç qenë egërsirat ndaj bujqve e s'çanin kokën për ta, ashtu nuk çanin kokën as për tokën, të cilën e mbanin si një pronë naturale, që vetëm duhej ta shfrytëzonin me anë të skllevërve, duke ruajtur prapambetjen më të thellë dhe mënyrën më primitive të prodhimit. Qante fusha dhe foshnja për një pikë ujë në tokat e mbuluara nga këneta dhe «*një lutje dëgjohet: — O zot, hithna shi! — Dhe Vjosa — kalon madhështore — përmes Myzeqesë!*»

Bujku, me gjithë këto të këqia, sado i painteresar për shtimin e prodhimit dhe i pamundur ta shpjerë përrpara jetën brenda caqeve ndrydhëse të feudalizmit, është i lidhur me tokën e zezë e me par mendën e drunjtë për atë të shkretë misër që i mban frymën, ndaj edhe tragjedia më e madhe për të është kur beu e dëbon nga tokat e veta dhe e lëshon në rrugën e madhe. Myzeqeja është plot me kujtime të hidhura dëbimesh të tillë, që janë ref-

lektuar edhe në vepra të tjera letrare («*Na hoqnë çatinë*» e Aleks Çاقит, «*Lumi i Vdekur*» i Jakov Xoxës). Parada e dhënë në fillim të poemës është pikërisht një kalvar i të dëbuarve që: «*në zemrën e natës... — largohen nga dhei — që u lindën, — që u rritën, — se beu — na bleu — të tjerë me para*».

Kjo shtypje dhe prapambetje shembullore feudale hedh hijen e vet të zezë në jetën e fshatarëve pa tokë, të cilët nuk rrojnë, po luftojnë dramatikisht me jetën.

«*Si zoqtë — që bëjnë folë — me bar e me baltë, — kështu këta njerës, — që nxijnë si nata, — ndërtojnë kassollet — me bar e me baltë*» dhe, sado e habitshme të duket: «*qan qëngji, qan nusja, qan djali për kripë*». Ata nuk rrojnë, po «*lëngojnë... nën grushtin e rëndë — të beut, — të shiut, — të tymit të zi*».

Jeta hyn në kontradiktë me vetëveten. Varfërimi i plotë dhe shtypja më e keqe e bëjnë jetën të padurueshme, barrë të rëndë për njeriun dhe ai, në një nyje të tillë vendimtare të qenjes së vet, ose pushtohet prej pesimizmit dhe i nënshtrohet fatit në mënyrë pasive, duke kërrusur kurrizin prej skllavi ose, i vdekur se i vdekur, mbledh grushtin me zemërim, ngrihet kundër mjerimit e skllavërisë në emër të jetës dhe kështu skllavi pushon së qeni skllav. Ai bëhet revolucionar. Poeti nuk është thelluar në këtë anë të çështjes e të historisë së luftës revolucionare të fshatarësë, që është manifestuar gjithnjë në forma pasive e aktive, spontane e të organizuara, në mendim e në veprim, në formë mallëkimesh e talljesh. Atë e ka tërhequr më tepër pasqyrimi me ngjyra të zeza i shtypjes në një vend ku: «*dhe foshnja — në barkun e nënës — tmerrohet, — fillon të mendojnë — si duhet të rrojë — në dheun e huaj!*».

Ky kufizim ideor dhe pasqyronjës i pjesës së parë të poemës, i ushqyer, mbasse, edhe nga paragjykime për Myzeqenë, nuk është një dobësi aksidentale e veprës, po një e metë organike e saj, që mendojmë se mbështetet në dy gjëra: në dëshirën e autorit, që në pjesën e parë të poemës të sundojë plotësisht ngjyra e zezë e shtypjes feudale (edhe në kuptimin më konkret: «fytyra të nxira», «njerëz

që nxijnë si nata», «dheu i zi», «nata e zezë») dhe në shpresën, se pjesa e dytë do ta japë luftën aktive kundër shtypjes në mënyrë të plotë, pa menduar se poema është ndërtuar në plan të njëkohshëm kohor e ideor dhe që, në qoftë se dy pjesët e tjera të poemës do të hidhnin dritë mbi të parën, edhe e meta e saj s'kish si të mos reflektohej edhe në to. Kulmi i revoltës dhe i shpirtit të protestës në pjesën e parë të poemës është: «një «ah», që lëkunt — themelet e dheut të zi — bashkohet me pemët, — me erën e ngrohtë, — me tymin — dhe ngrihet në qill».

A mund të kishte gjëzim në këtë vend? Në kuptimin e madh e të përgjithësuar historik — jo. Edhe në kuptimin e në qëllimet ideo-emocionale, që ka pasur poeti, gjëzim nuk mund të kishte ose, edhe kur kishte, ai pasohej nga dertet e hallet, ishte më shumë dëshirë e shpresë, se gjëzim i vërtetë. Çdo gaz ka qenë jetëshkurtër. Me të drejtë gjëzimin e parë poeti e ka lidhur me shpresën e një viti të mbarë bujqësor, që do të thoshte të mos vdisnin nga uria. Kjo ishte kryesorja, e cila bëri që drita e zemrës ta mundte errësirën. «Në bebet e syrit, — në faqet e nxira, — në ballin e gjerë, — fëmijët këndojnë — një jetë që vjen...», por edhe kësaj radhe: «kalliri vërtitet nga dheu, — po etja, e munt».

Gjëzim tjetër për poetin nuk ka.

«... dhe buza nuk qesh, — as këngë dëgjohet, — as valle, as raki, — nuk ngrihet dolli! — Të dashur nuk pati njeri, — nuk puthi me zemër, — s'këndoi me mall, — një gushë, — një ball, — një sy».

Skllavërimi i gjatë dhe i rëndë e shtazëron deri në një farë shkalle njeriun, duke reduktuar deri në minimum kërkosat jetësore të tij, po një mohim i tillë i gazit, i këngës dhe i dashurisë nuk është më dëshmi e thjeshtë e skllavërisë. Është njëkohësisht edhe mohim i vutive normale të njeriut, i lidhjeve shoqërore të tij. Në këngë e në valle mund që reflektohet vuajtja dhe trishtimi, monotonja e jetës dhe amullia dhe tingujt e kabave mund që janë të vajtueshme, ritmi i valleve i shtruar, po ato kanë egzistuar dhe kanë shoqëruar gjëzimet e vogla të jetës, ato pak çaste të bukura që bujku ja rrëmbente asaj. Dhe

dihet, sa më i madh të jetë mjerimi, aq më tepër vlerë marrin çastet jetëshkurtëra të gëzimit, që njeriu përpinqet t'i jetojë deri në fund.

Në pajtim me fryshtë e pjesës së parë të poemës, me fryshtë e nënshtrimit, nis edhe pjesa e dytë e saj me vargjet e gëzueshme:

«*Në majën e malit — barinjtë — kanë ndezur një flakë*» dhe bujqit e Myzeqesë: «*shikojnë me mall — një Dité të Madhe, — që zbret nga Tomori*».

Malet, vërtet kanë qenë foletë e lirisë dhe janë bërë simbol i luftës, po lufta nuk është bërë vetëm në male dhe njerëzit që kanë luftuar maleve nuk kanë qenë vetëm malësorë. Koncepti se mali luftonte dhe fusha duronte nuk është një koncept i saktë. Bujku myzeqar, të cilit i kish hyrë thika e shfrytëzimit deri në palcë, u ngrit me thirrjen e Partisë dhe luftoi në fushat e veta e në mal të Tomorit. Ai nuk shikoi malin me mall, po iu ngjit malit. Po të qe mbështetur më mirë në këtë realitet historik, figura poetike e fillimit të pjesës së dytë të poemës do të kishte një tjetër drejtim dhe revolta e lufta do të buronin «*nga dheu i zi*», që u quajt prej urisë e prej mjerimit. Këshfu do të ishin më të natyrshme dhe historikisht e poetikisht më të përligjura vargjet:

«*Në zemrat e tyre — kalon si një dallgë — hakmarrja — dhe duket liria, — se toka u ngrit, — fytyrat u ndezën — me dritë — dhe beu lëkundet, — si rrënjet e lisit, — nga vrulli i tërmëtit që vjen — dhe shëmp e rrëmben — terrorin, — çfrytëzimin — skullavërinë.*»

Kufizimi tjetër historik i kësaj pjese të poemës, siç e përmendëm edhe më lart, është përfytyrimi poetik i luftës si një kryengritje fshatare kundër shtypjes feudale. Përjashtimi nga poema i pushtimit fashist dhe i luftës kundër tij, megjithëse poeti theksin kryesor e ka vënë mbi kontradiktat dhe luftën e klasëve, e ka cënuar rëndë vërtetësinë historike të veprës dhe, ndofta edhe për këtë shkak, pjesa e dytë, që merret me një nga periudhat më intensive të jetës së popullit, ndryshe nga pjesa e parë, që sundohet prej ngjyrave të theksuara realiste, ka një

karakter fluid dhe enfatik. Lufta jepet në forma tepër të përgjithshme dhe pa ngjyrat tipike të kohës:

«Kasollet u doqnë, — parmandat e drunjta, — të lara me djersë e me lotë, — u bënë shkopinj — dhe gjaku, — i mpirë nga frika, — u bë më i kuq».

E rëndësishme është të theksohen se lufta e bujkut, që «nuk donte të rronte», i solli gjëzimin e grabitur nga beu, e çlirroi nga tmerri, që i ngjallte shtypja nga ankthi që mbillte varfëria. Atij, megjithëse «kasollet u doqnë», i qesh nuri dhe bota i duket më e bukur nga ç'ishte. Ky është transformimi i skllavit në revolucionar. Ai i pranon me dëshirë vuajtjet dhe sakrificat e luftës, se e di përse lufton. Në parafytyrimin e tij, valët e Vjosës këndojojnë një himn madhështor, dallga e jetës derdhet nëpër fusha dhe gruri i verdhë ngjitet gjer në quell «se mori fuqi — nga zemra e dheut».

Lufta revolucionare për poetin është e bukur. Ndërsa në paqen e shtypësve ai shihet vetëm mjerim dhe zi, në luftën e të shtypurve ai sheh shpërthimin e lirë të vullnetit popullor dhe ngazellehet, kur vëren që beu lëkundet «nga vrulli i tërmetit që vjen»; ndërsa «fëmijët — me buzë të zeza — dhe bujku — i rëndë si balta — shkëlqejnë», se «Liria — i dehu të gjithë». Ndërsa jetës nën thundrën e beut iu mohua çdo gjëzim, çdo dritë, luftës popullore i mohohet çdo vuajtje. Siç shihet, edhe ky konceptim poetik, në kuptimin e madh historik, është plotësisht i përligjur dhe i drejtë. Lufta revolucionare është vërtet e bukur, gjersa ajo i jep fund shëmtimit çnjerëzor të shtypjes e të poshtërimit.

Në kontrast të plot ideo-emocional dhe stilistik me pjesën e parë, është pjesa e fundit e poemës, kushtuar jetës së re, që lindi nga revolucioni. Me gjithë karakterin enfatik edhe të kësaj kënge, në vargjet e saj është folur me entuziazëm për fitoret kryesore që arriti fshatarësia punonjëse në revolucionin popullor dhe, mbi të gjitha këto fitore, poeti ve krijimin e pushtetit popullor, prandaj edhe pjesa e tretë e poemës, nis me vargjet e gjëzuara: «Mbi kullen e beut — këshilli — ka ngritur flamurin — dhe ylli i kuq lëshohet si nur — në fushat e gjera», që përjetësojnë

çastin e madh historik, kur masat punonjëse morën në duart fatet e veta e të Atdheut. Beu, që në fillim të poemës bënte të dridhej dhe foshnja në barkun e nënës, u kthyte në «*hije të zeza*» që «*zemra — me shpatën e flaktë — i djeg si rrufeja, — se lindi — besimi — për jetën e re*». Kësh-  
tu, si frut i fitores së revolucionit dhe vendosjes së push-  
tetit popullor, «*kasollet u mbushën me dritë — dhe ligji i ri, — që u shkrua me gjak, — u ngul në çdo prak*».

Lufta ndërroi edhe raportet e pronësisë. Beu nuk humbi vetëm sundimin, po edhe pronën feudale, ndërsa bujku nuk fitoi vetëm pushtetin politik, po edhe tokën. E ç'ishin vështirësitë e shumta të viteve të para të pas-  
luftës para këtyre fitoreve e ndryshimeve të mëdha historike?! Është meritë e shquar e poetit, që, edhe duke gjy-  
kuar në çast e jo nga një «*distancë kohe*», është ngritur mbi vështirësitë e shumta dhe ka parë e reflektuar me kthje-  
llësi mendjeje e ndjenje atë që ishte themelore në kohën,  
kur Shqipëria hidhte çapet e para në jetën e lirë, çape,  
që shkallmonin «*botën e vjetër, që nxinte si nata*» për të  
krijuar botën e re, ku gjëmbat e ferrat të digjeshin në  
zjarrin e tyre, dheu të mos shkelej nga këmba e rëndë e  
skllavit, shfrytëzimi të mos mbillej si misri, po malli për  
jetën të ngríhej e të bënte çudira. Për këtë:

«*Litari u shtri, — me thikë — u pre skllavëria —  
dhe dielli nga lartë... — lëshon i gëzuar — një dritë si  
ditë*».

«*Nuk ka më të huaj, — nuk ka më mëshirë, — se vendi  
ka zot — një popull të lirë*».

Njeriu i ri, psikologjia dhe mendimi i tij i ri, qenë,  
gjithashtu, një frut i revolucionit dhe poetit kjo gjë nuk  
i ka shpëtuar. Në poemë ne shohim si kthehet skllavi  
në luftëtar dhe si lindin tek ai ideale të mëdha shoqëro-  
re. Ndërsa në pjesën e parë të poemës, i zhytur në varfëri  
dhe i shtypur, bujku mendonte vetëm për vete me dësh-  
përim, në pjesën e dytë kthen par mendën në armë e, në  
pjesën e tretë, si zot i tokës dhe i fateve të veta, drejton  
trupin dhe vështron përpara. «*Dhe mendja ndryshon —  
si toka, — si jeta*».

Nga ky transformim revolucionar i njeriut, që «*u*

*ngrit më këmbë... — se foli Partia», — transformim që arrihet mbi bazën e ndryshimit të vetë jetës, lindin te fshatarësia punonjëse idealet e reja socialiste. Armik i saj imbetet prona private, ndërsa rruga e shpëtimit është bashkimi, kolektivizimi.*

«*Dhe gardhet, — që ndanin mjerimin — nga jeta, — që ngrinin — një mur — dhe shpinin — urinë në vatër, — u shëmpnë, — si nata — nga Dita e Madhe».*

Kjo është rruga dhe poeti tek sheh të punojnë bashkuar njëzet përdë qe, ka të drejtë të thërrasë me gjithë zemër: Ashtu, Myzeqe! Jeta e miratoi plotësisht këtë entuziazëm.

Në kontrast me vargjet e para të poemës, në pjesën e tretë të saj, kalojnë para nesh: «*fytyra që qeshin — dhe dielli — dhe hëna dhe yjtë — bashkohen — dhe drita e madhe — pushton tokën tonë».*

Poezia e Aleks Çuçit në vitet e para të pasluftës, sikurse edhe poema «*Ashtu Myzeqe!*», është mbrijtur me entuziazmin e masave popullore dhe ka shprehur, pa hije, gjëzimin dhe optimizmin e tyre revolucionar, ashtu si vjersha e tij e dikurshme kish qenë refleks i brengës popullore. Ky entuziazëm mund të kish qenë më dinamik, i pleksur më thellë me kontradiktat e mprehta të asaj kohe. Ndofta kështu do të kishte qenë edhe më mirë, po, siç e përmendëm edhe më sipër, poeti pikërisht se ishin vitet e para të jetës së lirë dhe vështirësitë e mungesat qenë të mëdha, si mjet ndikimi në masat gjeti afirmimin entuziast të jetës së re, jo vetëm pa u lëkundur, po edhe pa u dhënë rëndësinë vështirësive; që ishin historikisht më pak të rëndësishme se fitoret e arritura. I tillë është ai. E tillë është edhe poezia e tij, që çau përpara dhe ndikoi seriozisht në hedhjen e themeleve të letërsisë së realizmit socialist.

## V

U ndalëm në tri prej veprave të para e me rëndësi të fillimeve të letërsisë së realizmit socialist, po ato nuk

qenë të vetmet në atë kohë. Në pesëvjeçarin e parë të lirisë, që çeli shtigjet e ndërtimit të socializmit, u shkruan e u botuan edhe disa vepra të tjera me rëndësi kushtuar Luftës nacionalçirimtare, mbresat e së cilës qenë ende shumë të freskëta, dhe jetës së re që po krijohej mbi gërmadhat e lëna prej luftës. Autorët kryesor të kësaj poezie ishin Shevqet Musaraj, Dhimitër Shuteriqi, Llazar Siliqi, Andrea Varfi, Zihni Sako, Vehbi Bala, Mark Gurakuqi dhe Luan Qafëzezi, kurse prej veprave kryesore të kësaj kohe, përveç atyre që analizuam, mund të përmendim poemat: «*Do bëhen zgjedhjet*» të Shevqet Musarajt, «*O Ptoleme*» dhe «*Enverit*» të Dhimitër Shuteriqit, «*Të njëzeteshatët*» të Llazar Siliqit, «*Parakalojnë fitimtarët*» dhe «*Ushtarit të Kuq*» të Petro Markos, «*Me ty, Stalin!*» të Aleks Çaqit etj. Në këto vepra u shtruan dhe morën udhën e zgjidhjes problemet më themelore të letërsisë së realizmit socialist, siç janë karakteri afirmonjës i kësaj letërsie, në raport me luftën revolucionare dhe ndërtimin e socializmit, fryma popullore dhe e partishme, pasqyrimi i realitetit në zhvillimin revolucionar, problemi i qëndrimit të ri ndaj punës, pronës, etj., çështja e gjetjes dhe krijimit artistik të heroit të ri revolucionar e probleme të tjera. E rëndësishme është të shënohet që asnjë prej këtyre problemeve, as më parë dhe as në atë kohë nuk qenë trajtuar teorikisht, po u shtruan dhe morën udhë nga vetë praktika letrare, e frymëzuar nga luftha dhe puna ndërtimtare e popullit, e drejtuar prej parimeve të përgjithshme të partisë dhe e ndihmuar nga njojha e letërsisë revolucionare botërore, sidomos e letërsisë sovjetike të asaj kohe. Kjo është edhe një dëshmi tjetër që provon karakterin objektiv të kalimit të artit në pozitat e realizmit socialist dhe lidhjen e ngushtë të këtij kalimi me lëvizjen revolucionare të masave, me depërtimin e ideve e të idealeve komuniste në letërsi e në art. Kjo provon, gjithashtu, që realizmi socialist as mund të importohet nga jasht, as mund të imponohet në mënyrë administrative. Ai lind nga vetëjeta, nga vetë zhvillimi historik i letërsisë dhe i artit. Tek ne ai lindi në zjarrin e luftës popullore, u konsolidua në periudhën e ndërtimit

të socializmit dhe pati si pararendës të afërt letërsinë përparimtare e me tendenca revolucionare të viteve '30, kohë në të cilën morën drejtimin fillestar edhe shkrimtarët e parë të letërsisë sonë të realizmit socialist.

Në qendër të këtyre veprave është heroizmi i kohës së luftës dhe entuziazmi i fitores. Heroi lirik i këtyre veprave është një hero i ri, që hynte për herë të parë në letërsinë shqipe, duke marrë nga letërsia revolucionare e së kaluarës revoltën dhe patriotizmin (edhe këto të ngritura në një përmbajtje më të gjerë klasore e populllore), po duke u pasuruar me qëndrimin e hapur klasor e të partishëm, me karakterin aktiv, me një qëndrim të ri ndaj jetës, me qartësinë e perspektivës dhe me optimizmin revolucionar, që karakterizoi vetë Luftën tonë nacionalçlirimtare dhe periudhën e rindërtimit të vendit. Ai u bë shprehës i zgjimit të ndërgjegjes populllore. Partia, si mishërim i ndërgjegjes dhe i aspiratave të popullit, — edhe pse nuk kemi ndonjë vepër të veçantë kushtuar asaj, — u këndua me fryshtësim dhe, prej vargjeve që i kushtohen, del qartë vendi i saj në historinë e popullit, si udhëheqëse dhe fryshtësimi e luftës dhe e punës dhe dashuria e ngrohtë dhe e pastër e popullit për të. Në asnjë vend më parë dhe asnjëherë kaq shpejt Partia Komuniste nuk është përqafuar me masat dhe nuk është përqafuar nga masat, siç ndodhi me Partinë tonë dhe me masat tona punonjëse. Dhe letërsia, si pasqyrë e jetës, e kapi dhe e pasqyroj menjëherë këtë motiv krejt të ri të poezisë e të vëtë jetës.

Patriotizmi dhe këngët e trimërisë kanë karakterizuar gjithnjë letërsinë tonë kombëtare dhe vetë rruga historike e popullit e ka ushqyer këtë fryshtë. Edhe letërsia jonë e re e ndoqi këtë vazhdë, pa qëndruar në vend. Vetë karakteri i Luftës nacionalçlirimtare, si gërshtetim i Luftës për çlirimin kombëtar me luftën për çlirimin shoqëror, i dhanë patriotizmit një natyrë të gjerë popullore dhe, trajtimi i motiveve patriotike u lidh ngushtë, ndonëse në mënyrë ende jo aq të theksuar, me qëndrimin klasor revolucionar, antiimperialist dhe antifeudal. Edhe heroizmi nuk mbeti ai që ishte. Shtytjet e reja politike dhe ideolo-

gjike i dhanë edhe heroizmit një fizionomi të re, e bënë më të ndërgjegjshëm, më masiv, më të fuqishëm. Qëndrimi krenar ndaj vdekjes në luftë nuk ishte «marrëzi trimash», po u kthye në bindje të thellë, se asnë pajtim nuk mund të kishte me fashizmin,asnë jetë nuk do të ishte e ndershme më tej. Ideali i madh i çlirimit të popullit dhe i lumturisë së tij dhe besimi i patundur, se lufta e sakrificat do të sillnin lirinë e lumturinë pér gjithë popullin, i bënte heronjtë të shkonin me këngë në gojë drejt plumbit e litarit.

Heroi i këtyre veprave nuk është «mbinjeri» çudibërës. Ai është njeriu i thjeshtë i popullit, i gatuar prej vuajtjes dhe i kalitur prej luftës dhe idealeve të Partisë. As jeta, as vdekja e tij nuk janë të bujshme, po në thjeshtësinë e në kuptimin e tyre historik janë të mëdha, të madhërishme. Ky hero është punëtori e fshatari i varfër, partizani dhe komunisti. Të tillë heronj letërsia jonë nuk kish njohur më parë. Të tillë heronj letërsia jonë e re s'kish nga t'i merrte, veçse nga jeta e nga lufta e popullit.

Në çdo kuptim që t'i marrësh këto vepra të poezisë sonë të re kishin një karakter të fuqishëm novator, edhe kur ndiqnin traditën popullore të vargëzimit (poemat e Shevqet Musarajt), edhe kur qenë përpjekje pér një trajtim të ri të formës e të vargut. Ato, bashkë me krijimet e para në prozë, (tregimet e shkurtëra të Zihni Sakos, Fatmir Gjatës, Dhimitër Shuteriqit, etj. apo modelet e përshkrimeve të luftës: «Kujtime nga jeta e Brigadës së parë sulmuese» dhe «Shtek më shtek me partizanët e Divizionit të parë») hodhën hapin më me rëndësi gjer atëhere, pér kalimin e letërsisë sonë në pozitat ideologjike dhe estetike të realizmit socialist, u bënë prekrusore të ndërgjegjshme të kësaj letërsie dhe ndikuan pér zhvillimin dhe lulëzimin e mëvonshëm të saj. Ato do të mbeten gjithnjë gurët e themelit mbi të cilët ngrihet ndërtesa e madhe e letërsisë sonë të sotme, që ka arritur të zgjidhë shumë prej problemeve të mëdha, që u shtruan dhe u vunë në rrugë pér herë të parë nga këto vepra.

## POET NOVATOR

(Shënime për krijimtarinë poetike  
të Ismail Kadaresë)

*Poet është ai që me dorën e fortë, ashtu siç këput  
një trandafil në lëndinë, mund të zbërthejë pranë  
trandafilit edhe një minë.*

(ISMAIL KADAREJA)

### 1.

Në vitin 1954, kur festohej dhjetëvjetori i çlirimit të Atdheut dhe i fitores së revolucionit populor, në letërsinë tonë të re — të re në moshë e në fizionomi — u dëgjua edhe një zë i ri. Një libër i vogël me vjersha ngjallli ku-reshtjen e letrarëve e të dashamirëve të poeziს. Ishte libri i parë i Ismail Kadaresë (*Frymëzimet djaloshare*). Atëherë Shqipëria socialiste festonte dhjetëvjetorin e vet, kurse poeti fillestari hynte në botën e poeziს, duke qenë gjimnazist, 18 vjeç djalë. Këto dy data kanë rëndësi për të dhënë një gjykim të drejtë e të gjerë për vjershën e Ismail Kadaresë dhe për rrugën që ai ka ndjekur në krijimtarinë e vet gjatë këtyre pesëmbëdhejtë vjet veprimtarie letrare, që e kanë shquar si në poezi, edhe në prozë.

Kur filloi të shkruante Ismail Kadareja — më sakt, kur nisi të botonte, — Shqipëria hidhte hapat e parë të vështirë e të sigurt drejt socializmit, pasi kishte shëruar

plagët e rënda të luftës dhe, në shumë drejtime, kishte larë hesapet kryesore me klasat shfrytëzonjëse e të përmbyshura nga revolucioni. Lufta e klasëve vazhdonte ende me rreptësi, disa herë edhe me komplotë të dështuara, me diversione të neveritshme, me sabotime, me armë, me gjak. Në këto beteja, edhe pse buka ishte e pamjaftë dhe mungesat qenë të shumta, populli, duke vështruar përparrë, si një vigan i ngritur mbi pirgun e madh të vështirësive e të hallevë, shtrëngonte radhët e veta rrëth partisë, cimentonte themellet e diktaturës së vet dhe ekte përparrë me besim të madh, me bindje të thellë politike, me heroinëzëm. Ai luftonte i udhëhequr nga partia, shkallmonte plane e varroste ëndrra armiqsh e tradhëtarësh dhe, në luftë e sipër, krijonte diçka të re, vendoste ligje të reja, ndërtonte kombinatet e para, thante kënetat dhe zhdukte analafabetizmin, mësonte teknikën e re dhe njihet me shkençën, pa hequr pushkën nga krahu. Kjo ishte një botë e madhe përpjekjesh, luftash e heroizmash drejt së cilës populli shkonte me një ndjenjë të lartë patriotizmi.

Letërsia jonë e re qe munduar, në mos ta pasqyronte gjerësisht këtë përmbyshje dhe këtë krijim të madhëri-shëm revolucionar, të paktën t'i përgjigjej atij, të ishte pjesë e tij, të akordohej në harmoninë e përgjithshme të këngës së madhe, që po krijonte populli dhe partia në krye të tij. Dhe, në mos paçim aq vepra letrare, sa qenë veprat heroike të popullit, prej asaj kohe na kanë mbetur «Epopeja e Ballit Kombëtar», «Ashtu Myzeqe!», «Prish-tina» dhe vepra të tjera me vlerë, që kanë për të mbetur si gurët e parë të kilometrazhit në rrugën e gjatë të letërsisë sonë të realizmit socialist.

X Në atë kohë, letrarët fillestare mbështeteshin dhe mund të mbështeteshin kryesisht në katër themele letrare të forta: në krijimtarinë popullore, në traditën e letërsisë sonë kombëtarë, në sukseset e para të letërsisë sonë të realizmit socialist dhe në traditën revolucionare të letërsisë sovjetike të realizmit socialist, pa mohuar edhe letërsinë botërore, që ndikonte sidomos te më të rriturit. X Megjithëkëtë, puna nuk ishte e thjeshtë, jo vetëm se njohja e këtij trashëgimi nuk mund të siguronte *suksesin* le-

trar, po, sidomos, se qështja kryesore ishte që letërsia, duke u mbështetur në trashëgimin pozitiv të së kaluarës e të kohës, që të zinte vend në jetën e shoqërisë, duhej të gjente rrugët e shkrirjes me këtë jetë, t'u jepte përgjegje problemeve të reja të saj, gjë që nuk mund të bëhej me gjuhën e vjetër, me mënyrën e vjetër të të konceptuarit, të të ndjerit, të të menduarit dhe të të pasqyruarit të jetës. Jeta ishte e re. E re duhej të ishte edhe letërsia. Jeta vazhdonte nëpërmjet transformimesh revolucionare. Nëpër këtë rrugë vazhdimësie historike e transformimesh revolucionare duhej të kalonte edhe letërsia. Ndryshe s'kish si të ndodhte. Si në çdo sektor tjetër të jetës, si në çdo front të revolucionit, mbi bazën e transformimeve të mëdha materiale, politike e shoqërore, mbi bazën e ndërrimit të strukturës së shoqërisë, edhe në letërsi dilte problemi i shkrimtarit të *ri* problemi i shkrimtarit të socializmit, me botëkuptim të ri, me qëndrim të ri revolucionar ndaj jetës, me prirje emocionale të reja, me një metodë të re hetimi, studimi e pasqyrimi të jetës.

*Ky shkrimtar i ri* erdhi në letërsinë tonë nga disa rrugë. Ai, para së gjithash, *erdhi nga mali*, zbriti në Lidhjen e Shkrimtarëve me veshje partizane, me pushkë në krah, me fletore vjershash e kujtimesh të shkruara me laps. Ai, doemos, solli në letërsi erën e barutit, thirrjet e luftës, këngët partizane për beteja e për shokët e rënë, entuziazmin e fitores. Kështu ndodhi që vështirësitë e mëdha, dramat e rënda të jetës, në ato vite, nuk ngjallën psherëtimë e dëshpërim, po *entuziazëm*, marshe, himne. E ç'ishin vështirësitë para fitores së madhe, para asaj bote të vjetër skllavërie, që ishte shembur në luftë? Kështu u përcaktua një prej tipareve themelore të letërsisë sonë: *karakteri i saj militant*. Ky karakter nuk mund të përcaktohej aq lehtë prej shkollës e studimeve. Ai do të lindte nga lufta e përpjekjet e përgjithëshme populllore.

Ai erdhi nga radhët e *intelektualëve patriotë*, të cilët nuk ranë në prehër të armikut dhe gjetën rrugën e bashkimit me popullin duke iu nënshtruar procesit të riedukimit politik e moral të vetëvetes, duke kuptuar *detyrën morale* karshi popullit dhe duke u përpjekur të fitoj-

në të drejtën morale, që t'i flasin popullit me logjikën e tij, në interes të tij, me gjuhën e tij.

Ai erdhi edhe prej brezit më të ri, prej fëmijëve të kohës së luftës, që dolën në jetë të përshëndetur me breshëri artilerie dhe që i mësuan parimet e reja në shkollë, në çetat e pionierëve dhe në organizatën e rinisë. Të tillë janë, në përgjithësi, shkrimitarët që e nisën krijimtarinë e tyre në vitet 1950 e këtej.

Këta shkrimitarë krijuan *një letërsi revolucionare*, që përshkohet nga fryma luftarake e revolucionit popullor, nga entuziazmi historik, që lindi në popullin tonë prej fitores, nga fryma e shëndoshë e Partisë Komuniste, e cila krijoi lidhje gjaku me popullin. Krahas kësaj, në letërsinë e atëhershme, është e natyrshme të dallojmë edhe *një vazhdim* jo krijonjës të letërsisë së mëparshme, të mentaliteteve e të psikologjisë së mëparshme, që vërtet po humbisnin bazën ekonomike, po kishin akoma fuqi të madhe ndikonjëse. Kjo vërehet veçanërisht në trajtimin e temave shoqërore në frymë patriarkale (ose *neopatriarkale*, në karakterin idilik, në konceptime të jetës sipas modeleve të vjetra, etj. E kundërtë e kësaj dhe njëkohësisht me këtë u dukën edhe prirje stilizante të manifestuara në krijimet të pafrymëzuara, që nxiteshin jo nga jeta e gjallë, po nga dëshirat dhe përfytyrimet subjektive të autorëve, që, duke mos mundur të përzihen e të orientohen në kontradiktat e mëdha e në konfliktet e ashpra klasore, qëndrojnë në sipërfaqe, të qetë e të kënaqur. Të dyja këto prirje nuk arritën dot të sundojnë dhe, megjithë të keqen e tyre, nuk e prekën dot shpirtin revolucionar luftarak të letërsisë sonë në tërsësi. Në këtë mes ndikuancë edhe disa vepra të dobëta të letërsisë sovjetike të pasluftës, që sheshonin kontradiktat dhe krijonin iluzione jo revolucionare.

Në kohën për të cilën bëjmë fjalë terreni i luftës ishte i gjerë dhe i vështirë. Ai ishte i gjerë dhe i vështirë, si në kuptimin e përgjithshëm ekonomik, politik, ideo-logicik e shoqëror, edhe në kuptimin letrar e artistik. Në kuptimin e përgjithshëm, ndeshjet zhvilloheshin ndërmjet masave punonjëse të udhëhequra nga partia dhe

reaksionit të brendshëm të ish-klasave shfrytëzonjëse, ndërmjet Shqipërisë socialiste dhe reaksionit botëror, ndërmjet rrugës socialiste të ekonomisë, që apo hidhte hapat e parë dhe rrugës kapitaliste, feudale dhe anarkisë mikroborgjeze, ndërmjet ideologjisë e moralit të ri proletar, që fitonin terren dhe ideologjisë e moralit feudal, borgjez e mikroborgjez, nërmjet kulturës së vjetër feudo-borgjeze dhe kulturës së re, që apo krijohej, duke u mbështetur në traditat më të mira, po edhe pa shpëtuar prej ndikimeve të këqija. Reflekse të kësaj lufte të madhe u dukën edhe në letërsi, pa acarime, po në mënyrë të natyrshme, të ligjshme, objektive, më tepër nëpërmjet praktikës letrare, se sa nëpërmjet diskutimeve e mendimit kritik, megjithëse edhe këto nuk munguan. Objektiivi i luftës ishte forcimi i pozitave ideologike të letërsisë së re dhe formimi i fizionomisë së saj realiste socialiste. Në këto drejtime e orientontejeta letërsinë tonë dhe, në mënyrë të ndërgjegjshme, këto orientime pasqyroheshin në direktivat, vendimet, mësimet dhe masat e partisë.

Ajo ishte luftë për çirimin e krijimtarisë letrare prej ndikimit të koncepteve, të mentalitetit dhe të psikologjisë patriarkale e mikroborgjeze, që kishin rrënësë në popull dhe, për këtë arësy, ngatërrroheshin me mentalitetin dhe psikologjinë e mirëfilltë popullore, disa herë edhe i nënshtronin ato. Këto ndikime u dukën sidomos në trajtimin e temave shoqërore. Mjaft letrarë, pikërisht nën ndikimin e shtresave të prapambitura mikroborgjeze, ndërsa politikisht qëndronin në pozita të shëndosha dhe në trajtimin e temave kryesore të luftës orientoheshin drejt, kur vinte puna për proceset e reja të jetës shoqërore, që rridhnin prej riorganizimit të shoqërisë në baza socialiste dhe prej zhvillimit të përgjithshëm të vendit, anonin nga patriarkalizmi dhe mentaliteti mikroborgjez. Idilet, ske nat dhe veprat sentimentaliste, qëndrimet në thelb patriarkale ndaj jetës familjare (marrëdhënjet burrë-grua, prind-fëmijë, etj.), deri te malli për peisazhin e dikurshëm rustikan e te hollësítë etnografike etj. ishin, në të vërtetë, një vazhdim i rrugës së vjetër, i drejtimeve të vjetra ideore të letërsisë së dhe, në mos e luftonin hapur,

e dëmtonin lulëzimin e letërsisë së realizmit socialist, pengonin brumosjen e saj me ideologjinë revolucionare dhe shoqërisht bëheshin një mbështetje e koncepteve dhe e psikologjisë patriarkale e mikroborgjeze. Është kundërtatë e këtyre prirjeve në letërsi ishte ende e dobët dhe nuk mundi t'i kapërcente përfundimisht ato.

↗ Megjithkëtë lufta për ta mbajtur letërsinë sa më afër jetës së popullit, sa më afër problemeve me rëndësi që shtronte zhvillimi revolucionar i vendit, për *afirmimin* e realitetit të ri shoqëror, ishte prirja kryesore, qëllimi kryesor, prandaj edhe veprat më me vlerë u janë kushtuar fenomeneve më me rëndësi të jetës së popullit e të luftës së tij. Gjithshka në atë kohë, në jetë e në letërsi, shihej nën prizmin e fitores së madhe të popullit mbi fashizmin dhe mbi klasat shfrytëzonjëse. Entuziazmi i kësaj fitoreje ishte ndjenja më e fuqishme dhe qëdo element i ri i jetës sonë të re merrte një kuptim të madhërishtë, sublim. Kjo ndjenjë revolucionare, që sundonte në jetën tonë dhe zgjonte energjitetë dhe shpirtin heroik të popullit, i dha letërsisë një ton të theksuar *optimizmi revolucionar*, që mbetet një prej tipareve të përhershme të realizmit socialist.

— Ndeshje e kundërshtime pati edhe në çështjen e trajtimit e të kuptimit të temave intime. Lindën qëndrime të ndryshme *pro et contra* si dhe variante kompromisi, që kënaqen gjer në një farë shkalle ata që mohonin vlerat e poeziës intime dhe e quanin të dëmshme atë. Absolutizimi është një e keqe e përhershme në krijimtarinë letrare e artistike. Edhe në këtë rast ai nuk mund të qe i mirë, kurse përpjekja për ta larguar poezinë nga temat e mëdha nuk mund të ishte veçse një lajthithje fëmijërore, një moskuptim i misionit shoqëror të saj, sepse ngatërronte me naivitet të metat dhe dobësitë e krijimtarisë së atëhershme me vetë natyrën e letërsisë së realizmit socialist që po krijohej.

Edhe *problemët e formës* erdhë koha që morën rëndësi të posaçme. Kjo ndodhë se ndihej që format e vjetruara qenë pengesë për brendinë e re. Në këtë mes kishim të bëjmë me tërësinë e elementeve të metodës krijonjëse, po, sidomos, me shkëputjen e domosdoshme prej

ndjekjes dogmatike të traditës, prej vështrimit të realitetit të ri «me syrin e shkrimtarit të vjetër», prej pasqyrimit të jetës së re me mënyrat dhe mjetet e vjetra. Pati korrente të ndryshme në mendime dhe në krijimtari. Një palë ishin partizanë të ndjekjes së folklorit dhe e ndiqnin atë në mënyrë sempliste, sidomos duke pasur përmodel krijime të mëparshme të letërsisë së shkruar. Një palë tjetër ndiqte traditën e letërsisë së shkruar kombëtare, duke e imituar e duke u munduar t'ja përshtatnin kohës; një palë e tretë gjeti mbështetje në traditën e huaj, sidomos në traditën përparimtare të letërsisë ruse e sovjetike, që nisi të njihej mirë. Pati edhe ndonjë prirje klasikezante parëndësi. Kjo tregon se të gjithë kërkonin, të gjithë interesoreshin dhe mundoheshin, sipas formimit dhe prirjeve të tyre, t'u jepnin udhë çështjeve të brendisë e të formës së re të letërsisë që po krijohej. Këtë rrugë nuk mund ta shtronte vetëm një njeri dhe aq më pak, përgjithnjë. Në çdo etapë të re të zhvillimit, këto probleme, siç e provon edhe realiteti ynë i sotëm letrar, shtrohen me forcë të re, gjithnjë e në një shkallë më të lartë.

Në viia të përgjithshme, kjo ishte atmosfera dhe këto qenë problemet e letërsisë sonë në kohën kur trokiti në dyert e saj Ismail Kadareja. Vëllimi i tij i parë («*Frymëzimet djaloshare*») të kujton edhe moshën e njomë të poëtit, edhe atmosferën letrare të asaj kohe. Në vetëvete vëllimi tani nuk ngjall ndonjë interes letrar apo ideor, povlen të përmendet përm dy arësy: si vlerë në raport me letërsinë tonë të asaj kohe dhe, së dyti, si shfaqje e parë e një personaliteti të ri, që pati e do të ketë një zhvillim të mëvonshëm. Dhe, në të vërtetë, «*Frymëzimet djaloshare*» ngjallën interesim në kohën kur u botuan Ato lanë mbresë me naivitetin dhe shprehjen direkte të një bote shpirtërore të thjeshtë e gati fëmijërore, me frymën intime të trajtimit të temave e të motiveve në mënyrë «personale», me detajimin tematik dhe më përshypjet e reja ngajeta, me embëlsinë dhe muzikalitetin e vargut në vjershat më të mira. Në vjershat e vëllimit kishte ende shumë reflekse ndikimesh të poezisë romantike kombëtare e të huaja, ndjenja dhe mendime të papëraktuara, elemente

ndikimi të poezisë standarde të kohës, gjuhë të varfër, të çalë gramatikisht, etj.

## II.

Ndërsa në vëllimin e parë Kadareja tërroqi vëmendjen e rrretheve letrare, si një poet i ri me perspektivë ndonëse nuk doli jashtë kufive të poezisë së kohës dhe notonte përgjithësisht në ujërat e leximeve e të ndikimeve letrare, me krijimtarinë e tij të mëvonshme (*Endëri met*, 1957, *Shekulli im*, 1961, *Përse mendohen këto male*, 1964, *Motive me diell*, 1968, etj) ai u formua plotësisht si një personalitet i shquar i poezisë sonë të re, ndoqi rrugën e vet të kërkimit e të krijimit të poezisë, krijoi vlera të njoitura poetike dhe, jo vetëm ndjeu ndikimet e të tjera, po edhe ndikoi në zhvillimin e poezisë sonë edhe drejt-përdrejt, edhe tërthoraz, nëpërmjet krijimit të një atmosferë diskutimi e debatesh për rrugët që duhej të ndiqte poezia. Gjatë kësaj rruge krijonjëse elemente të rëndësishme shoqërore, politike e letrare-artistike përzihen në formimin e personalitetit të poetit: zhvillimi i vrullshëm i industrisë, i qyteteve dhe i klasës punëtore, lufta e gjatë dhe e ashpër ideologjike e politike ndërmjet marksizëm-leninizmit dhe ideologjisë borgjeze e revizioniste, dalja e poetit «në botën e madhe», siç e quan ai, ngritja e nivelit të kulturës kombëtare, zhvillimi me sukses i letërsisë dhe i arteve, njojja më e thellë dhe afiniteti më i madh me poezinë e De Radës e të Migjenit, të Eseninit, Bllokut e Majakovskit, të Uitmanit, Eluarit, Ricos..., njojja me poezinë e sotme moderne, etj. — të gjitha këto doemos që do të ndikonin në formimin e personalitetit të poetit, në kërkimet ideo-artistike dhe në pëlqimet e tij. Dhe Kadareja, si një poet me natyrë të ndjeshme dhe me intuitë të hollë, ka ecur gjithnjë. Ai kurrë nuk ka qëndruar në vend, <sup>1</sup> Gjithnjë ka kërkuar e ka gjetur diçka, gjithnjë ka krijuar diçka të re, e ka parë botën «me tjetër sy», duke qënë po ai, po edhe duke lakuuar përherë të kapërcejë vetëveten, dhe duke iu larguar uniformitetit, monotonisë, ngushtësisë së motiveve, njëtrajtshmërisë në trajtimin e

tyre, varfërisë është mjetëve shprehëse. Në kuptimin e përgjithshëm dhe në tërësi, ky është një proces krijonjës pozitiv, i materializuar në krijime me vlerë si «*Endërr industriale*», «*Përse mendohen këto male*», «*Shqiponjat fluturojnë lart*», dhe në mjaft vjersha dhe poema të tjera, që do të na bjerë rasti t'i shqyrtojmë e t'i përmendim gjatë studimit.

— Në rrugën e zhvillimit krijonjës të Ismail Kadares vërehet një zgjerim i vazhdueshëm i rrethit të interesimeve të tij, një shumim i përhershëm i motiveve, një kuptim gjithnjë më i gjerë i jetës dhe i fenomeneve jetësore. Prej korieve të fshatit dhe udhëve me baltë, në të cilat qerret lënë shenja «si shkrimi i vjetër i Gjon Buzukut», nisemi për të dalë në rrugët e qyteteve të mëdha dhe në pistat e aeroporteve; prej interesimeve të ngushta studenteske, kalojmë në trajtimin e problemeve të mëdha, si çështja e luftës dhe e paqës, industrializimi, fluturimet kozmike, filozofia «eterne» e jetës njerëzore; prej pshërëtimave përdashurinë në «clirimin» prej ankthit të saj, etj. Ky zgjerim interesimesh, i lidhur ngushtë me vetë zhvillimin e poetit, përmban edhe elemente kontradiktore, po — e përsëritim, — në tërësinë e vet është një proces pozitiv dhe i frutshëm, një proces paralel me vetë zhvillimin dhe përaparimin e vendit tonë dhe të botës në përgjithësi, në këtë kohë ritmesh të vrullshme shoqërore, politike, shkencore dhe teknike.

¶ Poezia e Ismail Kadares është një poezi e gjallë, aktive. Ajo, në rastet më të mira, buron ngajeta dhe ka përmision të ndikojë në jetë përfomimin moral, politik dhe estetik të lexonjësve. Koncepti për poetin i shprehur në vargjet e përdorura në krye të këtij artikulli është një koncept aktiv, luftarak, që nuk ka vlerën e një deklarate, po shkrihet në tërësinë e krijimeve poetike. Ky koncept, që ka të bëjë me raportin e poezisë e të poetit me botën, me realitetin historik, me njerëzit, nuk ka ndjekur një vijë të drejtë, horizontale, të sheshtë në krijimtarinë e poetit, po ka pasur qartësimë dhe errësimë, forcime ose dobësimë, sipas ndikimeve, shkallës së zhvillimit dhe gjendjeve shpirtërore të shkrimtarit.

Në vëllimin «*Endërrimet*» kemi të bëjmë përgjithësisht me një qëndrim romantik kontemplativ ndaj jetës, me një intimitet dhe ngrohtësi njerëzore, ku njeriu me nauenjet, mendimet, kujtimet dhe fatin e tij vepron si një qenje e natyrshme, në mënyrë të natyrshme në natyrë dhe në kushtet jetësore të krijuara historikisht. Gjithshka objektive është e natyrshme dhe, duke qenë e tillë, kalon pa u vënë re, pa ngjallur as nervozizëm, as indiferentizëm dhe pa nxitur prirjet për filozofime. Nga ana tjetër, bota e pasqyruar në vjershët e poemat e vëllimit është një botë jo shumë e gjerë, që nuk i kalon caqet e poezisë së njohur romantike.

Ndryshe ndodh me vëllimin «*Shekulli im*» botuar kater vjet më vonë. Mendimi këtu merr fuqi aktive, sulmonjëse, ka ritëm të shpejtë, është i shqetësuar dhe nervoz, sikur poetit nuk i mjafton durimi gjersa të shohë të jetësuara idealet e veta. Njeriu bëhet vepronjës. Ai përzihet në ngjarjet e shqetësuarë të kohës, ndikon në to, i gjykon, ndikohet prej tyre, është një pjesë organike dhe e natyrshme e botës së madhe. Nga ana tjetër, edhe vetë bota e pasqyruar është më e gjerë (shumë më e gjerë se në dy vëllimet e mëparshme). Problemet që shqetësojnë poetin janë më të rëndësishme, më me peshë shoqërore. Ato janë probleme që interesojnë popullin dhe njerëzimin. Hollësitë poetike janë gjithashtu të tjera, krejt të ndryshme nga ato që gjenim në vëllimet e para. Shirave, gjethëve të vjeshtës, këngës së zogjve, etj. ua zënë vendin pistat e aerodromeve, dritat e reklamave të natës e të semaforëve, antenat e televizorëve, kurse dashurive idilike, më pshëretima, takime e ndarje romantike, ua zënë vendin takimet e ndarjet e përhershme të një «dashurie moderne», që është e bukur dhe ngjall kënaqësi të çastit, pa lënë mbresa të thella, pa shkaktuar lot e pshëretima. Ndërsa terreni i dy vëllimeve të para është zakonisht ambienti fshatarak, auditori dhe ndonjë gjë tjetër e tillë, terreni i vëllimit «*Shekulli im*» është planeti, bile në disa raste, gjithë kozmosi. Në brendinë e poezisë hyn ritmi i shpejtë, lëvizja, ndryshimi, ecja përpëra, shqetësimi dhe nervozizmi. Misteriozitetit të romantizmit, që buron nga

e kaluara, ja zë vendin shqetësimi për të ardhmen e një-  
rçimit dhe çlirimi prej anktheve të jetës personale.<sup>1</sup>

Në vëllimin «*Përse mendohen këto male*», sado që ru-  
hen shenjat e vruolleve të vëllimit të mëparshëm, poeti  
bëhet më i qetë, më i menduar, me një trishtim «të madh»,  
e sheh botën nga jashtë, si diçka në vetëvete, të pavarur.  
Në funksion të kësaj pozite, është edhe kthimi në të kalu-  
arën në mjaft krijime. Ruhet prej vëllimit të mëparshëm  
gjerësia e interesimeve, problematika e rëndësishme dhe  
karakteri i hollësive poetike, që i gjejmë edhe më vonë.  
<sup>2</sup> Poeti tani as nuk përzihet drejt për së drejti në fenomenet  
që pasqyron, as nuk bëhet nervoz e i padurueshëm.<sup>3</sup> Edhe  
shprehja bëhet më e myllur, më pak komunikonjëse, gjë  
që kapërcehet në poemën «*Përse mendohen këto male*».  
Në poezi, në vend të pasqyrimeve të gjera të fenomene-  
ve e të problemeve jetësore, çan rrugë e kërkon të zejë  
vend *simboli*, në pajtim me prirjen për ndjenja e mendi-  
me «eterne» e jo aq të përcaktuara.

Në këtë moment të ri të zhvillimit të poetit vërehet,  
ndonëse me përdorim të simboleve, <sup>4</sup> një afrim edhe më i  
madh me mjetet realiste të shprehjes poetike, saktësi më  
e madhe në shfaqjen e ndjenjave e të mendimeve, zhvesh-  
je e vargut nga figuracioni i papërbajtur dhe një lidhje  
akoma më e fortë ndërmjet momenteve poetike të reali-  
tetit, që janë pasqyruar sidomos në poema, konceptimit  
dhe mishërimit të figurshëm të temave, elementeve stilis-  
tike, që akordohen plotësisht me to dhe u nënshtrohen  
atyre.<sup>5</sup> Një përpjekje e tillë, mbështetur në një mjeshtëri  
e punë të kujdeshme artistike, u ka dhënë poemave një  
ndërtim arkitektural të përkryer dhe një individualitet ar-  
tistik të theksuar, që nuk e kemi vënë re aq tepër në kri-  
jimet e mëparshme të Kadaresë. Po të sjellim ndër mend  
poemat kryesore të vëllimit, do të vërejmë se ato janë  
të veçanta, jo vetëm se përshkohen nga motive të ndrysh-  
me dhe, në vartësi të tyre, përbajnë secila një theks të  
veçantë ideo-emocional, po edhe se poeti ka arritur një  
shkallë të atillë mjeshtërie e sigurie shprehëse, sa çdo  
poemë, sipas natyrës së temës, i ka dhënë edhe një fizio-  
nomi të jashtme të veçantë që e dallon nga të tjerat. Poe-

mat e vëllimit janë një kalim prej koncepteve e pasqyrimeve tërësish simbolike të realitetit («*Poema e blinduar*»), në gjetjen e momenteve simbolike, po me trajtim realist të motiveve («*Toka kufitare*») dhe, së fundi, si rezultati më pozitiv i këtyre përpjekjeve, — në një përfityrim e pasqyrim të përgjithësuar, të thellë, emocional dhe realist me gjerësi e më direkt të jetës («*Përse mendohen këto male*»). Edhe më vonë do të vërejmë se poeti në këtë drejtëm pozitiv do t'i përqëndrojë përpjekjet e veta dhe, në krijimtarinë e tij, do të ndjehet edhe më tepër afirma me motivet e gjalla të nxjerra nga realiteti i kohës, ndryshtë nga vëllimi për të cilën po flasim, ku bie në sy një tentim drejt së kaluarës.

Aktualiteti shoqëror e politik bëhet sundonjës në vëllimin «*Motive me diell*», ku ndihet në konkretësi gjallëria entuziaste e jetës sonë të sotme të mbushur me përpjekje, me luftë, me heroizma, si një kohë me bukuri të ashpër e të madhërishme. Në konkretësinë e motiveve të zbuluara në jetën e përditshme poeti është përpjekur të krijojë mozaikun e madh e të gjerë të realitetit socialist dhe, nëpërmjet pasqyrimeve e reflektiveve ideo-emocionale, të hedhë në vjersha e në poema vijat karakteristike të portretit shoqëror, moral e politik të bashkëkohësve, — mbartës të heroizmit e të përparimit. Ndërsa në vëllimin «*Shekulli im*» poetin e tërhoqin kryesisht temat dhe motivet me potencë të madhe filozofike dhe ndjehej prirja për t'i konceptuar kështu edhe temat intime, në këtë përbledhje poetike ai ndjek jetën në aspektet më të gjalla konkrete të manifestimit të saj dhe sikur ua lë vetë këtyre aspekteve të pasqyruara që të zbulojnë thellësinë ideo-emocionale që përbajnjë, pa qenë nevoja për figuracion të pasur dhe për deklamime tronditëse. Ky është një hap tjetër interesant drejt realizmit në poezinë lirike, që po të përpunohet më tej dhe të orientohet gjithnjë nga aspekte me rëndësi politike e shoqërore, siç është bërë në krijimet më të mira të vëllimit, do t'i sjellë poezië sonë dobi të madhe. Kjo pikënisje ngajeta e gjallë e kohës dhe afiniteti më i madh i poetit me njerëzit e punës e të përpjekjeve për ndërtimin e socializmit kanë

ndikuar edhe në shprehjen artistike të poezisë e në fisionominë e saj stilistike, që janë bërë më të qarta, më të thjeshta dhe, prandaj, edhe më komunikonjëse në një masë të gjerë lexonjësish, pa rënë në primitivizëm dhe në vulgaritetë pseudopopullore. Ndonjë prej krijimeve me rëndësi të përfshira në vëllim, si poema «*Shqiponjat fluturojnë lart*», me karakterin përgjithësonjës dhe aftësinë e shprehjes së figurëshme romantike, të kujton krijimet më të mira të kësaj natyre, që kemi ndeshur në vëllimet e mëparshme, po vërehen tek-tuk edhe vjersha, në të cilat kalohet në thjeshtëzim jo artistik, sidomos në rastet kur krijohet afinitet me motive të parëndësishme e jo tipike të jetës së sotme qytetare të një kategorie të vogël të rinjsh.

Në vija të përgjithshme ky do të ishte karakteri i poezisë së Ismail Kadaresë, zhvilluar në kohë të ndryshme, dhe, siç shihet, anën më kryesore, më të rëndësishme dhe që ze vend më tepër në krijimtarinë e tij e përbën shprehja e qartë e idealeve revolucionare komuniste, e ndjenjave dhe e mendimeve të fuqishme patriotike, e një bote shpirtërore të pastër, të shëndoshë, të gjerë, e lidhjeve të gjalla e të forta me jetën dhe me preokupimet e popullit, e pasqyrimeve të realitetit revolucionar të kohës sonë, që, ndryshe nga çdo epokë tjeter e mëparshme, karakterizohet prej një dinamizmi të paparë, prej ndryshimeve të thella, tronditjeve të mëdha revolucionare, luftave të ashpra dhe madhështisë heroike të popullit tonë, që qëndron i patundur si një grup skulptural i gdhendur në shkëmb graniti. Këtë vrull është përpjekur të pasqyrojë poezia e Ismail Kadaresë dhe e ka pasqyruar, gjer diku, jo në mënyrë të sipërfaqshme, po duke rrahur të kapë, ndonjëherë, edhe me një figurë të vetme të fuqishme, fenomene të gjera shoqërore e politike, në kompleksitetin e tyre dramatik. Ndonjëherë vërehen në poezinë e tij edhe turbullira ideore, që cenojnë vlerën e përgjithshme pozitive të veprave, po edhe në këto raste, siç do ta vërejmë më poshtë, gjithnjë atyre u është kundërvënë me ndimi i shëndoshë, që, si karakteristikë, bëhet aq më i fu-

qishëm, sa më reale dhe më të lidhura me jetën të jenë motivet e krijimeve poetike.

Ismail Kadareja është një poet aktiv në karakterin e krijmtarisë së vet. Në vjershën «Poezi e deklasuar» (ribotuar me titullin «Sfidë»), duke ju drejtuar poetëve stilizantë e të shkëputur ngajeta, ai shkruan:

*Mbi asfalt luleshqerrat tuaja — ne i shtypim. — Drejtohemti atje ku ju e ndjeni veten si mbi gjëmba — në konferencë shtypi.*

Këtë qëndrim e gjejmë edhe te Majakovski i periu-dhës së pasrevolucionit dhe është një qëndrim i drejtë, i saktë, revolucionar, bile do të thosnim, edhe novator, se ka të bëjë me një orientim të ri të poeziës, me një lidhje të hapur të saj me politikën. Po që pozita të jetë e vërtetë, vetë poezia duhet të jetë, në radhë të parë, politike. Edhe në mos qoftë e tillë në kuptimin tematik, ajo duhet të karakterizohet, në tërësinë e vet dhe në aspektet e veçanta, nga një qartësi dhe qëndrueshmëri klasore e shëndoshë, që jo në kuptimin vulgar, po në kuptimin e vërtetë shoqëror, drita e politikës të depërtojë edhe në trajtimin e temave intime dhe t'i përcaktojë ato. Kështu po ndodh në jetë. Tipi letrar e, në mënyrë të veçantë, *heroï lirik* i poeziës, në çdo aspekt që të merret, është heroï i përparuar i kohës sonë, komunisti dhe punëtori revolucionar, ndërmjet idealeve dhe jetës së të cilit nuk ka kontradiktë. Edhe në qoftë se në jetë hasim shfaqje të kundërtta me këtë, është detyrë e letërsisë, që, duke kapur fillin kryesor, të ngrihet mbi rastet e zakonshme, të nxitë e të edukojë të renë revolucionare, duke e përgjithësuar, pa harruar kurrë perspektivën.

Poezia lirike nuk është një ditar personal i poetit. Ky do të ishte një kuptim i ngushtë, primitiv dhe jo shoqëror i poeziës. Poezia është mjet komunikimi me njerëzit, mjet ndikimi te njerëzit. Nga fakti se ç'u komunikon njerëzve dhe në ç'drejtim ndikon tek ata, përcaktohet edhe karakteri i poeziës, vlera dhe rëndësia shoqërore e saj. Sa më të rëndësishme të jenë temat, sa më reale pasqyrimet, sa më të drejta pozitat e sa më e kuptueshme shprehja e tyre, aq më me vlerë shoqërore është poezia. Elementi

personal në poezi merr vlerë shoqërore në qoftë se ngrihet në nivelin e shembullit, të elementit tipik të jetës shoqërore, të vlerës së lartë morale e politike. Ndryshej mund të jetë vetëm një kuriozitet, një intimitet i zakonshëm i poetit me lexonjësin për të fshehtat e jetës së tij, gjë që, edhe kur është shoqërisht e pranueshme, nuk e forcon, po e ul vlerën shoqërore të poezisë. Kështu ndodh me temat. Kështu ndodh edhe me ndjenjat, mendimet, me qëndrimet, në të cilat do të dallojmë realist subjektivistin e «luleshqerrakun» nga poeti që «*drejtohet në konferencën e shtypit*». Individ i mbyllur në vetëvete, që shpreh vetëm vetëveten dhe që i përket vetëm vetëvetes nuk mund të jetë poet revolucionar. *Poeti është personalitet shoqëror*. Ai, nëpërmjet veprës së vet, i kthehet popullit si *njeri shoqëror*, sadoqë në formë individuale. Vlera e ndjenjave dhe e mendimeve të tij «personale», pra, në thelb, e gjithë krijimeve të tij, përcaktohet nga raporti i asaj që është «personale» me atë që është shoqërore, sadoqë çdo anë «personale» është shoqërore dhe çështja shtrohet për të parë c'karakter shoqëror ka dhe jo në është apo s'është e lidhur me shoqërinë. Mefjalë të tjera, çështja është se deri në c'shmollë përfaqësojnë poetët ndjenjat dhe mendimet e pjesës më të përparuar të kohës së vet. Poet që prin është ai që qëndron pa lëkundje në pozitat më të përparuara, që kap problemet themelore të kohës dhe ndikon me veprën e vet përnjë kuptim sa më të drejtë e sa më shoqëror të fenomeve të jetës.

Në këtë drejtim poezia e Ismail Kadares përmban në vetëvete një kontradiktë, që është, në fund të fundit, një kontradiktë objektive, me të cilën ndeshemi shpesh gjatë luftës ideologjike, që po zhvillohet sot në terrenin e shoqërisë sonë, ndërmjet botëkuptimit dhe psikologjisë së re dhe ideologjisë e psikologjisë së vjetër. Ndërsa në shumë gjëra kryesore poezia e Kadaresë e kapërcen me sukses këtë kontradiktë në dobi të një mendimi të thellë e të shëndoshë shoqëror proletar dhe ai ngrihet në nivelin e përfaqësonjësit të idealeve më të përparuara shoqërore e politike të kohës, në raste të tjera ai — edhe duke i ku-

ndërshtuar, — bie në pozita subjektiviste ose, pa e kuptuar, nën ndikimin e prirjeve ideore e psikologjike mikroborgjeze. Në këto raste poezia nuk përfaqëson më forcat e përparuara të shoqërisë sonë dhe idealet e tyre, po pikëpamje dhe ndjenjat subjektiviste.

Problematika kryesore drejtonjëse e poeziës së Ismail Kadaresë, ajo që i jep asaj një vend të veçantë në letërsinë tonë të sotme, është problematika e përgjithshme politike e filozofike, të cilës i kushtohen edhe krijimet më me rëndësi të poetit.

Ai, më tepër se çdo poet tjetër i sotëm, e hedh vështrimin në një horizont të gjerë interesimesh poetike, preukupohet dhe gjen frymëzim në aspektet më të ndryshme të jetës së sotme njerëzore, kërkon të hyjë thellë në proceset e mëdha historike të shekullit tonë, do të thotë fjalën e vet për gjithshka që e shqetëson, ka një interesim gati fiziologjik përfatet e njerëzimit, u jep kuptim filozofik të gjitha manifestimeve të jetës dhe krijon përshtypjen e sigurisë përfunduese shqetësim të reflektuar edhe përfundim të shprehur. Në vija të përgjithshme, si një element ideor me rëndësi, në gjithë poezinë ka depërtuar mendimi themelor mbi kuptimin revolucionar marksist-leninist të proceseve të mëdha politike të kohës sonë dhe bindja, se vetëm nëpërmjet revolucionit bota do të transformohet dhe planeti do të pastrohet «*nga kolonializmi, zinxhirët, poshtërimi*». Mbështetje kryesore përfundimtare bindje janë përfundimtare revolucionare e popujve dhe qenja përballet botës imperialiste e vendave socialiste, që përfaqësojnë të ardhmen e njerëzimit. Ai sheh se:

«*Në të katër horizontet digjet flamuri i kuq, — era e lindjes zotëron mbi erën e perëndimit*» dhe «është» i sigurt që:

«*Bota në dy kampe e ndarë — dhe ti — vetëm një je ti, — por komunizmit i përket ti, — shekulli im i ri*».

Një vend me rëndësi në konceptin e përgjithshëm poetik mbi botën, mbi jetën njerëzore dhe zhvillimin e saj zë lufta dramatike e të kundërtave, ndeshjet historike ndërmjet të vjetrës dhe të resë, të konkretizuara në ashpërsinë e dy kampeve kundërshtare të epokës sonë dhe

në luftën ndërmjet forcave revolucionare dhe reaksionit, ndërmjet të cilave, nëpër mjegull, gjatë shekujve, në bar-kun e kalit të drunjtë, ka trouar tradhëtia. Poeti ka besim në të ardhmen e njerëzimit dhe në forcat e mrekullueshme krijonjëse të tij, që janë në gjendje të ulin në tokë edhe Arushën e Madhe, ashtu siç ulin pleqtë në tryezë dopio gjashtën. Bota e vjetër për të është bota e vdekjes dhe vdekjes i përket ajo. Poeti aq i shqetësuar për fatet e njerëzimit dhe i prekshëm para çdo humbjeje njerëzore, në këtë rast mban qëndrim afirmonjës ndaj vdekjes, e cila përtërin jetën dhe e bën më të bukur.

«*U desh të zbulukeshin përbindshat — që te kjo botë të vije ti*» — i thotë poeti vajzës, siç do t'i thoshte gjithë jetës së re.

Në mënyrë më të konkretizuar dhe ideologjikisht e poetikisht më të përcaktuar, ky koncept i përgjithshëm mbi botën e mbi jetën është dhënë nëpërmjet reflektimit në vjersha e poema të fateve historike të Shqipërisë, gjë që dëshmon edhe një herë që sa më i vërtetë, më i gjallë dhe më i ndjeshëm nga ana shoqërore e politike të jetë frymëzimi, aq më qartë e më me përgjegjësi pasqyrohet në vepra letrare, në të cilat spekulimet filozofike zor se mund të gjejnë vend. Historinë e Shqipërisë, sikurse historinë e njerëzimit, poeti e ka parë nëpërmjet luftës së të resë me të vjetër, të të shtypurve kundër shtypësve, të forcave përparimtare kundër reaksionit në dy etapa historike krejt të kundërtë: në të kaluarën, kur populli ishte i shtypur dhe në të sotmen kur populli është sundimtar. Ky koncept është mishëruar më së miri në poemën «*Përse mendohen këto male*», në të cilën, duke u mbështetur përgjithësisht në motive të trajtuar edhe nga Migjeni, poeti ynë ka hedhur një hap me rëndësi përpara, duke shkrirë motivin shoqëror të luftës së të kundërtave, të urrejtjes për «botën e vjetër» e të dhembjes për të mjerët me motivin e atdhedashurisë e të shpirtit luftarak e liridashës të popullit, duke dhënë si dy simbole të mëdha të së kaluarës sonë mjerimin dhe pushkën, urrejtjen për shtypësit dhe luftën për mbrojtjen e Atdheut.

*Sa histori e dhimbëshme, ç'rrugë bëmë nëpër shqo-*

të — gjer tek kjo vajzë e ky djalë q'ecin të përqafuar nën blire — gjer tek këto pista të drejta e të pafundme aeroportesh — lexojmë në vjershën «Çfletoj historinë» dhe, mbi pirgun e madh të historisë së dhimbshme e luftarake të popullit, në jetë e në poezi, ngrihet madhështore një forcë e re: Partia Komuniste, që në poemën «Përse mendohen këto male» përmendet vetëm në vargun e fundit, si një finale e madhërishme, që ka forcë t'i kundërvihet gjithë «historisë së dhimbshme» të së kaluarës. Vargu:

*Dhe Shqipëria priste Partinë Komuniste — që mbyll poemën, ka forcën e një fillimi të madh, ngjan si praku i një epoke të re, «se ka një forcë të madhe — sot Shqipëria — q'u shtohet maleve, stuhive, krenarive — të saj, — forcë e re: — Partia!»*

Shpeshherë nëpërmjet kontrasteve midis të kaluarës e të sotmes, elemente të të cilave gjenden edhe në realitetin e në psikologjinë e ditëve tona, poeti ka dhënë zhvillimin dhe ka konkretizuar idelet tona shoqërore.

Në vjershën «Bjeshkët e namuna» lexojmë:

*Kulla të gurta, — dritare të vogëla, — frëngji të ngushata — sikur kanë picërruar sytë nga kjo hapësirë pa mbarrim. — Përse, me sy kaq të vegjël e shikoje vallë — botën e madhe, o vendi im?*

Kurse në poemën «Shënime për brezin tim» shpërthen entuziazmi:

*«Këta tela tensioni të lartë, që zgjaten pa kufi, që si nuse të stolisin, — janë nervat e tua të ndezura, — nervat e tua me çelik salduar — nervat e tua të hekurta, — Shqipëri» dhe vjen koha, kur qeleshet e bardha të shqiptarëve i duken poetit si një «buzëqeshje mbi botë», si një gjëzim i ri mbi botën e vjetër.*

Por, në poezinë e Ismail Kadaresë, sado entuziaste dhe afirmonjëse të jetë ajo, rrallë gjejmë një ndjenjë të vakët kënaqësie nanuritëse ose një madhështi të jashtme, pa thellësi mendimi e ndjenje. Ai ka mundur, në krijimet më të arrira, të depërtojë në dialektikën revolucionare të jetës dhe në njohjen e luftës për realizimin e idealeve të larta, si aktin më sublim të forcave të reja, kundër vjetërsisë së shekujve dhe monstruozitetit të sotëm kapitalist, mbasi

*«qielli nuk pastrohet, — siç, duke hapur kanatat, — pastrohet mëngjezeve — një kafene».* Këtë qëndrim revolucionar e gjejmë të pasqyruar jo vetëm në trajtimin e problematikës shoqërore të vendit, po edhe në ato vjersha e poema, sidomos të vëllimit *«Shekulli im»*, që u kushtohen motiveve me një shtrirje ideo-emocionale më të gjërë dhe me një kuptim politiko-filosofik më të madh, siç janë vjerashat e poemat kushtuar shekullit XX, problemit të luftës e të paqes etj.

Në karakterizimin poetik filozofik të shekullit të XX Ismail Kadareja, si edhe në rastet e tjera, nuk është kënaqur me ato vlerësimë të sipërfaqshme deklarative, që kemi ndeshur shpesh në vjersha e poema të ndryshme. Ai është munduar që të japë një përfytyrim poetik sa më të thellë, më kompleks dhe më emocional të epokës, duke u përpjekur të zbulojë dallimet e saj nga epokat e mëparshme, rapportet shpirtërore të njerëzve të kohës me shekullin e tyre dhe, në këtë kompleksitet, të gjejë anën më emocionale, që do të ishte edhe filli ideor drejtanjës i vlerësimit ideo-emocional. Dhe, siç është përcaktuar shpesh, shekulli XX është epoka e fundit të pashmangshëm të imperializmit, që po kalon krizën më të madhe të historisë së vet dhe e fitores së pashmangshme të lëvizjes revolucionare të klasës punëtore e të popujve të shtypur, që janë në ofensivë dhe, siç thotë poeti, do ta *«pastrojnë këtë planet nga kolonializmi, zinxhirët, poshtërimi»*. Prandaj, me gjithë kontradiktat e thella, shqetësimet dhe kompleksitetin e situatave, për poeten shekulli XX është shekulli i komunizmit. Kjo ide themelore është shprehur qartë në vargjet:

*«... Bota në dy kampe e ndarë — dhe një — vetëm një je ti! Po ti i përket komunizmit — shekulli im i ri! ...».*

Kjo është via themelore, po duke hyrë në kompleksitetin, në shqetësimet dhe, duke u munduar të na japë një përfytyrim ideo-emocional edhe më të konkretizuar dhe më *«të paanshëm»*, Kadareja u është larguar vlerësimeve themelore, kur ka parë në shekullin tonë vetëm kulmet e zhvillimit teknik të tij dhe jo kontrastet e thella, kur e ka përfytyruar si një *djalë* të *veshur me këmishë nailon apo*

*me svitër, që pi koktej, apo edhe kur na ka dhënë imazhe sugjestjononjëse, si në vargjet e mëposhtme:*

*Kush mund të mbarojë portretin tënd të ngatërruar-shekulli XX? — Të vizatojë zjarrin dhe tymin e flokëve të tu, — shkëlqimin atomik të syve viganë, — frysëmarenjën reaktive, — gjëmën e elektroneve, — dhe rrëzeve të radarit, — që vërshojnë në dejt e tu anembanë?*

Ky «portret» sugjestiononjës largon vëmendjen prej proceseve themelore politike e shoqërore të shekullit dhe nxjerr në plan të parë atomin, reaktivin e radarin, siç nxirren në të tjera raste antenat e televizorëve, pistat e aeroportave, etj. Dhe pas kësaj, vjen një gabim tjetër:

*— Sot qiejt dhe kontinentet — vështrojnë njëri-tjetrin — me syrin e mjegullave — me majat e raketave, ardhëtë vëllazërimi, — i qiejeve dhe i kontinenteve, — i brigjeve dhe ujërave, — i lartësive dhe thellësive, — i largësive dhe afërsive, — i njerëzve dhe i njerëzve!*

Ky predikim, i shprehur në formë klasike predikimesh, është i gabuar dhe në kundërshtim me vlerësimin revolucionar të kontradiktave të kohës së sotme dhe të rrugës pér çlirimin e njerëzimit.

Kulmi i këtij shqetësimi nervoz, që vjen nga humbja e fillit kryesor në vlerësimin e gjendjes dhe të së ardhmes së njerëzimit dhe të karakterit e të pasojave të një lufte të mundshme, arrihet në poemën e ripunuar «*Paqen do ta imponojmë*», me të cilën kalojmë në një tjetër problematikë të rëndësishme: në problematikën e luftës e të paqes në kohën e sotme, ku dallojmë *aspektin patriotik* dhe *aspektin e përgjithshëm*.

Në aspektin patriotik qëndrimi i poetit është i drejtë, luftarak e mobilizonjës, një qëndrim që kundërshton në mënyrë të vendosur kaosin, frikën e panikun dhe bën të rrezëllojë në vjersha e poema realiteti i ashpër i kohës dhe heroizmi i popullit të gatshëm pér të mbrojtur Atdheun e vet socialist. Pér këtë qëllim të lartë «*që në bark të nënës fëmija, — si ushtar është radhitur në rrjeshta*» dhe «*në furrënalta do t'i hidhnim — shpatat e vjetëra, — që ne t'i shkrijmë pér Atdhenë — t'i bëjmë raketa*», kundër pikëparnjës së sotme të rreme të revisionistëve, të cilët kanë

hedhur parullén çarmatosëse «t'i kthejmë shpatat në parmanda». Populli ynë, i rrahur në dallgët e egra të historisë, e kuhton qartë falsitetin e kësaj pikëpamjeje të atyre, që, duke çarmatosur popujt, kërkojnë të sundojnë përjetësish mbi ta, mbasi, siç thotë poeti, gjatë gjithë historisë: «...s'na u ndanë armiqtë. — Të neveritëshmit, barbarët — armiqtë. — Agresorët, të dobëtit — armiqtë. — Të pabesët, provokonjësit — armiqtë. — Shekullorët, të mundurit — armiqtë. — Edhe një herë t'i goditim — armiqtë!»

Prandaj poeti, duke u bërë interpret besnik i ndjenjave popullore, premtón me solemnitet:

«Sikur, Atdhe i shtrenjtë, — t'i thërrasësh brezit tonë: — Radhën ke! — Për ne alarmi yt do të jetë i shenjtë, — do jetë ligj për ne» dhe, në mënyrë romantike po kuptimplotë shton se:

«Minat në s'mjaftofshin — shpirrat tona si mina do të vendosim, — fushave të pambaruara — që ti (armik) të mos kalosh».

Ky shpirt luftarak na bën për vete e na frymëzon, jo vetëm se lidhet drejtpërdrejt me interesat e vendit tonë, po edhe se shpreh bindjen tonë të përgjithshme mbi kuptimin dhe karakterin e luftës, konceptin tonë mbi domosdonë e luftës e të sakrificave për mbrojtjen e Atdheut e të fitoreve të revolucionit.

Në mënyrë të pakushtëzuar poeti thotë:

«Ty, Atdhe, të gjitha të përkasin: — Jeta ime, — èndrrat, fantazitë...»

Edhe në aspektin e përgjithshëm, në një prej krijimeve poetike, shprehet ky mendim themelor i drejtë:

— Kapitali — duke parandjerë netët e fundit të agonisë — me vete botën e tërë deshte të zvarrisë, — në një kaos gjaku e ulurimash tragjike.

Ky është burimi i vërtetë i luftës: imperializmi, dhe gjykimi i poetit i përgjigjet vlerësimit të përgjithshëm marksist-leninist të këtij fenomeni. Po, menjëherë pas kësaj, vijnë «grindjet e shteteve», «mëria e tyre», rrëmuja e kaosi, që sunduaka botën.

Ekziston një mendim, sipas të cilit poezia nuk u dash-

ka vlerësuar me rreptësinë e vlerësimit të traktave politike dhe ideologjike. Ky është një koncept i gabuar dhe shumë i dëmshëm. Poezia, kur pretendon të trajtojë probleme ideologjike e politike, në radhë të parë, do të vlerësohet si e atillë. Specifika artistike nuk lë shteg për lëshime ideologjike. Ajo nuk është kryesore. Ajo nuk mund të jetë as qëllim në vetëvete, po vetëm mjet për shprehjen më të saktë dhe më ndikonjëse të të vërtetave ideologjike e politike.

— Aparatet e ftohta, si ndër ethe, — drejtoheshin drejt pikave të largëta mbi botën, — trajektorët fatale — vdekjen në çdo pikë do të çonin zvarrë, — si një tren të përmotshëm mbi binarë, — trajktoret përpjete ajërin do të plagosnin anembanë, — dhe nga trupi i planetit, — si nga një plagë kozmike — do të pluskonin të gjaktat shatervane.

Ky përfytyrim nuk është revolucionar dhe heroi lirik i poeziës së Ismail Kadaresë, duke u ngritur mbi këto, thërrret me zë kumbues prej luftëtarë:

Ne... fitimtarë — nga fushat e betejave do të kthehem — plot flamurë të kuq — dhe fasha të bardha... — Në kaltërsitë e mëngjezeve të ardhme, — do të kridhem, — në gjokset njerëzore drejt nga gjiri i vdekjes — do të hidhem — se:

— Nderin e Atdheut — më lart se këto male e mbajmë!

Poeti është krenar për popullin dhe Atdheun e vet. Në shumë krijime të bukura ai i ka kënduar me zjarr lavdisë së lashtë e të re, është entuziazmuar nga revolucioni dhe, si një element të fuqishëm lëvizës të historisë së re shqiptare, që shkrihet me ndjenjat e atdhedashurisë e të krenarisë kombëtare, ka parë partinë, mishëronjëse e gjithshkaje të bukur, realizonjëse e ëndrrave më të guximshme. Karakteristike është, se edhe në këtë aspekt sublim, poezia e Kadaresë nuk bëhet as sentimentale, as pompoze, po ruan si gjithnjë një karakter aktiv luftarak. Për të:

— Atdheu është — gjeneratat e shqiptarëve, që përjetësisht lëvizin mes shekujve...

— Betonarmeja e ëndrrave të vjetëra dhe të reja, — muzgjet e shkuara dhe mëngjezet e ardhme.

— Atdheu: një milion diej mbi këtë tokë! Është shqiptari që:

— Nëpërmjet shënjestrës së pushkës së tij — ...vështronë horizontet dhe kohërat, — vërvëllima e vetmuar e malipherit të tij — detyronte shekujt të ulnin kokat — është toka që «më shumë heroizma se sa grurë — ka prodhuar gjatë shekujve». Ai është sot «buzëqeshje përmbi botë», prandaj poeti, duke vështruar pasaportën e vet, krenohet e thotë:

— Në vend të huaj, shesheve të huaj, — si copa të prera nga rrafshirat e vendit tim, — mbaj në xhep këto fletë, — ku gërmat kanë lulëzuar, — ku mbi kapak — RPSH — është shtypur plot shkëlqim.

Dhe, krahas kësaj dashurie e krenarie për të kaluarën e lavdishme dhe të sotmen revolucionare, si një pikë kulmi i të gjithë poezisë me këto motive janë vargjet:

... ka një forcë të madhe — sot Shqipëria, — q'u shton maleve, stuhive, krenarive — të saj — forca e re: — Partia!

Vend me rëndësi në poezinë e Ismail Kadaresë zë edhe trajtimi i motiveve intime, në të cilat është shprehur me forcë qëndrimi i vendosur i poetit kundër moralit feudal e borgjez dhe kundër meskinititet familjar mikroborqjez. Në poemën «*Ëndërr industriale*», nëpërmjet imazhesh të përgjithësuara romantike, poeti ka pasqyruar vijën kryesore të transformimit të njerëzve e të shqelmimit të paragjykimeve patriarkale e të mentalitetit të prapambetur nën ndikimin e përparimit të vendit, sidomos të industrializimit e të klasës punëtore. Si rrallëkush tjetër në letërsinë tonë të sotme Ismail Kadareja ka ndjerë, ka kuptuar dhe ka pasqyruar atë ndikim revolucionarizonjës të industrializmit, jo vetëm në prodhim, po edhe në mënyrën e jetesës, në mentalitetin dhe në psikologjinë e njerëzve. Qyteti industrial, vajza që zbret nga malësia dhe bëhet punëtore, plaku i shqetësuar dhe i hakërryer janë elemente reale të luftës, që zhvillohet sot në jetën tonë, siç është reale

edhe rruga që marrin ngjarjet. Këto imazhe, në mënyrë më të zërthyer e më të konkretizuar, po gjithnjë në trajtën e figurave romantike të përgjithësuara, gati si simbole, do t'i gjejmë më vonë edhe në romanin «Dasma». Bindja e potit eshtë se:

— Korrenti — çdo kalbësirë dhe ndryshk do përcëlllojë, — si çelik i shkrirë i ndritshëm, — i pastër — nderi proletar do rrezëllojë.

Në «Ëndërr industriale», po të lëmë mënjanë ndonjë vërejtje anësore, ndihet fryma proletare e Shqipërisë së re socialiste, ngadhnjimi i saj mbi çdo kalbësirë e ndryshk dhe, nëpërmjet kësaj lufte, afirmimi i botëkuqumit dhe i moralit të ri proletar, komunist. Këtë pozitë mban në përgjithësi poeti dhe qortimet që i bëhen se i shtron në mënyrë të mprehtë problemet, nuk janë veçse një thirrje për qëndrime sentimentale dhe për kompromis me të vjetrën, me ndryshkun dhe kalbësirën. Ai ka të drejtë. Ai shpreh një mendim të shëndoshë, të përparuar. Ai përfaqëson tendencën objektive të zhvillimit të shoqërisë sonë, të ardhmen e saj. Eshtë rasti vetëm që, duke përvendetur këtë afinitet të poetit me industrializimin e vendit, të vërejmë se në disa vjersha të tij ky *industrializim* sikur «çlirohet» nga kushtet konkrete historike në të cilat kryhet.

Në letërsinë tonë të mëparshme, sidomos në poezi, vërehej një fenomen i tillë: shkruhej për kanale vaditëse, për fabrika, etj., dhe u këndohej atyre me entuziazëm. Ky entuziazëm ishte i natyrshëm dhe i ligjshëm, po a ishin kanalet dhe fabrikat në vetëvete gjëja kryesore? Kanale e fabrika — edhe më të mëdha se tonat, — janë ngritur e ngrihen edhe në vendet kapitaliste. Kryesore eshtë ndërtimi i socializmit dhe fabrikat janë vetëm elementë të këtij ndërtimi. Ky eshtë edhe objekti kryesor i poezisë, në këtë rast. Këtij objekti të përgjithshëm i nënshtrohet gjithshka e veçantë. Kështu ndodh në jetë dhe s'ka pse të ndodhë ndryshe në poezi. Kapërcimi i prapambetjes teknike tek ne kryhet në procesin e transformimit socialist të shoqërisë e të njerëzve. Entuziazmi për fabrikat dhe uzinat, që ndërtohen, eshtë një gjë e mirë, po kultivimi i bindjes se këto uzina e fabrika janë *tonat*, të popullit, të punëtorëve eshtë

gjëja më me rëndësi shoqërore, qoftë në kuptimin e pasqyrimit të realitetit, qoftë edhe në kuptimin e ndikimit ideo-edukativ të letërsisë, sidomos kur kemi parasysh që klasa jonë punëtore është relativisht e re dhe formohet e shtonhet nga elementë që vijnë nga shtresa jo proletare.

Këtë mungesë, jo në trajtën e dikurshme primitive, e gjejmë në thelb edhe në poezinë e Ismail Kadaresë, në të cilën kemi një trajtim të drejtë si tendencë, po të mangët të problemit. Kjo ka ndikuar edhe në shumë poetë të rinj të ditëve tona.

Poezia e Ismail Kadares qëndron në pozita konsekutive në luftën kundër mentalitetit dhe psikologjisë së vjetëruar patriarchale e konservatore. Në vjershën «*Nuset me duvak*» ai shtron një problem me rëndësi të jetës sonë të sotme shoqërore, problemin e domosdosh së ndryshimit të mentalitetit e të psikologjisë e jo të formave, që shërbejnë vetëm për ta veshur mentalitetin e vjetër me një petk të ri, pa prekur esencën e tij të vjetëruar. Kjo poezi është edhe një kundërshtim i hapur dhe i vendosur i shpirtvo-gëlsisë mikroborgjeze në marrëdhënjet e dashurisë dhe në lidhjet familjare. Ai është kundër dashurive me llogari dhe «dashurive të vogla», që kërkojnë t'u kthehen fotografitë.

*Mohimi* është i drejtë. Poezia, edhe në këtë rast, shpreh tendencën e zhvillimit objektiv të shoqërisë, është mbartëse dhe përfaqësonjëse e mendimit të përparuar të kohës. Po nuk mund të themi të njëjtën gjë edhe për *pohimin* që bëhet në shumë vjersha e poema, të cilat zënë mjaft vend në vëllimet e botuara të Kadaresë.

— Në «*Endërrimet*» problematika e dashurisë ka një karakter pothuajse krejt intim, pa ndonjë pikësynim dhe theks të dukshëm shoqëror, prandaj poezia kushtuar kësaj teme, edhe kur është e bukur, nuk ngjall ndonjë interes të veçantë. Në letërsi, çdo temë ka vlerë kur ka karakter shoqëror, kur trajtohet në mënyrë *shoqërore*, duke u theksuar ato anë të saj, që tërheqin më tepër vëmendjen në një kohë të caktuar. Tema e dashurisë, si tema më intime, nuk del jashtë caqeve të natyrës së përgjithshme të letërsisë. Ndryshtë, siç ndodh shpesh, në krijimtarinë me tema shoqërore e politike do të kishim një letërsi revolucionare, kur-

se në poezinë e dashurisë (gabimisht quhet *erotike*) një kri-jimtari me tendenca subjektiviste mikroborgjeze.

Një gjë e tillë është vërejtur me kohë në poezinë tonë, në të cilën motivi i dashurisë ka qenë në shumë raste një fole e meskinititetit mikroborgjez apo e një individualizmi të pakontrolluar, që po të vihej përballë pjesës tjetër të poezisë, që frymëzohej prej idealesh të mëdha shoqërore e politike, ose tingëllonte krejt e huaj, ose kishte një karakter të rremë stilizant artificial. Kjo kontradiktë, veç të tjerrave, e ka burimin në shpërpjesëtimet e zhvillimit të anëve të ndryshme të ndërgjegjes shoqërore dhe në iluzionin mikroborgjez se ndjenjat intime të njerëzve qenkan «të pavarura» nga kushtet shoqërore dhe nga shkalla e zhvillimit historik. Që të prishej kjo fole mikroborgjeze, e cila ka raste që bëhet shkak konfliktesh të paqena ndërmjet poetëve e botonjësve, ishte e domosdoshme që edhe në motivin e dashurisë të frynte një erë tjetër dhe të depërtonte ndërgjegjja shoqërore e politike e njerëzve të socialist, duke pasur si bazë e si shëmbull, edhe në këtë rast, jo reflekset e një qytetërimi të përciptë, po ndjenjat e thella të njerëzve të rinj, të mbështetura në çlirimin prej prangave të interesave materiale, të egoizmit dhe të hipokrizisë borgjeze apo të fanatizmit patriarkal.

Ismail Kadareja ka bërë përpjekje të shumta për ta kapërcyer këtë kontradiktë dhe ka arritur disa rezultate me rëndësi edhe në këtë drejtim, qoftë duke i çliruar marrëdhëni e dashurisë prej kanuneve të mykura të kohës së kaluar, qoftë edhe duke u ngritur me zemërim kundër «taksimeve barbare të dashurisë». Ai është shprehur edhe kundër kuptimit meskin të dashurisë, kundër lidhjeve të saj me interesat e vogla të çastit dhe me llogarinë. Në përfundime të tilla ai ka arritur në mënyrë të natyrshme, duke u nisur si shumë të tjerë prej përfytyrimeve romantiqe të moshës, kur njeriu shkruan për dashurinë i nxitur më tepër nga instiktet e nga ndikimet letrare, se sa nga përvoja e jetës.

Heroi lirik i poezisë së dashurisë në «Endërrimet» është një djalosh i mbyllur, i prirë drejt dashurisë në mënyrë të pastër, po edhe të ndrydhur e të ndrojtur. Kjo da-

shuri lulëzon netve me hënë ose kur bien gjethet apo çelin lulet korieve, në një ambient idilesh fshatarake. Pra, nga pikëpamja shoqërore, përveç ndonjë qëndrimi qortonjës ndaj plakave, që ka pasur vend prej kohe në letërsi, nuk kemi ndonjë gjë të re, ndonjë hap përpara, në krahasim me letërsinë e të kaluarës ose të asaj kohe. Edhe nga pikëpamja artistike (nuk është fjala këtu për aftësitë e autorit, por për natyrën e krijimeve) nuk vërehet ndonjë zhvilim i mëtejshëm në krahasim me gjithë letërsinë romantike kushtuar kësaj teme, përveç disa elementeve që tenojnë drejt një realizmi «sui generis» në poemën «*Ngjarje në pushime*» e në ndonjë vjershë tjetër.

Në krijimtarinë e mëvonshme të Ismail Kadaresë, sidomos në vëllimin «Shekulli im» kemi një kapërcim të dukshëm në trajtimin e temës së dashurisë, si në kuptimin ideor, edhe në kuptimin artistik. Poezia bëhet më shoqërore, nuk është një këngë e përsëritur për takimet e ndarjet. Ajo pretendon të mohojë e të pohojë diçka në konceptet dhe qëndrimet shoqërore ndaj dashurisë.

Në vjershën «*Dashuria*», duke folur kundër atyre forcave e koncepteve të vjetëruara, që e «taksojnë rëndë dashurinë», poeti shkruan:

— *Ngrenë kundër teje — pushkën, shkopin, mallkimin. Duan të të shtypin — me syndyqet e pajave, të të marrin frymën — me dysheqet e jastëkët e qendisur. Hedhin — baltën e zezë të shpifjeve mbi rrobën tënde të bardhë.*

Kjo protestë është e drejtë dhe, bashkë me ato që shënuam pak më lart, përfaqëson anën pozitive në qëndrimin e poetit ndaj problemeve shoqërore të dashurisë e të familijes në kohën tonë. Kundrejt këtij mohimi, poeti vë konceptet «e reja» për dashurinë. Në vjershën «*Pizhamet dhe aeroportet*» ndeshim në këtë mendim të përgjithshëm të poetit mbi dashurinë — mendim, të cilin e gjemjë të reflektuar pastaj në të gjitha vjershat dhe poemat e kësaj natyre:

— *Ka dashuri të vogëla — dashuri të para (nr. 1) —*

*dashuriza — që zukatin në kujtesë pos i miza, — që bëjnë kakao — që lajnë kanatjere; — ka dhe dashuri të mëdha, të lira si era, — mbetur tutje-tëhu nëpër botë anembanë, — që s'na dinë ku jemi, — që s'i dimë ku janë.*

Nga lufta e drejtë për ta çliruar dashurinë dhe marte-sën prej prangave të llogarisë e të paragjykimeve — luftë që zhvillohet objektivisht në jetën tonë, ndaj edhe gjen pasqyrim në letërsi — shpesh kalohet në përpjekje për ta «çliruar» dashurinë prej detyrimeve morale shoqërore, — gjë që ndeshet edhe në jetën tonë, jo si diçka e re, e shëndetshme, po si një refleks i qëndrimeve borgjeze, egocentriste, si një ndikim i mënyrës perëndimore të jetesës. Këtë reflekse e ndikime letërsia ka për mision t'i luftojë e jo t'i reklamojë, siç ndodh disa herë me heroin lirik të vjershavë të Kadaresë, që vërtet kundërshton me vendosmëri patriarkalizmin dhe meskinitetin mikroborgjez, që manifestohen akoma në shoqërinë tonë në forma komike e dramatike, po nuk është ai që do të përfaqësonë idealet e shoqërisë së sotme as në kuptimin e dashurisë, as në kuptimin më të përgjithshëm të fjalës.

Përkundrazi, një tjetër hero do të ishte ai, që do të sakrifikohej për Atdheun, do të përballonte me burrëti vështirësitë dhe do të lartësohej si shembull heroizmi! Dhe ky nuk është një hero imagjinar, as edhe një përfytyrim i idealizuar i njeriut të së ardhmes. Ai është bashkatdhetari ynë i sotëm revolucionar, që me kohë ka gjetur vend në letërsinë e realizmit socialist, si shprehësi më tipik i idealeve ideo-estetike të shoqërisë e të letërsisë sonë. Ky hero, me botën e tij të madhe të ndjenjave e të mendimeve, me raportet e reja ndaj jetës, me veprimtarinë e me fatin e tij në jetë, ka hyrë që në krijimet më të hershme edhe në veprën poetike të Ismail Kadaresë dhe është pikërisht bota e madhe e këtij njeriu, që u ka dhënë vjershavë e poemave tingullin kryesor ideo-emocional. Nëpërmjet tij është zbuluar në vepra patriotizmi, shpirti luftarak, qëndrimi entuziast ndaj realitetit socialist, etja përparrim, besimi në të ardhmen komuniste të njerëzimit. Fizionomia e këtij heroi të përgjithësuar lirik është viza-

tuar nëpërmjet reflektimit të botës shpirtërore të luftëtarëve të lirisë, të komunistëve, të brezit të ri të vendit tonë, të punëtorëve e fshatarëve, të njërzëve me vullnet të hekurt e të heronjve të luftës e të punës, të cilët kanë forcë e besim të zgresin në tokë Arushën e madhe, të montojnë diej në qellin e Atdheut, të mposhtin tërmete, të sundojnë mbi fatkeqësitë, të jasin edhe jetën për t'i shërbyer popullit, të venë shpirtin e tyre si minë në fushën e betejës për mbrojtjen e Atdheut, të pastrojnë botën nga zinxhirët e poshtërimi, të luftojnë e të fitojnë mbi armiqjtë, të fitojnë me drejtësinë e me madhështinë e tyre edhe mbi hijet e së kaluarës, që zbehen e treten para fuqisë e bukurisë së realitetit të sotëm revolucionar socialist. Në këtë përfytyrim të përgjithshëm poetik të shpërndarë si shkëndijat e një drite në veprat kryesore të Kadaresë (kujtojmë: «*Sekretari*», «*Shënime për brezin tim*», «*Toka kufitare*», «*Përse mendohen këto male*», «*Shqiponjat fluturojnë lart*», «*Fjalim përpara tokave të reja*», «*Ti dhe nata*», «*Fillojtesi*»), është pasqyruar bukuria sublime e heroizmit nëpërmjet një shkrirje të natyrshme emocionale të poetit me heroin, të pasqyrimit të njëkohshëm të realitetit me idealet dhe të përpjekjes për një depërtim filozofik në thelbin ideo-estetik të motiveve të trajtura. Sado konkrete, të veçanta dhe të lidhura me një kohë e një vend të caktuar të jenë motivet e krijimeve poetike, Ismail Kadarëja, në rastet më të qëlluara, ka mundur të arrijë një rezultat pozitiv duke ngjeshur në një tërësi të vetme artistike aktualitetin me perspektivën historike, të kaluarën, të sotmen e të ardhmen, kombëtaren me njëzoren, temën politike me trajtimin filozofik. Në këtë mënyrë ai ka mundur-dhe është përpjekur me vetëdije për një gjë të tillë, — që të zbulojë e të trajtojë në krijimet e veta ato momente poetike të realitetit, që shprehin një ide të madhe, e cila i kalon kufitë e kohës e të vendit, pa humbur fizionominë bashkëkohore. Kjo bën që veprat kryesore të Ismail Kadaresë të kenë frymëmarrje të gjerë e t'i qëndrojnë kohës, kurse heroi i tij lirik të ruajë freskinë rinore të tij, edhe kur etapa historike që e lindi kapërcehet. Se ç'rëndësi ka një rezultat i tillë krijonjës, do të kuptohej lehtë, në qoftë

se do të kujtonim shumë krijime poetike, pa përjashtuar edhe disa të vetë Kadaresë, që me kalimin e kohës që i lindi, vjetërohen, humbasin fuqinë ndikonjëse dhe në vend të vlerave, vjen një ditë që zbulojnë vetëm ngushtësinë dhe dobësitë e tyre, gjë që nuk ndodh kurrë me veprat e mira. Po të kishte diçka, që është e diskutueshme në krijimtarinë poetike të Ismail Kadaresë në këtë drejtim, do të ishte gjykim i disa herë subjektiv i perspektivës në aspektet e vogla të jetës, që e ka shtyrë aty-këtu të përfaqësojë kategori të parëndësishme shoqërore, të estetizojë cikërrima dhe, në vartësi nga ato, të vulgarizojë thjeshtësinë e shprehjes poetike, siç ka ndodhur në disa vjersha të vëllimit «*Motive me diell*». Poezinë mund ta shpëtojë nga këto dobësi vetëm përcaktimi më i qartë i heroit lirik të kohës, lidhja gjithnjë më e ngushtë me problematikën e rëndësishme dhe kuptimi më i thellë i rëndësisë së karakterit të përparruar të sistemit shoqëror mbi përparimet teknike. Po këto kanë qenë dhe janë ndikime dhe lajhitje në poezinë e Ismail Kadaresë, në të cilën dobësitë ideore zakonisht nuk janë shprehje e vjetërsisë, siç ndodh me poetë të tjerë, po të përpjekjes për të çarë përpara dhe për të marrë me vete nganjëherë edhe gjëra, që me kohë do të mbeten rrugës. Kryesore është se në veprat që përmendëm e në dhjetëra krijime të tjera poetike të asaj natyre ndodhemi përballë një poezie luftarake, me «*motive me diell*», me ndjenja të thella, të sinqerta e të shëndosha. Në to pasqyrohet vërtet një «botë e madhe», e kundërt me atë të disa vjershavë për dashurinë, një botë lufte e përpjekjesh, gjëzimesh e shqetësimësh, mendimesh dhe optimizmi për të ardhmen. Dalja nga «*bota e vogël*» dhe lidhjet me popullin e me fata e tij, edhe në këtë rast kanë dëshmuar se janë e vetmja rrugë për të pasur një poezi të madhe revolucionare.

Veprat kryesore të Ismail Kadaresë janë vazhdim dhe plotësim i njëra-tjetrës. Ato nuk përsëritin njëra-tjetrën, nuk i ngjajnë formalisht njëra-tjetrës, kanë secila nga një horizont të veçantë motivesh dhe reflektojnë qëndrime ideo-emocionale ndaj aspektesh të caktuara të realitetit. Ky, gjithashtu, është një rezultat krijonjës me rëndësi, që ka të bëjë me talentin, me mjeshtërinë dhe me punën e vetë-

dijshme të poetit, një rezultat, që, për fat të keq, nuk e kanë arritur të gjithë poetët tanë të sotëm, prandaj edhe ndeshemi shpesh me varfëri motivesh, me uniformitet dhe monotonji, me përsëritje mendimesh të njëjtë dhe me predispozita shpirtërore të ngjashme, jo vetëm në krijimtarinë e të njëjtë poet, po edhe në poezinë në tërsi. Le të marrim, për shembull, poemat «*Përse mendohen këto male*», «*Shqiponjat fluturojnë lart*» dhe «*Vitet gjashtëdhjetë*».

Tani që i kemi në dorë të trija dhe na ngjajnë si copa të një poeme të madhe të jetës shqiptare, të heroizmit të popullit e të partisë, të rrugës së vështirë historike dhe të madhështisë heroike, e shohim edhe më mirë, që në secilën prej tyre ka pasur rëndësi jo vetëm ajo që është thënë, po edhe ajo që nuk është thënë, bile, edhe ajo që nuk është thënë akoma, nga të tria poemat së bashku. Ndërsa në poemën e parë vështrimi i poetit është kthyer nga e kaluara dhe sundon dhembja përmjekimin e popullit dhe përmjekëmbjen e vendit nga armiqtë e jashtëm, që e kafshonin dhe e zhvatnin dhe a posteriori shprehet bindja, se vetëm Partia Komuniste mund ta shndërronte këtë gjendje, në të dytën kjo Parti Komuniste hedh rrënje të thella në trullin e maleve dhe vepra e saj, që nga trakti i parë deri te «Letra e hapur» ka shkëlqimin e një vetëtime. Kurse në poemën e tretë, malet shqiptare, dikur të mjera e të lëna në fatin e tyre, duken të madhërishme dhe nuk mendojnë më përbukën e misrit, po përfatet e mëdha të botës, përfthë ardhmen e revolucionit dhe qëndrojnë të pamposhtura përballë stuhive kundërrevolucionare të imperializmit e të revizionizmit. Dhe pikërisht me vepra të tillë Ismail Kadarëja është nga ata që qëndrojnë në ballë të përpjekjeve të sotme përfthë krijuar një letërsi revolucionare të kohës, me nivel të lartë artistik, të aftë të pasqyrojë transformimet e mëdha revolucionare nëpërmjet imazhesh të fuqishme poetike.

Kohët e fundit ai ka bërë një hap tjetër përpara, sidomos në krahasim me disa poema të mëparshme, përfthu afro me jetën e gjallë dhe me heronjtë e kohës, nëpërmjet një poezie më të qartë, më të kuptueshme dhe më të drejtë përdrejtë. Largimi prej trajtimit simbolik dhe prej krijimit

të komplekseve figurative subjektiviste është një hap i rënëdësishëm pozitiv, që e ndihmon poezinë të kryejë më mirë funksionin e vet shoqëror të ndikimit edukativ dhe artistik. Para së gjithash, në këtë kuptim, poezia e Ismail Kadare-së dhe, në tërësi, poezia dhe letërsia jonë e realizmit socialist, kanë një karakter të përcaktuar e të thellë bashkë-kohor. Sot poezi me karakter bashkëkohor, në radhë të parë, është ajo, që pasqyron luftën dhe transformimet revolucionare në jetë e në ndërgjegjen e njerëzve dhe përshkohet nga thelbi deri në hollësitë e veta prej ideve dhe idealeve komuniste, se pikërisht këto janë elementet kryesore të bashkëkohësisë, që përcaktojnë edhe shijet, edhe idealitet estetike të popullit e të shkrimitarëve. Poezia e Kadare-së, si një lirikë qytetare e kohës, është mbështetur kryesisht në pasqyrimin e transformimeve socialiste në jetë, duke depërtuar në vetë procesin e ndryshimeve të mëdha dhe pa i mbuluar ato as me frazeologji «të bukur» as duke u ngjitur prapa epiloge nanuritëse, po duke lënë të celur shtigjet e betejave të ardhshme, të perspektivës e të ngjittjes në lartësitë e reja që na presin. Jetën ai e përfytyron në luftë për realizimin e idealeve dhe në këtë luftë gjen bukurinë dhe madhështinë e epokës, që i jep poezisë së tij theks të dukshëm bashkëkohor mobilizonjës. Në funksion të këtij shpirti aktual të poezisë janë përdorur edhe hollësitë jetësore e stilistike, fjalët, që hyjnë në fjalorin aktiv të kohës dhe elementet e tjera të hollësishme, që e bëjnë më të dukshme ngjyrën bashkëkohore të krijimeve.

Në zgjidhjen dhe përdorimin e hollësive jetësore e stilistike, poeti, sipas natyrës artistike të veprave, ka ndjekur dy rrugë: rrugën e përdorimit të simbolit figurativ romantik dhe atë të detajit artistik realist. Ndërsa në rastin e parë kemi një figurë simbolike të krijuar, në rastin e dytë kemi një hollësi të ngjashme jetësore me forcë përgjithësonjëse, që arrin deri në vlerën e një simboli. Hollësitë e natyrës së parë janë karakteristike për veprat me natyrë romantike dhe i ndeshim sidomos në poemat e vëllimit «Shekulli im», kurse të dytat bëhen të zakonshme sidomos në vëllimin «Motive me diell».

Krahas kësaj vërehet, po në pajtim me natyrën qyte-

tare të poezisë, edhe depërtimi i elementeve të qyteteve moderne e të jetës së sotme qytetare, që nga pistat e aeroportave, semaforët, bulevardet e pistat e vallëzimit, deri te radiotranzistorët dhe cigaret me filtër, gjë që dëshmon nga një anë lidhjet e poetit me jetën e kohës dhe përpjekjen e tij për poetizimin e elementeve të kësaj jete dhe, nga ana tjetër, prirjen e tij drejt kësaj jete moderne. Kjo është gjithashtu një gjë pozitive, po mbapse do të ishte me vend. që të bëhej një përpjekje më e ndërgjegjshme dhe më kuqimplotë, që edhe ndër hollësi të tilla të gjendeshin e të pëndoreshin më tepër nga ato, që do të karakterizonin më mirë jetën tonë revolucionare dhe do t'i përshtateshin më shumë heronjve të përparuar të jetës sonë të sotme qytetare, punëtorve, pa kaluar në kërkime deri diku manieriste si në poemën «*Teknologja e një poeme*», po edhe pa rënë në një pasqyrim deskriptiv jo emocional, bile edhe pa kuqim. si në poemën «*Këto ditë dhjetori*», në të cilën, gjejmë edhe vargje të tilla:

— Në bulevard të madh, tek Rruga e Dibrës, në trotuarët, — vështroj si ecin me shpejtësi kalimtarët. — Njerës me kapelë, pa kapelë, me pardesy, me pallto të madhe, — vajza të bukura, vajza të zakonshme, pensionistë, ushtarë, — djem me pulovra, zëvendësministra, gra me radhë — kalojnë njerëzit. Them me vete: — Ja, këta janë shqiptarët...

Kurse në «Autobuzi i orës 5» punëtorët, që venë në fabrikë, «lenë pas të thyerat shkrepse, posa të thyerat shpresë» (!), ndërsa hidhet cigari nga dritarja, fatorinot thërrasin e kthejnë reston me të shara, dikush mban tranzistorin në qafë, kurse ti mund të grindesh e të shtyhesh me shefin e degës ose zëvëndësministrin (!)

Këtu rastësia dhe mungesa e mendimit tentojnë të kthehen në qëllim, gjë që është në kontradiktë me tërësinë dhe me vetë shpirtin dhe misionin e kësaj poezi. Çlirim i prej këtyre ndikimeve «pseudomoderne» do ta bëjnë poezinë më të gjallë, do të rritin vlerën ideo-artistike të saj dhe do ta qartësojnë edhe më tepër atë.

Duke lexuar vjersha të kësaj natyre, ne sjellim ndër mend shumë krijime të bukura poetike të Ismail Kadaresë,

që janë reflektim i një bote shpirtërore të pastër e të pasur, siç është bota shpirtërore e popullit dhe e njerëzve të tij të pararojës. Ky hero lirik shpesh vihet edhe në kundërshtim të hapur me njeriun e pistave e të tranzistorëve, siç ndodh, për shembull, me sekretarin e partisë, i cili:

«Ndër mend nuk binte mbrëmje vallëzimi, — as letra për vajzat nuk shkroi, — veç ëndrat e tij për Atdhenë — askurrë e askund s'i harroi».

Edhe në vjershën «Fillrojtësi», që është nga krijimet e vona, ashtu si në poemën e hershme, po kësaj radhe në mënyrë më të drejtpërdrejtë, vihen përballë meskinitët dhe heroizmi, bile, në një mënyrë shumë therëse, saqë, kur lexon vjershën, nuk mund të besosh se mund të ketë raste, kur kotësia, vogëlsitë e përbuzura dhe «jeta konfortabël», siç thuhet në një varg, të josh në mënyrë borgjeze. Edhe në «Ti dhe nata» ndeshim në një kundërshtim të ash-për të shpirtvogëlsisë mikroborgjeze:

«Dy sytë e tu... — kur plogështia ledhatare — afrohet dhe na shtrihet si mace nëpër këmbë — ata shkrepëtijnë si dy rrufe gjëmimtare, — si një kushtrim, — si një fjalë që dhemb».

Kjo kundërvenje është pozitive, është revolucionare dhe mund të jetë shenjë e kapercimit të kontradiktës për të cilën folëm, në dobi të një heroi lirik kurdoherë luftarak, që vlen t'u jepet të tjerëve si shembull për idealet e mëdha shoqërore që e frymëzojnë, pa rënë në asketizëm e në kuptim të njëanshëm e të ngushtë të jetës. Në këtë rast do të ishte e dëshirueshme që të arrihej në një konceptim e pasqyrim të atillë poetik të jetës e të bashkëkohësve, në të cilin të mos jepej mundësi për kundërvënje të tillë, po heroi lirik të kishte karakter unik dhe, siç do të shprehej vetë poeti, fryma socialiste revolucionare të depërtonte në çdo ind e qelizë të jetës, të shpirtit e të veprës poetike. Dhe që të arrihet një gjë e tillë plotësisht ka rëndësi se në ç'momentë të jetës e në ç'rrethana tipike për kohën e vëmë heroin tonë, në ç'prizëm e shohim atë dhe ç'duam të themi në-përmjet tij. Poezia e vërtetë nuk mund të krijohet, po nuk pati në themel një problematikë shoqërore me rëndësi.

Edhe problemet artistike të poezisë së Ismail Kadare-së, sikurse problemet ideore të saj, meritojnë vëmendje të veçantë. Shqyrtimi i tyre ka të bëjë jo vetëm me vlerësimin kritik të krijimtarisë së poetit dhe të rrugës së ndjekur prej tij, po edhe me vetë rrugën që ndjek e mund të ndjekë poezia jonë sot dhe në të ardhmen.

Ismail Kadareja është një poet kërkimtar, që lëviz, që pasurohet, duke ruajtur personalitetin e vet, fizionominë kryesore të krijimit, pa u bërë skllav i formave dhe i rezultateve krijonjëse të arritura në një kohë të caktuar. Në krahësim me poetët tanë të tjera të talentuar, ai është më i ndjeshmi ndaj formës në kuptimin e përpunimit të saj, jo thjesht në aspektin stilistik, po si tërsi. Nga kjo pikëpamje, poezia e tij është *elementi më i lëvizshëm* në gjithë poezinë tonë të sotme, bile, në gjithë letërsinë tonë.

Forma artistike, stili i poetit, disa herë edhe elementë të veçanta të metodës krijonjëse tek ai, si në çdo poet të talentuar, në fazë të caktuara, janë determinuar prej interesimeve shoqërore dhe politike, prej brendisë ideo-ëmocionale që e ka tërhequr atë në kohë të ndryshme, prej mënyrës si e ka parë ai botën, domethënë prej shkallës ideologjike në të cilën ka qenë gjatë pesëmbëdhjetë vjetve të veprimtarisë së tij krijonjëse. Si gjë kryesore, që bie në sy, në radhë të parë, është se interesimet e poetit kanë ardhur duke u zgjeruar e duke u shumuar, mendimi i tij është bërrë më i thellë dhe më i zhđervjellët, ndjenjat e tij, përgjithësisht, më të përcaktuara dhe më të hapëta. Kjo ka bërë që poezia edhe nga pikëpamja formale të çlirohet prej kufizimeve të vjetra formale e stilistike, të jetë më e hapët, të ketë fryshtësimi më të gjerë, ritëm më të shpejtë, shtrirje më të madhe, një stilistikë e e gjuhë poetike më të kohës, të largët prej «stilizimeve» dhe «qëndrisjeve» të dikurshme. Në këtë drejtim, gjithnjë në aspektin pozitiv të çështjes, do të ishte me vend krahësimi i disa veprave të shkruara në kohë të ndryshme dhe që mendojmë se janë karakterizonjëse për të parë rrugën e ndjekur prej poetit. Vepra të tilla do të ishin: *Ruga e dritës* (1954), *Ishujt e Italisë* (1957) Poemë

*Industriale* (1961), *Poemë e blinduar* (1962) «Përse mendo-  
hen këto male» (1964) dhe «Këto ditë dhjetori» (1968).

Në «Rruja e Dritës» dhe përgjithësisht në vëllimin «Frymëzimet djaloshare» vërehet një kthjellësi mendimi, shprehje e drejtpërdrejtë e ndjenjave, sundim i përshtypjeve të rastit, cektësi në trajtim, dobësi interpretonjëse, mungesa, në tërësi, e vulës personale. Si në brendi edhe në formë kjo është një poezi e singertë dhe naive, një poezi formalisht *pa karakter*, do të thoshnim. Tek-tuk duken në librin e parë të vjershavë edhe shkëndija të një qëndrimi romantik, që, disa vjet më pas, do të bëhen sundonjëse në vëllimin «Endërrimet.» Kjo natyrë e vjershavë të para të Kadaresë është përcaktuar nga disa rrëthana: nga mosha dhe niveli i poetit në atë kohë, nga mungesa e përvojës kri-jonjëse dhe nga gjendja e poezisë së zakonshme të kohës. Veprat më të mira të poezisë sonë të asaj kohe nuk mundën të ushtronin ndikimin e tyre pozitiv te poeti i ri, se, siç dihet, ky ndikim, sidomos në krijimtari, nuk përcaktohet thjesht prej *vlerës së veprave*, po edhe prej *nivelit dhe interesimit të lexonjësit.*

*Ishujt e Italisë* (një variant të saj e gjejmë edhe në librin e parë) është një poemë tipike romantike, siç janë, në përgjithësi, gati të gjitha krijimet e vëllimit «Endërrimet». Ndërmjet përshtypjeve të drejtpërdrejta nga jeta dhe pas-qyrimit të tyre letrar hyjnë në këtë kohë *leximet*, formimi i kulturës letrare të poetit, pëlqimet e tij artistike, që, të gjitha, kanë karakter romantik. Kjo, si të thuash, ishte një ngritje artistike, një shkallë e re e formimit të personalitetit të poetit, që u shoqërua me një farë largimi prej përshtypjeve të gjalla të jetës. Kjo është një shkallë zhvillimi e njohur për një formim të natyrshëm e të zakonshëm, jo vetëm në letërsi e në art, po edhe në jetë përgjithësisht, sidomos kur mungon lidhja e ngushtë e formimit kultural me përpjekjet konkrete, me punën, me realitetin. Edhe në një poemë me brendi shoqërore e klasore, si «Sekretari» ashtu si në «Ishujt e Italisë» në baladat historike e aq më tepër në lirikën intime, sundon një frymë e përgjithshme romantike, që hedh hijen e vet edhe në zgjedhjen e detajeve, të hollësive dhe të mjeteve stilistike të shprehjes

poetike. Për kohën kur u botuan këto poezi ishin një gjë e re në gjendjen e përgjithshme të poezisë sonë, që po merrte, në rastet e rëndomta, një karakter të thatë deklamativ dhe vuante prej uniformitetit dhe monotonisë ideore e artistike. Përveç freskisë në trajtimin e motiveve dhe shenjave të personalitetit krijonjës, Ismail Kadareja solli me vëllimin «Endërrimet» edhe intimitetin në poezinë e kohës, ose më mirë të themi, e përtëriti këtë intimitet, pa u larguar nga modelet letrare prej të cilave që nisur. Pra, me gjithë interesin e veçantë që ngjallin, vjershët e asaj kohe janë zakonisht përtëritje e re e një të kaluare letrare, si në formë, edhe në brendinë ideo-emocionale të krijimeve në mjaft raste. Në «Endërrimet» dhe «Ngjarje në pushime» vërehet prirja e poetit për t'u shkëputur prej ndikimeve romantike të leximeve, drejt një trajtimi realist e të pavarrur të materialit jetësor. Nga ana e jashtme kjo provohet edhe prej faktit që poema «Endërrimet», sigurisht e rishikuar, ka gjetur vënd edhe në vëllimin «Motive me diell» (shih: «Anketa») dhe është në harmoni me prirjet dhe interesimet e sotme ideo-artistike të poetit. Këto krijime, me gjithë një farë naiviteti poetik (veçanërisht «Ngjarje në pushime»), shërbyen si shkallë të kalimit të poezisë së Ismail Kadares në fazën e pjekurisë poetike, të një pozie me gjërsëi ndjenje e mendimi, me interesime të mëdha shoqërore, me një formë artistike të çliruar prej ndikimeve të dikurshme romantike e të prirë drejt përpjekjeve për një shprehje moderne. Vëllimi «Shekulli im» e dëshmon plotësisht një gjë të tillë.

Për këtë kalim ndikuan dy rrëthana shoqërore dhe letrare: hyrja e poetit në «botën e madhe», siç e quan ai dhe, si pasojë, zgjerimi i madh i horizontit të përshtypjeve, njohurive dhe bindjeve të tij dhe njohja më e gjërë e poezisë moderne, duke nisur me Majakovskin, sidomos të përiudhës së pararevolucionit, me Uitmanin, Eluarin, Ricosin dhe me poetë të tjera të drejtimeve të sotme moderne e moderniste të botës.

Është koha kur në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të Europës po merrte hov edhe në letërsi e në art revizionizmi, kur rishqyrtohej qëndrimi ndaj traditave dhe

ndaj korrenteve letrare jo socialiste, kur, nga ana tjetër, po ngrihej hovi i luftës kundër revizionizmit dhe po ndasheshin hapur hesapet me të. Vendi ynë në këtë kohë kish arritur suksese të mëdha në ndërtimin e socializmit dhe, nën udhëheqjen e partisë, po u bënte ballë me heroizëm sulmeve imperialiste dhe revizioniste. Të gjitha këto, në një mënyrë ose në një tjetër, janë reflektuar në krijimtarinë poetike të Ismail Kadaresë edhe në formën artistike. Vitet 1958-1961 janë për poetin *vitet e vrullit*. Poezia e tij, deri atëhere e qetë, merr karakter sulmonjës, ka një ritëm të brendshëm mendimi të gjallë e të çrrëgullt, është goditëse dhe nervoze, e papërmabjatur. Duket sikur poeti i «çliruar» prej romantikës së vet të mëparshme, rreh t'i largohet asaj në mënyrën më të vendosur, duke kthyer ftyrën drejt idealesh të reja, krejt të reja artistike për të.

Në këtë kohë në poezinë e Ismail Kadaresë hyri mendi-m i gjallë, me dinamikë e ritëm të brendshëm, një mendim thellësish emocional e me ngjyra të forta, me shtrirje të gjërë, që rreh të kap nganjëherë njëkohësish dridhjet e lehta të gjetheve në vjeshtë dhe tronditjet e mëdha shoqërore e politike të kohës. Gjer atëhere pak raste ka pasur në poezinë tonë të re, ku mendimi të hynte aq vrullshëm e me aq madhështi sa në krijimet e përfshira në «Shekulli im» dhe të jepoj, jo në formën e përfundimeve të thata, po në vetë procesin e formimit e të gjallërimit të tij. Këtu nuk kemi të bëjmë me racionalizëm apo me një poezi cerebrale, po me një mendim të gjallë emocional të shkrirë me ndjenja të mëdha e të forta, që u zënë vendin ndjenjave të dikurshme të topitura e të ndrojtura, ndjenjave të vogla për motive të vogla. Në këtë kuptim poeti ka bërë një përpjekje serioze për të çliruar edhe motivet më intime prej kuptimit të ngushtë, ndjenjave të vakëta e të brishta dhe për t'iu dhënë një frymëmarrje të gjerë, që do të kish qenë më e sigurt sikur të që shkëputur prej individualizmit mikroborgjez, për të cilin folëm më lart.

Poezia e Kadaresë në këtë kohë merr karakter të dukshëm polemik. Idealet e reja shoqërore dhe poetike, siguria e madhe në vetëveten dhe përpjekja serioze për t'u shkëputur prej forcës tërheqëse të çdo lloj rutine i kanë

dhënë poezisë së tij në këtë kohë një natyrë ndaj së cilës nuk mund të qëndrojnë ftohtë as partizanët e saj as kundërshtarët. Ka raste kur kjo frymë polemike është adresuar drejt dhe tehu i saj është pozitiv, shoqërisht i shëndoshë e revolucionar, qoftë në trajtimin e problemeve të mëdha shoqërore e politike, qoftë edhe në trajtimin e vlerave e të kuptimit të artit poetik. Kështu ndodh, siç e kemi vënë re, sa herë që pozita klasore e poezisë dhe pikësynimet shoqërore të saj kanë qenë të qarta e të përcaktuara mirë, sa herë që poeti ka qenë i lidhur me truallin shqiptar dhe, duke dalë prej kufive të ngushta personale, është ngritur në shkallën e përfaqësonjësit të pjesës më të përparuar të shoqërisë sonë socialiste dhe prirja e polemikës poetike është drejtuar kundër vjetërsisë, rutinës, patriarkalizmit dhe ndjenjave e koncepteve borgjeze e mikroborgjeze. Në raste të tjera polemika poetike, sidomos për çështje të luftës e të paqes e për motivet e dashurisë është kthyer në drejtim të kundërt me të parin dhe pozita e poezisë, në këto raste, nuk ka përfaqësuar dot krahun revolucionar e përparimtar.

Të gjitha këto ndryshime të brendshme të poezisë shtruani si domosdo edhe ndryshime të thella në vetë formën artistike, mbasi u bë e nevojshme që të gjendej një formë e atillë shprehjeje, që do të ishte e aftë të reflektonë pa ndrydhje e cungime mendimet e mëdha, ndjenjat e forta dhe problematikën e gjerë shoqërore, politike e filozofike. Vargjet e lira, që nuk hynë në letërsinë tonë prej Ismail Kadaresë, po u përtëritën me dinjitet prej tij, u treguan si forma më e përshtatshme, që pajtohej me frymën e re që merrte krijimtaria e poetit. Muzikalitetit të dikurshëm delikat, që i përgjigjej ngushtësisë së temave e pasqyrimeve, ja zunë vendin tingujt e ritmet e forta, të shkathëta dhe shungullonjëse, që i përgjigjeshin pështjellimit dhe shpërthimeve të papritura të mendimeve e të ndjenjave tronditëse. Krahas këtyre edhe gjuha e stilistika poetike u bënë më të drejtpërdrejta, më të zhđervjellta dhe figurat më të guximshme, me krahë të gjata, që ishin në gjendje të përqafonin imazhe poetike të gjera e të pasura.

Për poezinë tonë të kohës këto prirje artistike ishin një tronditje. Ato prishnin atmosferën gjer atëhere të qetë

dhe bënин thirrje për një përtëritje, për një hov të ri, për një shpirt më luftarak dhe një formë artistike më të gjallë. Dhe këtë *rol lëvizës* nisi ta luante në letërsinë tonë poezia e Ismail Kadaresë, pikërisht pas botimit të librit «Shekulli im». Entuziazmi dhe kundërshtimet, që i dolën përpara ta prisnin këtë poezi, shprehnin, secila në mënyrë të njëanshme, vetë kontradiktat e brendshme të saj në brendi e në formë. Edhe entuziastët, edhe kundërshtarët kishin ç'të gjenin në këtë libër, në të cilin prirjet e shëndosha realiste e romantike revolucionare pengoheshin e ngatërrroheshin me elemente të ndikimeve subjektiviste nga poezia moderne e kohës.

Në përgjithësi poezia e Ismail Kadaresë, edhe kur nuk ka karakter të thjeshtë reflektiv, siç do të ishin poemat dhe një pjesë e mirë e vjershave të përbledhjes «Shekulli im» është një poezi e ngjeshur me mendime, që herë shpërthej-në në trajtën e gjykimeve të drejtëpërdrejta, herë dalin ose mbeten të nënkuptuara, nëpërmjet motiveve të trajtuara dhe përshtypjeve ngajeta e gjallë. Në një pjesë të mirë të krijimeve të tij ky mendim është i gjallë, me zhdërvjelltësi e gjerësi dialektike, që rreh të përfshijë kompleksitetin e fenomeneve shoqërore dhe të ndjenjave e të mendimeve që lindin qoftë prej shqetësimeve të mëdha për problemet e rëndësishme të kohës, qoftë prej hollësisë lirike të natyrës e të jetës intime. Kjo pasuri, gjerësi, thellësi e gjallëri mendimesh e ndjenjash është reflektuar në vjersha e poema nëpërmjet një figurativiteti poetik, që nis me përdorimin e figurshëm të fjalës, përfshin transmentimin e figurshëm të aspekteve e të momenteve të veçanta dhe arrin gjer në një konceptim të përgjithshëm figurativ të të-rësisë së pasqyrimeve poetike. Kështu vërejmë në poema e vjersha të ndryshme figura të natyrës simbolike, përfytyrime të forta romantike dhe trajtim figurativ më të drejt përdrejtë realist të pasqyrimeve poetike konkrete jetësore, po përgjithësisht natyra e figurës së Ismail Kadaresë ka ruajtur në çdo fazë një natyrë romantike, pavarësisht nga elementët e tjera, që kanë depërtuar në të. Figura në poezinë e tij, ndonëse disa herë edhe fluide e tepër subjektive, arrin të përfshijë fenomene të gjera shoqërore, të

konkretizojë mendime të mëdha dhe imazhe të fuqishme, të përqafojë periudha të gjata historike e t'i karakterizojë. E njohur është kundërvënja figurative simbolike e uzinës gjigante dhe e plakut malësor në «Ëndërr inndustriale», në të cilën hollësia artistike nuk është e ngjajshme në jetë, po shpreh-thellë, me forcë e qartësi të dukshme një proces të madh të transformimit shoqëror dhe zbulon madhështinë dramatike të këtij transformimi në mënyrë entuziaste revolucionare.

— *Larg — plot reflekse do të përgjakën mjergullat prej furrnaltave, — që do të vjellin tym të zi, — parandje-nja e zemërim të zjarrtë. — Plaku që larg do të shohë me urrejtje furrnaltat. — Së largu — flokët e tymtë e të përgjakur do t'i tundin — plakut dhe ai do të zbresë si një paragraf i thinjur kanunesh — i ngadaltë, — i thinjur e i tmershëm...*

Por këto dy simbole botësh të ndryshme, në pajtim me realitetin e sotëm socialist, vjen koha që harmonizohen me njera-tjetrën:

— *Dhe plaku koburen e vjetër — do ta flakë në asfalt. — Nesër — tok me hekurishtet e vjetra — do ta shkrijnë armën përsëri — ndryshku i shekujve do të digjet — dhe prej metalit të vjetër — do të derdhet i shkëlqyeshëm — një grusht metal i ri.*

E përafërt me këtë nga gjerësia e përfytyrimit, po jo në formë simbolike, është edhe figura në poemën «*Shqiponjat fluturojnë lart*», në të cilën, me pak vargje, është karakterizuar me ndihmën e një figure romantike historia njëzetepesëvjeçare e Partisë dhe roli i shokut Enver Hoxha në të. E përbashkët është në të dyja rastet përmasa e madhërishme, që marrin hollësitë artistike, duke u bërë shprehëse të koncentruara idesh e ndjenjash të mëdha.

— *Llambë e zbehtë vajguri — nënë fëmijësh të ndritur, — ç'vështroje ashtu menduar letrat mbi tavolinë... — Qenë minutat e fundit, — u hartua «Thirrja», — themeluesi i partisë zgjati dorën për firmë: — Firmë e tillë s'ish*

*dukur asgjëkundi, asnëjëherë. — Një firmë e gjatë. — Kos-telacion me pesë fjalë...*

... Kjo firmë do shfaqej në vitet që do vinin, — kohërat duke sqaruar, — situatat duke kapur. — Ajo do shkrepte gjithmonë para bubullimave, — nga thirrja e parë — gjer tek letër e hapur.

Në këtë rast, siç shihet, gjërësia e figurës i përgjigjet gjërësisë dhe madhështisë së fenomenit që pasqyron dhe ka mundur ta shprehë qartë atë në formë emocionale poetike, ashtu siç ndodh në raste të tjera, që e njëjtë mënyrë krijimi të figurave ka shprehur edhe përmasat monstruoze të shtypjes e të laksës kapitaliste. Një figurë të tillë gjejmë, për shembull, në poemën «*Buzëqeshje mbi botë*», në të cilën, duke u nisur nga përfytyrimi konkret i një kapitalisti, që udhëton me aeroplan dhe diçka ha, arrihet, nëpërmjet figurës, në një imazh të përbindshëm:

— *Ai mori pirunin — dhe mua m'u duk se — si pasta — ndërtesar, stacionet, muzetë — bëhet gati t'i hajë. — Zhytur në kolltuk — hamë drekë në të dy — vërtitet mbi botë piruni i tij.*

Një tjetër mënyrë e krijimit të figurës, gjithnjë në kuptimin më të ngushtë të fjalës, është edhe konkretizimi figurativ i imazheve dhe i përfytyrimeve të përgjithshme, të cilave u jepet një trajtë e kapshme, e prekshme, siç ndodh, për shembull, me përfytyrimin e Atdheut në poemën «*Shënime për brezin tim*»:

— *Atdheu im shtatlartë, — plot muskuj, — pa bark e dhjamë, — fytyrëhequr, burrërori, shamikuqi, — i pathyeshmi, — madhështori.*

Ndeshim, veç këtyre, edhe trajtën më realiste të krijimit të figurave, ku ato u përgjigjen pasqyrimeve dhe kanë shtrirjen e tyre, kur, si të thuash, figura nuk krijohet për ta koncentruar apo për ta përfaqësuar më lehtë realitetin, po sikur lind vetëvetiu prej aspekteve të pasqyruara në vepra. Duke ruajtur edhe në këtë rast nuanca ngjyrash romantike, figura detajohet më tepër, mbart hollësira më të mëdha, dhe, sado që në dukje është më pak pretendonjëse dhe e bujshme, në vlerë është më e sigurt dhe më shprehë-

se. Figura të kësaj natyre gjejmë në poemën «*Përse mendo-hen këto male*», «*Toka kufitare*» etj.

— Nga supet pushkën e gjatë s'e hoqe kurrë — nga supet e tua plot plagë, — nga supet kockë e lëkurë.

— Bukën e ngjyeje me shëllirë, — shëllirë dhe misër për natë, — e ruaje atë pak yndyrë, — oh, atë yndyrë të paktë, — për mikun dhe pushkën e gjatë, — për të lyer pushkën e gjatë.

Një përfytyrim të ngajshëm poetik gjemjë edhe në poemën tjetër, në të cilën, duke u ruajtur natyra konkretizonjëse e figurës, na jepet ky imazh figurativ i tokës kufitare:

— Je thirrur për të mbrojtur tokat e tjera, — tokat e mbjella, — të bardha, të blerta, ngjyrë arit, — ndaj ke vetëm një uniformë: — Kapotën e thjeshtë të barit, — ndaj, e qethur je ashtu si ushtarët.

Këtë natyrë të përgjithshme të shëndoshë artistike të figurës, që përcakton vijën themelore të krijimtarisë poetike të Ismail Kadaresë, ndonjëherë e prekin dhe e cënojnë prirjet subjektiviste, që e largojnë figurën prej mendimit ose vështirësojnë me kast kuptimin e saj.

Si në vëllimin «Shekulli im», dhe në librat e tjera ndeshen shpesh vargje të krijuara vetëm për hir të figurës, pa pretendime ideore ose pa lidhje me një mendim të shëndosh, në mos shoqëror, të paktën thjesht logjik. Ja një shembull:

— Erdhi koha e prodhimit të yjeve. — Koh'e prodhimit në seri të qiejeve. — Qiejt s'do t'i mbyllim në konserva (!) Do t'i arrijmë ku janë, etj...

Ose:

— Qiell madhështor, i ftohët, pa kufi. — Antena të kërrusura mbulojnë dhenë, — antena, që mardhin e dri-dhen në shi, — antena si krahë të thata kërcënojnë hapë-sirat — antena si shkopinj invalidësh trokasin mbi çatira.

— Kudo antena. Antena. Antena.

Mbi shekullin e XX fryn e breron. — Atomi gjumin fëmijëve u turbullon. — Që antenat mos u ngjajnë kryqeve — «Jo» popuj përgjigjuni.

**Seria e gjatë e krahasimeve të pjesës së parë të vjershës** është vetëm një lodër pa qëllim dhe pa lidhje me pjesën e dytë të vjershës, e cila është ideologjikisht e papërcaktuar.

Pas librit «Shekulli im» poezia e Kadaresë për një ko-hë, gjersa u botua poema «Përse mendohen këto male», i largohet vrullit, që kish shpërthyer i stuhishëm, bëhet e qetë, e, në dukje, e ftohtë.

Në krijime të kësaj natyre bëjnë vend simbolet: realiteti konceptohet në formë simbolike, — duke kaluar gjer në simbolizim, — kurse trajtimi i motiveve i nënështrohet konvencionalitetit simbolik, që shpesh merr trajta shumë komplekse, në dëm të brendisë dhe të spontaneitetit poetik. Kjo eksperiencë krijonjëse nuk është fare pa vlerë dhe pa rezultate pozitive. Siç e kemi vënë re në analizat e mësipërme, kur motivet kanë qënë të rëndësishme dhe simbolet kanë qenë figura të nxjerra nga realiteti dhe jo nga bota subjektive e poetit, atëhere edhe rezultatet kanë qenë më të mira, simboli më i konceptueshëm, më me brendi dhe më i gjerë e më i gjallë, sado që në parim, siç e provon edhe vetë krijimtaria e Ismail Kadaresë, rruga e përgjithësimit artistik realist mbetet rruga më e mirë, nëpërmjet të cilës realitetit jetësor, ndjenjat e mendimet mund të transmetohen me forcë, gjerësi, thellësi dhe hollësi të atilla ideo-artistike, që do ta ngrin figurën poetike të rëndësishme gjer në lartësinë e simbolit, në kuptimin përgjithësonjës të saj.

Ndryshe ndodh në «Poemën e blinduar», që do të ishte një veprë kushtuar lidhjeve të poezisë dhe, krasa saj, edhe të dashurisë me realitetin, me kohën, me shqetësimet e përgjithshme njerëzore, nëpërmjet një përfytyrimi simbolik të këngës dhe të lidhjeve e të kontrasteve të saj me realitetin dhe me dashurinë, që gjithashtu vihet në rapporte jo kurdoherë të njëjtë me këngën. Kur lexon poemën, ke përshtypjen se poeti është munduar të kërkojë një formë dhe të gjejë një pikë vështrimi, që do t'i jepte mundësi të mos ishte i qartë dhe i drejtpërdrejtë, gjë që është karakteristike në periudhat kur dobësohen lidhjet me realitetin e gjallë, kur i largohemi shprehjes poetike të

hapur dhe *mbivlerësojmë* poezinë në kahasim me realitetin. Kjo prirje e përkohshme e poetit, që erdhi fill pas vrullit të ti të rrëmbyeshëm, u kapercye me sukses prej tij në krijimet e mëvonshme, sado që gjurmë dhe shenja të këtij qëndrimi gjejmë edhe në krijime të mëvonshme.

Poezia në «Poema e blinduar» është edhe «*karro muhaxhirësh*» (si muhaxhiri pas karros së tij ndaj nate), edhe *autoblindë* (si ushtari pas autoblindës në gjëmime) edhe *kalë* (kaluar mbi këngë... po vijmë drejt jush), edhe *varëse* (eja varni armët në gozhdët e rimave), edhe *blindazh* (ke frikë nga bombat, e dashur? — Atëhere futu në këngën time — si në një blindazh të fortë (!), edhe *nikotinë* (jam mësuar me këngën si me nikotinën) edhe si *trarët e lagët* (do të rri në vargjet e mia, që pikojnë si trarët e lagët), edhe *kolovajzë*, edhe *buduar*, edhe *shtëpi* (portën s'ta hap), edhe... *arkivol*. (Këto s'janë rrjeshta, janë arkivole).

Ana e thjeshtë e keqe e çështjes është subjektivizmi, që karakterizon tërësinë e poemës dhe që e ka shtyrë poetin drejt «errësimeve të domosdoshme», kurse lexonjësi, në vend që të marrë frymë, të emocionohet, të mendojë për kuptimin e thellë shqëror të vargjeve, vret mendjen të gjejë ç'kuptim kanë vargjet dhe kahasimet në vetëvete. Në këtë mënyrë konceptimi poetik dhe figurat stilistike, duke larguar poezinë ngajeta e gjallë drejt koncepteve e përfytyrimeve subjektive, e largojnë edhe prej lexonjësit, krijojnë një hendek ndërmjet poeziës dhe punojnësve. Ky është *ekstremi* i kundërt i tendencave vulgarizatore në poezi.

Në krijimet e mëvonshme, sidomos në «*Përse mendohen këto male*», «*Shqiponjat fluturojnë lart*», etj. poezia e Ismail Kadares fiton dy elemente të reja pozitive (edhe në kahasim me «Shekulli im»): *gjerësinë e pasqyrimit*, duke ruajtur fuqinë e mëparshme poetike dhe nisjen prej *realitetit të gjallë jetësor* (jo prej mendimeve për realitetin, po prej vetë manifestimeve konkrete të këtij realiteti) — dy elemente shumë të rëndësishme për poezinë realiste. Këto kanë sjellë me vete edhe qartësimin e mjeteve shprehëse, edhe afrimin, kahas të tjera, *me heroin e kohës*, me njeriun e gjallë dhe jo me konceptet mbi njeriun. Siç

shihet, kjo është një prirje e shëndoshë për t'u shkëputur nga subjektivizmi, në mënyrë që, nëpërmjet poesisë, të flasë vetë jeta.

Pasqyrimi në poezinë e Ismail Kadares ka karakter problemor dhe kurrë (ndoshta, duke përjashtuar disa kriji me të hershme) nuk kthehet në qëllim më vete, në narration të thjeshtë dhe në ilustrim. Ndërmjet episodit apo fenomenit jetësor dhe mendimit nuk ka ndarje. Fenomeni vetë është mbartës i mendimit dhe i emocionit, kurse mendimi dhe figurat nuk kanë karakter komentonjës, po lin-din prej vetë fenomenit, jetojnë bashkë me fenomenin, janë të shkrira në të, shpërthejnë nëpërmjet tij. Në këtë lartësi poetike, veç gjithë veprave të tjera të poetit, qëndron poema «Përse mendohen këto male». Pra, siç shihet, prirje kryesore e poesisë së Ismail Kadaresë, si edhe e gjithë letërsisë sonë, është, në fund të fundit, një prirje drejt atrimit gjithnjë më të madh me jetën e gjallë, drejt një pasqyrimi më realist e më të partishëm të saj.

Një element me shumë rëndësi në krijimtarinë e poetit ka qenë dhe mbetet romantizmi revolucionar, që shoqërisht buron prej perspektivës historike të zhvillimit të shoqërisë dhe prej besimit në të ardhmen, kurse artistikisht prej natyrës së përceptimit dhe prej pasqyrimit të realitetit në një formë të përgjithësuar, të figurshme, pa hollësi e detaje ambienti e rrëthanash. Po të lëmë mënjanë vëllimin «Endërrimet», në të cilin romantizmi ka karakter soditës dhe jo kurdoherë luftarak, tipike për një romantizëm revolucionar të kohës do të ishte poema «Endërr industriale». Realiteti në këtë poemë është pasqyruar, para së gjithash, nëpërmjet dy përfytyrimesh të fuqishme: *uzinës gjigante* dhe *plakut malësor*, që zbret nga mali për të hyrë në luftë me të, po që nënshtrohet prej saj. Si uzina, ashtu edhe plaku janë konceptuar në të njëjtën mënyrë të përgjithësuar, jo aq si qenje konkrete, sa si mishërimë të ideve e të idealeve të poetit, si «konkretizime» të mendimeve të përgjithshme abstrakte mbi luftën e të kundërtave e mbi fitoren e së resë mbi të vjetrën, duke pasur në themel të tyre të vërtetën e jetës dhe prirjen e zhvillimit të saj historik. Edhe në poemën «Përse mendohen këto male»,

ndërsa fenomenet e veçanta janë konceptuar e pasqyruar në mënyrë realiste, figura e malësorit me pushkë të gjatë, që shërben edhe si element organizonjës, është konceptuar po në mënyrë romantike. Ky romantizëm është pozitiv dhe pajtohet me vetë shpirtin revolucionar të letërsisë së realizmit socialist.

Romantika në krijimet e vona të Ismail Kadaresë ëshë e re, si në fryshtën e saj (e lidhur me realitetin e kohës) edhe në mjetet shprehëse, që pasqyrojnë gjithashtu kohën dhe shijen artistike të kohës. Në letërsinë tonë, sidomos në poezinë tonë, elementet romantike të trashëguara nga e kaluara letrare e të ushqyera prej largimit ngajeta dhe prej një psikologjije të paçliruar prej elementeve patriarkale e mikroborgjeze, që e përfytyron realitetin në mënyrë idealiste subjektive, kanë zënë shumë vend, por, dalëngadalë, e kanë humbur vitalitetin e tyre, kanë rënë në kundërshtim me realitetin dhe me tendencën e zhvillimit letrar revolucionar dhe janë munduar të gjejnë strehë vetëm në lirikën intime mikroborgjeze ose në trajtimin e temave nga e kaluara në mënyrë të vjetëruar. Në ndeshje me këto prirje zvarritëse u lartësua që në vitet e para pas çlirimit romantika e poeziës së Llazar Siliqit dhe, në dhjetëvjetëshin e fundit, krahas poeziës së Kadaresë, edhe poezia e Dritëro Agollit, e Fatos Arapit, e Agim Gjakovës etj. — poezi me elemente romantike të dukshme, po jo si vazhdim i thjeshtë i së kaluarës në kohën tonë e në kundërshtim (artistik, e disa herë edhe ideor) me këtë kohë. Vetë Ismail Kadareja e kaloi këtë fazë nëpërmjet «Ëndërrimeve», kurse sot prirja e poeziës së tij është afrimi i mëtejshëm me një poezi më të formuar realiste.

Problem i veçantë për krijimtarinë poetike të Kadaresë është trajtimi i temave historike dhe i motiveve popullore. Në qoftë se disa poezi për dashurinë nuk pajtohen nga pikëpamja ideore me pjesën e shëndoshë të krijimtarisë së tij, në krijimtarinë e vonë (pas «Shekulli im») trajtimi i motiveve historike e popullore veçohet prej gjithë poeziës, si një element artistik, që të kujton akoma fillimet letrare të poetit. Në vjershat me natyrë popullore vërejmë edhe krijime të vetë poetit, edhe stilizime të reja të motive-

ve të vjetra popullore me frysë përgjithësit lirike e lirke-hu moristike. Vjersha të tilla gjemë në të gjitha përbledhjet poetike të Ismail Kadaresë dhe kjo, veç të tjerave, hedh posht qërtimin, sipas të cilit, poeti nuk paska lidhje me poezinë popullore dhe e mohuaka atë. Nga ana tjetër, edhe Kadareja, si në tërësi poezia jonë e sotme, në ritractimin e motiveve popullore, pothuajse nuk sjell gjë të re në krahasim me letërsinë tonë të mëparshme. Në vetëvete vjershat janë shkruar mirë, është pastruar e aktualizuar stilistika, janë zgjedhur ato motive që pajtohen me botëkuptimin dhe me moralin tonë, po kjo është vetëm një vlerë në vetëvete, një kalim nëpër rrugë të çelura, pak a shumë një përsëritje me mjeshtëri e asaj që është krijuar më parë edhe nga vetë populli, edhe nga poetët që shkruan me stil populor, sado që ndihet vula e personalitetit krijonjës. Po kështu vihet re se vjersha të tilla janë vetëm momentale. Ato nuk krijojnë njësi me térësinë e veprës, gjë që, në fund të fundit, as do të ishte e arësyeshme të kërkohet prej kujtdo e për gjithnjë. Ne vetëm duam të theksojmë (meqë qëndrimi ndaj krijimtarisë popullore është një problem i përgjithshëm), se çështja është te brendia e re e veprave me frysë popullore, te elementet e reja jetësore që duhet të hyjnë tek ajo e ta revolucionarizojnë, pastaj e si rezultat i këtyre, edhe te gjuha e stilistika poetike, që do të pastrohej me elemente të reja të kohës dhe do të pastrohej prej elementëve të vjetëruara. Në poezinë tonë me «natyrë» popullore ka shumë vjetësirë edhe në brendinë ideo-re (elemente patriarkalizmi), edhe në pasqyrimin e ambienteve (jo sipas jetës, po sipas stampave të njohurë), edhe në elementet stilistike e në gjuhën poetike. Kështu ndodh që, ndërsa jeta ecën përpara, kjo poezi mbetet prapa, duke krijuar një veçim të vetes prej kohës, që merr formën e afrimit më tepër me të kaluarën, se me të sotmen. Në rastin tonë nuk kemi të bëjmë me të këqia e rreziqe të tilla, po edhe këtu ambientet dhe heroï lirik nuk kanë vulë të kohës, janë të papercaktuar. Ashtu mund të ndodhë gjithnjë. Po s'është e thënë të vazhdojë gjithnjë kështu. Objektivisht janë të gjitha mundësítë për një mbështetje krijonjëse më të thellë në poezinë popullore. Kjo është, ta-

ni për tani, jo vetëm një mundësi. Janë dhënë prova të mira dhe janë krijuar vepra me vlerë. Do të përmendja këtu poemën «*Devoll, Devoll*», të Dritëro Agollit dhe «*Drashovica*» të Fatos Arapit, po në tërësinë e poezisë sonë kjo akoma mbetet një mundësi, që do të realizohet prej atyre poetëve të dalë nga gjiri i popullit, të cilët do të janë në gjendje, jo të ndjekin poezinë popullore, të krijuar dhjetëra e qindra vjet më parë, as atë të poetëve, që shkruan kohë më parë, po, duke njobur thellë shpirtin poetik të popullit, të krijojnë një poezi moderne. Dihet që kjo detyrë nuk mund të realizohet prej vargëzonjësve të patalentuar, që spekulojnë me folklorin. Poetëve më të talentuar u mbetet kjo barrë.

Edhe në trajtimin e motiveve historike ka vjetërsi. Kjo vjetërsi, mbase në një shkallë më të ulët, vërehet edhe në vjershat e Ismail Kadaresë. Pothuajse të gjitha vjershat me motive historike janë të vjetra në frymë dhe në formë. Ato, gjithashtu, nuk janë në pajtim me natyrën e përgjithshme të krijimtarisë, janë diçka më vete, që ka mbetur nga e kaluara dhe që përsëritet herë pas here, pa ndonjë tendencë të theksuar ideore e artistike. Forma e tyre ka karakterin e baladave të qëmotshme. Tipike është ballada «*Ikja e Moisi Golemit*», ku elementi i vjetër formal ka prekur e ka ngushtuar edhe brendinë ideore dhe, në vend të analizës klasore e të demaskimit patriotik, në vjershë sundojnë motivi psikologjik dhe shqyrtimi i «ndërgjegjes së tronditur» të tradhëtarit.

Ka disa qëndrime të njobura në trajtimin e motiveve historike, si: trajtimi në frymën dhe në formën artistike të *kohës nga nxirret tema*; trajtimi historikish besnik, po në frymën dhe në formën artistike *kur shkruhet vepra* dhe, trajtim i lirë subjektiv e arbitrar i historisë, në mënyrë romantiqe e «moderne». Për mendimin tonë qëndrimi i dytë, karakteristik për gjithë letërsinë realiste, është më i drejti. Gjertani poezia dhe gjithë letërsia jonë, bile, edhe artet tona në përgjithësi, kanë bërë shumë pak në këtë drejtim, ndaj edhe vetë problemi mbetet i hapur, i pazgjidhur prej praktikës. Me ndonjë përashtim, e tillë ishte, për shembull, krijimtaria kushtuar pesëqindvjetorit të Skënderbeut. Arti dhe letërsia jonë nuk kishin nevojë të ringjallnin

klasicizmin dhe romantikën pararevolucionare. Ato kërkonin heroin e madh kombëtar të parë prej bashkëkohësve tanë, të vlerësuar nga pozitat tona të sotme ideologjike, aq më tepër se momenti historik ishte shumë i përshtatshëm për një «paralelizëm» të dy epokave dhe për të kaluar në përgjithësimë të mëdha historike, filozofike dhe artistike.

Një element me rëndësi i poetikës së kaluar që përdoresh gjerësish në poezinë e Ismail Kadaresë është *animizimi* i natyrës, i sendeve, i teknikës. Ky është një element shumë i vjetër letrar. Atë e gjejmë që në përrallat më primitive dhe prejardhjen duket se e ka pikërisht në besimet e lashata të njerëzve primitivë, në bestytnitë e tyre. Me kohë ky element e humbi karakterin e brendisë letrare artistike (si të thuash: — doli nga përbajtja dhe mbeti në formë), duke ruajtur vetëm dukjen e jashtme si përbajtje. Ai u bë një konvencion artistik, që e përdor gjerësish poezia moderne, bile edhe proza. Në poezinë e Kadaresë dallojmë tri forma të përdorimit të këtij konvencioni: *formën e mirëfilltë*, kur vetë sendi animizohet dhe merr atributet e një qenjeje të gjallë (poema «Antena»), *formën e tërthortë*, kur poeti u drejtoshet sendeve dhe natyrës si qënjeve të gjalla (poemat «Lokomotiva» «Toka kufitare», etj.) dhe *formën thjesht stilistike*, kur poeti, në vargje të vecanta, u jep sendeve atrabile ose fate qenjesh të gjalla (antena që mardhin e dridhen në shi, etj.) Nuk mendojmë që për shkak të prejardhjes bestyde të këtij konvencioni, ai të hidhet poshtë e të mos vazhdojë në praktikën letrare të ditëve tonë, në qoftë se nuk përban dy elemente të rrezikshme idealiste, karakteristike për poezinë «moderne» të paktën nga vitet 1920 e këtej. Këto dy elemente kryesore janë: *kulti i teknikës* (në rastet më të mira fshehja e njeriut pas teknikës) dhe *karakteri i «përgjithësuar njerëzor»* (jo klasor). Në poezinë e Ismail Kadaresë ndihen përpjekje të ndërgjegjshme edhe për t'u afruar me këtë konvencion e për ta përdorur atë, edhe për të kapërcyer rreziqet që përmendëm, ndonëse në një mënyrë poetike naive.

Një tjetër element i huajt prej përrallave e legjendave, që ndeshet në poezinë e Kadaresë, është «*motivi i ri-*

*ngjalljes*» që me kohë ka humbur terren, po vazhdon të shfaqet jo në kuptimin e një besimi mbi përjetësinë e shpirtit (kjo do të ishte absurde), po si një element konvencional romantik i vjetëruar dhe i dëmshëm. Skënderbeu ngrihet nga varri dhe kërkon shokët e vet, varret e tyre. Ky konvencion është përdorur për të lidhur dy epoka luftarake: kohën e Skënderbeut me kohën e heroizmit partizan. E pse duhet e gjithë kjo? Ose pse duhet që të vdekurit e shekujve të kaluar edhe sot e kësaj dite të ecin me «kâtër patkonj» (Kënga e ushtarëve të vjetër)? Kjo tregon vetëm se poezia e re, edhe në krijimtarinë e njërit prej poëtëve më të talentuar, ende mbështetet në konvencione të vjetëruara dhe, ndërsa animizimi është *modernizuar*, motivi i ringjalljes ka mbetur po ai, që gjemë në legjendat e në përrallat populllore.

Lind pyetja: a duhet t'i japim rëndësi anës ideologjike të konvencioneve artistike, apo duhet *t'u përshtatemi* ose *t'i përshtatim* ato? T'u përshtatemi atyre është gabim, po edhe t'i përshtatim nuk është ndonjë meritë. Në iniciativat e sotme populllore janë hedhur poshtë edhe shumë konvencione (duvaku, forma të betimit, etj.), megjithëse ato, në vështrim të parë, duket sikur nuk kanë të bëjnë me esencën ideologjike të luftës kundër paragjykimeve fetare dhe zakoneve prapanike, po që, në të vërtetë, në mos më tepër, janë një kujtim i tyre. A nuk duhet që edhe letërsia ta ndjek këtë shembull? Ky nuk është një vulgarizim. Kjo është ngritje e letërsisë, edhe në pikëpamje të mjeteve që ajo përdor, në një nivel më të lart ideologjik e shkencor.

Poezia e Ismail Kadaresë është një poezi e figurshme. Një prej dukjeve më të sigurta të talentit të poetit, jo vetëm në poezi, po edhe në prozë, është pa dyshim zotësia e tij për të kapur dhe pasqyruar në mënyrë të figurshme realitetin, qoftë si tërësi, qoftë edhe në kuptimin e veçantë stilistik. Në shumë krijime të tij mendimet e gjalla dhe ndjenjat e fuqishme janë të shkrira në konceptimin e përgjithshëm figurativ të temës që trajtohet dhe, në pajtim me këtë, lulëzojnë në vjershat e poemat figurat e shumta stilistike, që e bëjnë gjuhën e përdorur një gjuhë të figur-

shme e me ngjyrë. Hiperbolat dhe antitezat, krahasimet dhe paralelizmat, epitetet dhe atributet janë mjetet më të përhapura në këtë poezi dhe kanë shërbyer gjer në një farë mase, duke iu nënshtruar elementeve të tjera krijonjëse më kryesore, për të përcaktuar fizionominë e vjershërimit. Këto figura janë organike dhe të natyrshme. Ato nuk të krijojnë, në të shumtën e herës, përshtypjen e kërkimit formal dhe të dëshirës së poetit për të stolisur vargjet. Ato janë vetë vargjet, brendia dhe forma e tyre, janë shprehëse të karakterit unik të krijimtarisë. Për to mund të shkruhej gjatë dhe me hollësi, po kjo do të dilte jasht kufive të këtij vështrimi të përgjithshëm.

#### IV

Kanë kaluar pesëmbëdhjetë vjet që nga koha kur Ismail Kadareja botoi vëllimin e vet të parë. Shumë ndryshime kanë ndodhur në këtë botë, në zhvillimin e vendi tonë, në nivelin e kulturës, të letërsisë e të artit tonë socialist, në vetë formimin ideologjik e artistik të poetit, që ka krijuar e plotësuar personalitetin e vet dhe është tanë një prej shkrimitarëve më të njobur e më prodhimitarë, krijimtarinë e të cilit e ndjek me interesim masa e gjerë e lexonjësve e, në mënyrë të veçantë, rinia.

Ne u munduam të shohim gjatë studimit procesin e formimit të këtij personaliteti krijonjës, shkallët e zhvillimit të tij, ndikimet shoqërore, politike dhe letrare-artistike, që kanë marrë pjesë në këtë proces dhe rezultatet kryesore të punës letrare të poetit. Para se të përpinqemi të nxjerrim disa përfundime të përgjithshme, mendojmë se do të ishte me vend të ndalemi në një çështje që po diskutohet, në çështjen e ndikimit të poezisë së Kadaresë në letërsinë tonë të sotme, sidomos në rininë tonë letrare.

Ka raste kur drejtëpërdrejt ose tèrthoraz kjo poezi merr si *shkak* i të gjithë të metave dhe dobësive në krijimtarinë e poetëve të rinj. Ky është një trajtim i gabuar, i njëanshëm dhe i ngushtë i çështjes së ndikimeve letrare e artistike, të cilat janë aq të natyrshme, sa ç'është i natyr-

shëm edhe vetë karakteri komunikonjës i letërsisë dhe roli edukativ ideor e artistik i saj. Të mohosh ndikimet në letërsi e në art do të thotë të mohosh *karakterin ndikonjës* të letërsisë, ta kuptosh atë si një krijimtari *thjesht personale*, të përjashtosh nga kjo fushë veprimtarie *përgjithësimin e eksperiencës së përparuar*, që të huajmë një shprehje, e cila përdoret zakonisht në ekonomi. Çdo letrar hyn në letërsi, kur ajo ka arritur një nivel të caktuar zhvillimi dhe ka përcaktuar idealet e veta ideo-artistike. Kjo është baza objektive letrare, e përcaktuar nga niveli i zhvillimit shoqërор, nga niset letrari për veprimtarinë e tij të ardhshme «të pavarur». Ka letrarë, që mbeten vazhdonjës pa personalitet të ndonjë apo disa «idhujve», ka të tjerë që i qëndrojnë denjësish kohës (këta përbëjnë masën), ka edhe disa që i kalojnë kufitë e gjetura dhe çelin horizonte të reja. Këta të fundit janë mishërim e konkretizim i tendencës objektive të zhvillimit dhe, për këtë arësy, të rintjtë ecin pas tyre gjersa të krijojnë personalitetin e vet dhe, pastaj, edhe ata të kapërcejnë mësonjësit, të çelin të tjera horizonte të reja.

Ismail Kadareja është një prej këtyre të fundit, që është rropatur t'i kapërcejë kufitë e letërsisë së kohës dhe të çelë, në kuptimin artistik, horizonte të reja për të. Ky është një rezultat pozitiv, që tregon vitalitetin e shoqërisë e të letërsisë sonë, që mishëron përpjekjet e gjithë letrarëve tanë, që, më në fund, nuk është gjithshka, po është pjesë me rëndësi e rezultateve krijonjëse të shumë shkrimtarëve të talentuar të kohës. Ndigimi i Ismail Kadaresë në letërsinë e sotme është një fakt, që mund të ngjallë edhe kundërshtime, po që nuk mund të mohohet, sidomos në poezi. Ky ndikim do parë, para së gjithash, në qëndrimet e reja që krijojen ndaj poezisë, në mënyrën e konceptimit poetik të realitetit, në mjetet e pasqyrimit, në stilistikën poetike, etj. Eshtë fakt i njohur që dhjetë vjetët e fundit vërehet një përtëritje e poezisë dhe e letërsisë në tërsi. Kjo përtëritje është e lidhur me zhvillimin e përgjithshëm të vendit dhe me ngritjen e nivelit kultural të punonjësve, me sukseset e mëparshme të krijimtarisë letrare-artistike, me ardhjen në letërsi të talenteve të reja dhe, doemos, me ndikimin e po-

etëve më të mirë e të veprave më të shquara poetike, ndër të cilat vend me rëndësi zënë edhe krijimet poetike të Kadarenë. Ndër rezultatet kryesore të poezisë së këtyre viteve do të përmendnim si më kryesoret theksimin e mëtejshëm të karakterit klasor proletar revolucionar të poezisë dhe modernizimin e formës, domethënë përpjekjet për të pajtuar artistikisht poezinë me kohën, me nivelin e ri të punonjësve. Në përgjithësi, vështrimi i poetëve është kthyer nga fshati drejt qytetit, nga elementet tradicionale te faktet dhe elementet e reja shoqërore, nga mënyrat tradicionale të konceptimit dhe të pasqyrimit të realitetit, në mënyra të reja më të gjera dhe më aktive, që e bëjnë poezi në nga një «*stolisje të realitetit*» një element që buron prej vetë realitetit dhe manifestohet nëpërmjet pasqyrimit aktiv të tij. Kjo tregon se letërsia jonë e re po *krijon traditën e vet*, po formon dalëngadalë *klasikën e vet* të realizmit socialist. Prej traditës më të hershme në këtë kohë merr rëndësi poezi e viteve 30 me Migjenin, si përfaqësuesnjësin kryesor të saj. Në këtë kohë, njëkohësisht me Ismail Kadarenë, formojnë personalitetin e vet krijonjës Fatos Arapi, Dritëro Agolli, Agim Gjakova, Dhori Qiriazi, etj. dhe, pas tyre, vazhdon një numër i madh poetësh të rinj, të cilët, gjithashtu po sjellin në letërsi (edhe nëpërmjet nditimit) freskinë e ndjenjave e të mendimeve, mentalitetin dhe psikologjinë e brezit më të ri dhe është e natyrshme që prej tyre të priten poetë, që do të çelin edhe horizonte më të reja për poezinë tonë kombëtare. Kështu lind ndikimi reciprok i brezave në letërsi, ndikim që presupozon edhe mohimin, edhe pohimin revolucionar. Në letërsinë tonë ky ndikim reciprok brezash zhvillohet në një terren shoqëror, politik, ideologjik dhe estetik unik. Mungesa e klasave kundërshtare dhe uniteti moral e politik i shoqërisë sonë s'ka si të mos reflektohet edhe në jetën letrare e artistike, pa mohuar luftën kundër mbeturinave ideologjike të klasave të përbysura, që gjejnë vend edhe në letërsi. Kjo është lidhja dialektike e përhershme ndërmjet traditës dhe zhvillimit, ndërmjet të vjetrës dhe të resë. Mohimi i njërsës prej këtyre anëve (karakteristike në momente ek-

zaltimesh) shpie vetëm në trajtime të njëanshme metafizike të çështjes.

Po a duhet dalluar ndikimi krijonjës prej imitimit? N dikimi krijonjës ka kuptimin e edukimit *krijonjës*, kurse imitimi është *skllavërim krijonjës*. Në letërsi e në art do të ndeshen gjithnjë të dy fenomenet, gjersa do të ketë gjithnjë talente dhe personalitetë të sigurta dhe njerëz me aftësi krijonjëse, po pa personalitet. Në këtë mes nuk ka asgjë për t'u shqetësuar dhe aq më tepër nuk ka vend pér të qërtuar të imituarin. Fajtor, në qoftë se kemi të bëjmë me faj, është ai që imiton, sidomos ai që keqimiton. Në rastin tonë, në poezinë e të rinxve, vërehen disa imitime formale të mënyrës krijonjëse të Ismail Kadaresë, të figurave dhe të formës së vjershërimit të tij, po me këtë anë të çështjes është e kotë të merresh, ndaj është më e arësyesh-me të kthethemi prapë te problemi i ndikimit.

Nga sa thamë në këtë artikull, del që vetë Ismail Kadarëja në procesin e zhvillimit e të formimit të personalitetit të vet, gjithnjë ka kërkuar, gjithnjë ka gjetur diçka të re (të mirë ose jo të mirë) dhe, në këtë mënyrë, gjithnjë «*ka braktisur*» vetëveten në një drejtim a në një tjetër. Kjo tregon se poezia zhvillohet, ecën, përparon dhe ndikimi më i mirë sigurisht do të ishte që të kalonte ky qëndrim ndaj poeziës nga ndikonjësi te i ndikuari, ndryshe, siç ndodh në mjaft raste, do të krijohej uniformitet, monotonji dhe rutinë, një rutinë e re, që do t'i zinte vëndin të vjetrës, gjë që ndodh sa herë nuk nisemi nga jeta e gjallë, po prej modelesh letrare të veçanta. Kjo është njëra anë. Ana tjetër është, se në vetë krijimtarinë e Kadaresë ka kontradikta ideore dhe artistike, disa prej të cilave me kohë janë kapërcyer. Pra, del nevoja, si në këtë rast, edhe në çdo rast tjetër, që entuziazmit dhe ekzaltimeve të çastit t'ja zërë vendin një qëndrim i vëmendshëm kritik ndaj krijimtarisë, ndryshe në vend që të marrim, të përhapim e të përgjithësojmë të mirën, të shëndoshën, të bukurën, do të marrim e do të përgjithësojmë bashkë me të edhe të keqen e të shëmtuarën, duke mbajtur një qëndrim shoqërisht objektivist ndaj letërsisë dhe, në vend që ta forcojmë e ta përparojmë atë, do ta mbajmë në vend, e do ta rrezikojmë.

Vëllimi i fundit me vjersha e poema i Ismail Kadaresë («Motive me diell») dëshmon se poeti nuk i ka ndërprerë kërkimet. Ai, siç e kemi përmendur edhe më lart, pas shumë kërkimeve, ka arritur në dy rezultate krijonjëse me rëndësi: e para, në afimin me jetën e gjallë dhe nisjen prej saj dhe, e dyta, në krijimin e një poezie të drejtpërdrejtë, të qartë e të thjeshtë, duke iu larguar subjektivizmit dhe ndikimeve të poezisë së huaj subjektiviste. Këto janë dy rezultate krijonjëse me rëndësi për të pasur një poezi realiste revolucionare, me karakter populor, edhe në kuptimin formal artistik, pa dyshim do të thellohen edhe më tej, duke iu shmangur rrezikut të vulgarizimit dhe të afirmit te njeriu i rrugës, me duar në xhep, me cigare në gojë e me tranzistor në krah, që krijojnë iluzionin e një jete e të një pozie moderne, po që, në të vërtetë, janë reflekse të psikologjisë e të mentalitetit të një kategorie të parëndësishme njerëzish në shoqërinë tonë të sotme. Tipave të tillë zakonisht nuk u thuren poezi, po u vihen fletërrufe. Vepurat, që përfaqësojnë prirjen e shëndoshë e kryesore janë ato që kanë edhe vlerë shoqërore pozitive me rëndësi artistike për gjithë letërsinë tonë të sotme. Ato mbajnë vullën e kohës sonë, të revolucionit tonë, të perspektivave të socializmit e të komunizmit tek ne dhe në botë. Të lindura nga revolucioni, të brumosura me idetë dhe idealet e mëdha klasore revolucionare, të nisura ngajeta e gjallë dhe jo nga abstraktume subjektive për jetën, ato janë edhe vetë revolucionare, novatore dhe kanë ndikuar e do të ndikojnë në zhvillimin e mbarë të letërsisë sonë të realizmit socialist.

## TOKA IME, KËNGA IME

(Shënimë për poezinë  
e Dritëro Agollit)

*Vjersha ime er' ugari bje,  
vargu im bje erë lulcsiqerë...*

(D. AGOLLI)

Poetët tanë, të vjetër e të rinj, e kanë bërë zakon të flasin në vjersha e në poema për vargjet e tyre, për veten dhe për poezinë në përgjithësi. Kjo është një e drejtë e tyre, s'ka gjë nëse na pëlqen apo nuk na pëlqen neve, që duam të këndojmë vargje për jetën e jo vargje për vargjet dhe ta gjykojmë vetë poezinë, pa qenë nevoja të na i reklamojë poeti, që kurdoherë lëvdon veten dhe thumbon e sulumon të tjerët. Sidoqoftë, duke lënë mënjanë anën etike të çështjes, bile edhe anën e përgjithshme estetike të saj, kur lexojmë vargje të atilla herë rrudhim buzët e herë qeshim dhe vetëm më të rrallë jemi në një mendje me poetin. Kjo ndodh se përgjithësisht njeriu e ka vështirë të njohë e të çmojë vetëveten pa subjektivizëm. Aq më tepër shkrimtari dhe artisti. Po ka poetë që e zbulojnë me paanësi vetëveten dhe e zhvillojnë gjithnjë e më mirë prirjen e natyrshme të tyre. Duke u zhvilluar, ata i qëndrojnë besnik natyrës së tyre, janë unikë në tërësinë e ndjenjave e të mendimeve dhe arrijnë deri sa edhe vlerësimet që i bëjnë vetëvetes dhe krijimtarisë së tyre të tingëllojnë të vërteta e të natyrshme dhe të jenë të pranueshme e të besueshme për

lexonjësin, i cili, në të tilla raste, as rrudh buzët i pakënaqur, as qesh me ironi, po thotë: ashtu është me të vërtetë!

Kështu ndodh, për shembull, kur lexojmë vjersha<sup>+</sup> e Dritëro Agollit, të cilat, edhe sikur të mos na e thotë poeti, do të na bënin të ndjejmë erën e ugareve, suferinë e maleve, gazin dhe brengat e fshatarëve, erën e djersës e të lëngut të pjeshkëve, vërvshimin e gjakut ndër deje dhe madhështinë e luftës për jetën, shpërthimin e hapur të ndjenjave dhe fjälën e bukur e të ashpër të gjuhës popullore. Ai sjell në poezinë tonë të re, dhe për herë të parë në gjithë historinë e letërsisë sonë, temperamentin dhe shpirtin e malësorit të jugut, me autenticitet, me forcë poetike dhe me një shprehje të drejtpërdrejtë e të hapur, që në pak poetë mund ta gjejmë. Prandaj ne e besojmë kur na thotë se: «vargjet nëpër fusha i ka shkruar, — ndënë hije rrapesh apo shelgjesh», apo kur deklaron me duf:

«Po, Devoll, — i tillë qen kam unë, — paskam marrë baltën tënë arave, — në një trajstë leshi — ndënë gunë — për t’ja sjellë — Lidhjes së Shkrimtarëve. — Thellë kësaj balte — përmbi lumë, — që aq breza rrënëjsh e lëvrinë, — unë, — devolliu i pagjumë, — gjeta vargjet, — gjeta poezinë.

Sa e vërtetë është kjo daklaratë poetike, do ta shohim prej analizës së veprave të Dritëro Agollit, me të cilat do të merremi në këtë studim.

## II

Dritëro Agolli i përket brezit të dytë të shkrimtarëve të realizmit socialist. Ai është prej atyre poetëve që hodhën hapat e para në letërsi rrëth vitit 1950, kur vetë letërsia jonë e re hidhte hapat e parë, po kish njohur edhe disa suksese të dukshme me krijimtarinë e Shevqet Mu-sarajt e të Aleks Çaqit, të Dhimitër Shuteriqit e Kolë Jakovës, të Lazar Siliqit e të Andrea Varfit me shokë. Vjer-shat e tij të para, që u botuan edhe në organet e Lidhjes së Shkrimtarëve, me të drejtë têrhoqën, vëmendjen e poe-

Wëve më të njojur, por sado që flisnin për aftësitë e vjershëtorit të ri, ato qenë vjersha të përgjithshme, pa ndonjë origjinalitet, bile edhe pa ndonjë frysëzim të madh. Ato, si të thuash, qenë prova vjershërimi, më tepër se poezi. Pas tyre, për pesë a gjashtë vjet, poeti i ri pothuajse nuk batoi fare, gjersa më 1958 na doli në udhë me përbledhjen e tij të parë poetike (*Në rrugë dola*) dhe, kësaj radhe, sikur e kish përcaktuar deri në një farë mësë portretin e vet dhe, përmes ndikimesh e reminishencash, nëpër barërat e naivitetit fillestar dhe vagëllimes romantike, në vargje nxirrte krye me një farë sigurie poeti i ardhshëm nga Devolli, që do të zinte një vend krejt të vetin, një vend nderi në poezinë shqiptare të pasur në tradita dhe në vlera aktuale. Në vëllimet e mëvonshme poetike (*Hapat e mia në asfalt* — 1961, *Shtigje malesh dhe trotuare* — 1965 dhe *Mesditë* — 1969) me elementet jetësore që ka sjellë në poezi, me karakterin direkt e të gjallë të shprehjes poetike, me dinamizmin e vargut, me atmosferën e shëndetshme dhe me manifestimin besnik të temperamentit e të botës shpirtërore të malësorit tonë të jugut, që merr forma të përgjithësuara shqiptare e njerëzore, duke mos humbur origjinalitetin e karakterit, Dritëro Agolli ka dhënë një kontribut të çmuar në zhvillimin e poezië sonë, duke qenë njëri prej poetëve më të gjerë, më të fuqishëm dhe më origjinal.

Heroi lirik i vjershave dhe poemave të Dritëro Agollit ka karakter unik, është i njëjtë kudo: edhe në krijuimet poetike me motive imtime, edhe në ato ku flitet përvuajtjet dhe për luftën revolucionare, për optimizmin jetësor dhe për entuziazmin e fitoreve, për dhembjen që shkakton vdekja e shokut apo për zemërimin, që ngjallin ndeshjet me vjetërsirat e botës së vjetër. Ai është i njëjtë kudo dhe kudo është sa i gjerë dhe njerëzor, aq edhe i përcaktuar në të gjithë kompleksitetin e vet psikologjik, shqëror e politik. Në takimet me këtë hero të veprave poetike ne zbulojmë, besojmë dhe ndjejjmë të vërteta gjithshka që i përket atij dhe gjithshka që ai thotë për vetëveten. Ai është malësori revolucionar me zemër të madhe, kurdoherë në luftë e në lëvizje, kurdoherë i shqetësuar

dhe që jepet me gjithë shpirt pas çdo gjëje të bukur e të mirë të kësaj bote, që e trondit një zog me krah të thyer, po qëndron ballëlartë para vdekjes, që e mahnit kokrra e vockël e grurit, po ecën me hapa të gjatë në rrugën e revolucionit, që jepet pas dashurisë me gruan, po përballon me stoicizëm të vetëdijshëm e shembullor çdo vuajtje e çdo dhembje që nga brezi në brez zhvillohet e përparon, po ruan ngaherë tiparet burrëore të natyrës së vet prej malësori. Në përgjithësi, ai është shqiptari i ditëve tona, është një «*unë*», tek i cili gjejmë vetëveten të gjithë ne, qofshim bujq që çelim ugare dhe lërojmë edhe zallishtet, qofshim punëtorë që ngremë hidrocentrale apo lidhim kullat me fijet e telave të elektrikut, qofshim intelektualë të popullit, që vrasim mendjen për t'i sjellë dobi Atdheut tonë socialist, qofshim luftëtarë të vjetër, që kemi mbajtur maliherë e nagantë, qofshim edhe të rinj, që sapo hyjmë në jetë. Historikisht ky hero i përket periudhës së Luftës nacional-çlirimtare, kurse, nga pikëpamja shoqërore është njeriu i popullit, njeriu i punës dhe i veprimit revolucionar, mbartës i gjithë barrës së rëndë të detyrave dhe të realizimeve historike të popullit, sidomos të fshatarësisë punonjëse, shprehës i aspiratave e idealeve shoqërore dhe estetike të popullit. Praj qoftë nga përkatësia klasore, qoftë nga konstitucioni mëndor e shpirtëror i tij, nga rruga e ndjekur në jetë, nga fatet e tij historike dhe nga prirjet dhe aspiratat e tij, heroi lirik i poezisë së Dritëro Agollit është një *hero popullor*, një mishërim i vetë popullit, i botëkuptimit dhe botëvështrimit popullor. Kur lexon vjershat dhe poemat e vëllimeve poetike që po analizojmë, krijon bindjen se poeti e njeh, e do dhe është i predispozuar të shprehë me dashuri e me forcë poetike botën e pasur interesante të këtij heroi popullor, portreti i të cilit vizatohet me ngjyrat e forta dramatike të fateve historike të popullit, po edhe me tonet e ndezura lirike të dashurisë për jetën e për botën, me ngjyrat gazmore të humorit popullor. Jeta e tij ështëjeta jonë e ashpër dhe e bukur, shqetësimet e tij janë ose bëhen shqetësimet tona, idealet e tij, në thelb, janë gjithashtu idealet tona, prandaj, nëpërmjet vargjeve të poetit, ne e duam këtë hero, frymëzohemi prej tij

dhe, megjithëse kemi përshtypjen se takohemi me një të njohur, gjatë takimit zbulojmë në fjalët e në rrëfimet e tij shumë gjëra të reja, që nuk i kemi vërejtur më parë ose — kemi kaluar pranë e përball tyre pa u thelluar, bile, ndonjëherë (këtë e gjejmë të shprehur aty-këtu edhe në poezi) kemi pasur përshtypje jo aq «poetike» prej tij, kur e kemi parë me syzet e intelektualit ose me «dhëmshurinë» është atij që kërkon t'i qajë hallin. Në qoftë se në poezinë e Dritëro Agollit nuk kanë gjetur vend këto dy pozita jo të shëndosha, kjo është një meritë e tij, një manifestim i vërtetë, i drejtpërdrejtë dhe i hapur e i sinqertë i karakterit popullor të poezisë, një kuptim i shëndosh realist i letërsisë, si pasqyrim aktiv i realitetit dhe jo si një kapercim intelektual apo një transfigurim subjektiv i tij. Poezinë e përmban vetë jeta. Atje poeti, në fatet historike dhe në jetën e përditshme të *masave të gjera popullore*, gjen burimin e frymëzimit dhe të gjitha elementet e brendisë e të shprehjes poetike.

Karakteri i thellë popullor i heroit lirik të Dritëro Agolliit shprehet, para së gjithash, në qëndrimin e këtij heroindaj botës dhe ndaj jetës, në njëmendësinë dhe në idealet e tij, që kanë ngahera *karakter konkret* e të kapshëm, që janë kurdoherë tokësore, që lidhen gjithnjë me tokën dhe me punën, që nuk mund të egzistojnë kurrë si mendime apo si parafytyrime abstrakte (karakteristike kjo për njërrëzit me fushë të ngushtë veprimtarie e lidhjesh jetësore), po janë të lidhura ngushtësisht dhe burojnë natyrshëm përherë nga lëvizja, nga veprimi i gjallë, nga aksioni, siç ndodh me ndjenjat dhe me mendimet e njerëzve të punës. Kjo konkretësi ndjenjash e mendimesh të ngjizura në matkën e jetës popullore nuk mbetet për poetin në stadin e primitivitetit të shprehjes imediate të nevojave jetësore, të epischeve dhe të shpërthimeve të egra, po ngrihet në lartësinë e përgjithësimeve e të idealeve me karakter të përgjithshëm shoqëror e kombëtar, jo si një diktum apo interpretim poetik intelektual i faktave të jetës popullore, po si brendi e vetë faktave, si një përgjithësim i natyrshëm i eksperiencës shekulllore të masave punonjëse, si një formim karakteri, temperamenti i botëkuptimit nën ndikimin e maleve e të

luftave, të dallgëve e të përplasjeve historike, të lidhjeve me tokën e me njerëzit, të sukseseve e gjëzimeve në jetë, të fitoreve historike dhe të frysëzimeve prej fjalës së zjarrtë të komisarëve e të sekretarëve të partisë.

Ky hero është i njëjësuar me poetin, jo se vjershat dhe poemat shpesh janë shkruar në vetën e parë (gjë që mund të ngatërrojë vetëm një lexonjës naiv), po se platforma ideo-artistike e poezisë së Dritëro Agollit nuk janë konceptet e tij intelektuale për jetën, po ështëjeta vetë, e cila vërvshon në poezi me fuqinë dhe gjallërinë e vërvshimit të gjakut ndër deje dhe ne e shohim poetin të rendë bashkë me të, me të drejtën e këngëtarit të zjarrtë të saj dhe, *vetëm nëpërmjet këngës*, edhe me të drejtën e gjyqtarit, po edhe në këtë rast pa e ngritur zërin mbi të tjerët, mbi popullin, po duke u bashkuar në kor, si shok, si mik e si bashkluftëtar, aq sa shpesh heroi lirik i poezi së tij merr trajtën e poetit, kurse poeti shkrihet e bëhet një me heroin e vet lirik. Kjo gjë vihet re mirë në poemat. Në «*Devoll, Devoll*», për shembull, megjithëse konkretizimi arrin gjer sa poeti të përmendë edhe emrin e vet në vargje (*Ndaj unë — komunisti nga Devollı*, — që kam pendë, — letër — *dhe armë*, — që hedh firmën: — *Dritëro Agolli*, — *ngrihem*, — *kur kap tingullin* — «alarm!»), ne prapë e pranojmë dhe e përligjim atë pikërisht si një shkrirje të poetit me heroin lirik të veprrës: bujkun e lashtë dhe luftëtarin e vjetër, që misheron në tiparet e në fatin e tij, tiparet dhë fatet e gjithë fshatarësisë sonë punonjëse, për të mos thënë të gjithë popullit. Kjo shkrirje e poetit me heroin lirik nuk është thjesht një manierë stilistike ose një pozë, gjë që do ta banalizonte poezinë, po është një shkrirje ideore, një përqafim i përzemërt dhe i singertë i gjithshkaje të bukur që ka populli, një depërtim në thellësi të jetës e të shpirtit popullor për të zbuluar madhështinë e kësaj jete e të këtij shpirti. Pikkërisht kjo pozitë është një prej atyre veçorive të rëndësishme që e dallon Dritëro Agolin prej poetëve të tjerë. Në këtë pozitë nuk mund të arrihet spontaneisht dhe as në rrugën e njobjes nga jashtë të jetës së popullit, po nëpërmjet vetë karakterit të natyrshëm popullor të predispozi-

tave shpirtërore e të mendimeve, nëpërmjet dashurisë për gjithshka popullore.

Të gjitha këto bëjnë që heroi lirik i poezisë së Dritëro Agollit të jetë konkret, i kuptueshmë dhe i dashur për masat e gjera të lexonjësve të kategorive të ndryshme popullore. Atë e kuptojnë edhe kooperativistët, edhe universitarët, se gjejnë të mishëruar në të jetën e popullit, jetën dhe idealet e shumë brezave. Absolutizimi në këtë mes, sidoqoftë, nuk do të ishte i arësyeshëm dhe i vërtetë. Heroi lirik dhe lexonjësi në afilitetin ndërmjet tyre kanë nga hera ndërmjetës poetin dhe poeti, sado i thellë e i gjerë që të jetë, sidomos në periudha ndrimesh të mëdha shoqërore, nuk mund të përfaqësojë çdo prirje e çdo shtresë dhe, për këtë arësy, me dikë do të jetë më i afërt e më i dashur, me dikë i pranueshmë dhe për dikë edhe i papranueshmë. Kjo jo vetëm për karakterin klasor të poezisë, po edhe për nivelin e pabarabartë të zhvillimit shoqëror të shtresave të ndryshme të popullit, që vijnë duke u njëjsuar, po ruajnë ende veçori të rëndësishme në punë, në mënyrën e jetesës dhe në mentalitet. Të rëndësishme në këtë mes janë dy gjëra: e para, që heroi lirik i poezisë së Dritëro Agollit është mishërim realist i fshatarit shqiptar të një periudhe historike të caktuar dhe si të tillë ne e pranojmë dhe e përligjim, duke e vënë përballë jetës (kjo, besoj, në vija të përgjithshme është jashtë diskutimit) dhe, e dyta, që ky hero lirik nuk është tipizim i një grupi a shtrese të parëndësishme shoqërore po është tipizim i fshatarësisë punojëse, i klasës më të madhe të shoqërisë sonë aktuale, pra, edhe afilitetin e krijon me këtë masë të madhe njerëzish.

Fizionomia e këtij heroi lirik është dhënë me gjërsi e me besnikëri në krijimet poetike të Dritëro Agollit e, sidomos në poemat «*Hapat e mia në asfalt*», «*Devoll, Devoll*», «*Toka ime, kënga ime*», dhe «*Baballarët*». Në këto vepra dhe në krijimet e tjera të poetit ai del si *hero i dramës së madhe* të së *kaluarës shqiptare*, njeriu i shtypur dhe i revoltuar, i uritur e i robëtuar, i goditur po i pagjunjëzuar, njeriu i parmandës së drunjë dhe i mauzerit, vërtet i varfër por në shpirt i lirë dhe krenar, i lidhur me copën e arës përmbi lumë, po edhe me ndjenjën e zjarrtë të atdheda-

shurisë, që shpesh e ka detyruar të lërë parmendën e të rrëmbejë dyfekun. Ai është nga ata «që mbanin malet mbi shpinë, — dhe plisa në bahë thërmonin me gishta». Ai «djepin e gdhendi nga boriga», «u nanurit me legjenda gjyshërish» «mbështolli trupin me velenxa leshi», dhe, gjer dje «për misër zbriste në qytet». Prandaj poeti thotë:

«Është gruri, kokërrza e grurit, — pjekur verës, arave nën diell, — që trondit e zbut zemrën e burrit».

Dallgët e jetës e të rrjedhës historike e goditën atë më keq se era dhe stuhia e maleve, e poqën më keq se dielli, e forcuan më tepër nga puna, e ashpërsuan më shumë se shkëmbinjtë dhe portreti i njeriut të punës, që i gjëzohet jetës për gjithshka, mori trajta të rrepta e të vrejtura dhe u përgjasua me malet, me shkëmbinjtë e me borigat. Po as u përkul, as u turbullua. Me stoicizmin karakteristik të popullit, që lind nga lufta e ashpër për jetën dhe nga bindja se vetëm ai mund të përtérijë lumturinë e zhkatëruar, ky hero, pas luftave për liri, me gjithë mynxyrat që i ndodhin, kthehet përsëri dhe e nis jetën nga e para me burrëri.

«Dhe erdha vatrës t'ja ndezë zjarrin, — që oxhaku prapë të nxjerrë tym, — që rreth oborrit të korr barin, — që murit t'i heq ndryshk e myshk».

Heroi lirik i poeziës së Dritëro Agollit është *njeriu i punës*. Kjo është një tjetër meritë e rëndësishme që është arritur në krijimtarinë e poetit. Puna është e pushtetshme, manifestim i madhërishëm i forcave jetësore, është mund dhe gjësim, përpjekje për të jetuar e për të përmirësuar jetën dhe këngë e frysësim. Poeti asnjëherë nuk merret me filozofime abstrakte, qofshin këto edhe të shëndosha, për të zbuluar mëndërisht të fshehtat dhe kuptimet e jetës. Aq më pak merret me filozofime për botën e për gjithësinë. Përkundrazi. Poezia e tij është poezi e lëvizjes, e veprimit, e punës, e përpjekjeve dhe e rrapatjeve të përjetshme të popullit dhe këtej, në mënyrë krejt të natyrshme, në një rrugë poetike plotësisht realiste e dialektike, dalin ose nën-kuptohen përfundimet filozofike. Në gjerësinë e jetës së popullit fshihen të vërtetat e jetës dhe jo në mendjen e njerëzve. Heroi lirik i poeziës së Dritëro Agollit ka bonsensin e njeriut të popullit, të fshatarit punonjës. Mendi-

mi i tij, sikurse edhe gëzimet dhe brengat e tij, janë konkrete, shkaktohen prej vetë jetës e jo prej stërhollimeve filozofike apo etike. Për të e bardha është e bardhë dhe e zeza e zezë. Realizmi i poezisë në këtë drejtim qëndron pikërisht edhe në faktin se poeti ka pasur aftësinë të zbulojë dhe të vizatojë me vërtetësi fshatarin malësor të kohës sonë, në stadin historikisht të përcaktuar të zhvillimit të tij, pa i atribuar gjëra që nuk do t'i shkonin dhe pa e veshur me kostume, që nuk do t'i rrin. Kjo është një fitore mbi subjektivizmin, që është arritur nëpërmjet kapërcimit të intuitivizmit në krijimtari, gjë që vërehej edhe në shumë krijime të hershme të vetë Dritëro Agollit. E gjejmë heroin lirik të kësaj poezie tek çel brazda në ugare, tek shtyn shkëmbin me shpatulla, që të fitojë një copë tokë të re, tek thyen plisat dhe hedh farën, korr grurin e barin, zgjat fijet elektrike dhe ndez minat, shtegëton gjithnjë i bindur se «*kudo të shkosh, — kudo të ndodhesh — të presin njerëz në takim*» dhe kështu, në valë të punës e të veprit, në mes njerëzve, ngjizet dhe merr formë mendimi i tij për botën, për jetën, për njerëzit. Dhe, si çdo gjë që del nga puna, edhe mendimi i lindur prej saj është i natyrshëm, i freskët, i fortë dhe bindës.

Dritëro Agolli, ashtu siç mishëron tiparet dhe fatet e popullit, mishëron edhe filozofinë e popullit, filozofinë naturale të fshatarit, një filozofi materialiste, në të cilën identë lindin prej sensacioneve e përceptimeve, prej veprit, dhe eksperiencës dhe akoma nuk ndihet ndikimi i librave, po ndihet, ama, ndikimi i fuqishëm i komisarëve dhe i sekretarëve të partisë, ndikimi i revolucionit dhe i transformimit socialist.

«*Mendimi juaj zgjatet edhe zgjatet — nga kokrra e grurit — gjer te qeveria, — kalon lugina, — fusha edhe shpate, — nga lëmi i fshatit — gjer te gjithësia*».

Pra, nuk kemi të bëjmë thjeshtësisht me një botëvështrim fshatarak të ngjeshur brenda kufive empirik, po me një *formim* mendor e ideologjik, me një konstitucion shpirtëror të përcaktuar historikisht, me një zgjerim hori-

zonti «*nga lëmi i fshatit gjer te gjithësia*», gjë që nuk mund të arrihej veçse nëpërmjet revolucionit dhe ndërtimit socialist, që zgjuan ndërgjegjen politike të fshatarit dhe po transformojnë ideologjinë dhe botëkuptimin e tij, krahas ndërrimeve politike, shoqërore dhe ekonomike në raportet e pronësisë, në organizimin e punës dhe në mënyrën e jetesës. Të gjitha këto kanë ndikuar në zhvillimin e fshatarit tonë dhe në përcaktimin e profilit moral e politik të tij.

Heroi lirik i poezisë së Dritëro Agollit është *njeriu i Luftës nacional-çlirimtare dhe i revolucionit*, pjesëmarrës aktiv i këtyre ngjarjeve të mëdha historike në jetën e populli dhe, siç e kanë zakon malësorët, atij i pëlqen të kujtojë e të përmendë gjithnjë luftën dhe trimërinë, të flasë përto me krenari legjitime, me entuziazmin e luftëtarit, që e sheh se fitoi mbi armiqtë dhe mundimet e tij nuk vanë kot. Vitet e luftës kanë hyrë thellë në ndërgjegjen e tij, janë bërë elemente të kësaj ndërgjegjje, pjesë të vetë qenjes së tij dhe ruajnë akoma aktualitetin dhe freskinë tërheqëse të kujtimeve të lavdishme, që kanë forcë jetëdhënëse, si pjesë me rëndësi të profilit të heroit lirik, i cili kujton me mallëngjim dhe me krenari kohën kur binin shokët ndër beteja dhe:

«Në çantë komisari listën e komunisteve kish, — në listë dhe emri im ish shënuar.... — Dhe lista e bardhë, nga gjaku, u bë lulekuqe. — Drutë e tua mblodha e ndeza një zjarr në lajthishte, — e letrën e thava, — po letra mbeti e kuqe — dhe emrat tanë mbetën të kuq në listat e partisë». Prandaj:

«Erë plumb e erë predhe, — erë prush e erë brengë, — erë dushk e luleshqerre, — binin, binin ato këngë» — thotë poeti për këngët e rapsodit Selim Hasani, ndërsa ne mund të themi të njëjtat fjalë për vjershat e poemat e tij.

Populli ynë ka ndërgjegjen e luftëtarit, të ushtarit të përjetshëm. Kjo ndërgjegje nuk është shenjë race apo manifestim fuqish të fshehta të shpirtit të tij. Ajo është formuar historikisht, është përcaktuar prej vetë karakterit të

zhvillimit tonë si popull e si komb, në luftë të pérherëshme kundër agresorëve dhe pushtonjësve të huaj. Nuk kemi provuar zinë e robërisë. Prandaj e duam dhe e mbrojmë lirinë, prandaj kënga e luftës dhe kënga e ushtarit ndihen edhe sot kudo, jo në balada romantike e në vjersha nostalgjike për «kohët e lavdishme», po si këngë të vetë jetës sonë, të vetë realitetit historik, të kohës sonë të ashpër e luftarake. Kështu ndodh që në fshat:

«*Nëna gatuante kulaç për të birë — dhe thoshte një këngë me vete. — Ish këngë që këndohet kur përcillet ushtari, — ish këngë kur i riu bëhet burrë — dhe do të këndohet gjatë kjo këngë në kullën e shqiptarit, — gjersa nata e shekullit zien në planet si furre...»* Se, thotë poeti, në një motiv të huajtur:

«*Sikur, o miq, të rrijmë pa luftuar, — na fut në zemër hasmi bajonetën, — pastaj të tjerët gishtat e helmuar — do zgjatin drejt nga ne për të treguar: — Shikoni robërit si e shkojnë jetën!»*

Për këto arësyen edhe ndonjë motiv i kërkuar me zor nga vetë Dritëro Agolli për t'iu larguar kësaj të vërtete luftarake, tingëllon e pavërtetë dhe spekulative, siç ndodh, për shembull, kur lexojmë vjershat «*Ariani im i vogël*» dhe «*Eureka*». Ariani i vogël dhe Arkimedi i zhytur në shkençë arrijnë të dy në një përfundim. Arianit «*aq i bën se ca amerikanë — paskan ngritur baza me raketa*», kurse Arkimedit: *aq i bënte se romakët, — po vinin re e zezë, — atij një ligj ja prishte mëntë, — në kokë kish një tezë*». Si pëll-qimi i naivitetit dhe i moskokëçarjes fëmijërore, ashtu edhe frymëzimi nga *indiferentizmi politik* «*prej shkencëtarë*» janë në kundërshtim të plot me frymën e përgjithshme luftarake të Dritëro Agollit, siç janë krejt të kundërtë me vetë interesat jetësore të popullit, që për asnjë arësyen nuk mund të rrijë e të presë t'i futë në zemër hasmi bajonetën. Edhe në rastin tonë ky mësim tragjik duhej nxjerrë prej historisë së njojur të Arkimedit.

Poezia e Dritëro Agollit ka karakter *afirmonjës*, qoftë në kuptimin e përgjithshëm njerëzor, qoftë edhe në raport

me realitetin historik të luftës e të ndërtimit socialist të vendit. Kjo karakteristikë, që përbën dhe duhet të përbëjë theksin kryesor të letërsisë sonë të re dhe që është një prej dallimeve themelore të realizmit socialist nga gjithë letërsia e mëparshme, që kishte *mohimin* si theks kryesor, nuk presupozon fshehjen apo kalimin e kontradiktave të zhvillimit. E kundërtat: kërkon pasqyrimin realist të kontradiktave për të dhënë në proces vetë zhvillimin dhe përparimin revolucionar të realitetit që afirmojmë. Poeti nuk i veçon kontradiktat shoqërore në mënyrë artificiale, po i kupton dhe i pasqyron ato si aspekte të realitetit në zhvillim, si shfaqje të vetë këtij realiteti. Ato egzistojnë dhe mund të egzistojnë vetëm në gjirin e jetës, e cila është konceptuar dhe është dhënë kurdoherë me gjerësi dhe me optimizëm, duke mos krijuar dramatizëm të jashtëm dhe të panatyrshëm, po duke ruajtur ngahera karakterin optimist dhe afirmonjës të poezisë, që përbahet në të vërtetën dhe në besimin e kapërcimit të kontradiktave prej shoqërisë së sociale socialiste. Këto kontradikta, — antagoniste dhe jo antagoniste, — në poezinë e Dritëro Agollit janë dhënë kryesisht nëpërmjet gjykimit të heroit lirik, që në këtë pikëpamje shpreh qëndrimin e poetit, nëpërmjet vlerësimit të aspekteve dhe ngjarjeve të ndryshme të jetës së gjallë, që janë mishëruar në vjersha e poema me forcë e bukuri poetike, me gjallëri dhe konkretësi të madhe. Në këto kontradikta heroi lirik mban një pozitë të qartë e të palëkundshme popullore e të partishme. Ai përfaqëson njeriun e punës, të pastër e të qartë, që gjithë jetën ka luftuar e ka puanuar dhe ka bindjen e thellë se për socializmin e për popullin nuk ka gjendje pa rrugëdalje, nuk ka kontradiktë të pakapërcyeshme. Vetëjeta e shoqërisë së sonë, në mënyrë të vëtëvetishme dhe vetë forcat më të përparuara të kësaj shoqërie, në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me ideale të përcaktuara luftojnë prapambetjen dhe vjetësirën, kapërcejnë pen gesat dhe zgjidhin kontradiktat që dalin në rrugë e sipër dhe, kurdoherë, në të gjithë krijimtarinë poetike të Dritëro Agollit, ndihet lëvizja, zhvillimi, përparimi. Edhe kur kontradiktat antagoniste marrin forma të acaruara dhe dramatike (motivet e luftës, këngët për shokët e rënë në beteja

dhe egërsia kriminale e armiqve të klasës pas luftës), toni i përgjithshëm i poeziës mbetet optimist e luftarak dhe heroi lirik ngrihet në lartësinë e detyrave dhe të realizimeve historike të popullit, ka një horizont të gjerë mendimi e ndjenjash revolucionare. Dëshpërimi është i huaj për të. I huaj është edhe çdo lloj sentimentalizmi. Mbi gjithshka sundon logjika e rreptë e luftës, që e bën edhe vdekjen po aq të natyrshme, sa jetën dhe një vdekje trimash e sheh kurdoherë me krenari luftëtar si kurorëzim të vetë luftës për jetën. (Kujtojmë këtu: vjershat kushtuar të rënëve, poemën për komisarin, motivin e të rënëve në poema). Ndër kontradiktat antagonistë, që kanë gjetur vend në poezinë e Dritëro Agollit, sundojnë, në përgjithësi, ato me karakter patriotik, që shprehin ndeshjen me armiqtë e lirisë kombëtare (të jashtëm e të brendshëm). Rrallë gjemjë ndeshje të forcave të kundërtë në jetën aktuale shoqërore, ekonomike e politike, gjë që mendojmë se është një prej kufizimeve ideo-tematike të poeziës, jo vetëm se nuk kanë gjetur vend në të kontradiktat e ashpra klasore, sidomos të periudhës së parë të ndërtimit socialist, po edhe se, në përgjithësi, në pasqyrimin e jetës së fshatit e të fshatarit tonë (që zënë vendin kryesor) është ruajtur si kufi periudha e çlirimt deri te reforma agrare. Gjithë transformimi i mëtejshëm i fshatit në rrugën e socializmit, që ka sjellë me vete edhe trasformimin e botës së brendshme të fshatarit, ose nuk është dhënë fare, ose është dhënë në mënyrë tepër evazive, kryesisht nëpërmjet aspektesh me karakter thjesht shoqëror e intim.

Kontradiktat jo antagonistë, sidomos ato me karakter etik dhe shoqëror, janë dhënë më me realizëm dhe kanë gjetur një mishërim poetik më të veçantë. Heroi lirik i poeziës së Dritëro Agollit është në kontradiktë të tillë, nga një anë me elementin e prapambetur patriarkal të trashëguar nga e kaluara, nga ana tjetër me elementin mikroborgjez të sotëm, sidomos me jetën pa ideale e pa përpjekje, me lakminë e kotësive dhe me pseudomodernizmin e tipave që bëjnë një jetë të tillë. Elementi dramatik në këto vjersha e poema përbahet në karakterin e dyfishtë të personazheve, të cilët ndeshen jo vetëm me realitetin e ri që u del

përpara, po në fund të fundit dhe në thelb ndeshen edhe me vvetveten, vihen në kontradiktë me vetë jetën dhe idealitet e përgjithshme të tyre, ndër të cilat, siç është karakteristike për popullin tonë, me të drejtë poeti vendin e parë ja ka lënë ngahera *elementit politik*, si elementi më i ndjeshëm dhe më ndikonjës. Kjo ndodh se edhe në këto raste heroï lirik është njeriu i popullit, i luftës dhe i revolucionit, që ndeshet me realitetin e ri, jo se ka një aspiratë të tillë, po se nuk është çliruar ende plotësisht prej ndjenjave e mendimeve të pronarit të dikurshëm, të patriarkalit të djeshëm etj. Këtu e ka burimin edhe ngrohtësia njerëzore, edhe ashpërsia shoqërore e poetit, që mendojmë se përkon plotësisht me qëndrimin e partishëm ndaj kontradiktave të kësaj natyre. Në poezinë e Dritëro Agollit nuk kemi as «konflikt brezash» as anësi patriarkale, as pseudomodernizëm, as edhe kompromis. Ndeshjet për të janë të natyrshme si vetë jeta, që i lind dhe i kërkon, prandaj ato nuk pjellin as pshëretima, as tragjedi, as shkëputje mikroborgjeze prej truallit popullor. Ato sjellin me vete zhvillimin real dhe jo përfytyrime thjesht romantike të një «bote të dëshiruar». Ajo që ishte dikur vetëm e dëshirueshme, tanë është reale, e prekshme. Trajtat e saj i jep vetë jeta, pa qenë nevoja përfantazime të shumta.

Në poemën «*Baballarët*», bazën e unitetit të brezave e gjejmë të shprehur, si në tingëllimin e përgjithshëm të veprës, edhe në vargje si këto:

«*Dhe morëm pas èndërat tuaja të mira... — dhe i bashkuam në èndrën tonë të madhe, — në endrën që quhej komunizëm*», pra vihet theksi në «èndërat e mira», të brezave të mëparshëm, në kujtimet e Luftës nacional-çlirimtare, kur «*rrotull kësaj sofre hanim bukën — dhe mendonim të të ndryshojmë botën*» dhe në çdo gjë tjeter të rëndësishme politike-patriotike. Kështu kontradikta nuk dobësohet, as nuk ngushtohet shtrirja e saj shoqërore, gjersa, në këtë mënyrë, natyrshëm si në jetë, shihet njëkohësisht edhe kundërshtimi ndërmjet mbartësve të mentaliteteve të mykura dhe zhvillimi shoqëror, edhe kontradikta që lind ndërmjet vetë anëve pozitive dhe negative të personaliteteve të tillë kalimtare, që luftuan për botën e re, po i sollën asaj

edhe shumë «trashëgime» jo të mira nga bota e vjetër. Në këtë themel qëndron edhe drama e personaliteteve të tillë, e kuptuar kjo edhe si një luftë me vetveten për të çarë përparrë, për të mos e lënë në mes këngën e nisur. Dhe, në poezi, gjen shprehje të njëkohshme kontradikta dhe uniteti dialektik i brezave, i kuptuar në mënyrë komuniste:

«*Po, — baballarë, — e kini të vështirë — t'ua veshni brucën ligjeve të reja... — Ashtu si heshti krisma e hakmarrjes, — po heshtin pashkë e ramazanë, — se rrugën tonë drita e ka larë, — se baballarë e bij një zemër kanë».*

Ky nuk është kompromis shoqëror, po unitet i gjërë moral e politik i popullit, mbi të cilin dhe, vetëm duke pasur parasysh atë, mund të shtrohen e të zgjidhen drejt si politikisht edhe poetikisht kontradiktat e konfliktet jo antagoniste të shoqërisë sonë të sotme, «*pa çka se sillemi pak ashpër, — edhe zbrazim gjithë bataretë... — Kur vjen rasti edhe në mes të rrugës, — krushqit edhe mblesët do t'i ndalim, — siç ndal dëborën era e jugës, — dhe e vesh me qyrk të gjelbër malin».*

Konflikti i brendshëm i këtij personaliteti kontradiktor e bën poezinë më luftarake, edhe më njerëzore, mbasi konceptet, paragjykimet dhe praktikat e vjetëruara gjykonhen e dënohen, jo vetëm si burim fatkeqësie për të tjerët dhe pengesa për përparimin shoqëror, po edhe si fatkeqësi për vetë bartësit e tyre, të cilët, dashur pa dashur, duke qenë shpirtërisht sklevër të atyre, e kthejnë edhe jetën e vet në një dramë.

Në «*Balladë e ashpër*» lexojmë:

Shumë pas oxhakut vrave mendjen, — prapë me botën tënde do të rrosh... — Vallë, kot i ndalëm ne lumenjtë — dhe i ndrydhëm valët nëpër llampa, — me oxhakë betoni shpuam qiejtë — edhe varfërinë e lamë prapa?»

Veprimi i ndërgjegjshëm shoqëror, krahas ndikimit të vetëvetishëm të realitetit socialist, shihet në poezitë e këtij karakteri, si një fuqi e rëndësishme pozitive, prej njohjes së të cilës kontradiktat dhe konfliktet jo antagoniste sho-

qërore nuk pasqyrohen e nuk intepretohen si shpërthime e ndeshje spontane, po si rezultat i vetë realitetit historik, si shprehje e përpjekjeve historike popullore për ndërtimin e shoqërisë socialiste dhe për transformimin e njerëzve. Në të vërtetë shumë transformime, si industrializimi, modernizimi i bujqësisë, lufta kundër patriarkalizmit, etj. nuk zhvillohen vetëm në socializëm, po në socializëm të gjitha ato marrin një karakter thellësish popullor dhe kjo bën që vetë esenca e tyre të jetë krejt e ndryshme nga ajo që është bërë në çdo shoqëri parasocialiste. Prandaj poeti, kur vjen puna të gjykojë për ata, të cilët nuk e kuptojnë këtë të vërtetë të madhe të jetës sonë, thërrret me zemërim:

«Dhe kur dikush, — këlysh mikroborgjezi, — me pet-kun progresiv na vjen vërdallë — dhe sherrin etér-bij kërkon të ndezë, — ja shkulim dhëmbë — e dhëmballë»

Bazën reale të këtyre konflikteve poeti e ka gjetur qysh herët në pronën private. Në vjershën «Pronari», që është ndër krijimet e hershme të Dritëro Agollit, jepen këto dy tablo të kundërtat:

«Këtu nuk ka gëzim dhe këngë s'ndjehet — n'oborrin e rrëthuar me avlli. — Kurrkush te port' e madhe nuk kë-thehet, — veç rrallë — tek blen qumësht ndonjeri». Dhe, pas kësaj, shpërthen:

«Ku jini miq, për ju ësht' vargu im! — N'oborrin tuaj jet' e pastër zjen, — dëgjoj unë zëra, qeshje, kuvendime, — gjykime për të nesërmen që vjen».

Në ndeshje me botën e ngushtë, jo vetëm të pronarit, po edhe të mentalitetit prej pronari, të psikologjisë e të paragjykimeve të ngushta patriarkale e mikroborgjeze, ngrihen njerëzit e rinj, të cilët i thérresin rruget e Atdheut të bindur se «*kudo të shkosh, — kudo të ndodhesh, të presin njerëz në takim*». Kështu ndodh që djalin e kurbatkës «e rrëmbe» estrada (*Kurbatka*), që vajza e malësorit njeh elektricistin (*Balladë optimiste*), që vajza e ndrojtur inter-preton Karmenin (*Karmen*), që bija e fshatarit vetullvrenjtur merr udhën për në shkollë (*Një natë*) dhe shokët e rinasë shpëtojnë shoqen e tyre të veshur nuse me zor (*Balladë e ashpër*). Prej ndeshjes, në terrenin e shoqërisë socialiste, lindin filizat e jetës së re, përftohet përparimi dhe lumtu-

ria njerëzore. Me të drejtë poeti ja ka mohuar të vjetrës «barazinë» në luftë dhe e ka vënë nën goditjet e gjithanshme të së resë dhe në këtë luftë ka parë të mishëruar në figura të qarta poetike perspektivën tonë shoqërore.

Ndryshe ndodh me trajtimin e elementit tjetër të kontradiktave jo antagoniste, me tipin e «*këlyshit mikrobor-gjez*», të «njeriut të bulevardit e të modës», të meskinit të sotëm, që përpinqet të rrojë si parazit e të mburret me një lustër të jashtme e të neveritshme qytetërimi. Ndërsa njeriun e sunduar prej mentaliteteve të vjetra, poeti e ka vënë përballë të kaluarës së tij luftarake dhe idealeve të sotme shoqërore, meskinin ai e vë në kontrast të thjeshtë me njerëzit e punës dhe me heroizmin e tyre dhe këtë e bën me një tallje therëse, pa e fshehur përbuzjen dhe pa kërkuar motive justifikimi. Ndërmjet njerëzve të punës dhe këtyre tipave ai jo vetëm nuk sheh ndonjë pikë takimi, po nuk sheh, në përgjithësi, as ndonjë mundësi ndërrimi të tyre, prandaj, sa herë zihen në gojë ata, vjersha e Dritëro Agollit merr theks satirik dhe nuk ndihet në të as dëshira më e vogël për t'u bërë thirrje e për t'u celur shtigje jete. Kjo anësi, që të mos themi kjo njëanëshmëri, në trajtimin e kontradiktave jo antagoniste mbasë ka ardhur, se në rastin e parë poeti ka pasur parasysh *njeriun e popullit*, që e ka vështirë të ecë me çapin e kohës dhe për këtë nuk është vetëm ai fajtor, kurse, në rastin e dytë, ka pasur parasysh vetëm *njeriun negativ*, që «prej natyre është sajuar keq» dhe ne, meqë nuk pajtohem me mendimet e me sjelljet e tij, e shikojmë thjeshtësisht me armiqësi, pa shpresuar në transformimin e tij.

Kush është ky tip? Ky është fëmija e një të deklasuar, që ka ende një burim të ardhurash nga pakot e nga çëqet (*Zemërimi i poetit*), është vajza, që në kundërshtim me ëndrrat e mëdha të vashërisë, gjen prehje në ambientin mikroborgjez, që krijon prej një martese me leverdi (*Dashuria*), është djali i minatorit, që kërcen fokstrot mbi pistën e shtruar me asfaltin, që nxjerr i ati nga fundi i dheut (*Fokstrot*), është përgjithësisht njeriu i jetës së vogël, që nuk sheh larg dhe nuk mendon gjerë (*Nga fletorka e shënimeve, Larg qytetit*) etj. Pra, si në rastin e parë, ky tip përfaqëson,

në thelb, dy kategori shoqërore: *të deklasuarit*, që «*asfalteve të nxehta — nisin motoçikletat e ftc'ha — të blera prej pakove e çeqeve...*» dhe *bijve të popullit*, që gjejnë kënaqësi në jetën e vogël e pa ideale të ambienteve meskine, të mbetura trashëgim nga e kaluara. Siç shihet, fenomeni negativ i meskinititetit mikroborgjez ka një bazë të vjetër ekonomike e shoqërore dhe është në kundërshtim me profilin moral e politik të njerëzve të socializmit, po kur këtë fenomen e ndeshim në njerëzit tanë, disa herë në një kategori më të gjerë njerëzish e në forma më të shumta, nga ç'është paraqitur në poezi, qëndrimi i rreptë kritik, goftë edhe tallës (gjë e drejtë) do të kërkonte edhe frymën luftarake transformonjëse, që karakterizon punën riedukonjëse të shoqërisë, përndryshe do të mbeteshim brenda caqeve të konstatimit, të kritikës e të talljes, po do të hiqnim një vijë sado të hollë paralel me vijën popullore, të punës e të heroizmit dhe nuk do të parashihnim zhdukjen e meskinititetit, siç parashohim, për shëmbull, zhdukjen e paragjykimeve fetare apo të zakoneve e të mentalitetit patriarkal. Nga kjo pikëpamje kritika kundër meskinititetit na duket e mangët, sidoqë në prirjen e saj është plotësisht e drejtë dhe shoqërisht e shëndoshë. Me këtë tip shpeshherë polemizzon ashpër poeti.

Këta tipa kanë zënë vetëm pak vend në poezinë e Dritëro Agollit. Vendin kryesor në të e ka zënë heroi i luftës dhe i punës, i cili është dhënë me vërtetësi e me ngrohtësi poetike, pa ekzagjerime e pa pompë, po ashtu siç ka qenë e siç është; njeri i thjeshtë i popullit. Kjo konkretësi poetike nuk e ka zbehur madhështinë e këtij heroi dhe nuk ka ulur forcën e poezisë, që përmban kurdoherë një ton romantik revolucionar të shkrirë fare natyrshëm me pasqyrimin realist të jetës, bile, disa herë, edhe duke i dhënë vjershavë e poemave ngjyrat e mallit përfshatin, për rinnë e përfémijérinë, përfshirë luftën dhe përfshirë kohën e aksioneve të para pas fitores së revolucionit. Në krijime të tillë poetike si «*Poema e udhës*», «*Vargu*», «*Nga fletorka e shënimive*», «*Dashuri dhe ferrobeton*», «*Poema e të pagjumëve*» etj. është dhënë heroika e punës ndërtimtare dhe, nëpërmjet

vështirësive e përpjekjeve, është zbuluar madhështia e njerëzve të punës. Në të tilla krijime, (me përjashtim të poemës së hershme «*Ndër shtigjet tonë*», në të cilën afirmimi kalon në zburim të realitetit ose «*Dashuri dhe ferrobeton*», në të cilën sikur himnizohet teknika) nuk është ndjekur as rruga e mohimit të vështirësive dhe minimizimi apo kapërcimi me lehtësi i tyre, as tendenca e pasqyrimit të këtyre vështirësive si qëllim më vete e aq më tepër me qëllim shkuraqonjës. Përkundrazi, në luftë me vështirësitë e paraqitura prej poetit jo vetëm shtrohet rruga e hekurt, hidhen në erë shkëmbinjtë e ngrihen shtylla tensioni të lartë, po mbi to ngrihet e madhërishme figura e njeriut të punës, i cili në poezinë e Dritëro Agollit gjithnjë flet me optimizëm, bile me gëzim për jetën e kaluar nëpër vështirësi e përpjekje, se ka pasur një qëllim të lartë dhe ka fituar mbi to. Ky është përgjithësisht njeriu i punës prodhonjëse, minatori apo druvari, njeriu që gjithnjë shtegëton maleve, ai që ndez fitilat e minave, që kalon netët në barakat e thjeshta të kantiereve, po është edhe njeriu i punës mendore, i projekteve dhe i poezisë («*Poema e të pagjumëve*»). Poeti, sidomos ka gjetur vend të natyrshëm në vargjet e poemave, si njeriu i popullit, që më parë mësoi të qëllojë me pushkë, pastaj të shkruan poezi, që as në fat, as në jetë, as në ndjenja e mendime nuk e veçon veten prej popullit. Poeti është edhe kundër predispozitave intelektualizante, edhe kundër *ouvrierizmit*, po kur i ka kundërvënë këto predispozita të gabuara, mendojmë se është larguar prej konceptit të përgjithëshëm e të shëndoshë të intelektualit popullor dhe raporteve të tij me njerëzit e punës prodhonjëse. Në vjershën «*Vargu*» lexojmë:

«Këtu jam si dhi në mes të dhene — dhe, më duket, se kurrikush s'ma var. — Shtrembër më vështron që lart shkëmbinje — një njeri, që minës i vë zjarr. — Tjetri buzë lumit as ngre sytë, — vetëm pantallonat i përvesh, — mbi një mur diç thotë një i dytë — dhe pastaj me shokun zë e qesh...»

Kjo pritje jo miqësore dhe tallëse, që i bëjnë punëtorët poetit, edhe pse ka shërbypet për të hedhur poshtë pikëpam-

jen e ngushtë ouvrieriste, që vetëm punën fizike quan punë, nuk i përgjigjet të vërtetës së jetës.

Në ndonjë rast tjetër është kaluar në një farë *mashinizmi*, në himnizim të teknikës në vetëvete, gjë që nuk është karakteristike për poezinë e Dritëro Agollit. Dikur u dukën simptoma të tillë në poezinë tonë (rreth vitit 1960), si kundërshtim ndaj fryshtave poezisë e si përpjekje entuziaste për t'i kënduar industrializimit të vendit. Pikërisht në atë kohë e nën ndikimin e të atilla predispozitive u shkrua edhe poema «*Dashuri e ferrobeton*», në të cilën lexojmë:

«Këtu nuk merren me kotësira erotike, — që bien erë parfum të modës së vjetër, — këtu ka front — dhe fronti ka fryshtë epike: beton, — motorë, — tela, — tunele, — gurre të egër. — Urra! — metalit, — telave, — motorëve! — Urra! — nepërËs — xixë elektrike, — që po ua heqin brekushet malësorëve, — që po ua prishin çerdhen zanave epike! — Që po i hypin zanat në maqina, — dhe në kurset e rezervave të punës i çojnë, — të mësojnë si ndizen minat, — që tunele të shpojnë... Urra! — barutit, — dinamitit, — fitilave, — që po e prishin heshtjen në odat me oxhakë, — që po i shuajnë psherëtimat e idileve....»

Në këtë përfytyrim poetik njeriu i nënshtrohet teknikës dhe vetëm preqatitet t'i shërbejë asaj (të ndezë mina, të shpojë tunele), kurse qëllimet shoqërore si edhe fenomeni vetë, ashtu siç është dhënë në poemë, mendojmë se nuk kanë pikërisht *theksin e kohës*, jo në kuptimin teknik, po në kuptimin shoqëror e politik të fjalës. Edhe dashuria në poemë (kredoja e së cilës është e drejtë) në manifestimin konkret të saj nuk mban vulën dhe erën e kohës sonë, po është paraqitur në formë tepër të përgjithësuar dhe sensuale. Psherëtimave e premtiveve mbasë u ka kaluar koha, po ndjenjave, bukurisë, bile edhe dhembjeve në dashuri, siç e provojnë edhe shumë vargje të poetit, nuk u ka ikur koha. Në dashurinë e vërtetë nuk sundojnë llogaritë, po nuk sundojnë as epshet. E para dallon proletarin prej borgjezit, e dyta — njeriun prej kafshës.

Ky ka qenë vetëm një shpërthim në karakterin e për-

gjithshëm unik të heroit lirik të Dritëro Agollit, bile edhe në tërësinë e natyrës poetike të tij.

Heroi lirik i poezisë së Dritëro Agollit është njeriu i ndjenjave të shëndosha popullore, që gjithë bukurinë e do «tokësore», që ka për ideal atë që është reale ose që është i sigurt se mund të sigurohet. Ai nuk rron as me ëndrra, as me shpresa. Toka dhe puna janë mbështetja e tij e fortë në jetë. Ato përcaktojnë edhe idealet e tij prej fshatari punëtor. Me tokën dhe punën ai ka lidhur edhe dashurinë:

«*E kam kërkuar ngaherë dashurinë tokësore. — Më të bukura se madonat e muzeve — kanë qenë për mua vajzat e gratë arbërore, — që tok me mua u kanë dhënë ujë kuajve e qeve, — që tok me mua kanë ecur në pllaja e shpate — me vezme në brez e malihet në krah, — që tok me mua kanë prashitur me shat — dhe grurë kanë hedhur në vrah.*» Ose:

«*Dashurinë e dua të shëndetëshme — femrën e shëndetëshme krah meje, — që pështet në gjoksin tim të leshtë — kryet — dhe ndjen rrähjen nëpër deje.*» Dhe:

«*Kur të kthehem nga fusha, — të dashurës lule s'kam për t'i sjellë, — po torbën e mbushur me mollë, — si grushata — me dorën time — vjelë...*»

Vetëm në disa krijime («Dashuri dhe ferrobeton», «Balladë e ashpër», «Rebelimi i parë» dhe deri diku «Baballarët») poeti ka arritur që, krahas tonit të përgjithshëm afirmonjës, të mbajë edhe qëndrim kritik ndaj psikologjisë e mentalitetit fshatarak dhe ka zbuluar në të elemente konservatorizmi, paragjykimesh fetare etj. Kjo prirje e kritikës nëpërmjet afirmimit mendojmë se do të zëjë edhe më tepër vend në poezinë e ardhshme të Dritëro Agollit dhe do ta ngrëjë atë në një nivel edhe më të lartë ideo-artistik, do t'i japë më tepër gjerësi e shpirt luftarak, më shumë mprehtësi dialektike.

Përsa i takon gazit të jetës dhe karakterit fshatarak të heroit lirik, nuk ka poet tjetër në letërsinë tonë të sotme, në veprën e të cilit ato të kenë depërtuar aq natyrshëm dhe aq me sinqueritet, pa intelektualizëm dhe pa interpretim të thatë. Gjithshka e natyrshme dhe e bukur, që ka të bëjë me

natyrën, me fshatin dhe me jetën në fshat ruan në kriji-  
met e poetit freskinë e parë të saj dhe forcën frymëzonjëse  
të një revelacioni.

«Më hidh — erë e vjeshtës, në kopshtet me mollë, —  
të shoh si mbush shportat ajo shamihollë, — të shoh si  
agimi mbi mollë përgjon, — kur lëngu i ëmbël i frutit ku-  
llon... — Më hidh, erë e vjeshtës, diku në rivierë, — që fry-  
ma e detit në faqe t'më bjerë, — të shkoj nëpër bahë, —  
të zgres që nga mali, — të shoh si skuq faqen diku porto-  
kallii».

Kurse për takimin me vajzën që ka dashur, poeti nuk  
ka zgjedhur as koriet e kronjtë, as fjalët standarde që përdoren  
në raste të tilla, po na ka dhënë këtë skenë konkrete  
e piktorike, të thjeshtë e të freskët:

«Nënë bark të lopës ti ngre kokën, — gishti të shpë-  
ton nga sisë e saj, — një rrëkezë qumësht bje në tokë: —  
Paska ardhë djali i xha Rizait».

Në vjershat e poemat e kësaj natyre ne ndjejmë aro-  
mën e vlagës së ugareve e të barit të thatë, uturimën e De-  
vollit dhe zhegun e vapës, kur në grurë bie drapëri dhe pëlcet  
për ujë gjarpëri, shikojmë dritaren e vogël të zënë përgjysmë nga hardhia, ndjejmë erën e pishës dhe mjegullën,  
që mbulon shelgjet buzë lumit, borigat krahëthyera prej  
borës, pluhurin e baltën në opinga, erën e brumit dhe të  
kulaçit të pjekur në çerep etj. etj. Gjithë këto hollësi të vërteta,  
krahas vërtetësisë të frymës së përgjithshme të poezi-  
së, e bëjnë vërgun e Dritëro Agollit të qartë, të sinqertë dhe  
e lidhin me lexonjësin në mënyrë krejt — të natyrshme.  
Prandaj, sa më i gjerë të jetë grupi shoqëror që tipizon heroi lirik, aq më i gjerë është edhe rrethi i lexonjësve që e  
lexojnë, e kuptojnë dhe e duan poezinë në mënyrë imedia-  
te, se nuk do mohuar as rasti kur heroi lirik përfaqëson ve-  
tëm filizat e të ardhmes, që ende nuk përbëjnë shumicën,  
po fitojnë gjithnjë terren dhe marrin rëndësi, ashtu siç nuk  
do mohuar as rasti i inversitetit të heroit lirik, kur ai hum-  
bet terren me zhvillimin e shoqërisë me ecjen e saj përp-  
ra

Po a ka diçka që është vjetëruar ose që mund të vjetë-  
rohet në botën e dashur të këtij heroi lirik? Në një prej  
vjershave të Dritëro Agollit lexojmë:

«*Gabohemi shumë, — kur flasim e grizmë... — se gra-  
të tona e humbën freskinë... — Jo, jo, s'humbet hijeshia e  
tyre, — mjafton të qëndrojnë pak në pasqyrë — dhe të du-  
ken prapë të njoma».*

Ky është një tolerim i rrallë, që i bën poeti shpirtit  
prej fshatari, një tolerim, që më tepër se vlera e tij në vetë-  
vete, për ne ka rëndësi, pak a shumë, figurative, që shtron  
në një mënyrë fare konkrete dhe jo aq me rëndësi pro-  
blemin e madh të kalimit nga një stad i natyrshëm dhe pa  
kërkesa i jetesës, në një stad të ri më të lartë, kur vetë fsha-  
tari ndjen nevojën e «pasqyrës e të tualetit», po, që të ndje-  
jë nevojën e tyre, duhet të kenë ndodhur shumë ndryshi-  
me në punën e në jetën e tij, në vetë mentalitetin e tij. Pas  
shtypjes erdhijeta e lirë, pas luftës — fitorja, pas reformës  
agrare — kolektivizimi, pas lërimit të «arës mbi lumë» —  
parcelat e mëdha të një bujqësie, që po modernizohet, pas  
parmendës e plugut — traktori e kombajna, pas gjades —  
radioja, pas velenxës së leshtë e brucit tradicional —  
shtrati me dyshek e me jorgan, pas qerres — kamionat e  
kooperativës dhe motoçikleta dhe, bashkë me këto e, aq më  
tepër, pas këtyre, edhe fshatari ndryshoi e po ndryshon  
vazhdimisht (bariu blen në MAPO motoçikletë). Preokupi-  
met e tij nuk janë më krejt ato të parat dhe horizonti i tij  
zgjerohet vazhdimisht. Ai mbasë nuk ndjen më as avullin  
e bukës së pjekur me çerep, se e merr bukën në dyqan të  
kooperativës, në mos hëngërt edhe në mensë. Në ndërgjegjen e tij, krahas krenarisë së ligjëshme për luftën, që  
zë kurdoherë vend kryesor në poema, kanë depërtuar edhe  
shumë elemente të reja që po zënë vend me siguri edhe që  
duhen kultivuar. Tani, bile, nga pikëpamja e perspektivës,  
edhe ndjenja e pronës kolektive të grupit kooperativist dhe  
preokupimi për mbarëvajtjen e kooperativës nuk janë të  
mjaftueshme, po duhen plotësuar me ndjenjën e përgjith-  
shme kombëtare socialiste, me shikimin e çdo problemi në  
raport me ndërtimin e socializmit në të gjithë vendin. Ky

transformim i arritur dhe i pritshëm i jetës materiale e shpirtërore të fshatarit tonë ka ndërruar edhe mentalitetin e tij për gjëzinë e jetës, se ai nuk kërkon tani vetëm spec djegës e raki, po edhe koncerë e mbrëmje vallëzimi e do të vijë dita që në shtëpinë e kulturës së fshatit të kërkoyë me doemos edhe televizor, se kinema ka që tani në shumë fshatra. Pra, horizonti i interesimeve, qofshin këto të përgjithshme apo personale të fshatarit, është zgjeruar e zgjerohet gjithnjë, duke ruajtur atë natyrë karakteristike, që është përcaktuar prej ambientit gjeografik, prej zhvillimit historik e prej natyrës së punës, megjithëse edhe këto zhvillohen e pasurohen me kohë. Në këtë pikëpamje heroi lirik i poezisë së Dritëro Agollit nuk i përgjigjet plotësisht fshatarit tonë të sotëm dhe, duke ruajtur rëndësinë sidomos patriotike e njerëzore, mbetet një hero lirik i një faze shoqërore që në shumë drejtime është kapërcyer e në shumë drejtime të tjera po kapërcehet. Ai duhet të ecë me kohën, të përparojë. Në këtë mënyrë nuk do të jetë vetëm një shëmbull interesant, që të edukon me të kaluarën e vet, po edhe një *njeri i pararojës*, që përfaqëson fshatarin e përparuar të ditëve tona dhe të së nesërmes. Fryma e përgjithshme e poezisë së Dritëro Agollit e përbën këtë mundësi, që do të kthehet në realitet artistik, në qoftë se vështrimi i poetit do të ndalet më tepër në transformimin që ka ndodhur në fshat gjatë tridhjetë vjetve të fundit. Në këtë mënyrë do të shmangen edhe dy dobësi të sotme të poezisë së tij, sidomos të poemave: përsëritja e motiveve dhe vendosja poshuajse e njëjtë historike e subjekteve, gjëra që nuk e pasurojnë veprën. Megjithë nuancat e trajtimit dhe thekset e veçanta ideore që kanë poemat kryesore («*Devoll, Devoll*», «*Toka ime kënga ime*», «*Baballarët*»), janë shkrirje e të njëjtave motive dhe ruajnë të gjitha fryshtën e transformimit të madh politik të pasluftës me pak elemente ngajeta e mëvonshme. Në këtë mënyrë do të gjejë një konkretizim të bukur poetik mendimi se «*shekulli ynë ngjitet në male, — lë gjurma në gérxhet, — lë gjurma në shpatet*», pa qenë nevoja që «*dora poetike*» të pastrojë burimin prej njollave të vajit e të benzinës që lë SMT-ja. (*Ëndërr e largët*).

### III

Pasi u munduam tē vizatojmë nē vija tē përgjithshme portretin e heroit lirik tē poezisë së Dritëro Agollit, aq sa mund tē arrihet një gjë e tillë, duke nxjerrë elementin e përbashkët tē tē gjithë veprës, do tē ishte me vend tē ndaleshim edhe nē motivet kryesore që janë trajtuar nē këtë poezi dhe nē vlerat ideo-artistike tē trajtimit tē tyre.

Para së gjithash éshtë pér t'u vënë nē dukje se frymëzimet e Dritëro Agollit lindin nga jeta e gjallë, nga manifestimet konkrete tē kësaj jete, prandaj edhe trajtimi i tyre artistik, edhe pérceptimi i tyre ideo-emocional prej lexonjësve e ruajnë këtë karakter. Poeti na jep nē krijimet e veta reflekset e drejtpërdrejta tē jetës, prandaj edhe lexonjësi ndeshet drejtpërdrejt me këto reflekse, i merr ato négpermjet formës së natyrshme tē shprehjes poetike dhe mendimi lind tek ai pikërisht négpermjet mbresave estetike, që i ka shkaktuar poezia.

Poezinë e Dritëro Agollit e kupton kushdo dhe janë tē shumtë ata që e pëlqejnë. Dikush mund tē thotë se kjo ndodh ngaqë ajo éshtë e thjeshtë, nuk ka shumë mendime, nuk éshtë e thellë, etj. prandaj edhe kuptohet e pëlqehet. Ky nuk éshtë një mendim i drejtë. Thjeshtësia, e marrë si një vlerë estetike, éshtë vërtet një meritë e kësaj poezie, po kjo nuk do tē thotë se ajo éshtë e përciptë dhe pa shumë mendime. Nga ana tjetër ka edhe poezi tjetër tē thjeshtë që kuptohet prej një mase tē madhe, po pëlqehet vetëm prej disave. Pra, nuk éshtë thjeshtësia ajo që e bën tē pranohet e tē pëlqehet (tē pëlqehet do tē thotë tē ndikojë ideo-emocionalisht te lexonjësi) nga një masë e madhe lexonjësish tē kategorive tē ndryshme, po éshtë pikërisht brendia ideo-emocionale e saj, që térheq vëmendjen e tyre, se nē një masë ose nē një tjetër, shpreh botën e tyre shpirtërore, aspiratat e tyre, domethënë lexonjësi gjen nē motivet e poezi së motivet e tij tē dashura jetësore ose poeti i zbulon atij anë tē reja tē jetës e tē shpirtit njerëzor, që edhe pér lexonjësin janë tē pranueshme, prandaj bëhen edhe tē dashura. Kjo brendi ideo-emocionale e gjerë, që përfaqëson predispozitat e një ma-

se të madhe njerëzish, ka gjetur në poezinë e Dritëro Agolliit një formë shprehjeje poetike të drejtpërdrejtë, të qartë e të thjeshtë dhe këto vlera formale të saj janë në unitet të plotë me brendinë e krijimeve poetike, mbasi masa që përfaqësohet në poezi, gjen atje jo vetëm aspiratat dhe ide-alet e veta, po edhe gjuhën e vet, mënyrën e vet të shprehjes, si të thuash, konkretizimin poetik të vetes. Karakterit të gjerë popullor të brendisë poetike i përgjigjet forma popullore e shprehjes, natyra popullore e përceptimit, e përpunimit mendor dhe e pasqyrimit të realitetit jetësor në poezi. Vetëm në raste të rralla, në vjersha të shkurtëra e jo aq me sukses, i largohet poeti kësaj natyre të përgjithshme të përceptimit e të pasqyrimit popullor.

Në këtë drejtim mund të lindë edhe një keqkuptim tjetër, se kemi përshtypjen që, sa herë flitet për karakter popullor të poezisë, sidomos të formës së shprehjes poetike, mendja vetë menjëherë në fshat. Një gjë e tillë ka arësyet e veta, meqë në fshat ka lulëzuar një poezi e pasur dhe e bukur popullore dhe tek ne vetëm vonë, me zhvillimin e industrisë e të qyteteve, po lehtësohet ndikimi i përgjithshëm i fshatit mbi gjithë popullsinë e vendit, sidomos të qyteteve të vogla. Pra, poezia popullore, që përhapet kudo në-përmjet këngëve, valleve etj. ishte ushqimi kryesor poetik i popullit, që në fakt i është kundërvënë poezisë së poëtëve të oborreve feudale, të salloneve e të lumpen-mikroborgjezisë së qyteteve, të cilën populli nuk e ka pranuar, shpesh edhe nuk e ka njojur fare. Nga ana tjetër, kontrasti qytet-fshat krijoi edhe largimin e poezisë së kultivuar prej gurrës popullore, sadoqë nuk janë të paktë poetët që i qëndruan pranë asaj, të shumtën e herës të shtyrë prej vetë dispozitive popullore të tyre, po edhe me qëllime thjesht stilizante. Keqkuptimi që mund të lindë këtu dhe që mund të mbështetet edhe në një praktikë letrare të pasukses, ka të bëjë me mendimin se në trajtën popullore nuk mund të krijuhet një poezi moderne dhe se ajo (forma popullore) i përshtatet vetëm motiveve fshatarake. Të dyja këto keqkuptime, që janë shprehur tërthoraz në gjykimin e veprave të dobëta të kësaj natyre, janë pa baza, jo vetëm se karakteri popullor i poezisë duhet kërkuar, para së gjithash,

në brendinë ideo-emocionale të saj, po edhe se forma popullore nuk duhet kuptuar as si kallëp i përshtatshëm pér disa motive, as si një gjë e ngurtë e pérherershme, që tanë ka vetëm vlerë historiko-letrare. Të ndjekësh formën e poeziësë popullore do të thotë të kuptosh shpirtin poetik të popullit, të asimilosh thesarin e poeziësë së tij dhe, ashtu si në brendinë ideo-emocionale të veprave, edhe në formën e tyre të çash përpara, jo ta përsëritësh, po ta përtëritësh. Po të veprohet kështu, poezia me frymë popullore mund të jetë plotësisht moderne dhe të aftësohet pér trajtimin e çdo argumenti poetik. Një shembull në këtë drejtim është edhe poezia e Dritëro Agollit, e cila të kujton poezinë popullore, jo vetëm pér natyrën e krijimit të figurave e pér thjeshtësinë e bukur të shprehjes, po edhe pér ato elemente të konceptimit e të pasqyrimit të materialit jetësor, siç janë shprehja e drejtpërdrejtë, humor i gëzueshëm, ritmet e gjalla, krahasimet me elementet e natyrës e të jetës popullore etj. Në krijime të ndryshme të poetit, sidomos në krijime të herëshme të tij, ka mjaft vjersha të krijuara në frymë të plotë popullore, po ato nuk përbëjnë vlerën kryesore në këtë drejtim. Sa më e ndërgjegjshme është bërë vetë krijimtaria poetike, aq më i ndërgjegjshëm e krijonjës është bërë edhe qëndrimi i poetit ndaj poeziës popullore, e cila ka depërtuar dhe është përtëritur si një natyrë e dytë, jo vetëm në krijimet me motive fshatarake, po në të gjithë poezinë, e cila gjithnjë tingëllon popullore, duke qenë gjithnjë e më tepër origjinale. Në këtë poezi nuk tingëllojnë aspak të vjetra edhe figurat e huajtura nga poezia e popullit ose të krijuara në frymën e saj. Në këtë lidhje me poezinë popullore dhe në origjinalitetin e trajtimit të saj qëndron edhe karakteri *novator* i poeziës së Dritëro Agollit, gjë që ka ardhur gjithnjë duke u theksuar dhe që pritet të japë rezultate të reja të frytshme, si në krijimtarinë e tij, ashtu edhe në të gjithë poezinë tonë të sotme. Novatorizmi në këtë rast shprehet, përvëç brendisë së re dhe theksit personal që merr ajo në krijimtarinë e poetit, në faktin që ai ka sjellë një material jetësor të patrajtuar më parë në letërsi, është mbështetur në një traditë poetike popullore të pa-shfrytëzuar prej të tjerëve, ja ka përshtatur këtë traditë te-

mave të reja, gjerësisë e thellësisë së tyre dhe, duke qën-druar në terrenin e kësaj tradite, e ka përtëritur atë, e ka modernizuar, në pajtim me fryshtë e saj dhe i ka dhënë një vulë plotësishë personale. Kanë shkruar edhe të tjerë në fryshtë e poeziës popullore po jemi të mendimit, se Dritëro Agolli, megjithëse edhe ky mbështetet kryesisht në një traditë krahinore (gjë që duhet kapërcyer), bën një hap më përparrë dhe, me veprën e tij, shtron pikërisht problemin e krijimit të një poezië moderne e novatore në fryshtë e poeziës popullore, një poezi të aftë për të trajtuar çdo motiv e çdo temë, për të përballuar çdo argument, qoftë ky edhe filozofik. Kjo praktikë hedh posht paragjykimin se për të krijuar një poezi novatore duhet t'i mbajmë sytë vetëm nga eksperiencia e huaj. Praktika poetike e Dritëro Agollit është një eksperiencë e vlefshme, me gjithë kufizimet që ka dhe që janë përcaktuar prej kufijve kohore të motiveve kryesore (nuk mohohet këtu ndikimi i formës) dhe prej kufive krahinore si të materialit jetësor, edhe të traditës ku është mbështetur. Kohët e fundit në vjersha si «Rapsodi», «Komisari» dhe «Valle labërishte» ai po i ka-përcen këto kufij dhe po krijon afinitet edhe me këngën popullore të Labërisë. Shkrirja e këtyre elementeve, si dhe i gjithë elementeve pozitive të poeziës popullore do ta forcojë edhe më tepër karakterin novator të kësaj eksperiencë krijonjëse dhe do t'i theksojë më shumë ngjyrat kombëtare të poeziës, të cilat spikatin mirë në veprën e poetit dhe përbëjnë një tjetër vlerë të saj.

Ndërsa karakteri popullor është shprehur në pasqyrimin e jetës e të aspiratave të popullit në një trajtë poetike popullore, karakteri kombëtar në poezinë e Dritëro Agollit duket, në radhë të parë, në aftësinë e poetit për të dhënë, nëpërmjet atmosferës së përgjithshme të krijimeve të veta si dhe nëpërmjet hollësive, të tipareve dallonjëse të kombit tonë të shprehura këto në temperamentin e gjallë, të ashpër e gazmor të heroit lirik, në rrugën dhe fatet historike të tij, në mënyrën e jetesës e në zakonet, në vëtëdijen e tij kombëtare dhe në gjuhën poetike të përdorur dhe jo në brucin e në velenxën, siç mund të pandehet. Gjithështëka në poezinë e Dritëro Agollit është shqipta-

**re** dhe sot do të ishte vështirë të gjeje një tjetër poet, që ta ketë ndjerë e ta ketë shprehur më tepër se ai edhe në brendi, edhe në formë elementin kombëtar popullor dhe që të ketë po atë afinitet dhe po atë ndjeshmëri poetike ndaj këtij elementi. Prandaj, në tërësinë e poezi-së sonë të realizmit socialist, me brendi socialiste e me formë kombëtare, ajo i ngjan një luleje me ngjyra të ndezura në një tufë të madhe. Dhe nuk është vetëm «kujtimi i prejardhjes» që i jep asaj këtë karakter kombëtar. Në të edhe fshatari i traditës, edhe partizani i Luftës nacional-çirimitare, edhe komunisti e komisari, edhe sekretari i partisë dhe poeti, etërit dhe bijtë, natyra dhe ambientet janë të gjitha e të gjitha shqiptare. Kjo karakteristikë nuk e ka ngushtuar aftësinë shprehëse të poezi-së, siç mund të pundehet. Përkundrazi, manifestimeve të përgjithëshme njërezoje ajo u ka dhënë, krahas vërtetësisë realiste, edhe originalitetin kombëtar dhe e ka theksuar karakterin novator të poezi-së, në qoftë se e kuptojmë novatorizmin, jo si ndjekje të modës artistike, po si përpjekje për t'i celur shtigje e horizonte të reja poezi-së së realizmit socialist.

Poezia e Dritëro Agollit ka një frymëmarrje të gjerë e të thellë politike. Ndonëse krijimet e drejt-përdrejta politike nuk zënë ndonjë vend të dukshëm, në këtë poezi fryma politike, në kuptimin e gjerë të qëndrimit politik të masave punonjëse ndaj fenomeneve të rëndësishme të jetës, ka depërtuar në çdo qelizë, është element i pandarshëm organik i të-rësisë së konceptimit dhe të pasqyrimit të jetës, element i natyrshëm i ndërgjegjes, i ndjenjës dhe i mendimit poetik. Nuk gjen në këto krijime poetike pasthirma patetike, aq të zakonshme sidomos ndër poetët e rinj, për Atdheun, për socializmin e për revolucionin, po në çdo krijim të arrirë, sidomos të periudhës së vonë, ndjen prej çdo vargu dashurinë për Atdheun dhe për përkatësinë komuniste të poetit, që shprehet në formën më të vetvetishme e më spontane, me sinqueritet e forcë, disa herë edhe me vrull e krenari të hapur, ashtu siç shprehen të gjitha ndjenjat e mendimet e vërteta të njerëzve. Vetëm në raste të rralla, sidomos kur vë në shinjestër meskinitetin mikroborgjez, poeti zgjedh formën e polemikës së ashpër e të satirës therëse, që i

shtojnë vrullin poezisë dhe i zënë vendin atij humorit gazzmor, që përzihet shpesh me tonin lirik të vjershave e të poemave dhe i jep atij nota të freskëta, të gjalla e të natyrshme.

«Hej, — Devoll, — sa armë zbraza unë — për këtë t'uruar komunizëm! — Mbeta maleve të tu pa gjumë, — vrava tradhëti me nervozizëm... — Dhe sa herë lul'e ballit tim — éshtë marrë mirë në shënjestër, — po më paske bërrë mua trim, — se kam mundur plumb edhe gënjeshtër. — Në shënjestër prap më kanë vënë — snajperat e shquar përtej deteve. — Unë s'dridhem, — unë s'e ul zënë, — mbetem komunist për jet' të jetëve...»

C'ngrohtësi ndjenje e vërtetësi epoke kanë këto vargje për gjithë popullin tonë, aq therëse e tallëse tingëllojnë vargjet e mëposhtme.

«Në caqet, — ku i errët éshtë agimi — i ndan një akullnajë e ftohtë! — Bërtasin narkomanët: «Etërit janë mykur, — me ta në paqe ne, — modernët, — s'rrojmë, — në pleqërinë e tyre janë zhytur — dhe mes anakronizma ve notojnë!» — Dhe poetucët, — vargje thurin — dhe lëngje vargjesh derdhin mbi «të vjetrit» — ndër kabaretë modë e «izma» mburrin, — si setra demode i flakin etrit! — E dini cilët janë, baballarë? — Ata sot hedhin tuist fytyrëflakë, — e nesër vrasin vietnamezë në arë — e nesër ngasin tanket nëpër Pragë!»

Fryma politike e poezisë së Dritëro Agollit ka gjithash tu karakter popullor. Ai, si të thuash, nuk merret me politikanizëm, po zbulon, nëpërmjet vargjeve, në mënyrë të vetvetishme, shpirtin dhe qëndrimin politik të popullit, ndjeshmërinë e tij politike ndaj së mirës e së keqes, ndaj miqve dhe armiqve, ndjeshmëri që éshtë kultivuar gjatë shkujve, të cilët e mësuan popullin tonë të ndjekë me vigjilencë të lartë ngjarjet politike të kohës, të rrojë aktivisht me to dhe të marrë me kohë masat e duhura për të mbrojtur lirinë dhe tokën. Kjo frymë politike patriotike éshtë mishëruar në vjersha e poema nëpërmjet motivit të përhershëm të parmandës e të nagantit, që heroï lirik i poezisë i mban pranë dhe, sa herë éshtë nevoja, i këmben

me njëra-tjetërën, lufton e kthehet përsëri të çelë ugarë e të meremetojë shtëpinë e rrënuar, i sigurt në fuqitë e veta, me besim në drejtësinë e tij shembullore. Ai s'e ndan kurrë plugun nga malipheri, po brodhi me ta nga caku në cak dhe gati ka qenë përherë të vaditë kërcellin e grurit me djersë e gjak...

Këtij shpirti të ndjeshëm politik Lufta nacionalçlirimtare dhe ndërtimi i socializmit i dhanë një theks më të përcaktuar klasor revolucionar dhe, në këtë mënyrë, edhe vetë patriotizmi mori një karakter më të përgjithshëm popullor dhe një përmbajtje më demokratike. Në poemën «*Hapat e mia në asfalt*» dhe në vjershën «*Krevati i perandorit*» entuziazmi i fitores, në kohën kur «*u shembën dy perandori*», është dhënë njëkohësisht në plan patriotik (fitore mbi pushtonjësit e huaj) dhe në plan klasor (fitore e fshatarit e punëtorit shqiptar mbi imperializmin, mbi baronët gjermanë e kontët italianë, mbi perandorët). Ja një kontrast historik e poetik interesant.

«*Ja, unë jam Mekja, me opinga llastiku e me opinga lëkure, — me masat, kobure e vezme në brez, — unë të dogja kazermat dhe ushtarët t'i zura, — që në Sicili e gjer në Bradashesh. — Kudo jam unë, Mekja, e kudo kam qenë — e do të jem kudo e ti do të dridhesh nga unë, — e data të ka për të zënë — edhe zgjuar, edhe në gjumë... — Tfu! të pështyj në surrat, perandor! — një palo burrë dy pëllëmbë, — një palo Viktor, — me dy gisht këmbë!*

— Dhe u shtri në krevat të perandorit... — dhe tha me ngadal partizani Meke, — me dorën e madhe në kraharor: — Farë e keqe, — Tani jam vetë perandor!... — Dhe humbi në mjergull Viktor Emanueli i tretë, — dhe humbi në mjergull perandoria....»

Në krijime si «*Balladë e re për komisarin*» lufta politike dhe ndeshjet klasore janë dhënë edhe në plan të brendshëm, si pasqyrim të qëndrimeve të kundërtta të klasave të ndryshme: *komisari*, si përfaqësonjës i popullit dhe i arave me grurë, *Bazi i Canit*, si përfaqësonjës i bezlerëve dhe i ahengjeve. Komisari, heroï i ri i poezisë sonë të realizmit socialist -- megjithëse në poemë vritet, — mbetet i ma-

dhërishëm dhe i përjetshëm si idealet e tij, në një imazh të bukur poetik:

«Ai shtrëngon me duar kallinjtë, — kallinjtë përdhe s'e rrëzojnë, — po gjithë së bashku me shtat të florinjtë, — përkulen e «mbahu» i thonë. — Qëndron mes tyre e rritet mes tyre, — figura e tij si mal, — e kokrrës ja jep të tijën ngjyrë — e kokrra të sajën ja fal...»

Figura e komisarit, si konkretizim i idealeve revolucionare komuniste, një figurë që mbetet e idealizuar në kujtesën e brezave, si mishërim i rolit dhe i lavdisë së partisë, në poezinë e Dritëro Agollit gjen gjithnjë vend të merituar dhe hyn natyrshëm, ashtu siç hynë komunistët në kasollet e fshatarëve gjatë luftës.. Këtë figurë poeti e do, e kërkon gjithnjë në poemat e veta dhe të lë përshtypjen se asnjëherë nuk është i kënaqur me aq sa ka thënë, sikur kërkon gjithnjë rast e mundësi që ta plotësojë më mirë madhështinë e saj. Këta: komisarët, komunistët, sekretarët e partisë, sikurse vetë figura e poetit, që në të shumtën e herës shkrihet me heroin lirik, janë nervi politik i poezisë, shprehësit e aspiratës popullore. Poeti i ka trajtuar ata jo si «heronj kordhëtarë», po të shkrirë në popull, që dallojnë mes fshatarëve, si lulkuqet në ara, gjë që është në natyrën e konceptimeve poetike të Dritëro Agollit, në të cilat nuk vechohet *heroï* për t'u evidencuar, po jepet në rrjedhën e ngjarjeve si një element që konkretizon më mirë idealet e masave e të poetit. Hyrja e tyre në vargje nuk jepet me brogori. Ata lindin natyrshëm prej vetë jetës dhe po aq natyrshëm hyjnë edhe në poezi, si një kërkesë e domosdoshme për plotësimin e mendimit, për dhënjen e plotë të së vërtetës të revolucionit tonë, i cili as që mund të mendohej pa partinë, pa komunistët.

Kjo frymë përshkon edhe motivet e transformimit revolucionar pas luftës, periudhë në të cilën karakteri klasor i revolucionit u bë më i theksuar.

«A nuk e pe, — se ç'bëmë ne të revolucionit ushtarë, — kur u kthyem që brazda të reja të hapim? — Ne muarëm në duart tona me plagë litarë, — që gjoksin tënd mbetur djerrë ta matnim. — Të matëm si tereziu i mirë për të pre-re kostum. — dhe hoqëm nga supet e tua zhelin e vdekur,

— hoqëm bejlurçinat e pronarët e tu, — hoqëm turpin e mbetur në shekuj...

— A nuk të kujtohet, — si ra sekretari i partisë, — kur hiqte litarin në fundin e arës? — I fshehur hendekut, mes kulumbriesë, — ja futi në shpatull hanxharin armiku i klasës. — Litari prej kërpit, që rrite ti vetë, — mbeti i shtrënguar në gishtat e myllur të sekretarit».

Siq shihet, pozita klasore e poezisë është e qartë dhe, në qoftë se do të ndjekim zhvillimin e poetit, do të vërejmë se kjo pozitë, duke ruajtur gjithnjë karakterin popullor, ka ardhur duke u forcuar e duke u përcaktuar më mirë. Në ndonjë poemë të hershme të Dritëro Agollit («Fundë») dhe në ndonjë baladë («Cubi») diferencimi politik gjatë Luftës nacionalçlirimtare është parë në plan thjesht personal, pa u zbuluar rrënjet shoqërore e politike të tij dhe, në fryshtë e letërsisë romantike, është parë e trajtuar *drama* e armiqve, gjë që ka dobësuar pozitën politike dhe ka zbutur ndëshkimin kundër tyre. Po, në atë kohë, ky ndikim negativ e i paqartë i letërsisë romantike mund të themi se ishte bërë fenomen për poetët e rinj dhe iu desh atyre si një shkallë për të kaluar më vonë në pozitat e ndërgjegjshme të poezisë revolucionare të realizmit socialist.

Poezia e Dritëro Agollit është kryesisht poezi lirike. Me përjashtim të disa krijimeve të hershme dhe jo aq me sukses, që kanë karakter negativ, të gjitha vjershat e poemat e tjera sundohen nga nota të theksuara lirike, janë manifestime të raporteve shpirtërore e intelektuale të poetit me realitetin jetësor, që paraqet në vepër. Ky lirizëm, që zbulohet nëpërmjet trajtimit të motiveve më të ndryshme poetike: të luftës e të të rënëve, të tokës e të rrugës, të triumfit të së resë e të luftës kundër meskinitët e patriarkalizmit, të punës e të transformimit socialist, të dashurisë e të natyrës, — ky lirizëm, siç e vumë re, kur folëm për heroin lirik, është shprehje e një bote të pasur e të shëndetshme shpirtërore e intelektuale me vulë të theksuar personale, po që mishëron, nëpërmjet vetëvetes, jo raportet thjesht personale të poetit apo të një kategorie të ngushtë shoqërore ndaj realitetit, po raportet popullore, sidomos të fshatarësisë punonjëse, ndaj këtij realiteti. Një anë po-

zitive me rëndësi dhe origjinale në trajtimin e këtyre raporteve është se në veprën e Dritëro Agollit, në mënyrë të njëkohshme e në unitet të plot organik me njëra-tjetrën, janë dhënë katër komponentet më kryesore: *objekti* (realiteti shoqëror), *subjekti* (heroi lirik, poeti), *raportet* ndërmjet tyre dhe *gjykimi ideo-artistik* i këtyre raporteve.

Në këtë praktikë poetike të tërheqin vëmëndjen disa gjëra me rëndësi, që përbëjnë, nga pikëpamja artistike, profilin e poetit:

Së pari, mendimi dhe ndjenja në poezinë e Dritëro Agollit nuk janë kurri objekt kryesor dhe i vetëm i krijuar. Ato lindin prej zbulimit të momenteve poetike të realitetit, janë rezultat imediat i shtjellimit të argumenteve poetike, që nuk i përkasin botës së ndjenjave e të mendimeve, po realitetit objektiv të reflektuar në vepër. Poezia e tij është e mbushur me sensacione nga natyra dhe nga jeta popullore. Ajo i ngjan festës së elementeve më të ndryshme të botës objektive materiale e njerëzore dhe, në këtë mori sensacionesh nga jeta, nëpërmjet fakteve të vogla e të mëdha të jetës, që mbushin vargjet, nëpërmjet episodeve të shumta, që përbëjnë subjektin e vjershavë dhe motivet e poemave, burojnë ndjenjat e mendimet, jo të shprehura posaçërisht me fjalë, po të mbartura në kuptimin e botës së reflektuar, në hovet e në ritmin e vargjeve dhe në shpërthimet, disa herë me karakter polemik. Ky është një sukses krijonjës përforcimin e mëtejshëm të pozitave realiste të poesisë sonë të sotme dhe, ndonëse nuk është e vëtmja praktikë letrare që shpie në rezultate të tilla, mund të themi se është një kontribut me rëndësi në kapërcimin e intelektualizmit e të subjektivizmit në poezi dhe i jep lirikës një frymëmarrje më të gjerë jetësore, e trajton atë jo ngushtësisht si raport subjektiv ndaj realitetit objektiv, po si element të natyrshëm të këtij realiteti.

Le të marrim, përf shembull, vjershën «*Larg qytetit*». Motivi është i njobur: ndjenjat, që lindin, kur je larg gruas së dashur. Përf këtë motiv kemi lexuar shumë vjersha: me psherëtima e pa psherëtima, me xhelozë e me besim, me gëzim e me dhembje, me dashuri e me inat dhe shumë prej tyre kanë qenë «ndjenjë e gjallë», në natyrën e vet — vjer-

sha të frymëzuara dhe formalisht të realizuara, sugjestjo-nonjëse, përgjithësisht me një frymë romantike, së roman-tizmi i është ngjitur lirikës hap pas hapi e, aty-këtu, ngatë-ron edhe vetë konceptin mbi lirikën. Në vjershën e Dritë-ro Agollit nuk kemi ndonjë shpërthim të tillë ndjenjash dhe as ndonjë përqëndrim të theksuar mendimi, që do t'i ngjante fiksacioneve. Në këtë vjershë, përkundrazi: oshtin pylli nga shiu i çmendur, zogjtë struken nëpër degët e ahe-ve të trembur, druvarët kanë ndezur zjarrin dhe flasin për shtëpitë, për gratë, për fëmijët, për druvarin e ri që rrëmbeu një çupë në fshat, për dasmën e tij... Në këtë atmosferë je-pet edhe malli për gruan e largët, mall, që në këtë rast, du-ket fare i natyrshëm, i bukur, i pastër, sikur është larë nga shiu, po edhe si pjesë e gjithë jetës, jo si jeta vetë. Për vendin që zë ky mall, poeti bën pyetjen:

«*C'tu tregoj për ty unë në Munellë, — ku rënkon një sharrë e një qysqi?»*

Morëm si shëmbull një vjershë të zakontë me motiv inti-m, se, siç e kemi përmendur, pikërisht në këtë farë poezie lirike është më i vështirë realizimi i sundimit të elementit real jetësor mbi mendimin e ndjenjën, më zor shkëputja prej subjektivizmit, ndonëse teorikisht një gjë e tillë kup-tohet e kërkohet. Në vjershat e tjera dhe sidomos në poemat unifikimi i mendimit dhe i ndjenjës me paraqitjen e realitetit objektiv është edhe më i dukshëm. Për një gjë të tillë mund të gjykohet edhe prej shembujve që kemi përmendur gjer tanë. Mekia, fjala vjen, merr pjesë në luftimet për çlirim e Tiranës dhe i takon të flejë në shtratin e peran-dorit. Vetë ky moment i realitetit ka një kuptim të madh, që mund të jepte shkas për shumë retorizëm e komente, të cilat do ta mbulonin vlerën e vetë momentit dhe do të nxirrnin në plan të parë mendimet e poetit. Kurse në vjershën «Krevati i perandorit» fare natyrshëm, bile edhe me nota humoristike, nxirret përfundimi i madh historik:

«... Dhe tha me ngadal partizani Meke, — me dorën e madhe në kraharor: — Farë e keqe, — *tani jam vetë perandor!*»

Së dyti, realiteti në poezinë lirike të Dritëro Agollit jepet në lëvizje, prandaj lirika e tij ka gati gjithnjë edhe

elemente epike, është pothuajse gjithnjë me një farë subjekti, mbështetet në ndonjë episod; duke qenë kryesisht deklamative (në kuptimin e mirë të fjalës) është edhe tregimtare. Motivi i rrugës, i shtegëtimit nëpër Atdhe, i takimeve me njerëzit, i ndodhjes në ambientet më të ndryshme, është ndër motivet më të dashura dhe më të shfrutuara të poetit. (Edhe vetë titujt e përbledhjeve të tij «Në rrugë dola», «Hapat e mia në asfalt» dhe «Shtigje malesh e trotuare» e dëshmojnë një gjë të tillë). Në rrugë, gjatë shtegëtimeve, ai gjen motivet dhe heronjtë e vjershave të tij, që janë kurdoherë njerëz të popullit: fshatarë, barinj, druvarë, minatorë, ushtarë, vajza të reja, që hidhen në krahët e jetës së madhe, pleq, që u tundin gishtin me inat, gjeologë, etj. Në këtë drejtim ka ndikuar shumë puna e poetit si gazetar, shtegëtimet e vërteta të tij, takimet me popullin, ndeshjet me rastet më të ndryshme të jetës. Kjo ka bërë që ai të merret më tepër me jetën, se sa me mendimet e me ndjenjat e veta, të ketë një horizont të gjerrë interesimesh dhe mendimi në poezi, edhe kur nuk ka forcë, ka gjithnjë gjallëri, është i freskët dhe i vërtetë.

Poemat lirike të Dritëro Agollit (po lëmë mënjanë ato me subjekt) janë të mbushura me episode nga jeta. Në to gjithnjë tregohet diçka, sillet ndër mend një kujtim, përmendet një fakt, jepet një përshtypje. Në «Hapat e mia në asfalt», «Poemë malore», «Devoll, Devoll», «Toka ime, kënga ime», «Baballarët» konceptimet poetike janë realizuar nëpërmjet episodesh, megjithëse poemat në vetëvete kanë karakter lirik dhe tingëllimi kryesor u jepet prej mendimit mbi probleme të mëdha të jetës. Episodet dhe faktet jetësore në këto poema nuk të kujtojnë aspak veprat poetike «me subjekt», mbasi poeti ka përdorur të atilla kritere të futjes së tyre në krijimet poetike, që nuk kanë cënuar tonin e përgjithshëm lirik të krijimeve, po janë shkrirë me të dhe i kanë dhënë freski jete. Ja një shembull:

«A s'ishit ju — që në nëndor shtëpinë — e hapët dhe celësat na dhatë, — dhe lindëm ne te vatra juaj Partinë — mbi një rrogoz e një minder të varfër? — A s'ishit ju që mbajtët Enver Hoxhën — dhe rrobet bërë qull në mal ja thatë, — opingat partizane, grisur shqotës, — ja qepët kur

*rëndonte nata e gjatë, — kur malet në stuhi e zulmë gjë-monin — marshimeve të dimrave mes borës, — kur nën helrieta të egra e përgjonin, — banditët e Berlinit e të Romës?»*

Kjo është një prej formave të dhënjes së fakteve jetë-sore në poezinë lirike të Dritëro Agollit. Një formë tjetër është, kur ato jepen si fakte biografike të vetë poetit a të heroit lirik të poemave pér të krijuar një lidhje sa më të natyrshme të ndjenjave e të mendimeve të tij me jetën e gjallë. Në këtë formë janë dhënë, pér shëmbull, kujtimet nga Lufta nacionalçlirimtare, episodet nga puna në fshat, etj. Ka raste, pastaj, sidomos në vjersha, po edhe në poema si «Dhjetë sy», «Rebelimi i parë», «Baladë e ashpër», kur gjithë mendimi dhe qëndrimi i poetit shkrihet në një subjekt të përgjithësuar, që zhvillohet e përparon në formë lirike, pa thurje intrige e detajim situatash.

Së treti, lirika e Dritëro Agollit ka një ton të gëzueshëm, që shpesh merr nota të dukshme humoristike. Në vëllimin «Në rrugë dola», është bërë përpjekja pér një poemë humoristike («*Nga këngët e xha Taqkës*»), po kur flasim pér humorin e lirkës së poetit, nuk kemi parasysh këtë përpjekje fillestare e naive. Kemi parasysh vetë atmosferën e gëzueshme që krijohet në shumë prej vjershave e poemave, atmosferë që e përmban vetë elementin humoristik, i cili nuk shprehet kurdoherë me fjalë, po fshihet në theksin kuptimor që u jepet fjalëve dhe nxjerr krye edhe në momentet sublime të poezisë lirike. Ai është një aspekt i veçantë i konstitucionit shpirtëror të heroit lirik e të vetë poetit, gjë që shpreh vetë natyrën e fshatarëve malësorë të jugut, të cilët e kanë shakanë e rumuzin në majë të gjuhës. Ka raste kur vetë karakteri i motivit të vjershave është humoristik («*Van Gogu*»), po këto raste janë të pakta. Në përgjithësi vetë lirizmi i vjershave e i poemave përmban shkrirë me elementin sublim edhe elementin pér të qeshur, që depërtón deri në qëndrimin e heroit lirik e të poetit ndaj vetëvetes, — karakteristikë pér njerëzit shpirtgjerë, të hapur, po edhe të sigurt në mirësinë e tyre. Karakteristike pér këtë është, sidomos, poema «*Devoll, Devoll*», në shumë

momente të së cilës kalohet fare pa shtrëngime nga toni sublim në ton humoristik dhe anasjelltas.

«C'baltë dreqi qenka balta jote, — baltë plot trazira, shqetësime, — herë fllade fsheh e herë shqotë, — herë lotë e herë ëndërrime». Ose:

«Ndaj kam qejf — të shtrembëroj turinjtë — nga raki e fortë — në filxhan, — vallen ta bëj tym — me devollinjtë, — të më zerë koka në tavan, — T'ulem e të marr një spec të fortë, — spec — që sytë lotë të kuq të nxjerrin, — ku mehzeja sofrën mbush në odë, — ku te porta dashi pret ta therrin... — Dhe atij të ndrojturit të mjerë — faqja t'i mbetet pa mornica, — mjekra pa fuqi — në gjoks t'i bjerë, — kur të shohë vallen devolliçë. — Ndaj i dua dasmat e harenë, — ku bje erë mollë dhe lakrorë, — ku nga vallet, — vajzat gjinjtë ngrejnë, — ku nga këmbët pluhur del n'oborr... — Është dasma frut i lagur djerse, — ku mbi sofër — clodhet dorë e rëndë, — dora, — që ka mbledhur bar me vesë, — dora që me plug ka ngjallur vendë...»

Kur tehu i të qeshurës e i talljes drejtohet kundër armiqve dhe njerëzve që duhen goditur, nga e qeshura kalohet në tallje therëse, lirika merr ngjyra të forta satirike e sarkastike, siç e kemi vënë re edhe në shembuj të përmendur më lart, gjë që ndodh zakonisht, kur përballë një momenti sublim poeti vë diçka të neveritshme dhe qesharake. Momente të tillë gjejmë në poemat «Balladë e re përkomisarin», «Balladë e ashpër», «Rebelimi i parë», «Baballarët», «Dashuri dhe ferrobeton» dhe në shumë vjersha.

Së katërti, siç e kemi vënë re edhe në trajtimin e heroit lirik e në raste të tjera, në shumicën e herës, poeti identifikohet me heroin lirik, është pjesëmarrës i ngjarjeve të rëndësishme ose i pranishëm në ato që i thotë lexonjësit. Shumica e krijimeve të tij janë shkruar në vetën e parë. Sigurisht, një gjë e tillë nuk mund të merret e të kuptohet në mënyrë të thjeshtësuar e naive, kurdoherë si e vërtetë jetësore, po si një pretekst dhe konvencion artistik, i zgjedhur e i pëlqyer prej Dritëro Agollit për t'i transmetuar lexonjësit mbresat dhe gjykimet e veta, realitetin objektiv dhe raportet shpirtërore ndaj tij. Ky konvencion artistik i përshtatet plotësisht natyrës të poezisë së Dritëro Ago-

Ilit dhe e ka bërë këtë poezi më të besueshme, më të pranueshme pér lexonjësin, të cilit i duket se bisedon singerisht me një njeri, që ka qenë vërtet pjesëmarrës i atyre që rrëfen. Edhe në goftë se krijohet përshtypja e monotonisë së shprehjes poetike, — këtu doemos ndikojnë konvencionet artistike, — kjo ndodh, në radhë të parë, se përsëriten shpesh të njëjtat gjëra (lufta, fshati, toka) dhe këto në të njëjtat aspekte dhe, kështu, konvencioni artistik rëndohet e ndaj tij nis të bjerë interesin i lexonjësit. Në dobi të këtij përfundimi do të na shërbente fakti se, ndërsa në poema ka nisur të duket një dobësi e tillë, në vjersha, (e kemi fjalën pér ato vjersha, që janë shkruar në të njëjtën natyrë, nuk ndihet një dobësi e kësaj natyre, mbasi motivet e tyre janë të ndryshme dhe kurdoherë ja kanë ruajtur freskinë konvencionit artistik, se motivet poetike, edhe kur janë të afërt, nuk përsëritin njëri-tjetrin.

Po, veç anës formale, kur ky konvencion merret vetëm si pretekst ose si mjet pér të thënë diçka, pér të mishëruar motivin poetik, ka edhe diçka tjetër, që mund të na térheqë vëmendjen. Kjo është *fizionomia e poetit* në poezitë e Dritëro Agollit. Duke përgjithësuar, ai e paraqet poetin si njeri të popullit, që misionin e posaçëm të tij nuk e veçon nga gjithë jeta dhe veprimitaria jetësore e masave punonjëse, që është poet, po është edhe bujk e luftëtar, që më parë është stërvitur të shtijë me pushkë, pastaj ka mësuar të shkruajë vargje. Ky tip poeti popullor, megjithëse e përmend shpesh veten, është transmetonjës i ndjenjave dhe i mendimeve të masave punonjëse dhe, vetëm në këtë det të gjerë veprimtarie e mendimesh, gjen vend edhe ai vetë, gjejnë rast të shfaqen e të shpërthejnë edhe ndjenjat e mendimet e tij të sinfonizuar me ato të popullit. Ai nuk qëndron përmbi heronjtë e vet, nuk del para masave, po ecën e përparon bashkë me to, si pjesë e tyre, si njeri i tyre, nganjëherë edhe pa i kaluar kufitë e zhvillimit të tyre pér të luajtur rolin e udhëheqësit, si poet. Nga të gjitha këto, nëpërmjet figurës së poetit në poezi, na krijohet përshtypja e intelektualit të ri popullor,

të dalë nga gjiri i fshatarësisë, që ruan me besnikëri e dashuri tiparet e mira të prejardhjes dhe është i thjeshtë e i hapët si yetë populli, që asnijëherë nuk merr pozën e filozofit hijerëndë apo të poetit, që rreh të gjejë figura e të xhonglerojë me to. Megjithëse poeti është intelektual, çdo gjë e kuptuar në mënyrë të ngushtë prej intelektuali do të ishte krejt e huaj pér të, nuk do t'i shkonte natyrës së njeriut që bredh «*brigjeve me pisha — lugjeve me plepa — me trajstë në krah, — me gazetën në xhepa*».

Ideali, në këtë rast, është poeti, që kurrë nuk e ndan penën nga plugu e pushka, poezinë nga puna e nga lufta. Doemos ky është një ideal, po elemente të tij gjejmë edhe në jetën tonë të sotme, në luftën që bëhet pér të ngushtuar gjithnjë e më tepër hendekun e trashëguar ndërmjet punës prodhonjëse e punës mendore, ndërmjet popullit e intelektualit, nëpërmjet ngritjes së masave në një nivel të lartë kultural dhe shkrirjes së intelektualëve me jetën e masave, mbi bazën e bashkësisë së përkatësisë klasore e të interesave të tyre të shprehura në punën e përbashkët pér ndërtimin e socializmit e të komunizmit.

Së pesti, poezia e Dritëro Agollit, si në frymën e saj të përgjithshme ideo-artistike, ashtu edhe në hollësitë stilistike e gjuhësore ka karakter të theksuar popullor, gjë që e kemi shtjelluar në mjaft vende të këtyre shënimeve, prandaj do të ishte e tepërt të përsëritnim edhe një herë ato që janë thënë pér lidhjet e poetit me jetën e popullit, pér reflektimin në krijimet e tij të ndjenjave, të mendimeve e të aspiratave popullore, pér karakterin thellësisht popullor të heroit lirik dhe pér dhënjen me besnikëri të tipareve morale e të temperamentit të tij, pér afërsinë e konceptimeve poetike me konceptimet e poeziës popullore, etj. Të njëjtën që mund të themi edhe pér natyrën e krijimit të figurave artistike, pér sintaksën poetike dhe pér përdorimin e fjalës me natyrësi, me thjeshtësi dhe gati pa të dhënë asnijëherë përshtypjen se do të thuhen me ato fjalë të thjeshta mendime të mëdha e të thella apo ndjenja të fuqishme. Përdorimi i natyrshëm dhe i sakt i fjalës dhe i figurës vjen nga siguria e përfytyrimeve poetike,

kurse sintaksa e thjeshtë e e pastër poetike — nga qartësia e mendimeve që shprehen në vargje. Nga kjo pikëpamje do të ishte e dobishme që disa prej poetëve të rinj të qëndronin gjatë me vjershat e Dritëro Agollit në dorë dhe të shihnin sa bukur e me ç'forcë mund të jepen ndjenjat më të holla, mendimet më të thella me mënyrat popullore të shprehjes, me fjalën e thjeshtë e plot ngjyrë të gjuhës së popullit, e cila vetëm kur nuk e njohim mirë ose kur e njohim nëpërmjet shpërdorimeve letrareske na duket e vjetëruar për poezinë e sotme.

#### IV

Në një vjershë kushtuar Naim Frashërit lexojmë:

«*Vargjet e tua me thërrime dheu janë përzier, — dhe na duket se me qenjen tonë janë shkrirë».*

Na duket, padashur të bëjmë krahasime, se këto dy vargje u përshtaten edhe krijimeve më të mira të Dritëro Agollit, të cilat «me thërrime dheu janë përzier» dhe prandaj gjejnë lehtë rrugën për të hyrë në ndërgjegjen tonë, që të zgjerojnë horizontin e saj, të forcojnë lidhjet e saj me «tokën stërgjyshore», ta qërojnë nga barërat e këqia, t'i ruajnë pastërtinë, gazin, trimërinë. Doemos: Naim Frashëri është një fenomen i ndritur në historinë e kulturës e të letërsisë sonë, një fenomen i lindur në rrethana të caktuara historike, që shprehu më mirë se kushdo tjetër në atë kohë ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve dhe për këtë do t'i mbetet gjithnjë një vend nderi në letërsinë tonë dhe në zemrën e popullit. Këtë e ka kushdo të qartë, siç ka të qartë edhe kufizimet e anët e kapërcyera në botëkuptimin e Naimit. Po puna është te fryma popullore naimjane, që mbetet si një trashëgim i çmuar, si një rrugë e çelur, që vazhdohet edhe në ditët tona, që përpunohet e përtërihet, që merr nuanca e thekse të vëçanta në poetë të ndryshëm, që sillet nëpërmjet veprës së tyre si një pasuri popullore, që poetët ja kthejnë brezave të rinj të popullit për ta mbajtur gjallë e për ta zhvilluar më tej. Sot kemi disa poetë të talentuar, që po e plotë-

sojnë së bashku misionin e nderuar të përfaqësonjësve e të shprehësve të ndërgjegjes së popullit, në një kohë kur masat punonjëse janë bërë historikisht aktive në mënyrë të vetëdijshme dhe ndërgjegjja e tyre konkretizohet në botëkuptimin, moralin dhe vijën politike të partisë, manifestohet në punën krijonjëse për ndërtimin e socialistit e të komunizmit. Dritëro Agolli është njëri prej këtyre poetëve të talentuar, vargjet e të cilëve janë përzier me thërrime dheu, po si çdo poet i talentuar, ai zë një vënd të veçantë në letërsinë tonë të sotme dhe në të gjithë historinë e poezisë shqiptare, jo vetëm me ato elemente të rëndësishme ideore dhe artistike të reja, që ka sjellë poezia e realizmit socialist në krasim me poezinë e së kaluarës, po edhe me natyrën e tij krejt origjionale e novatore, që kur lexojmë krijimet e tij na bën të themi me bindje: «ky është Dritëro Agolli», pa u trembur mos e ngatërhojmë me një poet tjetër shqiptar apo të huaj, siç na ndodh në raste të tjera, pa përjashtuar as një pjesë të krijimeve të përfshira në vëllimin «Në rrugë dola». Në vështrim të përgjithshëm ai është shqiptar, që nga shpirti deri te shprehja e thjeshtë stilistike, në vështrimin shqiptar ai është devolli, me temperament të rrëmbyer e me shpërthime, i gjallë, energjik dhe që e thotë troç mendimin e vet. Ndokush mund të thotë se elementi krahinor sot është bërë anakronik, nuk i pështatet kohës, kur edhe elementet kombëtare po e humbasin rëndësinë e tyre të dikurshme. Ky mendim na duket krejt pa vend, në qoftë se do të kemi parasysh jo dasitë e dikurshme krahinore feudale, po ato elemente të rëndësishme e të veçanta të fisionomisë së krahinave të ndryshme, nëpërmjet të cilave shprehet më gjallërisht karakteri ynë kombëtar, si me anë të objektit të frysëzimeve poetike, ashtu edhe me anë të mjeteve shprehëse të poezisë, siç ndodh, për shëmbull, në krijimtarinë e Dritëro Agollit, të Fatos Arapit, të Agim Gjakovës, të Vehbi Skënderit etj. ose siç ndodh, fjala vjen, me ndjekjen e traditave të rapsodëve të veriuar në poemat e Kolë Jakovës. Një gjë e tillë merr rëndësi, sidomos në kushtet tona, ku letërsia e mëparshme nuk ka

arritur ta kryej këtë detyrë, e cila, nga ana tjetër, mund të kryhet, jo duke e zvarritur pas poezisë shekullore të popullit, po duke e përtëritur atë me qëllim që të krijojmë një poezi të kohës të realizmit socialist, jo për të vënë theksin në veçoritë krahinore, po pë të zbuluar në to elementet e fuqishme kombëtare të përtëritura e të konsoliduara në periudhën e ndërtimit të shoqërisë socialiste, pa qenë kjo e vetmja rrugë për poezinë tonë, me përbajtje socialiste e me formë kombëtare. Në poezinë e Dritëro Agollit ne gjejmë një shembull të mirë të konkretizimit të këtij parimi të madh. Ajo është një poezi sociale shqiptare, që kur e lexojmë e besojmë poetin që deklaron:

«*Thellë kësaj balte — përmbi lumë, — që aq breza rrënënjësh e lëvrinë — unë, — devolliu i pagjumë, — gjeta vargjet, — gjeta poezinë».*

## SHTIGJEVE TË REJA POETIKE

(Shënime për krijimtarinë  
‘e Fatos Arapit)

*...Linda këtu, mes malesh të mia.  
E malet u krodhën  
në shpirtin tim thellë.*

(FATOS ARAPIT)

### I

Nuk kanë kaluar as dhjetë vjet, që nga koha kur Fatos Arapi doli para lexonjësve me vëllimin e parë poetik dhe tanimë ai ishte bërë një prej poetëve më të njojur dhe më përfaqësonjës të letërsisë sonë të realizmit socialist. Ndryshe nga disa poetë të tjerë, që orvaten e rrapotan shumë gjersa gjejnë vetëveten në letërsi, ai, si të thuash, — po të lëmë mënjanë disa prova fare të pakta e pa rëndësi të fillimeve letrare — iu inponua menjëherë lexonjësit si poet i talentuar, me brendi ideo-emocionale të thellë, me temperamentin dhe me fisionominë personale të shëndoshë të shprehjes poetike. Si poet ai i përket vitezave gjashtëdhjetë (botimet janë: «*Shtigje poetike*» — 1958, «*Poema dhe vjersha*» — 1966 dhe «*Ritme të hekurta*» — 1968) dhe është e natyrshme që përpjekjet dhe realizimet e tij të na kujtojnë më së miri përpjekjet, që u bënë gjat këtij dhjetëvjeçari për një poezi më militan-

te, të çiruar nga rutina e së kaluarës, nga romantika e mefshtë dhe anakronike, nga elementet sentimentaliste, si dhe nga stilizimet e thata pa brendi të shëndoshë ideo-emocionale, që kishin zënë një farë vendi në poezinë e viteve pesëdhjetë. Po kështu, siç dihet, krahas hyrjes së vendit në betejat e mëdha të ndërtimit socialist me ritme më të shpejta e me përpjesëtime më të mëdha, vitet gjash-tëdhjetë u karakterizuan nga një luftë e ashpër politike dhe ideologjike kundër imperializmit e revizionizmit. Në të dyja këto aspekte me rëndësi poezia e Fatos Arapit solli, në atmosferën letrare të kohës, një fryshtësore të shëndoshë luftarake dhe, në tërësinë e poeziës së revolucionare, ushtoi si një zë i padëgjuar më parë, që, duke u akorduar me «*orkestrën e madhe*» të poeziës së revolucionarit socialist, e plotësonte këtë, e pasuronte dhe çelte perspektiva të zhvillimit të saj të mëtejshëm.

Gjatë dhjetë vjetve Fatos Arapi nuk është shquar për ndonjë veprimtari shumë të gjerë, por krahas kësaj, është për tu vënë re, se nga gjithë ç'ka krijuar ai janë të pakta vjershat që nuk i kanë bërë ballë provës së kohës dhe që edhe tanë nuk të ngjallin emocionet e viteve kur u shkruan, gjë që do të thotë se brendia ideo-emocionale e tyre është përcaktuar jo nga përshtypje të rastit dhe nga joshje ideo-artistike momentale të poetit, por nga një mendim i thellë e i sigurt politik e shoqëror revolucionar, që i bën jehonë vetë jetës së socialiste dhe përfaqëson mentalitetin e përparuar dhe predispozitat shpirtërore optimiste e luftarake të pararojës së shoqërisë. Po të mbajmë parasysh karakterin e koklavitur e të vrullshëm të dekadës që kaloi, morinë e ngjarjeve të rëndësishme, ndeshjet e forta politike e ideologjike, dramacitetin e situatave, ritmet shumë të shpejta të zhvillimit e të transformimeve socialiste, ngritjen e hovshme të ndërgjegjes revolucionare të masave etj., do të vërejmë, se qëndrueshmëria e vlerave ideo-artistike e poeziës së Fatos Arapit, si edhe e pjesës më të mirë të krijimtarisë së sonë letrare, dëshmon lidhjet e saj të ngushta e të gjalla me jetën e me luftën e popullit e të partisë dhe nivelin e lartë të kërkuesave e të realizimeve poetike, në

pajtim me botëkuptimin, ndjenjat dhe shijet artistike të përparuara të kohës.

Krijime poetike si «Drashovica, — Brezave që vijnë, — Kur nisi fëmijëria jonë, — I hodha sytë nga lindja, — Ne i thyem qiejt... — U dola përpara agimeve, — Republikës (nga vëllimi «Shtigje poetike»), I përkasim komunizmit, — Vargje për dritat, (nga vëllimi «Poema e vjersha»); Zëri i tokës, — Përgjigje Inës, — Rinisë, Poemë më vete, — Antiburokratike (nga vëllimi «Ritme të hekurta») janë ndër gjërat më me vlerë të poeziს sonë të re dhe një vazhdë gjithnjë në ngjitje e interesimeve shoqërore, politike dhe artistike të poetit, i cili, duke ruajtur fizionominë e vet dhe duke e plotësuar atë me tematikë të re, ka vazhduar edhe kërkimet ideo-artistike me prirjen pozitive e të sigurt të afromit gjithnjë më të madh e më të drejtpërdrejtë me klasën punëtore. Ai është një nga të parët në poezinë tonë të re, që e shtroi më konkretisht këtë çështje dhe që bëri përpjekjet e para të dukshme për të futur në poezi logjikën dhe realitetin punitor.

Poezia e Fatos Arapit karakterizohet nga gjallëria dhe dinamizmi i brendshëm, që janë manifestimi më i mirë i një mendimi të shkathët dialektik, i frysës së shëndoshë polemike, i ndjenjave aktive, i shpirtit luftarak, i vështrimit të botës e të jetës nëpërmjet luftës së të kundërtave, gjë që ka depërtuar me natyrshmëri e singeritet edhe në vetë zbulimin e botës së brendshme të heroit lirik, i cili, në të shumtën e herës, indentifikohet me poetin, mishëron kompleksitetin e zhvillimit të sotëm ideologjik e psikologjik dhe ka për ideal proletarizimin e mendimeve e të ndjenjave, në vartësi prej luftës revolucionare, ndërtimit të socializmit — sidomos industrializmit — dhe transformimeve të thella politike dhe ideologjike, që ndodhin në jetën e shoqërisë sonë, nën udhëheqjen e partisë. Ndofta nuk do ta tepronim po të thosnim se, në poezinë tonë të re, janë të rrallë ata poetë, vepra e të cilëve karakterizohet nga një dinamizëm i tillë i brendshëm, ku shpeshherë edhe në disa vargje ose brenda një vargu të jenë sintetizuar me mjeshtëri ele-

mentet kontradiktore të zhvillimit, që nga kundërvënja e forcave të mëdha politike e shoqërore, deri te elementet e kundërtë, që luftojnë me njëra-tjetrën në qëndrimet, mendimet dhe ndjenjat intime të njerëzve. Duke pasur një natyrë të tillë poetike dialektike të perceptimit e të pasqyrimit artistik, që në rastet më të mira depërton gjer në kockën e ndërtimit e të zhvillimit shoqëror, poezia e Fatos Arapit, e pëershkuar nga një frymë e shëndoshë afirmonjëse dhe optimiste, ruan gjithnjë karakterin aktiv të ndikimit ideo-emocional dhe, duke u prirë vetë drejt të ardhmes, si drejt idealesh gjithnjë të reja shoqërore, nuk krijon atë atmosferë të vakët kë-naqësie, me të cilën ndeshemi jo rrallë në poezinë tonë, po mbetet mobilizonjëse, ngjall një shqetësim optimist revolucionar dhe të bën të mendosh si për filozofinë e jetës e të përparimit, dhe për anën e përcaktuar që duhet të mbash në ndeshjen e forcave të kundërtë apo në kuptimin dhe trajtimin e kontradiktave. Sado e gjallë e dinamike që është, poezia e Fatos Arapit është ideologjikisht e përcaktuar, pa vagullime romantike dhe pa ekuivoke. Në vlerësimin e së mirës dhe të së keqes, të pozitives dhe të negatives, të përparimtares e të së prapambeturës, të revolucionares dhe të meskines nuk gjejmë as shenjën më të vogël të kompromisit e të lëshimit, ashtu siç nuk ndjejmë as atë ngushtësi skematike, që vërehet disa herë në trajtimin e temave politike aktuale. Pra, kemi në këtë poezi një karakter të përcaktuar mirë dhe, nëpërmjet tij, një gjerësi njerëzore të trajtimit poetik të materialit jetësor dhe kjo është një prej anëve më pozitive, që do të viente të përgjithësohej, duke mbajtur parasysh edhe pikënisjen dhe pikësynimet e poetit, që kanë bërë të mundshme një gjë të tillë.

Në të vërtetë për këtë problem janë shqetësuar të gjithë poetët tanë të talentuar dhe, në shumë krijime të bukurë të tyre, është arritur një shkrirje e harmonishme artistike e të veçantës me të përgjithshmen, të elementit bashkëkohor me të ardhmen, të materialit kombëtar me tingullin e përgjithshëm, njerëzor revolucionar, po nuk janë edhe aq të rralla rastet, kur, për të arritur rezultate

të tillë, rruga e shpëtimit kërkohet vetëm në sajimin e një heroi lirik të papërcaktuar, në shtrirjen tematike në vogëlsira ose, përkundrazi, në deklamacione poetike të bujshme pa brendi ideo-emocionale të shëndoshë dhe në qëndrime artificiale poetike. Në rastin e parë kemi një rënje të poezisë në nivelin e anëve kontradiktore të zhvillimit, pa një qëndrim aktiv të përcaktuar, pra, me një fisionomi klasore jo aq të përcaktuar, kurse në rastin e dytë, — me një spekulim poetik mbi materialin jetësor e me një pozitë etike e poetike false.

Poezia e Fatos Arapit, në këtë drejtim, është një hap i mirë përpërra, se mbështet në një platformë klasore të përcaktuar mirë e të theksuar me forcë dhe, në qoftë se ajo ka, krahas kësaj, një tingull të përgjithshëm njerëzor revolucionar, kjo ka ndodhur se është nisur nga klasa më e përparuar e shoqërisë njerëzore, që, për këtë arësy, është edhe klasa që përfaqëson më së miri idealet më të avancuara, mendimet më të thella dhe ndjenjat më të shëndosha e më të pastra njerëzore. Nga ana tjetër, duke u përpjekur të shprehë në poezi ndjenjat dhe mendimet e kësaj klase, poeti as ka rënë në një botë iluzionesh dhe pompoziteti pseudorevolutionar, as ka indentifikuar me klasën punëtore elemente dhe fenomene shoqërore, që nuk përfaqësojnë fisionominë shoqërore, politike dhe morale të saj. Në këtë mënyrë është mishëruar në poezi me thellësi e gjerësi ideo-emocionale transformimi i shoqërisë në rrugën dhe nën udhëheqjen e klasës punëtore, pa përjashtuar nga ky transformim dhe nga kjo udhëheqje as botën e brendshme të poetit, as poezinë. Qëndrim ideo-emocional proletar mban poeti jo vetëm në ato krijime poetike që i kushtohen klasës punëtore dhe që, domosdo, e shprehin më hapur një gjë të tillë, po edhe në gjithë krijimet e tjera, në të cilat ndihet theksi i frymës proletare në kuptimin e pasqyrimin e luftës, të revolucionit, të transformimit ideologjik, të industrializimit, të luftës kundër burokratizmit e meskinitetit, të dashurisë, të heroizmit në punë, të së ardhmes komuniste, etj. Në mes të punëtorëve poeti e ndjen veten «më njerëzor», «më të lehtë», e «më të mirë» dhe, pikë-

risht pse ka zbuluar dhe ka asimiluar këtë të vërtetë të madhe të jetës, është i gatshëm «*që mbi vete të shkel*» për t'iu afruar klasës punëtore. Ky është një qëndrim revolucionar, që nuk ka të bëjë me individin, po me gjithë shtresat shoqërore jopunëtore, që duhet të «*shkelin mbi veten e tyre*» pér t'u afruar me klasën e pararojes e pastaj pér t'u kthyer edhe vetë në punëtorë, si njerëz të ciluar nga bagazhi i rëndë i botës së vjetër. Kurse poeti ka pér ideal që nga koka «*si nga tribuna, — të zgres mendimi intelektual!* — *Edhe të ngjitet — mendimi i qetë, mendimi i rreptë i klasës sime, — mendimi i rëndë, — si copë metal*».

Punëtorët «*zgjojnë ditën me sirena*». Ata «*provojnë kalibret dhe rezistencën — e mejtimeve, të endrrave — e të dashurive tona*».

Bota e punës, e mendimeve, e organizimit dhe e herroizmave të klasës punëtore është elementi më i ekzaltuar në poezinë e Fatos Arapit dhe këtë element, që spikat në mënyrë të veçantë në krijimet me motive punëtore, e gjëjmë të shpërndarë edhe nëpër gjithë krijimet e tjera, si një forcë ideore të rëndësishme, nëpërmjet të cilës është realizuar depërtimi i vërtetë «në çdo ind të krijimtarisë» i frymës revolucionare socialiste. Dhe, pér këtë arësy, ne e besojmë poetin kur thotë:

«*Kjo botë e madhe, e komplikuar e çelikut, më është e afërt, si vetja*» dhe zbulojmë në këto vargje një qëndrim të ri ideo-emocional ndaj realitetit, që ka hyrë në jetë e në poezi nëpërmjet klasës punëtore dhe industrializimit socialist. Në këtë qëndrim të ri ideo-emocional e ka burimin gjëzimi, kur shohim se:

«*Me sup' e shpatulla uzinat — shtyjnë — pejsazhet e vjetra, grisë nga erozioni i kohërave*».

Në botën punëtore poeti ka parë «*frymëmarrjen ritmike, të shëndetshme të punës*» dhe «*organizimin e ri, të shëndetshëm*» që «*bluan e tret ciflat e kanuneve, që ende na kanë mbetur në tru*».

Kjo botë në poezinë e Fatos Arapit nuk ka mbetur diçka më vete. Ajo hedh dritë, ndikon e lë pasoja në gjithë jetën socialist, të cilën e transformon sipas shembullit dhe

idealeve të veta. Poeti ka të drejtë kur thotë se nuk është mendimi intelektual, po është klasa punëtore ajo që transformon shoqërinë dhe, në qoftë se në plan të përgjithshëm teorik këtu nuk gjejmë ndonjë gjë të re, për poezinë tonë kjo është një gjë plotësisht e re, që ka spikatur aty-këtu, po është konkretizuar më mirë në rastin tonë. Prandaj:

«... me drithërimë gëzimi në zemër, — dëgjojmë si kërcasin e shpihen — nga lava e zjarrtë e metaleve — (të mpirë nga igrasia e kohëve) — damarët e shpatullat gjigante — të maleve».

Me rrëzëllim të veçantë shkëlqen në vjersha e poema heroizmi i punëtorëve. Dhe, në qoftë se në përgjithësi në vjershën e Fatos Arapit mendimi «intelektual» është shkri-rë me përfytyrimet konkrete të jetës, në përshkrimin e heroizmit, kjo veçori perceptimi e pasqyrimi shfaqet me një forcë të veçantë dhe me një konkretësi realiste të atillë, sa që duket sikur çdo fjalë e bukur do të ishte e tepërt para bukurisë së ashpër e të madhërishme të heroizmit. Punëtorët e Fatos Arapit nuk u përngajnjë gjigantëve mitologjik dhe as përfytyrimeve pseudoromantike të idealizuara. Ata janë të madhërishëm dhe idealë se «nëpër shkëmbenj u grisën mushamatë, — këmishat, — u tendosën muskujt, — u përgjakën mishrat»...

...Po, kur mbytet tuneli, apo shëmbet traseja, — nëpër gjakun tonë, — këtu ndezim zjarret e heroizmave të reja».

Mbi themele të tilla të shëndosha, të qarta e të sin-qerta ideo-emocionale poeti ka ngritur madhështinë e klasës punëtore dhe ka zbuluar poetikisht rëndësinë transformonjëse dhe rolin udhëheqës të saj në jetën tonë shoqërore, pa dalë jashtë caqeve të realitetit konkret historik të ditëve tona «*gjysëm punëtore, gjysëm fshatare*», duke u kapur pas elementeve themelore të jetës, pa rënë në idealizim të maqinave e të ingranazheve, po duke parë se «*saldohen njëherësh — hekur e èndrra*» — dhe me besimin e madh se:

Ashtu si shndrohen energjitet — në mizëri jonesh e elektronesh, — do të shndrohen të gjithë. — Do të kthehen në rrëzëllime dritash.

Pas gjithë këtyre tingëllojnë si një thirrje e madhe

vargjet, që mund t'i drejtohen kujdo nga ne:

*Ja klasa jote e madhe, e fortë... vetëm në gjirin e saj mund të digjesh, — si yll në qiellin pa fund.*

Dhe, që të mos tronditesh, kur toka lëkundet nën këm-bë, «që të mos biesh, mbahu fort, në partinë tënde, — në popullin tënd».

## II

I nisur nga pozita të tillë ideo-emocionale klasore, Fatos Arapi, në mjaft nga vjershat dhe poemat e veta na ka dhënë një përfytyrim të bukur, të qartë e të shuman-shëm të revolucionit dhe është përpjekur të përfshijë në vargje jo vetëm kuptimin, po të na japë edhe gjerësinë e këtij revolucioni, duke iu përbajtur kurdoherë mendimit themelor të vlerësimit pozitiv dhe optimist të tij si «*lokomotivë e historisë*» dhe si «*festë e të shtypurve*», duke e përfytyruar atë, në kuptimin më të gjerë, si transformim të përhershëm të vetë jetës njerëzore, nëpërmjet luftës së të kundërtave. Edhe në këtë drejtim ideo-tematik kjo poezi zë vend të veçantë në tërësinë e letërsisë sonë të realizmit socialist.

*Unë i përkas revolucionit, — thotë poeti dhe ne, duke shfletuar vëllimet poetike të tij, bindemi plotësisht, që në këtë varg të thjeshtë e kuptimplotë, nuk kemi të bëjmë me një deklaratë patetike, po me një bindje, me një dëshirë dhe një ideal, që nuk mbeten frazë e thatë, po mishërohen në gjithë krijimtarinë, janë pulsi dhe shpirti i saj, se vërejmë që poeti vërtet:*

*«... botën mund ta shohë të kthjellët — vetëm mes dall-gëve të turbullta të revolucioneve».*

Koncepti i poetit për revolucionin, duke ruajtur theksin politik si elementin më të ndjeshëm e më të dukshëm, nuk mbetet brenda caqeve të tij, po merr një shtrirje të gjerë ideologjike, shoqërore dhe etike, kurse vlerësimi revolucionar është i vetmi kriter vlerësimi poetik, si i ndeshjeve të mëdha politike e shoqërore, edhe i skajeve të vogla të jetës e të botës intime të njerëzve. Në këtë ndeshje e për-

pjekje të madhe elementesh të kundërta të realitetit shoqëror, që herë shpërthejnë vrullshëm e herë bashkëjetojnë në kontrast, poeti ka zbuluar harmoninë e jetës, që nuk mund të jetë veçse harmonia e luftës për realizimin e idealeve revolucionare. Në kompleksitetin dhe karakterin kontradiktor të fenomeneve, të aspektave jetësore e të periudhave historike, duke patur për themel një platformë ideo-emocionale të shëndoshë e të kthjellët, poeti, pa e skematizuar jetën dhe pa notuar në sipërfaqe, i është shmanget edhe rrëmujës e nervozizmit anarqik mikroborgjez, edhe deklamacioneve pompoze, me të cilat ndeshim në mjaft poema e vjersha të kohëve të fundit. Ai ka besim në logjikën e hekurt historike të revolucionit, në ndjenjat e thella revolucionare dhe, duke u prirë të përfaqësojë në poezi botën ideo-emocionale të popullit revolucionar, nuk i shmanget as pasqyrimi me vërtetësi të madhështisë së ashpër të revolucionit, as kontradiktave të jetës, se është i mendimit që vetëm mikroborgjezi klith e «*si bolla dritës, — i trembet dhe i ikën — kontradiktës*». Dhe, në qoftë se, duke u rropatur të depërtojë në dialektikën revolucionare të jetës, poeti arrin t'u transmetojë lexonjësve të vet mendime dhe ndjenja të forta optimiste, të guximshme e mobilizonjëse, kjo do të thotë, se, duke pasqyruar kontradiktat e kontrastet shoqërore, ai ngrihet mbi to me një koncept të drejtë luftarak, si përfaqësonjës i pararojës poetike të shoqërisë sonë.

— *Unë e dua kohën time, — se si vigane ajo u ngrit — mes për mes historisë... — Tani marshon... — Dhe, nën këmbët e saj gjigande — shtypen, kërcasin kock' e koka-lla — të botës së vjetër, që po jep shpirt. — Shekujve, brezave, që radhë vinë, — koha ime u del përpura, — qesh kur i sheh... — Dhe mban në duart e saj agimin e botës së re.*

Duke pasur një përfytyrim të tillë të përgjithshëm të «harmonisë» progresive revolucionare të historisë njerëzore e të epokës, Fatos Arapi e sheh botën gjithmonë si një «*hymn të triumfit të saj të ri*», pavarësisht në se një herë «*në një varg këngë ti ndjen në çdo çast — si frysë marrin jet' e vdekje bashkë*», kurse një herë tjetër qesh i gjëzuar

me bindjen se do të vijë dita që punëtorët «kapitalin të të-rë, — brumbull do ta ngulin me gjilpërë».

Në afirmimin entuziast të revolucionit është thelbi i përgjithshëm afirmojës i poezisë së Fatos Arapit dhe, në qoftë se flasim në përgjithësi për karakterin afirmojës të letërsisë sonë të realizmit socialist, do të thoshnim se pikërisht në këtë gjë bëhet dallimi ndërmjet poezisë së vërtetë revolucionare dhe asaj konformiste, që në vend të nxitë për të hyrë në valët e stuhishme të veprimit revolucionar, të nanurit e të lehtëson si hape qetësonjëse, duke ta përfytyruar çdo kohë si kulmin e harmonisë e të përsosmërisë e duke kaluar mbi kontradiktat e konfliktet përciptas e me ndrojtje. Po «ç'na duhen vargje si karamele?»

Duke e përfytyruar revolucionin si një brohori entuziaste të gjerë e të thellë, që përfshin e rrëmben gjithë jetën, po edhe të rreptë, të ashpër e të vështirë, poeti, sado që shtrihet në gjerësi dhe përqafon çdo anë të jetës, kur vjen puna te njerëzit e revolucionit, si në një fokus të zjarrtë e të përqëndruar, përbledh mendimin dhe nënvizon ato, që për poetë stilizantë mund të duken prozaike: organizimin, disiplinën, unitetin proletar. Për të ushtarët e revolucionit:

— *Dhe kur marshojnë, në një hap marshojnë — dhe kur këndojnë, një këngë këndojnë».*

Mos kemi të bëjmë këtu me një ngushtim, varfërim dhe skematizim të mendimit e të jetës së gjallë? Mendojmë se jo. Në këto vargje, përkundrazi, kemi një theksim të bukur të një ideali të madh, që buron nga vetë jeta dhe që përfshin gjithë anët e përgjithshme dhe esenciale të qëndrimit revolucionar, që mbështetet në unitetin e mendimit e të veprimit. Ky mendim i jep karakterit revolucionar të poezisë një fizionomi politike, shoqërore e kohore më të përcaktuar dhe e shpëton nga ato përfytyrime të mjegullta, sipas të cilave veprimi revolucionar krahasohet me stuhi e shkrepitma, me ngjitje malesh e me diçka tjetër të ngjashme me këto. Kjo fizionomi e përcaktuar e përfytyrimit poetik të revolucionit vizatohet në mënyrë të shumanëshme në vjersha e poema, sa herë që poeti gjen rastin të flasë për forcat e këtij revolucioni dhe për kun-

dërshtarët e tij, për idealet e tij dhe për predispozitat shpirtërore revolucionare. Edhe në këto raste poezia është larg çdo fluiditeti figurativ dhe çdo ekuivoku ideor. Forcën ideo-emocionale ajo e merr nga paraqitja e koncentruar figurative e të vërtetës dhe nga pathosi aktiv mobilizojnës. Prej vetë konceptimit dhe pasqyrimit të jetës nëpërmjet kontradiktave, anëve të kundërta dhe ndeshjes së forcave, poezia e Fatos Arapit përshkohet nga një frymë e theksuar demaskonjëse dhe polemike. Poeti, duke u ngritur në lartësinë e ideve e të idealeve klasore revolucionare dhe duke reflektuar qëndrimin aktiv të klasës, të popullit e të partisë ndaj armiqve të revolucionit apo shfaqjeve të «botës së vjetër», shpërthen kurdoherë me zjarr kundër reaksionit, mykut dhe meskinitit, duke u vënë përballë pa hezitim dhe pa sentimentalizëm realitetin dhe idealet revolucionare, se «revolucioni nuk njeh kurrë mëshirë, — kush lyp mëshirë, bëhet qesharak».

Prandaj:

«Sus! — Feudalë të rjepur e këlyshë feudalësh, — që si hardhucat më nxirri kryet — nér shkëmbenj të kohrave.

Sus! — Borgjezë bastardë — nga urrejtja e frika budallepsur.

Sus! — Mikroborgjezë meskinë!... — ngërdheshje armiqsh, nënqeshje filistinësh... — se të gjithëve, — si me një kamzhik tërë nyje, do t'ju kamzhikojmë me vargun: — I përkasim komunizmit!..

Filistinit këto vargje do t'i dukeshin tepër të ashpra dhe, mbasë për të fshehur këtë të vërtetë, do të thoshte se nuk janë poetike, se poezia duhet të jetë e butë, e ëmbël, «njerezore», etj. Por, në goftë se i shohim nga pikëpamja klasore revolucionare, përkundrazi, do të zbulonim në këto vargje ashpërsinë e drejtë të revolucionit tonë, epërsinë e tij, fizionominë e përcaktuar politike e shoqërore, krenarinë e klasës dhe, gjersa i trasmetojnë lexonjësit ndjenja e mendime të tillë, ato janë vargje militante, orientonjëse, mobilizonjëse, vërtet të ashpra, po të bukura për ashpërsinë e tyre, se pasqyrojnë madhështinë e rendjes revolucionare pa lëkundje të shoqërisë sonë e të poezisë sonë. Vetë ritmi i poemës «I përkasim komunizmit» është një manifestim

i jashtëm efektiv i marshimit revolucionar, që ndal vetëm para kredos e qëllimit: *I përkasim Komunizmit!* Nëpërmjet këtij vargu, që përsëritet disa herë, poeti ka arritur të ngjeshë në poemë pasqyrimin e gjerë dhe mendimin e madh të revolucionit tonë në fazat dhe aspektet e ndryshme të tij, dhe ka zbuluar poetikisht të vërtetën historike, se vetëm nëpërmjet revolucionit dhe me veprimtarinë e ushtarëve të këtij revolucioni mund të arrihej liria dhe të ecë drejt komunizmit, se Shqipërisë:

*...nuk i munguan shkrepat e malet, — nuk i mungoi kurrë lavdia. — Po i mungoi ai partizani... (që)... shkoi pas komunizmit — dhe vdiq — ushtar besnik i Marksit.*

E mprehtë, dramatike dhe açik kjo kundërvénje forcash të kundërtta duket sidomos në vjershat dhe poemat kushtuar Luftës nacionalçlirimtare, në të cilat poeti, duke nxjerrë në plan të parë ndjenjat dhe idealet patriotike dhe pa iu shhangur pér asnjë çast karakterit konkret, historik e kombëtar të kësaj lufte, ka mundur ta shkrijë atë me luftën çlirimtare e revolucionare të gjithë njerëzimit dhe të theksojë tiparet klasore të ndarjes e të ndeshjes së forcave. Pér të, në betejat e Luftës nacionalçlirimtare, nuk u ndeshën thjeshtësisht pushtonjësit me forcat patriotike, por u ndeshën:

*...Shqipëria e vogël — nazizmi qikllop, — bujku i revoltuar, junker i krekosur, — revolucioni trim — reaksiioni i xhindosur.*

Në këtë mënyrë poeti mendojmë se ka arritur t'u japë motiveve dhe materialit konkret jetësor frysëmarrje më të gjerë dhe me tingull më të përgjithshëm, duke hedhur kështu një hap me rëndësi në zgjidhjen e kësaj çështje në letërsinë tonë të sotme, në të cilën përpjekjet e kësaj natyre janë bërë më të theksuara gjatë viteve gjashtëdhjetë. Zgjidhja që gjejmë në poezinë e Fatos Arapit — dhe jo vetëm tek ajo, — na duket zgjidhja ideo-artistike më e drejtë, mbasi vendi ynë dhe koha jonë do t'u flasin botës dhe kohëve që vijnë, nëpërmjet eksperiencës dhe gjuhës së tyre dhe është e natyrshme që poetët të gjejnë në këtë vend e në këtë kohë ato elemente jetësore dhe ideo-estetike me rëndësi, që duke zbuluar fizionominë e epokës dhe

duke pasur karakter të theksuar bashkëkohës e kombëtar, u drejtohen edhe brezave që vijnë dhe marrin një natyrë të përgjithshme njerëzore revolucionare. Në këtë kuptim edhe tragjedia kombëtare, edhe lufta kundër pushtonjësve fashistë, edhe fitoret tona janë parë në një kuadër sa konkret, aq edhe të përgjithësuar, qoftë në frymën e përgjithshme që përshkon krijimet poetike, qoftë edhe në theksimin e hapur të kësaj pozite. Dhe kjo nuk është një pozitë e sipërfaqshme, artificiale apo e rastit, po si në realitet, edhe në poezinë e Fatos Arapit, i ka rrënjet në karakterin klasor të revolucionit dhe mishërohet, jo në ndonjë prirje për përshtatje servile, po në kundërvënjen e guximshme e të hapur revolucionare ndaj gjithë botës së vjetër dhe shfaqjeve të saj të reja. «Ankorë gjigande», në të cilën poeti ka ankoruar krijimtarinë e vet, është revolucioni, kurse skelë — Shqipëria. Në revolucion e në luftat për komunizëm poeti nuk e sheh veten e vendin të shkëputur nga gjithë revolucioni botëror. Për të ne «*jemi trup prej trupit të tij*. — *Jemi dritë prej dritave të tij*. — *Jemi dashuri prej dashurive të tij*...»

...*Jemi gjak prej gjakut të tij. Jemi dhimbje e tragjedive të tij. Jemi lavdi prej lavdive të tij.*

Prandaj poeti mburret, që sheh në realitetin tonë të sotëm të vërtetën e madhe se «*Republika e vogël, e pakë... mbi supet e njomë, po mban gjithë èndrrat e shekullit tonë*» dhe që «*èndrrat tona njerëzore i tmerrojnë tani armiqtë*».

Si elementi më sublim i poeziës së Fatos Arapit dhe i gjithë poeziës sonë të re është heroizmi revolucionar në luttë e përgjithësisht në jetë, një heroizëm që buron nga vetëjeta, që kërkohet prej saj, si një domosdoshmëri për realizimin e idealeve të mëdha. Dhe, në qoftë se poeti ka mundur ta lidhë gjithnjë këtë heroizëm me ndeshjen e forcave të kundërtta, duke ja kundërvënë xhindosjes së reaksiionit dhe e ka lindur jo në pellgun e frazave të lulëzuara, po në ashpërsinë, rreptësinë dhe tragjeditë e luftës, një gjë e tillë e ka bërë atë më të madhërishëm dhe më kuptimplotë, duke zbuluar kështu ato tipare dallonjëse të heroizmit popullor e të qëndrimit popullor ndaj heroizmit, që u kul-

tivuan gjat shekujve dhe u bënë më të fuqishme në Luf-tën nacionalçlirimtare, në kohën kur:

«...Përshkojnë plumbat, ashtu, nëpër trup — dhe urrejtjen tonë — dhe dashurinë tonë».

Mbartës i këtij heroizmi është populli dhe, në mënyrë të veçantë, komunistët e partizanët, ata që i duheshin Shqipërisë pér të fituar lirinë dhe që Shqipëria i lindi. Janë komisarët, që zgjuan alarmet komuniste maleve dhe me dorën e tyre ndezën qiellin tonë. Janë ata që ushqyen një dashuri tragjike pér njerëzimin dhe «Atdheut i dolën pérpara me fytyrën e dëshëruar të së ardhmes».

Në këtë varg të qetë, të kthjellët e të thjeshtë ka shumë madhështi mendimi e figure. Përpara heronjve shtrihen hapësirat e gjera të epokave, që nisen me luftën e tyre, që u zgjuan nga «alarmet e përgjakura», që u vaditën me gjakun e tyre.

Në heroizëm poeti ka parë edhe madhështinë, edhe dhembjen krenare, që i kanë dhënë vetë vdekjes fytyrën e përtëritjes së jetës, kuptimin e madh të fitores mbi egoizmin, epërsinë e dashurisë pér popullin, pér lirinë, pér të ardhmen.

— *Ne biem mbi të, posi mbllaca zjarri, — futemi nën dhe, — posi rrënjejë èndrrash. — Që të vijë pranvera, që të vijë behari, — toka përbimi ne e balta të shkrijë, — èndrrat të shpërthejnë, siç shpérthen dhe bari.*

Prandaj poeti, duke depërtuar thellë në madhështinë e heroizmit, është i bindur se heronjtë, që ranë në luftë:

— *sikur të ngriheshin njëmijë herë, — njëmijë herë prap do të binin, — ashtu si ranë...*

Përballë heroizmit, në poezinë e Fatos Arapit, është vënë egërsia dhe krimi, ashtu siç janë vënë përballë luftëtarëve të lirisë pushtonjësit fashistë dhe përballë komunistëve — reaksionarët. Kjo zgjidhje ideoartistike është gjithashtu e drejtë dhe historikisht e vërtetë dhe e përligjur. Heroizmin e lind vetëm drejtësia, idealet e mëdha njerëzore. Nga padrejtësia dhe qëllimet çnjerëzore lindin vetëm egërsia dhe krimet. Fizionominë e armiqve poeti ka arritur, shpesh me pak vargje, ta vizatojë qartë e thellë, duke për-

fshirë tërë kompleksitetin klasor, ideologjik dhe moral të fashistëve.

— *Nën helmeta — qelbje mejtimesh. — Nën helmeta — qelbje prej krimesh.* Ata: — *Me gjak të lirive duart kanë lyer dhe shikojnë agimet mes kryqesh të thyer.*

Besoj se s'mund të portretizohej më mirë karakteri reaksionar, militarist dhe kriminal i fashizmit, si pjella më e urryer e kapitalit që «zhgryhet, — nëpër pellgje gjaku — si bualli ndër lera»

Ky vlerësim ideo-emocional i shëndoshë revolucionar i kundërvihet me forcë mendimit filistin jo klasor, se gjaja në luftë «njérëzit në marrëzinë e tyre ngrohin duart» dhe, prandaj, duket e habitshme që një mendim i tillë ka gjetur vend edhe në poezinë e Fatos Arapit, si një lajthitet e keqe momentale.

Pas gjithë këtyre, a nuk është e përligjur dhuna revolucionare? Poeti është entuziast. Si poet revolucionar, ai nuk e përmban vargun te dyert e dhunës revolucionare, po e kërkon dhe e këndon atë, jo nga pozitat e letërsinë ahmetiste, që idealizon dhunën reaksionare, po nga pozitat themësisht njérëzore e revolucionare, si ndëshkim për krimet çnjérëzore, si domosdoshmëri të zgjidhjes përfundimtare të kontradiktave të ashpra klasore, si kundërshtim të shtypjes e të tradhëtisë kombëtare. Në një formë, në dukje paradosksale, në poemën, «*Alarme të përgjakura*», është shprehur mendimi, se populli i mbajti mbi shpinë bejlerët e qifligarët, që t'i shpinte «në dasmën e madhe,... ku nën qielin gjak po theren klasat». Poezia revolucionare s'ka pse të mos e shohë drejt në sy këtë të vërtetë themelore të historisë dhe do të ishte mungesë dhe dobësi e saj, në qoftë se do t'i kalonte anash e nuk do të mbruhej me kuptimin e saj. Duke u dhënë vargjeve ritmin gazmor e të shpejtë të sulmit që ka vënë përpëra kopenë e çakërdisur e të çorditur të reaksionit, Fatos Arapi nuk ngurron të këndojoë:

— *Do t'ju varim rrepeve. — Do t'ju varim degëve. — Me brezat e brekëve...*

Kështu i kërkonte mushka drutë. Kjo është logjika e ashpër, po e drejtë e historisë, të cilës i shmangen vetëm «poetët budallë» në vargjet e tyre «*karamele*».

*Unë jam poet i vendit tim —* thotë Fatos Arapi në një prei vjershave të veta dhe, duke u marrë me krijimtarinë e tij, ne bindemi, se edhe në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një pozë, po me një pozitë të vërtetë, me një përfundim karakterizonjës dhe me një ideal ideo-artistik të konkretizuar, drejt të cilit ai është prirë kurdoherë.

Flitet shumë për brendinë socialiste dhe karakterin kombëtar të letërsisë së realizmit socialist, po nuk janë të rralla rastet kur ky parim themelor vulgarizohet, nuk kuptohet thellë ose, ndonjëherë në praktikë, mbetesh me përshtypjen se ndokujt mund që i duket edhe i vjetruar. Po, gjersa do të ketë kombe, letërsia dhe arti, si refleks i këtij realiteti historik, do të kenë karakter kombëtar dhe do ta manifestojnë brendinë e tyre të përgjithshme njerëzore revolucionare pikërisht nëpërmjet formës konkrete kombëtare, që as mund të mohohet nga pozita kozmopolite, që përmbajnë helmin e servilizmit ideologjik ndaj borgjezisë, as mund të reduktohet në gunën e në qeleshen apo në metrikë. Karakteri kombëtar i letërsisë së realizmit socialist është i shkrirë organikisht me karakterin popullor, klasor e të partishëm të kësaj letërsie dhe ka të bëjë, para së gjithash, me zbulimin në veprat letrare e artistike të temperamentit, të shpirtit dhe të idealeve përparimtare kombëtare në etapa të caktuara historike, me reflektimin, nëpërmjet përbajtjes së thellë njerëzore revolucionare, të «konsticionit shpirtëror» kombëtar, si shprehje e veçantë e kësaj brendie të përgjithshme njerëzore revolucionare.

Poezia e Fatos Arapit është një shembull i bukur i karakterit kombëtar të letërsisë sonë bashkëkohore. Ajo, siç e kemi vënë re, ka një tingull të përgjithshëm njerëzor revolucionar, po as në frymën e saj të përgjithshme, as në hollësi nuk mund të shkëputet nga temperamenti dhe ngjyrat mesdhetare, nga mbrujtja me brumin kombëtar shqiptar, nga fatet historike kombëtare dhe gjurmët e tyre në shpirtin dhe në mentalitetin e popullit, nga krenaria kombëtare për të kaluarën, të sotmen dhë të ardhmen e Atdheut, nga natyra e vrullshme dhe e thellë e shprehjes së ndje-

njave, nga lidhja e njeriut me natyrën e vendit, nga fryma bashkëkohore e vlerësimit të thesarit shpirtëror kombëtar, nga kuptimi i elementeve dhe i kontributave kombëtare, si pjesë të thesarit të madh të gjithë njerëzimit, disa herë edhe si ajkë e këtij thesari.

Për të krijuar një përfytyrim poetik të natyrës së Atdheut, poeti shkruan:

*— Ja toka ime, — mes dritash kredhur, — mes brohorish të gëzueshme — Mesdheu, — shtatin me male në quell hedhur...*

Në këto vargje, duke iu larguar shtampave, është dhënë një vizion plot dritë, ngjyrë e gjësim i natyrës shqiptare, që ushqen optimizmin dhe pëershkon gjithë krijimtarinë e poetit, jo vetëm kur është fjala për natyrën, po edhe për temperamentin, karakterin dhe shpirtin e njerëzve. Ashtu si janë kredhur malet në shpirtin e poetit ashtu na duket se edhe poezia e tij është kredhur në dritën dhe ngjyrat e ndezura mesdhetare, në «brohorinë e gëzueshme» të jetës e të natyrës shqiptare, si një nga manifestimet më të qarta të poeziës sonë kombëtare socialistë, që depërtion thellë në rrembat e historisë, të jetës e të fateve të popullit, banorë të kësaj natyre me dritë, me ngjyra të ndezura dhe me male.

Këtij përfytyrimi poetik të natyrës i shtohet ndjenja tronditëse e njerëzve të lidhur me tokën, që për ta është vetëjeta dhe prandaj edhe dashuria e tyre për të nuk është një ndjenjë dosido, apo një entuziazëm i çastit, po shpreh vetë thelbin e jetës.

*— Ne dhe toka — një, — vazhdim i një shprese, — i një këngë që s'ke ku i këput...*

*...Në tokë — dashurinë për tokën mbjellim, — të përjetshme, — si përjetësia e tokës, — se jemi:*

*Bij e zotë të saj, — mbi të e nën të...*

Ky përfytyrim poetik i lindur nga një ide e qartë njerëzore, klasore e kombëtare njëkohësisht vjen e plotësohet, merr formë më të kristalizuar dhe më të madhërishme, kur shkëputet nga njeriu i përgjithësuar dhe, krahas tokës, vihet populli — zot i saj.

*Populli është këtu, mbi tokën — nënë, i madh e i*

*pavdekshëm, si ajo. — Ndër kohëra — rrufetë i kanë rënë, — rrebeshet e kanë zënë, — po ja ku është ai: — në çdo pëllëmbë të tokës, — në çdo ngastër kohe, — mbjell gëzimin e jetës.*

Më tej ky përfytyrim plotësohet edhe më tepër me fatet historike të popullit, me tragjeditë dhe heroizmat e tij, që ruajnë edhe ato dufet e papërbajtura të stuhive dhe brohorinë e gëzueshme të Mesdheut, ashpërsinë e maleve dhe kthjelltësinë e qiellit. Ai plotësohet me traditat e lashta e të pasura dhe me prirjen e përjetshme drejt lirisë e përparimit, drejt të ardhmes kombëtare komuniste. Zakonisht, kur flitet për krenarinë kombëtare, theksi vihet në të kaluarën, në traditat dhe, mbasë ndonjëherë edhe ka pasur arësyen për një theksim të tillë, kurse sot, ashtu si në poezinë e Fatos Arapit dhe në letërsinë tonë përgjithësisht, krenaria kombëtare është gjithashu një ndjenjë aktive revolucionare, që vërtet mbështetet në të kaluarën e lavdishme, po është e lidhur sidomos me realitetin e sotëm dhe me idealet e mëdha të përparimit të mëtejshëm, është mishërimi i patriotizmit popullor. Vetëm kështu poezia jonë e realizmit socialist cilirohet nga idealizimi i së kaluarës — karakteristikë e romantizmit — dhe e shikon atë nga lartësitë e kohëve të reja, si një prirje drejt të sotmes, duke mbajtur prapë si element themelor të konceptimit ideo-emocional popullin dhe aspiratat e tij demokratike revolucionare. E konceptuar dhe e pasqyruar kështu, e kaluara ngjall edhe dhembje, edhe krenari: dhembje për mjerimin, krenari për luftat e pandërprera e shpirtin luftarak të popullit, që në poezinë e Fatos Arapit, nuk ngushtohen vetëm në përlleshjet me pushtonjësit e huaj, po shtrihen e shkrihen edhe me konfliktet e ndeshjet klasore brenda kombit.

— Jetonim nér male të lartë, — ku qiellin me dorë mund të zëmë — dhe prap: — në ç'humnera kishim rënë! — lexojmë në poemën «Alarme të përgjakura», ku gjemjë edhe një sintezë të tillë poetike të së kaluarës tragjike e heroike të popullit:

— Dufe shekullore lirije, — etje shekullore për dri-

*ta, — krisma tē thyera kryengritjesh, — bubullima revolucionesh...*

Poeti, për këto arësye, me tē drejtë, mban pozitën, se vetëm në realitetin e sotëm socialist gjetën realizim edhe gjithë ëndrrat dhe idealet shekullore patriotike, se vetëm tani Shqipëria, duke mbetur prapë «anije mes stuhisë» «është lidhur në ankorën gjigante: — I përkasim komunizmit! Éshtë ky realitet i ri, që e bën tē madhërishëm përfytyrimin poetik tē Atdheut socialist dhe i jep krenari-së kombëtare një puls tē ri, një forcë tē re, si një ndjenjë e fuqishme bashkëkohore revolucionare. Në këtë terren entuziazmi poetik është pa cak, po shpërthen dhe tē rrëmben, duke zbuluar madhëshitinë e sotme shqiptare, — shembull frymëzimi për këdo në botë, se sot Shqipëria, si pas poetit, mban në duar «... shpatë tē mprehtë, trimërinë e saj, — (që) mund ta marrin cilët tē duan — (dhe) në dorë tē patrembur mund ta mbajë — çdo luftëtar, që kërkon lirinë. — Shqipëria sjell dashurinë — e pafundme për njerëzinë — edhe për jetën. — Mblidhen në zemrën e Shqipërisë — gjithë gëzimet edhe gjithë dhembjet — e vegjëlisë sonë proletare. — Dhe ajo vetë rreh si një zemër — në kraharonin e botës së madhe.

Poezia jonë, që nga Rilindja e këtej, e ka pasur një prej motiveve kryesore krenarinë kombëtare, po ndërsa më parë ky motiv trajtohet i mbështetur kryesisht në materialin e të kaluarës historike, në poezinë e sotme të realizmit socialist, sidomos tē viteve gjashtëdhjetë, si reflekset i realitetit tē ri politik e shoqëror, u aktualizua së tepërmë dhe, pa mohuar tē kaluarën, u lidh, para së gjithash, me madhëshitinë e revolucionit tonë dhe me vendin shembullor që zë ai në botën e sotme revolucionare. Ky realitet i ri, duke përtëritur në një shkallë tē re motivin e njohur tē krenarisë kombëtare, e ka pasuruar atë me elementet e qëndrimit klasor e internacionalist, duke theksuar dy momente ideo-emocionale me rëndësi: trajtimin e revolucionit e të kontributit kombëtar, si pjesë tē pandarë tē përpjekjeve tē gjithë njerëzimit dhe njohjen e pozitës së përparuar tē vendit tonë, në krahasin me gjendjen e sotme tē botës e të lëvizjes revolucionare ndërkombëtare.

Kështu, ndërsa Naimi ëndërronte ditën kur Shqipëria do të ndriçohej nga drita «*që lind nga perëndon*» dhe Migjeni nuk guxonë të kërkonte më tepër se një *agim* të *ri e të lumtur kombëtar*, poetët tanë të sotëm, ndër ta edhe Fatos Arapi, të frysmezuar nga realiteti i madhërishëm historik i ditëve tona, kanë zbuluar e pasqyruar poetikisht faktin që Shqipëria e sotme, me luftën e saj, është bërë «fener ndriçonjës i socializmit» dhe nga një vend, ku «*di-ta nxinte, po aq e errët, — sa edhe nata...*», po ngjitet drejt majave më të larta të lirisë, të përparimit e të lumturisë njerëzore. Nuk kemi të bëjmë këtu me një mburrje të thjeshtë, po me krenarinë e ligjshme të revolucionarëve, që kanë pse gëzohen, kur e kryejnë si duhet detyrën e mëdhe para njerëzimit, edhe duke u sakrifikuar e duke u ngritur mbi interesat e ngushta kombëtare.

Një moment tjetër ideo-emocional, që karakterizon trajtimin e sotëm të motivit të krenarisë kombëtare dhe i jep atij dinamizëm dhe shpirt luftarak, është edhe zgjermi i horizontit kuptimor të tij, duke e mbrujtur jo vetëm me krenarinë, që ngjallin bukuria e natyrës, luftat për liri dhe trimëritë legjendare, po edhe me gëzimin e krenarinë që shkakton prirja e guximshme drejt përparimit, depërtimi i idealeve komuniste, zhvillimi i hovshëm ekonomik e shoqëror, krijimi i lirisë dhe i lumturisë njerëzore nëpërmjet luftës, punës, kapercimit të prapambetjes dhe shkëputjes revolucionare nga trashëgimi i keq i së kaluarës. Edhe ky është një element i ri ideo-emocional, që nuk mund të gjente dot vend në letërsinë tonë të mëparshme, se vetë realiteti i atëhershëm i detyronte shkrimtarët të shihnin e të pasqyronin jo prirjen drejt të ardhmes dhe ngadhnjimin e të resë mbi të vjetrën, po karakterin tragjik e dramatik të konfliktit ndërmjet realitetit të kohës dhe idealeve të reja përparimtare e revolucionare, siç e gjemë një gjë të tillë veçanërisht te Migjeni. Prandaj është e natyrshme që dhembjes e dëshpërimit të dikurshëm t'ua zenë vendin gëzimi dhe krenaria, kur vërejmë se malet tonë që «...me duar të thara, kokalla, — *xhvish-nin e hanin — legjenda e përralla...*», tanë duan të jenë «një copë — nga gëzimi i botës» dhe të mbajnë mbi

*supa «dritat e reja të mendimeve të reja».* Dhe poeti përfundon:

— Ashtu dhe i dua malet e mia... — kur tundin shpatullat e sokëllijnë — ... I përkasim komunizmit!

Kështu, krenarisë së prejardhjes kombëtare, i shtohet si një element me rëndësi të dorës së parë krenaria e realizimeve të sotme revolucionare, e idealeve të larta, që frymëzojnë dhe udhëheqin kombin tonë sot.

Mbi këtë bazë të shëndoshë ideo-emocionale, Fatos Arapi ka trajtuar me guxim edhe motivet e kontradiktave dhe të ndeshjeve në jetën e sotme shoqërore, si një nga poetët tanë më të guximshëm dhe më militantë. Sikurse jetën në tërësi, edhe realitetin tonë të sotëm poeti e shikon në prizmin e ndeshjes së të kundërtave, të luftës së të resë revolucionare me të vjetrën reaksionare, të manifestuar me intensitet të ndryshëm, sipas karakterit të ndeshjeve e të forcave që i kundërvihen njëra-tjetrës. Duke ruajtur anësinë e qartë revolucionare pa hezitim e lëkundje dhe pa ekuivoke, gjë që u jep krijimeve poetike karakterin e njëkohshëm afirmojës dhe kritik, duke ruajtur parësinë e afirmimit të realitetit socialist, duke iu shmangur lustrimeve dhe përfytyrimeve subjektive pseudoromantike, poezia e Fatos Arapit edhe kur pohon, edhe kur mohon, edhe kur i bën të dyja njëkohësisht, ruan karakterin aktiv dhe mobilizonjës revolucionar. Vetëm në disa aspekte jo aq me rëndësi të jetës shoqërore ajo mbetet brenda kufive të konstatimit dhe përshkohet nga një trishtim i lehtë. Kështu, për shembull, në poemën «*Ekzotikë tiranase*», ndoshta nga vetë motivi i dashurisë që ka trajtuar, ai sikur i ka «ëmbëlsuar» kontradiktat dhe është prirë të shohë më tepër të vjetëruarën në jetën e ditëve tona, duke u shkëputur për një çast nga bashkërenditja e poeziës me forcat më të përparuara të shoqërisë, që është karakteristike për të.

— Me kontraste hijesh — hyre në shpirtin tim. — A më kupton? Hieja e xhamisë — mbi fytyrën e dashurisë... — Kjo ekzotikë më trishton...

Kjo «ekzotikë» vërtet të trishton, po edhe në qoftë se ka pasur vajza të ditëve tona mbi shpirtin e të cilave

binte hieja e xhamisë (e kishës do të ishte më e vërtetë), kjo ka qenë në realitet jo aq e trishtueshme, se prirja e jetës sonë shoqërore e ka kapërcyer atë dhe pikërisht ky kapërcim do të ishte më tipik për t'u pasqyruar. Momente të tilla, rrallë e tek, gjemjë edhe në vargje të veçanta vjershash e poemash dhe, në përgjithësi ato shprehin mendimin, se «*kemi shumë trishtime, — që duhet t'i shkul lin prej zemrës*».

Po, siç thamë, ky qetësim i trishtuar është momental. Karakteristike, jo vetëm në problematikën e rëndësishme e politike e shoqërore, po edhe për motivet intime, është kundërvënja e hapët dhe e mprehtë e të kundërtave nga pozitat e së resë revolucionare. Ndër elementet, që i kundërvihen së resë dhe kapërcehen prej hovit revolucionar të saj, poetit i kanë tërhequr vëmendjen më tepër mbeturinat e klasave të dikurshme shfrytëzonjëse, kundër të cilave mban ngahera një qëndrim të rreptë demaskonjës, shpirti dhe mentaliteti meskin mikroborgjez, konceptet e qëndrimet burokratike, si reflekse të praktikës së dikurshme antipopullore të administratës dhe intelektualizmi, shfaqja borgjeze e mbivlerësimit dhe e shkëputjes së intelektualëve prej jetës e prej popullit. Ndër krijimet poetike më me rëndësi, që e kanë pasqyruar thellë e me mprehtësi ideo-emocionale këtë kundërvënje në realitetin e sotëm janë: «*I përkasim komunizmit*», «*Republikës*», dhe, sidomos, poema «*Antiburokratike*», që ishte një përshtëndetje e guximshme dhe flakë për flakë e thellimit të luftës kundër burokratizmit në vetë jetën tonë socialiste, sipas orientimeve të partisë dhe nën drejtimin e saj.

Në poemën «*I përkasim komunizmit*», krahas demaskimit të «këlyshëve të feudalëve» dhe të «borgjezëve basardë» për të cilët folëm më lartë, ndeshim edhe me tipin shoqëror të njeriut të revolucionit, që, pasi ka siguruar një mirëqënje personale, tërhiqet e joshet prej saj dhe, në këtë mënyrë, vetvetiu largohet nga revolucioni, shkëputet nga populli e nga hallet e tij dhe vihet në kontradiktë me idealet, që dikur e kanë prirë, po që mbeten idealet më të larta të shoqërisë e të poetit. Polemika me këtë tip është një nga momentet ideo-emocionale me rë-

ndësi të poezisë së Fatos Arapit. Hapur apo duke u lënë të nënkuptohet, kundërshtimi i shpirtit filistin mikroborgjez përbën një nga elementet kryesore të karakterit aktiv të kësaj poezie, të brendisë së saj të shëndoshë ngacmonjëse dhe shoqërisht orientonjëse. Edhe në kohën tonë kjo problematikë është shumë aktuale, delikate dhe e vësh-tirë, mbasi akoma nxjerr krye në jetën shoqërore në for-mat më të ndryshme kontradikta ndërmjet interesave të ngushta dhe rehatisë personale, nga një anë, dhe interesa-vë të mëdha shoqërore, nga ana tjetër. Poeti përballë këtij tipi vë jo thjesht konceptin dhe qëndrimin e vet, po popullin dhe revolucionin, pra, nuk kemi të bëjmë këtu, siç mund të pandehet, me një qëndrim asketik, po me një thirrje të zjarrtë për formimin e një *njeriu shoqëror*, që nuk mbyllët në guaskën e vet, që nuk mendon se është më mirë të qëndrojë mënjanë dhe që, pasi ka krijuar një farë mirëqenje personale, nuk i mbyll dyert revolucionit për të «mbrojtur» prej tij qetësinë dhe rehatinë personale mikroborgjeze. Me këtë tip poeti, duke shprehur vetë qëndrimin shoqëror revolucionar, nuk pajtohet në asnje gjë. Kjo vërehet në poemën «*Antiburokratike*», në të cilën kon-tradikta është reflektuar në mënyrë më të mprehtë dhe, prandaj, edhe fryma polemike është më e theksuar dhe më fshikullonjëse. Kundërvënja e burokratizmit ndaj popullit, klasës punëtore e revolucionit në poemë është parë si një fenomen shoqërisht negativ, që realiteti ynë revolucionar e ka nxjerrë në dritë për ta zgjidhur nga pozitat e popullit e të klasës punëtore dhe poeti, në trajtimin e guxim-shëm të këtij fenomeni, është mbështetur te populli, te klasa punëtore e te partia, që e kanë frymëzuar dhe e kanë orientuar me veprimtarinë e tyre revolucionare. Pran-daj në poemë nuk ka as vjetërsi trajtimi, as ndrojtje, as konformizëm, po shpërthen mendimi i guximshëm, që go-det si kamzhik çdo prirje për t'iu kundërvënë popullit e revolucionit. Në atmosferën shoqërore të krijuar vetëm «*burokrati s'e ndjen veten mirë*, — *veç burokratit — po i merret fryma*», se në kokën e tij «*mejtimin, më të qu-llet se krimbi — e ushqen rutina*», kurse ideal i tij është «*të ngjitet përpjetë... mbi shpatulla të gjera të popullit*».

Ja, ky éshtë tipi, ndërsa kundër tij vihet vetë populli, madhështor dhe i patundur, për të cilën poeti thotë:

— *Populli, këtu mbi tokën — nënë, — s'flirton me ideale nëpër dhëmbë, — nuk përgjërohet poshtë e lart përherra, — për komunizmin, për partinë, — kurse në gojë, — thelez portokalli, — t'i lëngëzohet karriera.*

Optimizmi i poetit buron prej faktit të madh historik, se në shoqërinë tonë ka perënduar koha kur demagogët e karrieristët «*mbi fjalën «popull» — mund të mbësh-teteshin, — si mbi tavolinë*» dhe vetëm: «*në pëllëmbën e gjerë të popullit, — si në një skenë të gjëzueshme, — mbe-tet njeriu dhe më i lehtë, — dhe më i urtë*».

Nëpër të tilla kontradikta e sheh dhe e pasqyron poeti ecjen e shoqërisë përpëra, ngadhënjimin e revolucionit, filtrimin e elementit njerëzor dhe, duke vënë në themel punën krijonjëse socialiste, ushqen e përhap besimin tek njeriu i ri i socializmit, që lind e rritet para syve tona, kur thotë në poemën «*Vargje për dritat*»:

— *Dhe ashtu si shndrohen energjitet, — në mizëri jo-nesh e elektronesh, — do të shndrohen të gjithë. — Do të kthehen — në rrëzëllime dritash.*

#### IV

Një prej sukseseve ideo-artistike të Fatos Arapit éshtë se poezia e tij, duke qenë mirë e përcaktuar në kohë e në tematikë, me një platformë ideore të theksuar klasore revolucionare, ka një tingull të gjerë e të thellë njerëzor. Ajo u kundërvihet edhe tendencave skematike, që e varfërojnë dhe e vulgarizojnë trajtimin poetik revolucionar të jetës, edhe tendencave që, për të arritur në një «gjerësi njerëzore» më të madhe, u rrëshqasin, me marifete stili dhe me shambahje ideore, pozitave të forta e të përcaktuara klasore. I bindur që idealet më të përparuara janë idealet e klasës shoqërore më të përparuar dhe që kjo klasë, në kohën tonë, éshtë klasa punëtore, poeti éshtë mbështetur tek ajo në të gjitha motivet, që e kanë interesuar. Dhe, a ka gjë më njerëzore se kjo? Prandaj, në poe-

zinë e Fatos Arapit, ndeshen në një unitet të fortë dialektik kundërshtimi i hapur i çdo gjëje reaksionare dhe i çdo shmanjje nga pozitat e revolucionit e të klasës punëtore dhe afirmimi i dashurisë për njeriun, për jetën njerëzore, për gëzimet e saj. Në këtë mënyrë njeriu nuk është marrë e parë si një qenje në «përgjithësi» dhe as si një «individ» më vete i padepërtueshëm, po si një qenje shoqërore e përcaktuar, kurse tipi ideal i poesisë së tij është njeriu i revolucionit, me interesime të gjera, optimist, i dhënë pas gëzimit e lumturisë dhe krijonjës i tyre, që do dhe lufton për ta bërë botën e jetën më të bukur për të gjithë. Idealitet e tij të mëdha politike e shoqërore janë në pajtim të plotë dhe hedhin dritë edhe në fisionominë morale dhe në jetën intime të tij. Kështu është krijuar një hero unik, të cilin e ndjejmë tonin edhe në betejat e Luftës nacional-çlirimtare, edhe në kundërshtimin e shpirtit filistin mikroborgjez, edhe në vjershat me motive dashurie, të zhveshura nga çdo egoizëm dhe sensualizëm. Kuptimi dhe interpretimi revolucionar shoqëror i personalitetit të njeriut dhe i botës shpirtërore të tij, në të gjitha format dhe fushat e manifestimit të tyre, për këto arësy, është kusht i domosdoshëm që krijimtaria letrare e, veçanërisht poezia lirike, të ketë një platformë dhe fisionomi ideo-emocionale unike, që ajo në çdo motiv të trajtuar të ketë tingull të vërtetë revolucionar socialist.

Dashuria për poetin është një nga manifestimet më të bukura dhe më të pastra të qenjes njerëzore, që fisnikëron shpirtin dhe e bën njeriun të mendojë më tepër për të tjerët se sa për veten e tij, të dashurojë bukurinë, të ndjejë gëzimin dhe të ndjellë optimizmin në jetë, se ajo e zbuluron jetën dhe është një nga shtigjet e lidhjes së njeriut me botën, me shoqërinë.

*Dua, — thotë poeti, — dritat e jetës gjithmonë — t'i ushqejmë dhe me dritat e dashurisë sonë. — Si një buzë-qeshje e posalindur, — të qëndroj më, — në buzët e njerëzve.*

Kjo dëlli i bukur dhe e madhe e dashurisë të ngjall ndjenja të thella njerëzore, të cilat janë larg çdo egocentrizmi mikroborgjez, që ndonjëherë kërkon të na shitet

si «emancipim i ndjenjave» dhe si «revolucionarizm» i motivit të dashurisë, në një kohë kur është e njojur, se në dashurinë e vërtetë nuk mund të sundojë lakmia egoiste e çdo natyre qoftë, po devotshmëria mbi bazën e mirë-kuptimit e të idealeve të përbashkëta. Këtë lidhje të sin-qertë zemrash poeti e ka pasqyruar nëpërmjet krahasimit me detin e qiellin, të cilët «*kur mvrejtjet njëri — nxihej tjetri, — kur kthjellohej njeri — kaltërsohej tjetri*».

Gëzimin e jetës poeti e ka për ideal. Dhe ky, gjith-ashtu, është një ideal i bukur njerëzor, që harmonizohet plotësisht me botëvështrimin e poetit dhe buron prej vetë kuptimit të jetës, prej dashurisë me njeriun dhe prej njojjes së të drejtës njerëzore për lumturi, për një lumturi të ngritur mbi punën, që nuk e mohon po e presupozon luf-tën për realizimin e saj për të gjithë.

— *Zemrat duan në jetë të qeshin*, — thotë në një prej vjershave të veta Fatos Arapit, duke pasur parasysh pikërisht krijimin e atyre kushteve politike e shoqërore dhe të asaj atmosfere jete, që do ta bënte të mundshme realizimin e një prirjeje të tillë kaq të natyrshme dhe kaq të bukur të njerëzve, që arrihet, jo ndryshe, po nëpërmjet revolucionit, i cili nis atje ku njerëzit vetë e kuptojnë se:

— *Lumturi tjetër — botës i duhet! Dhe më e drejtë — dhe më njerëzore...*

Në kuptimin më të gjerë shoqëror dashurisë poeti i ka njojur me të drejtë forcën çudibërëse, që mposht tërmetet dhe, duke u sulur nëpër furtunë, përtërin jetën dhe kthen gëzimin e lumturinë e tronditur prej fatkeqësive. Këtë ndjenjë të fuqishme e fisnike poeti e gjen në shoqërinë tonë socialiste dhe entuziazmohet, kur sheh, se në qaste të vështira «*dashurinë e shqetësuar për njëri-tjetrin ne ndajmë si kafshatë*».

A nuk është kjo një nga ndjenjat më të bukura dhe një nga forcat më të mëdha njerëzore të shoqërisë socialiste? Në asnje rast tjetër të së kaluarës ose të botës së sotme kapitaliste nuk mund të ishte as i vërtetë, as i mundshëm një motiv i tillë. Vetëm në një shoqëri si jona:

— *Dashuria... sulet nëpër furtunë, — që jeta — më e fuqishme e gjëzueshme — të ngrihet...*

Këto ndjenja të mëdha, të pastra e të sinqerta njerëzore, që i kundërvihen edhe pa u deklaruar një gjë e tillë, meskinititet, egoizmit dhe shpirtit filistin mikroborgjez, e bëjnë poezinë e Fatos Arapit më të gjëzueshme dhe më optimiste në tërësinë e saj. Ajo është një poezi e gjallë dhe aktive, po meqë ndjenjat dhe mendimet e poetit janë të sigurta dhe të qëndrueshme, ajo është larg çdo shfaqjeje të jashtme nervozizmi dhe hallakatjeje ideo-emocionale dhe është e mbrutjur me shqetësimin revolucionar të poetit për jetën, për njerëzit dhe për revolucionin. Optimizmi i përhershëm dhe i padiskutueshëm i kësaj poezie buron vrullshëm nga vetë reflektimi i luftës revolucionare dhe nga idealet, që e udhëheqin atë. Në revolucion e në mes të popullit — njerëzve të revolucionit — njeriu i kohës sonë ndjehet «*edhe më i lehtë — edhe më i mirë*». Kjo do të thotë, se poeti ka mundur të formojë një platformë ideo-emocionale mbi të cilën çdo motiv i trajtuar bëhet një anë e reflektimit të ideve, të ndjenjave dhe të idealeve të përgjithshme revolucionare, që poeti i gjen të konkretizuara në realitetin e sotëm dhe, duke i përgjithësuar, ka për synim t'i rrënjosë edhe më thellë në jetë, në mendjen e në shpirtin e njerëzve. Prandaj nuk është e vësh-tirë që, duke lexuar poezinë e Fatos Arapit, të arrijmë në përfundimin e saktë, se njeriu ideal për të është pikërisht njeriu i revolucionit, tek i cili harmonizohen dashuria për jetën dhe etja për gjëzime me ndjenjën e gadishmërisë e të sakrificës. Ai qenjen e vet nuk e kupton ndryshe, veçse si një ushtar i revolucionit, si një pjesë e botës së madhe, që ka shtruar për të «*shpirtin e saj gjithë drita*», prandaj edhe ai ka për ideal të jetë i téri «*grimca dritash*» për botën dhe, po të jetë nevoja, të harrojë edhe veten, duke mbledhur hallet e gazet e botës, ashtu siç mblidhen ullinjtë «*një kokërr këtu... një kokërr aty*».

Duke qenë në tërësi optimiste revolucionare, poezia e Fatos Arapit nuk i është shmangur, kur ka qenë rasti, jo vetëm dhembjes njerëzore, po edhe ndjenjës së trishtimit. E rëndësishme është që edhe në këto raste poeti nuk mbe-

tet brenda guaskës së botës subjektive, po u jep edhe këtyre ndjenjave një kuptim të gjërë shoqëror, qoftë kur motivi ka karakter të përgjithshëm, qoftë edhe ku shfaqet në trajtën e një aspekti personal. Si burim trishtimi poeti ka pasur ose kujtimet e dhimbshme të së kaluarës, ose reflektimet në kontrast të së kaluarës në jetën e sotme. Karakterizonjëse për këtë do të ishin vargjet:

— *Fytyra të zbehta të ditëve që shkuan — pjellin e ushqejnë mendim të trishtuar — ose:*

— *Në këtë kupë dashuria derdhi — hijet e kishës së vjetër bizantine, — hijet e minaresë mesjetare.*

Kjo ndjenjë trishtimi, që shfaqet aty-këtu më të rrallë, si një refleks jete, sado njerëzore, duket se i del padashur përpara poetit dhe ai nuk i shmanget, po edhe nuk joshet prej saj. Shpejt, si një pjesë të shkurtër sinfonike, ndjenja e gëzimit dhe e optimizmit e kapërcen këtë ndjenjë dhe vjen e bëhet pothuajse ngahera sundonjëse, se poeti thotë:

— *Dot s'i duroj njerëzit e rëndë si dordolecë, — që ballëmvrejtur thonë: mir' mëngjes!*

Optimizmi është ndjenja, që lidhet më shumë dhe këtë bëjë më tepër me të ardhmen dhe, prandaj, krahas besimit në të ardhmen revolucionare të Atdheut e të botës, këtë ndjenjë poeti e ka shkrirë edhe në përfytyrimin e bukur poetik të rinisë, si forcë përtëritëse të jetës, si materializim njerëzor të vrapimit të përjetshëm të njerëzimit drejt të ardhmes, që ka qenë e mbetet realizimën-drash e idealesh gjithnjë më të mëdha e më të guximshme, se, — siç thotë poeti, — ashtu siç mban në krah i ati të birin foshnjë, që të kapë me dorë dritën, ashtu mbajnë edhe brezat njëri-tjetrin në krahë dhe priren drejt ditës. Dhe mbetet përherë, kështu, rinia një burim i pashtershëm gëzimi dhe optimizmi për njerëzimin dhe një motiv nga më të lumturit për poezinë. Ky motiv (më tepër se motivi kjo ndjenjë e brendshme e krijimit) përshkon një pjesë të mirë të poeziës së Fatos Arapit dhe në vjershën «*Rinisë*», përmblidhet si në fokus e shpërthen me zjarr:

— *Rini, — kaltërsi e ndershme, — èndër e pavdek-*

*shme, — e tokës tënde. — Dashuria e saj të ushqen, të rrit kockat. Dashuria jote tokën përtërin...*

— *Para teje shkrin ngrica — e mejtimeve patriarkale, fanatike...*

— *Meri të gjitha ç'kemi, meri: — dhe gjëzimet, edhe dhembjet tonë, dhe fitoret, edhe humbjet tonë. — Ç'harruum pa të dhënë?*

— *Përleshjet e ardhshme, — si tufë bubullimash, në duart e tua — meri, moj rini.*

— *Dhe sulu mes kohërave. — Brohori e pamposhtur e jetës.*

Siq shihet, motivi i rinisë në poezinë tonë të realizmit socialist ndjek vazhdën e Migjenit, e çon përpara dhe e pasuron atë me elementet e reja të realitetit të sotëm revolucionar dhe me një konceptim ideo-emocional shumë më të gjerë e më të përcaktuar, nëpërmjet një reflektimi të shumanshëm dialektik të lidhjeve me traditat e të prirjeve drejt të ardhmes, që shihet, jo ndryshe, po si e ardhme e revolucionit. Kësaj rinie që do të ndeshet në «përleshjet e ardhëshme» dhe do të sulet kohërave si «brohori e pamposhtur e jetës» i këndon poeti, ndaj janë të besueshme vargjet:

— *Mos vallë, ne studentët, që çkujdesur qeshim, — përlirinë e shenjtë nuk ditëm të vdesim?*

Historia e revolucionit tonë e përligj plotësisht vërtetësinë e këtyre vargjeve. Atë e përligj edhe e sotmja e rinisë sonë dhe, s'ka dyshim, që edhe në të ardhmen këshfu do të jetë. Për poezinë éshtë me rëndësi që e trajton këtë motiv dhe e trajton nga pozitat luftarake optimiste të një rinie revolucionare, e cila di nga vjen dhe e shehu shkon, që ngrihet mbi të kaluarën me madhështinë e të ardhmes. Kjo ndjenjë dhe ky besim ngjall gjëzim në zemër dhe poeti, me një ndjenjë të tillë të pastër e sublime, i pret brezat e ardhshëm me vargjet e kthjellëta:

— *Po vini ju të bukur, të gjuar — si dielli pranveror në të aguar, ndaj edhe ne, me këtë mendim të madhërishëm në thjeshtësinë e çiltërsinë e tij, mbyllim këtë vështrim të përgjithshëm mbi motivet dhe karakterin ideo-emocional të poezisë së Fatos Arapit, e cila bashkërendi-*

tet, si tërësi, me përpjekjet dhe rezultatet më të mira të poezisë sonë të realizmit socialist dhe e bën reale dëshirën e poetit për të qëndruar gjithnjë si flamur i kuq mbi bajonetë.

## V

Si të gjithë poetët tanë të sotëm, edhe Fatos Arapi ka gjetur shkak e rast të flasë në vargje për poezinë dhe të na japë, si të thuash, një kredo poetike të shpërndarë në vjersha e poema të ndryshme dhe, në një farë shkalle, ne gjemjë unitet të plotë ndërmjet dëshirave të shprehura dhe realizimeve krijonjëse të tij, gjë që dëshmon së deklaratat nuk kanë qenë shprehje të rastit dhe që poeti e ka njohur vetëveten aq sa mund të bëhej interpret objektiv i saj — gjë aq e natyrshme, po edhe aq e vështirë për t'u arritur disa herë.

Në ngjasim me prirjet poetike të letërsisë së viteve gjashtëdhjetë, poezia e Fatos Arapit, sikurse ajo e Ismail Kadaresë dhe e shumë poetëve të rinj, që ndjekin këtë rrugë, është një poezi «e figurshme», në qoftëse do ta pranonim këtë përcaktim në mënyrë konvencionale e përlehtësi shprehjeje. Ky karakter i figurshëm, si edhe përdorimi i formave të lira të vjershërimit, që u përtërinë në atë kohë, sado që poezia e Fatos Arapit përkon me prirjen e përmendur, nuk kanë prekur karakterin original të saj, që është shprehje e natyrshme e personaliteteve të formuara artistike. Duke kaluar nëpër këto shtigje një-kohësisht me poetë të tjerë, Fatos Arapi, ndryshe prej tyre, ka krijuar një fizionomi të vetën të mbështetur në traditën popullore e të poezisë moderne të kohës, i ka shkrirë elementet e asimiluara mirë prej tyre me temperamentin dhe me prirjet e veta artistike, duke krijuar kështu një poezi, ku sundojnë impulset e brendshme, shpërthimet e hovshme, po të sigurta, drita dhe ngjyrat e natyrës shqiptare, kuintesanca e konstitucionit shpirtëror të popullit. Në këtë përpjekje, — edhe nga pikëpamja formale, —ai ka krijuar një poezi me karakter të thek-

suar popullor, kombëtar dhe modern, duke dhënë një kontribut të çmuar në çeljen e shtigjeve të reja për poezinë tonë të sotme, krahas poetëve tanë më të njojur e më me personalitet, siç janë Lazar Siliqi, Ismail Kadareja, Dritëro Agolli, që secili në mënyrën e vetë, kanë pasuruar thesin e poezisë sonë të realizmit socialist.

Ne u përpoqëm të zbulojmë në këto shënimë, krahas vlerave kryesore ideo-emocionale, edhe mënyrën origjinale të konceptimit e të pasqyrimit poetik të realitetit në krijimtarinë e këtij poeti dhe prej vërejtjeve që kemi bërrë, prej shëmbujve që kemi përmendur, lexonjësi nuk do ta ketë të vështirë të zbulojë, se poezia e Fatos Arapit, sikurse në përgjithësi poezia jonë lirike, përshkohet nga një romantizëm i fuqishëm revolucionar. Pra, me gjithë vërtetësinë jetësore dhe prirjet realiste, ajo mbetet kryesisht një poezi romantike, si në natyrën e saj të përgjithshme, edhe në mjaft hollësira. Në këtë mes ndofta ndikon, si edhe te poetët e tjerë, karakteri përgjithësisht lirik — filozofik e lirik-shoqëror i poezisë, po kjo mendojmë se nuk është gjithshka, bille, ka dhe mund të presupozohet edhe një poezi lirike kryesisht realiste, siç e dëshmojnë, ndër të tjera, mjaft krijime të Fatos Arapit, Ismail Kadaresë e Dritëro Agollit. Prandaj romantizmin e poezisë sonë nuk mund ta kuptojmë të shkëputur prej rrëthanave shoqërore, që e ushqejnë dhe prej traditave, që e kanë pararendur e që e mbështetin. Po, në krahasim me romantizmin e mëparshëm të poezisë sonë, romantizmi i sotëm i poezisë së Fatos Arapit (dhe i letërsisë në përgjithësi) është një romantizëm me ndryshime cilësore ideo-emocionale e shoqërore-politike të dukshme, qoftë për objektin e fryshtimit, për vështrimin revolucionar të jetës, për shkrirjen e vështrimit subjektiv të botës me pasqyrimin objektiv, qoftë edhe për një shkrirje të elementeve romantike me elemente të dukshme realiste, shkrirje që, siç dihet, jo vetëm e pranon, po edhe e presupozon realizmin socialist. Poezia e Fatos Arapit, në pajtim me këtë, nuk është një reflektim i thjeshtë subjektiv i raporteve të poetit me realitetin, po përmban në vetëvete, si komponentë me rëndësi të shkrirë me njëri-tjetrin, reflekti-

min e raporteve shpirtërore të poetit me jetën dhe të jetës me poetin, pasqyrimin e elementeve objektive kryesore e të hollësive artistike realiste. Raportet e poetit me jetën dhe me shoqerinë janë raporte të reja cilësore, mba-si, në romantizmin e ditëve tona, nuk mohohet e nuk kundërvihet shoqëria, po bota e brendshme e poetit pri-ret drejt unifikimit me botën e madhe të pjesës më të përparuar të shoqërisë. Nëpërmjet kësaj faze të re cilësore të raporteve poet-shoqëri, duke njohur parësinë shoqë-lore, i vihet një kufi ipakapërcyeshëm subjektivizmit të dikurshëm romantik dhe, në fakt, i çelen shtigje realizmit, në kuptimin më të gjerë të fjälës. Prandaj ky ro-mantizëm është një kundërshtim i hapur i tendencave romantizante, që pa njohur zhvillimin historik, kanë rra-hur të përtërijnë në mënyrë formale romantizmin e vje-tër. Duke kundërshtuar këtë pseudoromantizëm, poeti shkruan:

— *Zana nuk ka. Nuk ka shtojzavalle — ka vetëm ma-lësorë e dëshira malësorësh.*

Karakteristike për poezinë e Fatos Arapit është shkrirje harmonike dhe e natyrshme e elementit shoqëror, poli-tik e filozofik të motiveve të trajtuara. Në përgjithësi, duke u nisur nga momente poetike të realitetit ose nga mo-tive me natyrë intelektuale, ai arrin që, pa iu shmangur pasqyrimeve të drejtpërdrejta, po asnjëherë deskriptive, të ngjeshë në një tërësi unike aspektet më të ndryshme të fenomeneve, të depërtojë në kuptimin filozofik të tyre, të zbulojë theksin politik të temave dhe të ruajë kurdohe-re një vlerësim shoqëror të shëndoshë e të thellë të tyre. Duke e pasur për natyrë një gjë të tillë dhe duke ja nën-shtruar që në procesin krijonjës spontanitetin logjikës së fortë dhe qëllimeve të qarta e të përcaktuara, në pro-cesin e zhvillimit të tij poetik, vërejmë prirjen e fshehjes e të nënkuptimit të filozofisë së momenteve të trajtuara, në dobi të një theksimi më të madh të karakterit të hapur politik e shoqëror të poezisë. Një gjë të tillë do ta vinim re, po të krahasonim vëllimin «*Shtigje poetike*», me vëlli-min «*Poema e vjersha*» e, sidomos, me përbledhjen «*Ritme të hekurta*». Tipike për këtë sens të zhvillimit

të poetit do të ishin poemat «*Vargje pér Halidën*», «*I përkasim komunizmit*», dhe «*Antiburokratike*». Ky proces, që doemos do të arrijë një kristalizim e përsosje të mëtejshme, është një proces pozitiv që është shoqëruar me theksimin e realizmit në poezi dhe me largimin gjithnjë më të dukshëm prej dëshirës pér të filozofuar, ose, në të shumtën e herës, duke u treguar mjaft i përmbytj e i kursyer në arësyetime, në dobi të një zbulimi më direkt e më të shumanshëm të vlerave poetike të vetë realitetit. Një prirje e tillë është bërë më e dukshme në poezinë tonë të kohëve të fundit dhe është pér t'u përshëndetur fakti, që edhe një pjesë e mirë e poetëve të rinj, krahas disa poetëve të njojur si Agim Gjakova, Vehbi Skënderi, Dhori Qiriazi, Agim Shehu etj., po e braktisin atë mënyrë të shkruari, në të cilën poezia e vërtetë e jetës mbytej në zhurmën e vargjeve të shumta e të bujshme, që krijonte një kakofoni poetike pretendonjëse, pa ndonjë thellësi ideo-emocionale të vërtetë e të qëndrueshme, me gjithë figurat e stuhishme dhe «filozofimeve» të pa-përbajtura e të pakontrolluara. Në disa vëllime poetësh të rinj (Shefki Karadaku, Viktor Qurku, Sulejman Mato, etj.) dhe në vjersha e poema të botuara në revistën «*Nëndori*» e në gazeten «*Drita*», vërehet pikërisht një përpjekje serioze e zbulimit të poezisë e të filozofisë së jetës, në-përmjet vetë momenteve me potencë shprehëse. Kjo gjë është shoqëruar, gjithashtu, me një dishiplinim më të madh të formës e të shprehjes e, disa herë, me një kthim të bukur në traditën «klasike» të të shkruarit, e cila po merr përtëritje dhe freski prej motiveve më të reja të jetës sonë socialiste dhe prej reflektimit në të të shpirtit poetik e të botëvështrimit të brezit të ri të kohës sonë, që, doemos, do t'i sjellë poezisë dhe gjithë letërsisë sonë freskinë e moshës së re e të kohëve të reja. Edhe nga kjo pikë-pamje po ta marrim, prirja që vërejtëm në krijimtarinë e Fatos Arapit duket që është pozitive dhe, si çdo kontribut tjetër, ka ndikuar në orientimin e zhvillimit të përgjithshëm të poezisë së ditëve tona, duke i shërbyer si mbështetje e si nxitje.

Ashtu si ndjenjat e mendimet, edhe figurat, në poe-

zinë e Fatos Arapit, pothuajse kurrë nuk të lënë përshtypjen e një spontaneiteti të pakontrolluar. Përkundrazi, me përjashtime të rralla, ato janë figura që shprehin saktë, qartë e me emocion faktin poetik, nuk vuajnë nga «hipertrofia» e figurave të së ashtuquajturës «poezi e figurshme», kanë pikënisje reale jetësore, nuk rrëmbejnë me vete figura të tjera, që, duke shprehur të njëjtën gjë, humbasin kuptimin, mbytin ndjenjën e mendimin dhe kthehen në qëllim më vete, ne mani figurash. Po kështu, duke qenë poezi «e figurshme», ajo qëndron larg «lulkave» stilistike, kurse në kuptimin më të përgjithshëm, natyra e figurshme e saj përbahet në vetë konceptimin e tërësi- shëm të motiveve, në krijimin e figurës ideo-emocionale të atyre aspekteve të realitetit, që janë reflektuar në vjersha e poema. Nga kjo pikëpamje, ndofta, nuk është arritur plotësisht konceptimi poetik i motiveve të poemës «*Alarme të përgjakura*» dhe një gjë e tillë është shkaktuar, me sa duket, se poeti nuk ka gjetur atë kënd vështrimi, që do t'i jepte mundësinë e pasqyrimit kohor e të shumanshëm (në aspektet e ndryshme) të Luftës nacional-çlirimtare dhe të unifikonte e të ndërthurte organikisht motivet e ndryshme, disa prej të cilave janë gjëra të bukurë në vetëvete. Kjo poemë, — edhe për ketë arësy, — me gjithë vlerat që ka, në tërësinë e vet, nuk ka sjellë ndonjë theks të ri në trajtimin e temës së Luftës nacional-çlirimtare, siç ka sjellë, për shembull vjersha «*Drashovica*», e përfshirë si një këngë më vete në poemë. Pra, veprës duket se i mungon platforma ideo-figurative, mendimi nuk është përqëndruar dhe interesimet e veçanta të poetit, për këtë arësy, nuk kanë gjetur dot një taban të përbashkët e një shprehje figurative unike, qoftë edhe duke ruajtur vepra karakterin e një mozaiku poetik.

Duke lexuar vjershat e poemat e Fatos Arapit, më tepër nga figurat stilistike, të lë përshtypje aftësia e tij për të dhënë me pak vargje figura të bukurë të realitetit, me një figurativitet piktorik të rrallë, që të mbetet në sy. Një mjeshtëri të tillë e vërejmë sidomos në përshkrimet e natyrës, gjithnjë të shkrira me qëllimin dhe me momentet emocionale, që reflektohen në vjersha. Le të kujtojmë,

për shembull, vizionin poetik të luftëtarëve lebër, që ecin nëpër malet e mbuluara nga mjegulla:

— *Mjergull — Lebër.* — *Lebrit ecin mbi mjergull,*  
— *mjergulla mbi shpatulla lebrish.* Ose këtë konkretësi poetike të përfytyrimit të një gryke malit:

— *Një rrisk të hollë qelli kemi përmby krye,* — *neteve mbi ne vetëm një grusht yje.*

Në shumë raste të tilla figurativiteti i poezisë përbahet në vetë konceptimin e figurshëm të objektit, pa qenë nevoja pér të krijuar në ndihmë të tij krahasime e metafora, që do ta rëndonin përfytyrimin dhe vetëm do të lagonin vëmendjen nga konkretësia emocionale e reflektimit. Një gjë e tillë mund t'u ndodhë vetëm poetëve, që depërtojnë në vlerat estetike të realitetit dhe janë të sigurt në ekspresivitetin e tyre. Bile, edhe me një thjeshtësi më të madhe gjuhe e stili, në raste të tilla, mund të krijojen përfytyrime të forta e të qarta poetike.

— *Rreth e qark gurishte.* — *Armiku gjuan keq.*

Po t'i shqyrtonim këto dy vargje nga ana formale stilistike, nuk do të gjenim në to asgjë, që do të na tërhiqte vëmendjen, mirëpo, nëpërmjet një thjeshtësie maksimale, pa asnjë pretendim formal figurativ, në to na është dhënë me saktësi e bukur ashpërsia e një vendi të thatë, ku të zhurit dielli dhe s'ke ku të fshehësh kokën dhe rreptësia e luftës. Në kujtesën tonë, vargje të tilla ngjallin përfytyrime emocionale të vendeve që kemi njojur, ndryshe nga ç'na ndodh kur lexojmë vargje romantizante pér malet e pér shkëmbinjtë, në të cilat figurat stilistike bëjnë të sundojnë përshtypjet subjektive, disa herë aprioristike, mbi figurën e vërtetë të realitetit. Po në këtë mënyrë konkrete, disa herë poeti, veç përfytyrimeve poetike të natyrës, arrin të transmetojë thjeshtë e me gjallëri sensacionet e hapësirës, të kohës, të ngjyrave, të tingujve, të qetësisë, të lëvizjes.

— *Heshtje mbi tokë dhe në quell heshtje mbi ne,* — lexojmë në poemën «*Vargje pér Halidën*» dhe në këtë varg, ndjejmë madhështinë solemne të botës e të universit dhe heshtja e një nate të kthjellët sikur na hyn në shpirt,

kurse, në vjershën «Në park» na jepet ky përfytyrim i bukur, konkret, po edhe jo fort i kapshëm:

— Në trup të natës, hije nëpër hije, — duken e zhduken forma dashurie.

Një mënyrë e dëshiruar e krijimit të figurave në poezinë e Fatos Arapit, si edhe të Ismail Kadaresë e të ndonjë tjetri, është konkretizimi i nocjoneve abstrakte dhe trajtimi i tyre në forma të materializuara jetësore. Në këtë mënyrë arrihet në një shkrirje të elementit konkret jetësor me fenomenin e përgjithshëm, që ai shpreh e përfaqëson.

— Dyert mbeten të hapura: — mund të hyjë në to liria ilegale e Shqipërisë. Në këtë rast «liria ilegale», duke ruajtur edhe vlerën e drejtëpërdrejtë kuptimore, shpreh e përfaqëson luftëtarët ilegalë të lirisë. Ose:

— Dhe një grusht studentësh, — si në një llogore, — hynë — në një këngë lirije.

Kjo mënyrë e kundërt me mënyrën e shprehjes së drejtëpërdrejtë dhe e përqasjes së nocioneve abstrakte me format konkrete jetësore, ka vlerat e veta artistike, në goftë se nuk shpërdorohet e nuk kthehet në mani, që do ta largonte poezinë nga qartësia ideo-emocionale, duke e futur në hullitë e subjektivizmit. Po, te Fatos Arapi, sig e kemi vënë re, një mënyrë e tillë përdoret më të rrallë, krahas e pa krijuar kontrast me mënyrat e tjera. Vetëm tek-tuk mund të gjejmë në vjershën e tij ndonjë figurë jo aq të qëlluar e as fort origjinale si: «globi — pjepër, — thela-thela ndarë. — jo me lugje po me meridianë» ose:

— Rruzulli — bucelë e rrumbullaktë — Rruzullin ngre, si një bucelë. — Pi me gurmaze e gllënnjka, pi. — Rruzulli — bucelë. — Me gllënjka pi — musht kryengritjesh e revolucionesh.

Në disa raste të tjera ndeshim në paralelizma parodksale, pa një logjikë të brendshme të fortë, si:

— Nëna ime pillte fëmijë, — koha ime pillte revolucionë.

Po këto janë vetëm gjëra të rastit që, si edhe ndonjë dobësi tjetër formale, nuk kanë cënuar vlerën e përgjith-

shme të krijimeve poetike. Përkundrazi, si nga pikëpamja e brendisë ideo-emocionale, edhe nga forma, poezia e Fatos Arapit ka një fizionomi të përcaktuar mirë dhe, me gjithë zhvillimin nga një kohë në tjetrën e me ndryshimet e diktuarë nga motivet e trajtuara, ajo mbetet si një tërsësi artistike unike, ku çdo anë është në harmoni me anët e tjera dhe hollësitë në harmoni me thelbin ideo-emocional të saj. Krijimtaria e tij mbetet një nga vlerat e bukurë të poezisë sonë të realizmit socialist. Ajo të tërheq me brendinë e thellë revolucionare, me tendenciozitetin ideo-artistik klasor, me romantizmin dhe ngjyrat kombëtare, me frymën e shëndoshë bashkëkohore dhe me nivelin e lartë të realizmit të vjershave e të poemave më të mira. Ideali i poetit është shprehur në këto vargje:

— *Në pushkë — bajoneta. — Mbi bajonetë — flamuri i kuq, — nervoz i sertë. Porsi ai qëndrofsha për jetë.* —

Ky është ideali i të gjithë letërsisë sonë të realizmit socialist, të lidhur me revolucionin dhe me ndërtimin e socializmit e të komunizmit. Kjo është kredoja e të gjithë shkrimitarëve tanë revolucionarë.

Vepra e Fatos Arapit e përligj këtë deklaratë poetike.

## KËNGA E POPULLIT

(Shënime për folklorin  
e Luftës nacionalçirimitare)

### I

Populli gjithnjë ka kënduar dhe në këngët e tij, si në shumë fusha të tjera të krijimtarisë artistike, ka shprehur qëndrimin e tij ndaj jetës, ka pasqyruar botëkuptimin dhe botëvështrimin popullor, ka mishëruar aspiratat dhe idealet, ka manifestuar gjeninë krijonjëse dhe ka konkretizuar shijet dhe pikëpamjet e veta estetike dhe artistike, në pajtim me kohën, me interesat dhe me perspektivat e zhvillimit historik, me shkallën e gjendjes shpirterore, me mënyrën e jetesës etj. Krijimtaria artistike popullore, në këtë mes edhe krijimtaria poetike e popullit, është më e vjetra, më e gjera, më e shumanshmja, më interesantja dhe më autentikja krijimtari që njeh historia e kulturës njerëzore. Ajo ka lindur nga gurra e frymëzimeve të pashtershme popullore, ka ushqyer me idetë dhe me bukurinë e saj masat e gjera të popullit, ka transmetuar e përpunuar brez pas brezi ideologjinë dhe estetikën popullore, ka thelluar brendinë demokratike dhe, për këto arësy, ka tërhequr vëmendjen, ka frymëzuar dhe ndikuar në shekuj artistë dhe shkrimitarë të shquar, që, të mbështetur në artin e popullit, kanë krijuar kryevepra.

Me të drejtë është theksuar se folklori ka qenë një

polemikë me letërsinë e klasave sundonjëse,<sup>1)</sup> që shprehë ideologjinë, interesat, shijet dhe idealet shoqërore dhe estetike të këtyre klasave, megjithëse në këtë drejtim s'ka si të mos mbahen parasysh edhe shtresat e ndryshme kohore në krijimtarinë popullore dhe nuancat që i jepin asaj kategoritë e veçanta shoqërore të së njëjtës kohë. Sidoqoftë është fakt i njohur që poezia dhe kënga popullore, si e gjithë krijimtaria artistike e popullit, duke qenë më e vjetra, është zhvilluar paralelisht në kohët më të vona me letërsinë e shkruar, duke përfshirë këtu edhe letërsinë e shkruar përparimtare, që ka ardhur duke theksuar karakterin e vet demokratik popullor. Një fenomen i tillë, krahas karakterit polemik, që me letërsinë përparimtare vjen duke u ngushtuar, ka shkakë shoqërore objektive, që dalin jashtë kufive të interesimeve artistike dhe kanë të bëjnë drejtpërdrejt me strukturën klasore të shoqërisë dhe hendekun e thellë, që krijojnë klasat shfrytëzonjëse ndërmjet kulturës dhe masave të gjera popullore, me kontrastin ndërmjet qytetit dhe fshatit, ndërmjet qytetërimit borgjez dhe mënyrës së jetesës popullore etj. Prandaj fshati, si zona e veçuar nga kultura dhe qytetërimi i klasave shfrytëzonjëse, ka qenë vatra kryesore e lulëzimit të krijimtarisë letrare e artistike të popullit, ndërsa në qytete vërejmë aktivizimin kryesisht të mikroborgjezisë në këtë drejtim. Shijet estetike dhe artistike popullore, në një farë kuptimi, vazhdojnë të ruajnë «pavarësinë» edhe në një kohë, si koha jonë, kur krijohet një afërsi shumë e madhe, bile një unitet i plotë ideologjik e politik nëpërmjet folklorit dhe letërsisë së shkruar, si refleks i unititetit moral e politik të popullit, nën udhëheqjen e partisë. Një fenomen i tillë, doemos ka të bëjë me traditën, por përcaktohet gjithashtu nga disnivelet e zhvillimit shoqëror, nga ndryshimet ende të dukshme ndërmjet fshatit e qytetit dhe për shkak se asnjëherë gjer tanë letërsia e shkruar dhe arti «profesionist» nuk kanë arritur dot të

---

1) Ismail Kadare: Autobiografia e popullit në vargje (gazeta «Drita» 31 janar 1971).

plotësojnë në sasi e cilësi të gjitha kërkesat e mëdha të popullit për art dhe akoma nuk është arritur në një harmonizim të plot gjer në nuanca të shijeve artistike, pa harruar edhe ndikimin e fortë të nxitjes së ndërgjegjshme të krijimtarisë popullore në kohën tonë. Por, ndërsa gjithnjë janë bërë përpjekje për të studjuar veçoritë e poezisë popullore dhe dallimet ndërmjet saj dhe letërsisë së shkruar, duke u marë edhe me ndikimet reciproke që janë vërtetuar në periudha e në shkrimitarë të ndryshëm, na duket se pak vëmendje është treguar për të zbuluar e studjuar pikat e afrimit, disa herë edhe të unititetit ndërmjet folklorit të një periudhe historike dhe letërsisë së shkruar të saj, gjë që do të vendoste në kushte më objektive dhe do të bënte të vlerësohej edhe më drejtë kontributi i shkrimitarëve në raport me popullin, pra, me kohën kur jetuan e krijuan. Me këtë kemi parasysh raportet ndërmjet letërsisë së shkruar dhe ideologjisë popullore të kohës, të demokratizmit popullor, të shijeve dhe të idealeve shoqërore dhe estetike të popullit dhe jo thjeshtësisht afërsinë apo largimet nga stilistika e vjershërimit.

Nga fillimi i Luftës nacionalçlirimtare e këtej ne vërejmë një afrim të madh themelor ndërmjet krijimtarisë poetike popullore dhe letërsisë së shkruar të realizmit socialist, që është manifestim i unititetit politik të masave punonjëse, nën udhëheqjen e partisë, në luftë kundër pushtonjësve fashistë dhe veglave të tyre — përfaqësonjës të klasave shfrytëzonjëse — për një Shqipëri të lirë, demokratike, për vendosjen e pushtetit popullor dhe çeljen e rrugës për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Kjo platformë politike, e konkretizuar në dokumentat kryesore të partisë në atë kohë dhe depërtimi, nëpërmjet partisë, i parimeve themelore të ideologjisë marksiste-leniniste në masat e gjera të popullit, u bënë terreni i përbashkët ideo-politik i krijimit të njëkohshëm të poezisë popullore të Luftës nacionalçlirimtare dhe të letërsisë së realizmit socialist. Kënga e popullit, si edhe letërsia e shkruar, patën për herë të parë një objekt plotësisht të përbashkët frysëzimi — Luftës nationalçlirimtare, një orientim unik ideo-politik — vijën e partisë dhe, me mënyrat e veçanta të shprehjes

poetike, iu drejtuant të njëjtës kategori shoqërore — popullit të ngritur në luftë. Mbi këto themele ideo-politike e, në thelb, edhe estetike të përbashkëta, si në krijimtarinë poetike popullore, edhe në letërsinë e shkruar të Luftës nacionalçlirimtare u theksuan më tepër karakteri demokratik e popullore, fryma patriotike u bë më e qartë dhe mori theks të dukshëm klasor revolucionar, partishmëria komuniste u bë shpirt i krijimtarisë, vështrimi i kthjellët i perspektivës historike i dha folklorit e letërsisë optimizmin revolucionar dhe gjykimin e drejtë përmadheshtinë e luftës e të heroizmit, për nevojën dhe bukurinë dramatike të sakrificave në emër të botës së re, që do të krijohej pas lufte. Prej këtij zhvillimi të njohshëm të poezisë popullore e të letërsisë së shkruar në vjetët e Luftës nacionalçlirimtare, na duket fare me vend të nxjerrrim si përfundim të parë «*kontributin poetik popullore në lindjen e letërsisë së realizmit socialist në Shqipëri*, pa rënë në kundërshtim me dallimet që ka folklori me letërsinë e shkruar. Në të vërtetë, në kuptimin e përgjithshëm historik e shkencor, letërsia e shkruar burimin e parë e ka pasur në krijimtarinë më të hershme popullore. Ajo që thotë Marks i për artin grek, për të cilin «*mitologjia greke nuk ishte vetëm arsenali... po edhe terreni i tij*», është e vërtetë për të gjitha fillimet e letërsisë së shkruar e të artit «profesionist» në shkallë botërore. Në rastin tonë nuk kemi të bëjmë me prejardhje të letërsisë së shkruar të realizmit socialist nga poezia popullore po, në kushtet e lindjes e të zhvillimit të njëkohshëm të tyre mbi një terren e me një arsenal të përbashkët, jo vetëm u zhduk çdo frymë polemike ndërmjet tyre, po u formua një qëllim i përbashkët, një drejtim i përbashkët ideo-artistik dhe, në atmosferën letrare artistike të kohës së luftës, si edhe më vonë, kënga popullore dhe letërsia e shkruar plotësuan njëra-tjetër, ndihmuan dhe ndikuan njëra-tjetër, aq sa, në drejtime themelore, mund të merren gati si i njëjti fenomen i manifestuar në dy trajta të jashtme të ndryshme. Ndikimin reciprok, mbi terrenin e përbashkët historik, politik e ideologjik, që e përcakton, do të ishte pa shumë rëndësi në qoftë se do ta

kërkonim në metrikë e në stilistikë, megjithëse edhe elemente të tilla ndeshim. Në radhë të parë ndikimin e gjejmë në atmosferën që krijuan njëkohësisht, për shembull, këngët partizane të shkruara nga poetë e të muzikuara nga kompozitorë dhe këngët popullore të luftës, në difuzionimin reciprok të ideve, të ndjenjave, të frysë bashkë-kohore, të karakterit politik të përbashkët, të pasqyrimit flakë për flakë të aktualitetit, të gjuhës popullore, të shprehjes artistike, të karakterit të drejtëpërdrejtë të pasqyrimeve etj. Në këtë kuptim të gjërë e themelor poezia popullore, jo vetëm u gjend e pranishme në fillimet e letërsisë sonë të realizmit socialist, po edhe plotësoi një pjesë me rëndësi të detyrës historike të krijimit të kësaj letërsie. Trajta e jashtme tradicionale e paraqitjes dhe anominiteti konvencional i poezisë popullore, që në disa raste është kapërcyer, s'ka pse të na pengojnë në nxjerrjen e përfundimit mbi «bashkautorësinë» e popullit poet në krijimin e letërsisë së realizmit socialist. Këtu është vendi të vërejmë se, gjatë Luftës nacionalçirimitare, si letërsia e shkruar, edhe folklori, krahas mbështetjes në traditën e mëparshme përparimtare e patriotike, patën edhe një shkëputje ideo-artistike novatore prej saj, bile, deri në një farë mase, për shkak të rrethanave që krijoj lufta, nuk qenë as «*vazhdim i natyrshëm*» i traditës më të afërme të tyre. Në letërsinë e shkruar, për shembull, në prak të luftës e në fillimet e saj, poezia pas Migjenit tentonte të merrte një tingull proletar, të nxirrte në plan të parë domosdonë e revolucionit në formën klasike të tij (shih, p.sh. «*Në zgjim*» të A.Varfit dhe «*Horizonti në kuletë*» të P.Markos). Me luftën nacionalçirimitare tingulli i letërsisë u përcaktua, para së gjithash, prej patriotizmit dhe antifashizmit, pa iu shmangur qëndrimeve klasore të pre-ra, po edhe pa i nxjerrë në plan të parë ato. Ky ndryshim ishte reflektim i vijës politike, që ndoqi partia gjatë luftës dhe i programit imediat të saj në atë kohë. Po për këto arësy tematika shoqërore, që zinte kreun e vendit më parë, ja lëshoi terrenin tematikës patriotike e politike. E njëjta gjë ndodhi edhe me folklorin, që nga pikëpamja tematike, ka më tepër afërsi në këngët e dikurshme të

luftës për liri. Veç këtyre, për herë të parë gjatë historisë letërsia e shkruar, (po sidomos folklori) orientohet në mënyrë të ndërgjegjshme nga një politikë e nga një ideologji e vetme, nga politika dhe ideologjia e partisë. Ky fenomen i ri ka të bëjë me ndryshimet themelore në brendinë e krijimtarisë letrare dhe është faza e parë e zhdukjes së spontaneitetit e të ndikimeve ideopolitike të shtresave e të forcave të ndryshme politike e shoqërore mbi letërsinë e shkruar e mbi folklorin.

Kënga popullore e Luftës nacionalçlirimtare është një nga manifestimet më të bukura të ndërgjegjes politike dhe të nivelit ideologjik të masave tona punonjëse, që u arritën si rezultat i patriotizmit tradicional, po sidomos i punës intensive dhe efikase që bëri partia. Ndryshe s'kish si të ndodhë që brenda pesë vjetëve të luftës të arrihej një shkallë e atillë e pjekurisë politike e ideologjike, që jo vëtëm të konkretizohej me pjesëmarrjen e gjerë në luftë, po, aty për aty, të shprehej edhe artistikisht në mijëra vargje të frymëzuara nga madhështia e luftës dhe e heroizmit në luftë. Si shprehje e predispositave shpirtërore të masave të gjera, kënga popullore dhe folklori në tërësi, kanë rëndësi të dorës së parë për të gjykuar mbi gjendjen e popullit dhe për të studjuar rrugën e zhvillimit të tij. Ato kanë po këtë rëndësi edhe për letërsinë e shkruar dhe për kulturën kombëtare në tërësi. Edhe në këtë pikëpamje folklori dhe letërsia e shkruar e Luftës nacionalçlirimtare janë në unitet të plotë si pjesë përbërëse të një të tere, si për motivet e trajtuara, edhe për theksin ideor të trajtimit të tyre.

Si shprehëse të predispositave shpirtërore, të aspirative dhe të idealeve politike e shoqërore të pjesës më të përparuar të popullit, që është krijonjësja e tyre, këngët popullore të Luftës nacionalçlirimtare ushtruan një ndikim të fortë edukonjës revolucionar. Ato mbajtën gjallë frymën luftarake e patriotike, heroizmin dhe optimizmin e partizanëve dhe përhapën idealet e luftës, në çdo skaj të vendit, duke mobilizuar njerëzit dhe duke i bërë ata më të vetëdijshëm për sakrificat që kërkonte liria, që i ka «rrënjet në gjak» dhe për domosdoshmërinë e luftës me

armë kundër pushtonjësve e tradhëtarëve. Ky ndikim i këngëve popullore kalon nga çështjet e çlirimt kombëtar, deri në depërtimin fillestar të pohimeve të përgjithshme për socializmin e pér komunizmin. Në qendër të tē gjitha këtyre vlerave ideore, si një konkretizim i brendisë së re politike, po edhe ideologjike, është edukimi i popullit me dashuri për partinë dhe për komunistët, si shprehësit më të mirë të aspiratave popullore. Kënga popullore e luftës në çdo drejtim, po sidomos në himnizimin e rolit të partisë e të komunistëve, është një dackë kundër gjithë propagandës së armiqve të komunizmit, që u përpoqën të përhapnin legjenda nga më të përbindshmet në atë kohë. Të njëjtin karakter propagandonjës dhe edukativ, në radhë të parë politik, po edhe ideologjik, pati edhe letërsia e shkruar e kohës së luftës. Në disa letërsi, si edhe në realitetin revolucionar të shumë vendeve, ka ndodhur që lufta teorike dhe ideologjike i ka çelur rrugë luftës politike. Mendojmë se në vendin e në letërsinë tonë, pa mohuar një farë pune të mëparshme teorike dhe ideologjike, politika dhe aksioni politik gjatë luftës shtruan terrenin e shëndoshë të depërtimit të ideologjisë marksiste-leniniste në jetë dhe në letërsi. Prandaj edhe letërsia dhe folklori i Luftës nacionalçlirimtare shkëlqejnë pér një qartësi të kristaltë të përbajtjes politike dhe, sado që nuk kanë një shtrirje aq të gjerë në problematikën ideologjike e shoqërore, — gjë që u përcaktua nga koha, — edhe ideologjikisht pér tematikën e trajtuar janë në një nivel shumë të lartë, jo vetëm si një hap i madh në krahasim me të kaluarën, po edhe në tërësinë e letërsisë sonë të realizmit socialist. Një gjë të tillë e provon edhe trajtimi i temave ideologjike e shoqërore, krahas temave politike.

Vatër e ndezur e krijimtarisë poetike popullore gjatë Luftës nacionalçlirimtare ishte prapë fshati, sidomos në krahanat që ishin qendra nga më të parat të vetë luftës,<sup>1)</sup> po të tillë vatra u bënë edhe repartet partizane, që bash-

1) «Këngë popullore të Luftës nacionalçlirimtare dhe të periu-dhës së ndërtimit socialist» (Tiranë 1969, v. I. f. 6).

kuan në radhët e tyre shumë fshatarë, të cilët, duke pasë asimiluar traditën e këngës së popullit, ishin ndër të parët vjershëtorë popullor të luftës. Edhe në qytete u krijuan disa këngë, që ndoqën traditën e folklorit qytetar, po këto ishin shumë më të pakta se të parat. Kjo prejardhje e këngës popullore të luftës, si dhe e pjesës themelore të thesarit poetik popullor, është e natyrshme që do të reflektohej në trajtën e saj, në mënyrën e konceptimit e të pasqyrimit të motiveve, në figurat stilistike, në përshtatjen e metrikës e të ndërtimit të vjershës me tipat e melodive popullore krahinore etj., veçori këto që e dallojnë atë nga letërsia e shkruar. Në këngët qytetare ky dallim zvogëlohet, ashtu siç zvogëlohet edhe kur autorë të këngëve popullore janë njerëz me shkollë dhe figura të njoitura të lëvizjes nacionalçlirimtare (Memo Metua, Shefqet Peçi etj.), të cilët i dhanë këngës popullore një trajtë më të afërt me letërsinë e shkruar, ashtu siç i dhanë kësaj të fundit trajtë më të afërt me folklorin ata shkrimtarë, që u mbështetën për krijimet e veta në konceptimin dhe në mjetet popullore të pasqyrimit poetik (Shefqet Musaraj etj.) Ky proces i dyanshëm afrimi ndërmjet letërsisë së shkruar e folklorit, që u vërejt edhe në dhjetëvjeçarin e parë pas çlirimt, nuk është një fenomen i ri për letërsinë e kohës së luftës. Atë e ndeshim edhe në letërsinë e mëparshme, vetëm se në këtë kohë nuk vërehen më fenomene negative, si shfrytëzimi i traditës popullore për krimjin e një letërsie antipopullore dhe spekulimet formali të folklorin, që ishin vërejtur në letërsinë e mëparshme. Kjo është ana e re e fenomenit, që është përcaktuar nga platforma e përbashkët ideo-politike dhe që provon edhe një herë tezën e njojur të parësisë së brendisë ndaj formës. Për këtë ndihmoi si mbështetje edhe tradita e përpunuar e së kaluarës.

Letërsia e realizmit socialist, duke përfshirë edhe krimtarinë poetike popullore, mbështetet në parimet ideo-estetike marksiste-leniniste, po sipas vendit që i përket, ajo ka edhe veçoritë kombëtare historike të zhvillimit, që përcaktohen nga kushtet objektive shoqërore e politike. Studimi krahasonjës i letërsive të ndryshme është i ne-

vojshëm dhe i domosdoshëm, kur është fjala për natyrën e përgjithshme të tyre, po paralelizmi i plotë është i dëmshëm, kur shtrohet çështja e rrugës së formimit, në të cilën veçoritë kombëtare marrin rëndësi dhe përcaktojnë origjinalitetin e zhvillimit historik të këtyre letërsive. Në rastin e lindjes së letërsisë sonë të realizmit socialist, krahas të tjerave, krijimi i një folklori të pasur në një kohë me letërsinë e shkruar dhe aktivizimi i tij në hapat e para të letërsisë së re, është një nga ato veçori kombëtare, që na duket se duhet mbajtur parasysh. Mund të duket, në vështrim të parë, që një gjë e tillë është përcaktuar nga shkalla e ulët e zhvillimit të shoqërisë shqiptare të paraluftës, nga prapambetja jonë kombëtare e atëhershme. Po e vërteta nuk është kjo dhe për këtë mund të na vijë në ndihmë krahasimi i folklorit të Luftës nacionalçirimtare me krijimtarinë poetike popullore të popujve ballkanikë, që nga shkalla e zhvillimit shoqëror nuk kishin ndonjë dallim të madh me vendin tonë. Nga ky krahasim arritmë në përfundimin, se vetë Lufta nacionalçirimtare dhe puna intensive ideo-politike e partisë, që i dhanë një ngritje të vrullshme ndërgjegjes politike të popullit, janë dy faktorët themelorë, që nxitën dhe orientuan si letërsinë e shkruar, edhe krijimtarinë poetike popullore dhe, ndërsa letërsia e shkruar e kohës së luftës ishte relativisht e kufizuar, krijimtaria popullore përbën një det të tërë. Veç këtyre, gjatë Luftës nacionalçirimtare nuk patëm një vazhdim të zakonshëm të traditës poetike popullore, as një përpunim motivesh të thjeshta patriotike e luftarake, sipas modeleve të vjetra. Patëm në atë kohë një përparim të dukshëm cilësor të folklorit, lindjen e poezisë popullore të realizmit socialist, me brendi të re ideo-emocionale. Kjo tregon se nuk kemi të bëjmë me prapambetjen po me përpunim dhe me një përparim të atillë, që po të kemi parasysh kohën e shkurtër në të cilën u arrit, është me të vërtetë i mahnitshëm. Një pasqyrë e shkurtër e këngës popullore të luftës do të na jepte mundësi ta provojmë plotësisht këtë përfundim.

Çështja e parë dhe themelore për të gjykuar mbi vazhdimësinë dhe kalimin e letërsisë e të artit nga një etapë zhvillimi në tjetrën, është brendia e saj ideo-emocionale, që misheron interesimet dhe idealet e kohës dhe që kërkon e gjen format e përshtatshme të shprehjes artistike, si mjete të domosdoshme të konkretizimit poetik të ideve, të subjekteve e të motiveve. Shqyrtimi i vëmendshëm i një gjëje të tillë është veçanërisht i domosdoshëm për folklorin, i cili, pa një hetim të tillë, të krijon përshtypjen e jashtme sikur ka mbetur ai që ka qenë — një krijimtari me karakter të theksuar tradicional, që shpreh koncepte, ide, ndjenja dhe ideale të reja me po ato forma të shprehjes poetike, që ka trashëguar nga e kaluara. Kjo përshtypje e rrreme krijohet se trashëgimi dhe tradita në folklor kanë pasur dhe kanë rëndësi më të madhe se në letërsinë e shkruar, ku kalimet dhe veçoritë individuale të autorëve janë më të dukshme. Lidhja e tekstit poetik të këngës popullore me meloditë krahinore të caktuara, që janë më konservatore dhe marrin zhvillim shumë më të ngadalshëm, bën që të ruhen për një kohë shumë të gjatë disa elemente formale (metri, struktura e këngës etj.) që krijojnë përshtypjen, se nuk kemi zhvillim edhe në një kohë kur ky zhvillim ka prekur si thelbin ideo-emocional të brendisë poetike, edhe mjetet artistike të shprehjes së tij. Kënga popullore e Luftës nacionalçlirimtare, duke ndjekur vazhdën e traditës së këngës popullore të mëparshme, shënoi, në radhë të parë në brendi, po edhe në formimin e vet artistik, një kalim të dukshëm në pozita të reja ideo-artistike. Po cilat janë ato tipare të reja, që përbëjnë novatorizmin ideo-artistik të këngës popullore të Luftës nacionalçlirimtare në krahasim me folklorin e së kaluarës?

Që t'i përgjigjemi drejt dhe sakt kësaj pyetje, para se të shqyrtojmë motivet e këngës së popullit dhe natyrën ideo-artistike të trajtimit të tyre, është e nevojshme të mbajmë parasysh ato karakteristika themelore të periudhës historike të luftës, që përcaktuan lindjen e poezisë

popullore të realizmit socialist dhe u bënë objekt i pasqyrimeve të saj.

Lufta nacionalçlirimtare nuk ishte e para luftë që bënte populli ynë kundër pushtonjësve të huaj për çlirimin kombëtar, po ajo ishte e para luftë nacionalçlirimtare me karakter të thellë demokratik e popullor, që udhëhiqej nga një parti marksiste-leniniste dhe që, në procesin e zhvillimit të saj, mori tiparet e një revolucioni popullor, që erdhën duke u theksuar. Detyrat kryesore që shtroi dhe zgjidhi lufta nacionalçlirimtare e udhëhequr nga paria ishin:

«...Lufta e paprerë dhe pa kompromis kundër pushuesve dhe tradhëtarëve për çlirimin e vendit, për lirinë dhe pavarësinë kombëtare, për qeverinë demokratike popullore; kryengritja e përgjithshme e armatosur dhe krijimi i Ushtrisë nacionalçlirimtare, organizimi i ndihmës së gjithanshme politike dhe ekonomike për luftën popullore, duke pasur si burim vendimtar popullin e fshatit e të qytetit; shkatërrimi i pushtetit të pushtuesve dhe të bashkëpunëtorëve të tyre (që përfaqësonin interesat e klasave kryesore shfrytëzuese të vendit), krijimi i pushtetit politik të popullit, përgatitja e gjerë politike dhe ideologjike e masave për kryengritjen e përgjithshme popullore dhe për vazhdimin e luftës edhe pas çlirimit të vendit për mbrojtjen e fitoreve të arritura, për rindërtimin e vendit dhe për kryerjen e transformimeve të mëdha shoqërore-ekonomike në interes të popullit<sup>1</sup>)

Ky karakteri i gjerë i Luftës nacionalçlirimtare, që dilte shumë Jasht kuadrit të një lufte të zakonshme për çlirimin kombëtar, u reflektua edhe në ndërgjegjen e masave punonjëse dhe kënga popullore, si edhe letërsia e shkruar, u bë pasqyronjëse e kësaj ndërgjegje revolucionare, pasqyroj vetë luftën dhe, nëpërmjet saj, edhe raportet shpirtërore dhe praktike të popullit me luftën, me heronjtë dhe me udhëheqësen e saj të vetme, Partinë Komuniste të Shqipërisë. Po dihet që interprete e ndërgjegjes dhe e veprimtarisë revolucionare të masave të popu-

1) Enver Hoxha: Raporte e fjali me (1967-1968), f. 162-163.

Ilit mund të jetë vetëm një letërsi revolucionare, që lind nga vetë revolucioni dhe i shërben atij si një formë e manifestimit të atyre elementeve me rëndësi të ndërgjegjes popullore, që mishërojnë karakteristikat themelore të epokës dhe përbajnjë embrionet e zhvillimit perspektiv të shoqërisë. Përfaqësonjësit më tipikë të kësaj ndërgjegje revolucionare në kohën e Luftës nacionalçlirimtare ishin komunistët dhe elementi më i vendosur për idealet e luftës e të revolucionit popullor, që dilte nga shtresat më të varfëra të qytetit e të fshatit, luftonte aktivisht dhe kalltej politikisht dhe ideologjikisht nga partia. Nga radhët e këtij elementi dolën edhe rapsodët e shumtë të kohës së luftës, që u dhanë shprehje artistike idealeve revolucionare, nëpërmjet qindra këngëve për ngjarjet më me rëndësi, për heronjtë, për partizanë, etj. Pra, që në pikënisjet e veta kënga popullore e Luftës nacionalçlirimtare dallon nga gjithë krijimtaria e mëparshme popullore dhe është e predispozuar të jetë një këngë me theks të dukshëm novator në brendi e në formë. Ky karakter novator është pasqyruar në përbajtjen politike të re, në frymën ideologjike revolucionare dhe në trajtën poetike të përpunuar e të përparuar në pajtim me kohën, me kërkesat e brendisë së re dhe me nivelin e ri të zhvillimit të shijeve artistike popullore.

Kënga e Luftës nacionalçlirimtare ka një karakter politik të ri. Edhe në folklorin tonë të mëparshëm nuk janë të pakta këngët me motive politike, bile ka edhe kryevepra të lirikës e të satirës politike, po, megjithkëtë, si tërësi, krijimtaria poetike popullore e Luftës nacionalçlirimtare arrin një shkallë shumë më të lartë në këtë drejtim. Duke u bërë shprehëse e vijës së përgjithshme politike të partisë, që përfaqësonte më së miri interesat kombëtare e popullore, kënga e kohës së luftës, duke iu larguar ndikimeve politike të kategorive të veçanta shoqërore dhe forcave të ndryshme politike, thekssoi edhe më tepër karakterin e vet popullor, në kuptimin e shprehjes më të thellë, më të plotë dhe më të drejtë të interesave popullore dhe të qëndrimit popullor ndaj ngjarjeve, forcave politike dhe personaliteteve të kohës. Ajo u bë më e qartë

në gjykimin e ngjarjeve e të fenomeneve politike e shqërore, më afirmonjëse në shfaqjen e ideve e të idealeve të përcaktuara, më e sigurt në vështrimin e perspektivës historike dhe të fateve të luftës e të popullit, më programatike për të ardhmen, më e drejtpërdrejtë në kapjen e problemeve dhe në shprehjen e qëndrimeve. Kjo përmbajtje politike e qartë ka ardhur duke u theksuar dhe duke u përcaktuar. Sado që periudha e luftës është e shkurtër (katér-pesë vjet), të bie në sy menjëherë ndryshimi ndërmjet këngëve dhe krijimeve poetike me fryshtë popullore para dhe pas themelimit të partisë. Një ndryshim i tillë është i kuptueshëm dhe ka të bëjë me vetë përcaktimin e idealeve, me hovin dhe organizimin e Luftës nacional-çlirimtare. Një gjë të tillë do ta vërenim po të krahasonim këngët e para për pushtimin fashist me ato të vjetve të mëvonshëm ose po të ndiqnim, për shembull, krijimet poetike të Selim Hasanit e të Shevqet Peçit para dhe pas themelimit të Partisë.

Karakteri politik i këngëve popullore të luftës është përcaktuar nga qëndrimi me anësi ndaj forcave të kundërtta politike e klasore, që u ndeshën me ashpërsi ndërmjet tyre. Kjo nuk është anësia e jashtme prej dëshmitari. Populli, në krijimet e veta, del si pjesëmarrës aktiv i ngjarjeve revolucionare. Ai është objekt dhe subjekt i historisë, luftëtar dhe poet. Në vargje ai këndon historinë e vet, shpreh ndjenjat dhe mendimet e veta dhe, në këtë drejtim, anonimiteti që marrin këngët pajtohet për bukurinë me gjerësinë popullore të shikimit e të vlerësimit të ngjarjeve.

Për pushtimin fashist në atë kohë dhe më vonë u shkruan shumë këngë dhe, sikurse për vetë karakterin e luftës, edhe për letërsinë e folklorin kjo dramë kombëtare shënoi pikënisjen e një orientimi të ri, kur në plan të parë dilnin kontradiktat me pushtonjësit e huaj. Por, siç provohet nga shumë vargje, vajtimi i gjëndjes së krijuar jo vetëm nuk ngjall dëshpërim, po, në krahasin me këngën patriotike të së kaluarës, mori një karakter më të theksuar e më të qartë antifashist e antiimperialist, gjë që, me thellimin e luftës, do të bëhej gjithnjë e më e hapur. Kra-

has gjëmës, që «*gjithë skelat se ç'u nxinë zbret fashizmi Shqipëri*» tingëlloi fuqishëm edhe dhembja e thellë popullore për pushtimin:

*Që në Durrës dhe në Vlorë,  
mbushur deti me vaporë,  
mbushur qielli me ballonë.  
Ç'të bëj' Shqipëri e gjorë?*

Sadoqë «në çdo sqelë u bë pusi» «prapë Shqipëria e gjorë» nuk e përballoi dot rrebeschin që u përplas furishëm mbi të, ndaj poeti bën pyetjen tronditëse, thellësisht historike dhe emocionale: «Ç'të bëj' Shqipëri e gjorë?», kurse shoku i tij klithi:

*Shtatë prilli më të rirë,  
qaj e zeza Shqipëri..., ndërsa një tjetër  
rapsod zbulon me tallje therëse tradhëtinë e mbretit, të  
bejlerëve e të tregëtarëve dhe, kështu, i jep një shpjegim  
më të plotë pyetjes së kohës:*

*Ahmet Zogu t'madhe briti:  
— Bini burra, mos koriti,  
të luftoni sa të hiki!*

Po nuk mbeti gjendja pa rrugëdalje. Dhembja e zemërimi ushqen revoltën, që shpërthen në veprimtarinë populllore antifashiste, të udhëhequr nga komunistët dhe shpejt lindi, si gjithnjë, bindja se «*vetëm lufta na shpëton*». Me këtë bindje u gatuau vargjet kushtimitare të shumë këngëve popullore dhe të krijimeve të kësaj natyre, hartuar nga Memo Metua, Shevqet Peçi, etj. Në fillim këngët e kushtimit patën kryesisht një theks të zakonshëm patriotik, në vazhdën e traditës së mëparshme (*Për flamur e përvatan — ngrihi bini, o djemo!*), po me kohë sentimenteve patriotike iu ngjiz edhe qëndrimi klasor popullor, që e dallonte Luftën nacionalçlirimtare nga gjithë luftat e mëparshme se, siç thuhet në një këngë, «*kjo është lufta*

*jonë». Tipike për këngët kushtrimtare të fillimeve të luf-tës janë thirrje të tilla:*

*Hapuni ju, male,  
mos rrini me re,  
ngreu ti, o popull,  
flak' edhe rrufe.*

Ose:

*O vëllezër shqipëtarë,  
lini këngën, lini vajnë,  
po na pret luftë e parë,  
me sëpat' e me hanxharë.*

Jemi ende në prologun e luftës dhe, doemos, karakteri politik i këngës popullore do të përcaktohej, para së gjithash, nga fryma patriotike, nga vlerësimi realist i gjendjes së krijuar prej pushtimit fashist, nga kundërshtimi i këtij pushtimi në emër të lirisë e të pavarësisë kombëtare. Ndërsa idetë e këtyre këngëve përshkohen nga fryma patriotike, brendia emocionale e tyre shkon nga dhembja te thirrjet e flakta për luftë, gjë që i heq lirizmit të tyre karakterin e thjeshtë elegjiak dhe i bën të anojnë drejt një forme pak a shumë liriko-epike, në të cilën bashkë me shfaqjen e ndjenjave e të mendimeve pasqyrohen edhe ngjarjet e kohës dhe çelët perspektiva e luftës së ardhshme, ndërsa përballë vuajtjes vihet optimizmi luftarak, karakteristik për çdo periudhë të ngritjes së ndërgjegjes e të veprimtarisë politike të masave. Më vonë, sidomos nga viti 1942 e këtej, (megjithëse koha e saktë e lindjes së këngës popullore është vështirë të caktohet), kënga popullore e luftës e përcakton edhe më mirë fizionominë e vet politike. Duke ruajtur karakterin patriotik, ajo bëhet më e mprehtë dhe më e gjerrë në zbulimin dhe gjykimin e aspekteve politike të kohës, zgjeron horizontin e pasqyrimeve poetike, bëhet më aktive, më luftarake dhe, ndërsa në fillimet e veta tentonte drejt epikës, tanj merr trajtën e plot të këngës liriko-epike, lidhet më ngushtë me ngjarjet autentike dhe brendia e saj

bëhet më e thellë dhe më e përcaktuar; në të hyjnë qëndrimet klasore dhe idealet e krijimit të një bote të re. Qëndrimi ndaj Luftës nacionalçirimtare, ndaj partizanëve e ndaj partisë përbën thelbin e karakterit afirmorjës të folklorit e të letërsisë së shkruar të asaj kohe, kurse qëndrimi ndaj pushtonjësve të huaj, tradhëtarëve dhe klasave sundonjëse, që i shërbyen fashizmit, përbën thelbin e karakterit të saj demaskonjës e mohonjës. Ky kundërshtim e konflikt i madh historik kombëtar e klasorës së pasqyruar gjerësisht e me realizëm në folklorin e kohës së luftës dhe së përmbytja themelore e tij.

Lufta në këngën popullore, megjithëse duket sikur nuk del jashtë kufive të kronikës historike e të reflektimit poetik të ngjarjeve autentike, po ta shohim në tërësinë e folklorit, shtë pasqyruar me një gjerësi të mahnitshme, me qartësi ideore të kristaltë dhe me qëndrim emocional të thellë, të sigurt e të shumanshëm. Duke ruajtur karakterin e theksuar patriotik dhe duke zbuluar madhështinë e luftës e të heroizmit, këngët popullore kanë shkriren në thjeshtësinë e paraqitjes së tyre elementet dramatike, tragjike e komike të kohës së luftës, duke u siguruar gjithnjë vendin e parë elementeve sublime të luftës revolucionare, duke realizuar kështu idenë e madhe të qëndrimit të ndryshëm e të njëkohshëm ndaj luftës imperialiste shkatërrimtare dhe luftës çlirimtare, që nëpërmjet sakrificave e heroizmave, do të sigurojë fitoren mbi armiqëtë dhe çlirimin e Atdheut. Nëpërmjet një sinteze të fortë poetike, me dy vargje, shtë dhënë një prej veçorive të rrugës historike të vendit, ku thuhet në një këngë: «*gjithnjë luftë e pusi — gjithë armiq e mirixhi*». Në këto vargje nuk kemi të bëjmë vetëm me një konstatim të thjeshtë, po me një përgjithësim të fuqishëm ideo-emocional, në të cilin përfshihet edhe vetë Lufta nacionalçirimtare.

Në mënyrë koncize dhe me plasticitet të madh e ngjyra të gjalla tronditëse, që mbartin një dhembje të madhe, pa shifrime të pakontrolluara, pa sentimentalizëm e pa mjegullirë romantike, janë dhënë në këngët popullore pësojat shkatërrimtare të luftës, pikëllimi për dëshmorët e për viktimat dhe dramaciteti i ngjarjeve, që, duke u për-

punuar poetikisht, mbarojnë zakonisht me një optimizëm e shpirt luftarak të sigurt, që buron nga kuptimi i zhvillimit revolucionar të historisë. Dhe, nëpërmjet vargjeve popullore, na mbeten në sy tablo me një madhështi të dhembshme:

*Moj krahinë e Mesaplikut,  
të griu gryk' e belçikut,  
top' e murtaj' e armikut... Ose:*

*O Kuçi në rrëzë mali  
dhe Bolena për karshi,  
tim e flakë nga çdo anë  
të hëngër me tradhëti...*

të tjera është pasqyruar po me kaq forcë e plasticitet dramaciteti i skenave tipike të luftës. Në një këngë për Luftën e Tiranës, gjemjë dy vargje të tilla:

*Sokakët me gjak u lanë,  
hidhej tanksa mi të vrarë.*

Por, siç e përmendëm, kjo anë e dhimbshme e dramatike e luftës, duke qenë një nga ngjyrat e përdorura në pasqyrimin e saj, u është nënshtruar kurdoherë toneve optimiste e heroike, që përbëjnë shpirtin e këngëve. Karakteristike është, që në këngë me motive të tilla, si një element ideor me rëndësi, hyjnë vargjet kushtimtare, besimi në fitoren, urrejtja për armiqtë dhe siguria, se shkaktari i gjithë këtyre të këqijave «*do të vijë një ditë, që do japë llogari*». Në të kaluarën, këngë të tilla zakonisht mbaronin ose me dëshpërim, nga që nuk shihej perspektivë, ose me mallëkime dhe me dëshirën dhe etjen për hakmarrje personale. Besimi në të ardhmen dhe kuptimi i karakterit të gjerë popullor të luftës, u japin këngëve të luftës një tingull ideo-emocional më të lartë dhe, pothuajse gjithnjë, mbi përshkrimin e sakrificave e të humbjeve, lartësohen idealet e mëdha dhe thirrjet luftarake, bindja se do të vijë dita, që vetë populli do t'u kër-

kojë llogari kriminelëve të luftës. Tipike për një përparim të tillë ideo-emocional është kënga «*Kurvelesh, zemëra ime*», një nga më të bukurat e folklorit tonë të luftës. Ndërsa gjer nga mesi i këngës flitet për bombardime dhe për pasojat e dhimbshme të luftës, («*zjarr’ e flak’ e shkatterime, — shtëpitë cop’ e thërrime, — do mbeten foshnjat jetime...*») fill pas tyre bëhet një ndalesë e menjëherëshme prej thirrjes: *Rrofsh, moj djalëria trime!* që si në një muzikë sinfonike bën kalimin nga tema e parë e dhimbjes, në temën e luftës e të fitores dhe i çel rrugën pasqyrimit sublim të heroizmit popullor, që përbën anën më të ndritur të folklorit e të letërsisë së shkruar të Luftës nacionalçlirimtare. Ky kalim nga elementet dramatike në elementet sublime ka të bëjë me kthimin e vështrimit nga krimet e fashizmit në luftën e vendosur, të ashpër dhe heroike kundër tij, nga viktimat e luftës në heronjtë e saj, nga dhembja për humbjet në idealet e luftës dhe në madhështinë e saj, si një manifestim i fuqishëm dhe i vrullshëm në jetën e popullit, që është ngritur me armë kundër robërisë dhe shtypjes.

Ky karakter sublim i këngëve popullore të Luftës nacionalçlirimtare, i reflektuar në pasqyrimet poetike dhe në qëndrimin ideo-emocional të popullit ndaj luftës çlirimtare, buron prej bindjes «*se liria i ka rrënjet — veç në gjak*». Mbi këtë kuptim revolucionar të luftës e të sakrificeave ngrihet i madhërishëm heroizmi popullor dhe u bëhet një vlerësim i drejtë, realist revolucionar ngjarjeve të luftës në tërësi, karakterit dhe idealit të saj dhe manifestimeve konkrete, vështirësive dhe epikës e episodeve heroike. Rapsodi popullor, me një vështrim të gjerë historik, me një ndjenjë të gjiltër, të thellë e me shumë reflekse dhe me një mjeshtëri të rrallë karakterizimi të shpejtë, të thjeshtë e të ngjeshur, këndon:

*Shqipëri e halleve*

*luftë bën e dyfek s’ke... — dhe këtë  
ide themelore populli poet e shtjellon dhe e konkretizon  
në dhjetëra këngë, duke zbuluar kështu një nga aspektet*

historikisht të vërteta e të rëndësishme të heroizmit. Jo vetëm më të paktë se armiqtë, jo vetëm të robëruar e të masakruar prej tyre, por edhe «pa dyfek» shkëlqen heroizmi i partizanëve, të cilët endeshin maleve e luftonin:

*... me një dyfek nën gunë,  
me tre fishekë me skurë,  
nëpër borë e në furtunë*

Kjo është njëra anë e zbulimit të madhështisë së luftës. Një anë tjetër edhe më me rëndësi është qëndrimi heroik në luftë dhe, i frymëzuar nga ky realitet, kapërcimi ideo-emocional i dhembjes dhe i ngjyrave tragjike. Populli realist nuk e ka përfytyruar dhe nuk e ka pasqyruar kurrë luftën si një paradë gazmore, po, me thjeshtësinë e bukur që e karakterizon, i ka hyrë thellë natyrës komplekse të saj, pa humbur asnjëherë fillin drejtanjës ideo-emocional afirmonjës. Madhështia e luftës pikërisht kështu del më në pah, dhe ne, duke lundruar në detin e poezisë popullore, e ndjejmë thellë, e përfytyrojmë qartë dhe na lindin emocione të forta njerëzore revolucionare e patriotike.

*Të keqen e djemve tanë,  
ca në plumb, ca në litarë,  
edhe ca burgjeve janë,  
po të shum' jan' partizanë...*

Katër vargje janë këto, po sa dhembje, dashuri, krenari dhe madhështi është derdhur në to! Këta «djemtë tanë», që hynë të thjeshtë në histori dhe mbetën si përmendore madhështore të saj, kur vjen puna qëndrojnë të vendosur në luftë, duke përballuar me burrëri shembulllore gjithë vuajtjet dhe vështirësitë «nëpër borë e në-për shi, — maleve në eremi, — pa shollë e me uri». Dhe më konkretisht:

*Dy ditë luftë e paprerë,  
binte breshër edhe shi,*

*partizanët as dëgjojnë,  
s'lonte këmbë, s'trembej sy!..*

Në folklorin e Luftës nacionalçlirimtare nuk janë të pakta edhe këngët, që mbështeten në një përfytyrim të thjeshtë entuziast të luftës. Ndërsa në këngët e tjera, me pretendime e me vlera më të mëdha ideo-artistike, gjemjë një përfytyrim të shumanshëm të luftës dhe një shtrirje të elementeve dramatike e sublime të saj, në këto të fundit sundon kryesisht gëzimi për përparimin e luftës çlirimtare dhe një lirizëm i lehtë optimist, kur shohim që «*gjemon malin*», se «*partizanët shkojnë në çetë — me krah' e armë të lehtë*», osë:

*Vajzat shqipëtare turren me tërbim,  
muar armët e lëftojnë si luane,  
mbushur burgje, mbushur fusha, mbushur male,  
armikun s'duan ta dinë, s'tremben fare... .*

Një vend të veçantë e me rëndësi, në krijimtarinë poetike popullore të kohës së luftës, zënë këngët kushtuar dëshmorëve. Ato nuk janë mejtime të dëshpëruara, po këngë trimash të përshkuara nga një ndjenjë e sinqertë dhembjeje njerëzore, po edhe lartësimi të trimërisë e të heroizmit, urrejtje për armikun, thirrje për luftë dhe vlerësim i kontributit me gjak për fitimin e lirisë. Shpesh ato, me thjeshtësinë dhe koncizitetin që i karakterizon, me një renditje në dukje jo aq emocionale e figurative të meritave apo me një përshkrim të tillë të ngjarjes, u ngajnjë plakave të mermarta të lapidarëve dhe janë një tip i veçantë dhe origjinal elegjish, ca primitive, po të çliruara nga çdo notë pesimizmi, ankthi e fataliteti. Vdekja kurrë nuk është gëzim, po rënja në fushën e betejës është parë nga populli si një kurorëzim i madhërishëm i jetës së luftëtarit, që udhëhiqet nga ideale të larta. Populli gjithnjë u ka kënduar trimave që kanë dalë nga gjiri i tij dhe kanë luftuar për të, po në këngët e Luftës nacionalçlirimtare brendia ideo-emocionale pasurohet me dy elemente të reja: me tipin e ri të heronjve (*ju kish rritur nëna për një*

*botë të re), që i kalon kufitë e përfytyrimit të mëparshëm*  
*popullor dhe me bindjen se këtë herë sakrificat dhe gjaku*  
*i derdhur nuk do të venin kot. Këto u japid këngëve një*  
*karakter të atillë revolucionar që largon prej tyre çdo hi-*  
*je vdekjeje dhe bën të sundojnë në to aktet heroike dhe*  
*idealet e heronje, që mbeten të gjalla e do të realizohen*  
*me siguri. Ata «derdhën gjak e hodhën rrënjet», «dhanë*  
*jetën për lirinë» dhe «mbeten në histori». Nënët shami-*  
*zeza të dëshmorëve, kur marrin mandatën, nuk pranojnë*  
*që djemtë e tyre kanë vdekur. Ata mbeten luftëtarë edhe*  
*pas vdekjes dhe jetojnë në këngët e në trimëritë e luftës,*  
*në idealet e shokëve të tyre të partisë. Ky ngadhnjim*  
*mbi vdekjen ka të bëjë jo me një përfytyrim idealist apo*  
*të idealizuar, po me kuptimin revolucionar të zhvillimit*  
*historik. Në këngët e mëparshme të kësaj natyre si notë*  
*përfundimtare zakonisht mbetet dëshpërimi, jo vetëm*  
*për vdekjen e heroit, po edhe për idealet e tij, që populli*  
*i ka pasur të vetat dhe nuk ka shpresë të realizohen. Në*  
*shumë këngë për dëshmorët, mbi dhembjen për të rënин,*  
*ngrihet shqetësimi i madh për vazhdimin e mëtejshëm*  
*të luftës, si një triumf i patriotizmit dhe i ndjenjës së për-*  
*gjegjësisë historike. Në vjershën e Memo Metos, nëna e*  
*dëshmorit, kur i venë për ngushullim, u thotë bashkëfsha-*  
*tarëve:*

... *mos vajtoni*  
*dhe për ngushullim tek unë*  
*mos nxitonî*  
*se, si djalin tim, Fuatin,*  
*këtë herë*  
*gent' e Romës do na vrasin*

*dhe të tjerë — dhe përfundon:*  
*le të hidhemi në luftë*  
*djalë e plak,*  
*se liria i ka rrënjet*  
*veç në gjak.*

Kjo frymë e re në këngët e popullit është e lidhur  
 ngushtë me njohjen e politikës së partisë gjatë luftës, me

vlerësimin e lartë të rolit udhëheqës të saj, me depërtimin e ideologjisë marksiste-leniniste në shtresat e gjera të popullit. Këngët për partinë janë të shumta, po më e rëndësishme nga vetë këngët kushtuar asaj, është brendia e partishme, që merr folklori në atë kohë e që gjemë të shpërndarë si një element themelor në të gjitha krijimet. Ky është thelbi dhe shpirti bashkëkohor i këngës popullore të Luftës nacionalçirimitare, gjëja më esenciale, që i jep asaj karakter aktual e novator, mbasi çdo element tjeter ideo-emocional dhe stilistik i nënshtrohet dhe i shërben atij. Fjala «komunist» nuk hyri në këngën popullore si një koncept abstrakt i përgjithshëm, por si reflektim i gjallë i vetë realitetit të kohës, që e solli komunistin në jetë dhe, shumë shpejt, e bëri figurë qëndrore e të dashur, mishërim të vityteve të larta popullore, përfaqësonjësin më të vendosur e më heroik të vegjëlisë. Prandaj lëvdata më e madhe, që u thuret heronje të luftës kanë qenë shprehjet: «Komunist i nënës», «bëje pjesë në parti» etj. Edhe vetë partinë populli e çmoi, e ndoqi pas dhe e deshi me gjithë shpirt, se në programin dhe veprimtarinë e saj gjeti pasqyrimin e idealeve të veta, pa lartësimin më të madh të traditave luftarake, qëndresën dhe besnikërinë. Udhëheqja e partisë është një gjë e re në historinë e popullit tonë dhe po aq e re ishte edhe për folklorin e për letërsinë e shkruar, po intensiteti i ngjarjeve, si rrallë gjetiu bëri që fjala «Parti» të tingëllojë me krenari dhe të bëhet më e dashura dhe më e rëndësishmja ndër fjalët në një kohë shumë të shkurtër.

*Moj Parti, t'u shtoftë nami,*

*s'u tunde nga istikami — ja, me këto dy*  
vargje rapsodi ka karakterizuar gjithë historinë e partisë, vendosmërinë dhe heroizmin e saj dhe ka treguar pse u bë ajo aq e dashur për popullin, ndërsa një tjeter rapsod do ta shtjellonte më gjërë këtë mendim lapidar dhe, duke i kthyer sytë nga historia, do të tregonte atë rol të madh që luajti partia në luftë:

*Lum e lum për kët Parti,  
për Enverin djalë dai,  
si na msunë me kapë manzeren,  
kush taljanen, kush malipheren  
e me i kallë barot anmikut,  
me trimni e shpirt çelikut,  
me dhanë jetën si me le,  
për vatan e për ide,  
për flamurin kuq e zi,  
për liri, demokraci!  
Pra, ket ditë pat pritë Shqipnia  
e ket ditë na e sull Partia!*

Njohja e rolit të partisë është baza dhe kulmi i karakterit afirmonjës të këngës populllore të Luftës nacionalçlirimtare, që përbën, siç u theksua, njëren prej anëve themelore të qëndrimit ndaj ndeshjes së forcave të kundërta. Anën tjetër e përbën qëndrimi demaskonjës ndaj armiqve fashistë dhe tradhëtarëve të vendit. Ky qëndrim është përcaktuar nga urrejtja për pushtonjësit fashistë, nga revoltat kundër krimeve të tyre, po edhe nga epërsia morale e popullit, që u ka dhënë këngëve shpesh një ton entuziast, kurse armiqtë shumë herë janë përshkruar me theks të dukshëm satirik. Në një këngë të thjeshtë me emocionalitet të brendshëm, na është dhënë kjo tablo e pasojave të pushtimit fashist:

*Na erdhi fashizmi,  
zaptoi Shqipërinë,  
seç na la pa dritë,  
s'sheh njeriu njerinë;  
seç na la pa bukë,  
vdiqi foshnjérinë;  
internoi familje,  
mbushi Italinë.*

Kjo këngë në dukje e qetë dhe me një ngjyrë ideo-emocionale të përmbytjatur, ka pasqyruar me saktësi pasojat e pushtimit fashist, pra, edhe nevojën dhe motivet

kombëtare, ekonomike dhe politike të luftës kundër tij Në të tjera këngë, me motive më të përcaktuara, janë pasqyruar pasojat e luftës fashiste pas pushtimit, kur ushtria e pushtonjësve «*s'la plevicë e s'la shtëpi, — vrau burra e cilimi*». Ky theksim gjithnjë më i fortë i denoncimit të krimeve fashiste, që pasqyron ashpërsimin e luftës, plotësohet në këngët populllore me realitetin dhe idetë e kryengritjes populllore dhe me thirrjet e zjarrta për ta ndezur edhe më tepër zjarrin e saj. Përballë luftës populllore, përveç pushtonjësve fashistë, janë vënë edhe tradhëtarët e vendit dhe, në këtë drejtim, vërejmë një përparim ideor të krijimtarisë populllore, në krahasim me këngët e kohëve të shkuara, mbasi nuk kemi të bëjmë më me denoncime tradhëtarësh të veçanta, po me demaskimin politik të gjithë frontit të tradhëtisë, që i ka rrënjet në klasat shfrytëzonjëse. Shërbëtorë të fashizmit u bënë, në radhë të parë, bejlerët dhe pasanikët, prandaj titulli «*bej*» si dhe fjalët «*ballist*», «*milic*» e «*fashist*» përmenden gjithnjë me urrejtje dhe me tallje, gjë që shpreh urrejtjen e vjetër e të re të popullit kundër tyre dhe epërsinë morale dhe besimin në fitoren mbi ta. Demaskimi politik i tradhëtisë kombëtare dhe i krimeve, është elementi i parë i qëndrimit popullor ndaj tyre:

*Të gjithë burrat i vranë,  
Ali bej, ç'na thua ti?  
Ti e dogje Kurveleshin,  
s'le kasolle dhe shtëpi,  
po do të vijë një ditë,  
që do japësh llogari!*

Satira dhe humor i këngëve populllore janë një tjetër element ideo-emocional i qëndrimit ndaj armiqve e tradhëtarëve. Ato pasqyrojnë më së miri fitoren shpirtërore mbi armiqtë, para fitores përfundimtare politike dhe ushtarake mbi ta. Tallja dhe gazi i kanë dhënë zjarr shpirtit luftarak dhe, duke zbuluar kalbësinë e frikën e kampit të armikut, kanë shtuar entuziazmin popullor dhe besimin në fitore, kanë zbuluar edhe më mirë pasojat e Luftës na-

cionalçlirimtare dhe forcën e madhe goditëse të saj. Fashistët ishin të egër, po nuk ishin të tmerrshëm e të pa-thyeshëm. Ata, jo vetëm mund të luftohen e të munden, po kur e shohin pisk, bëhen frikacakë dhe qesharakë, «*se ky popull ka djem me huqe — këmishën e zezë ta bajnë të kuqe*». Prandaj «*gjermanët i mori frika — në llogore gjer tek gryka*» dhe rapsodi popullor, duke parë këtë gjendje, «u qan hallin»:

*O gjerman, o ditëzi,  
ç'kërkove në Shqipëri?* Ose u përcakton fatin, kur u thotë se pas lufte:

*me dhën e me dhi do shkoni,  
me bucela do ngarkoni... në mos u mbet-*  
çin «*këmishat shkarpave*» si në Grykën e Gjormit. Në raste më konkrete na pëershkuhen skena plot optimizëm e humor të hollë e të ndritur:

*Lufta nëndë orë vazhdoi,  
nga gjermanët s'mbet njeri,  
se nga vanë, seç i gjeti  
plumb' i dyfekut e di.*

Një objekt i preferuar i satirës popullore gjatë luftës ka qenë organizata tradhëtare e Ballit Kombëtar, krerët dhe bashibozukët e saj. Është vështirë të gjesh këngë popullore kushtuar Ballit Kombëtar, që të mos përshkohet nga ndjenja e përcimit dhe e talljes. Tradhëtia kurdoherë është parë si një akt i përcmuar dhe i pështirë, po, në rastin e Ballit Kombëtar, kemi të bëjmë me një përpjekje të ethshme të pushtonjësve fashistë dhe të klasave sundonjëse të vendit për ta «organizuar» tradhëtinë dhe, në këtë mes, elementi satirik qëndron që në themel të çështjes: në karakterin e vërtetë tradhëtar të Ballit Kombëtar dhe në pretendimet dhe bujën «patriotike» e «nacionaliste» që përpinqej të bënte për të mbuluar natyrën

e tij të vërtetë. Kulmi i komedisë së Ballit Kombëtar arrin me hyrjen e tij në luftë të hapur e të armatosur kundër Lëvizjes nacionalçirimitare. Në këtë luftë u zbulua plotësisht jo vetëm fizionomia tradhëtare, po edhe kalbësia dhe degjenerimi moral e politik që e karakterizonte. Populli, nga çdo pikëpamje dhe kurdoherë e ka parë nga lart këtë hordhi tradhëtarësh, e ka demaskuar dhe e ka vënë në lojë, duke stigmatizuar natyrën e saj të përgjithshme dhe taktikën, që përpiquej të përdorte.

*O popull i Shqipërisë,  
pa shih Ballin Kombëtar,  
si iu përvesh tradhëtisë  
me nazizmin gjakatar.  
Sa ish Duçja në fuqi,  
punonte prapa perdesë,  
në çdo vend na bën pusi,  
posi qeni i pabesë.*

Në një tjetër këngë popullore të kohës së luftës, na është dhënë në pak vargje karakteri kriminal, fizionomia politike e klasore e Ballit Kombëtar, ftyra e tij morale dhe qëllimet imediate, që e udhëhiqnin në luftë. Në pak vargje na jepet një karakterizim i plotë:

*Ç'deshët ju, o derëzez,  
me gjak lyer gjer në bres...  
ç'deshët ju, o qën zagarë,  
Shqipëri me agallarë!...  
ju duallt për kusëri,  
s'lat' kusi e s'lat' tepsi...*

Në të tjera këngë populli është tallur me gostitë dhe me défrimet e krerëve të Ballit, të cilët «luanin me gramafone, — pinin verë dhe raki», me kusëritë e tij, po sidomos me frikën nga partizanët. Ata paraqiten, në këngët popullore, si një hordhi e shthurur, që morën vrapin nëpër driza e nëpër ferra dhe «shënohen posa shtjerra», kur ndeshin në zjarrin e luftës partizane. Një karakterizim të

plotë të këtij paniku, që i pushton «ballistët ballëderra», e gjejmë edhe në këto vargje satirike:

*Ballista, more të mjerë,  
erdhët për një copë herë,  
mbetët me gunë të çjerrë,  
si cicamiu në ferrë,  
si cicamiu i ngrirë,  
si viçe të palëpirë,  
si të dehur, si të pirë,  
si njerëz të pështirë... .*

Në qëndrimet ndaj Ballit Kombëtar dhe tradhëtarëve të tjerë, ashtu si dhe në qëndrimin afirmonjës ndaj Luftës nacionalçlirimtare, partisë dhe komunistëve, kënga popullore i kapërcen caqet e një kënge të thjeshtë patriotike dhe shpesh merr ngjyrat e një krijimtarie me brendi politiko-shoqërore, në të cilën qëndrimi patriotik shkrihet e pasurohet me qëndrimin klasor revolucionar, duke pasur në pikënisje ndjenjat kombëtare, po edhe duke i kaluar kufitë e tyre dhe duke përqafuar idetë e reja klasore dhe idealet e revolucionit popullor. Në të vërtetë Lufta nacionalçlirimtare ndau mirë shapin nga shegeri: vegjelia ndoqi partinë dhe u bashkua në luftë kundër fashizmit, kurse pasanikët u bashkuan me fashizmin dhe u vunë kundër popullit. Nga ky diferencim politik, u zbulua më mirë në syt e popullit dhe u kuptua më thellë e më konkretisht prej tij baza klasore e qëndrimit të njerëzve, udhëheqja prej interesave të klasave, lufta e pashmangshme kundër tyre. Demaskimi politik i klasave shfrytëzonjëse gjatë luftës, që plotësonte urrejtjen shekullore të popullit, e lehtësoi pa masë luftën kundër tyre edhe në terrenin shqëror dhe ekonomik.

*O flamur i hijeshuar,  
belerët të kanë turpëruar! — kjo është  
pikënisja e gjerë e urrejtjes dhe armiqësisë së popullit  
me klasat shfrytëzonjëse në vjetët e Luftës nacionalçlirim-*

tare. Pra, kemi të bëjmë me një pikënisje të përgjithshme patriotike, që vjen e konkretizohet gjithnjë e më shumë dhe merr gjithnjë e më shumë një karakter të mprehët klasor revolucionar. Edhe një gjë e tillë shënon një hap të madh të ngritjes, jo vetëm politike, po dhe ideologjike të krijimtarisë poetike popullore. Këtë theksim të karakterit klasor në folklor e gjejmë të pasqyruar në dy aspekte themelore: në qëndrimin ndaj klasave shfrytëzonjëse, vuajtjeve dhe mjerimeve, që ato i kanë shkaktuar popullit dhe në njojhen dhe pasqyrimin e atyre momenteve dhe idealeve të Luftës nacionalçlirimtare, që i jepnin asaj karakterin e revolucionit popullor.

Pushtimi fashist e ruajti dhe e intensifikoi shfrytëzimin klasor dhe, në kushte të tillë «*fukaranë e ka marrë dreqi! — nuk ka bukë me ngranë për veti*», ndërsa çifligarët, bejlerët dhe pasanikët e tjerë «*për ca rroga e pozita*», që iu dha fashizmi, ranë në prehër të tij dhe ai «*na rrëmbeu gjithë ç'keshëm — gjë s'na la*». Ky polarizim politiko-ekonomik i forcave të kundërtat shoqërore shpuri në theksimin e karakterit klasor. Nga një anë e barikadës ishin ata që thoshin:

*Jemi rritur në të keqe,  
në bejlerë e në oxheqe,  
ata fol' e neve peqe,  
në dorë kabash e qelqe...*

—, kurse nga ana tjetër, ishin shfrytëzonjësit e popullit, ata që edhe vetë luftën donin ta shfrytëzonin për të forcuar pasurinë dhe pozitat e tyre, duke zbuluar kështu jo vetëm lakmitë klasore, po edhe fytyrën antikombëtare të tyre. Edhe këtë gjë populli e kuptoi dhe e pasqyroi në këngët e veta, se e pa që «*të damkosurit me damkë*»:

*Kapidan begj e aga  
e kanë ba fashizmin vlla... se:*

*bejlerët duan kolltuqe,  
kërkojnë thela me dhjamë...*

Edhe vetë klasat shfrytëzonjëse e kuptionin, se Lufta nacionalçlirimtare, e udhëhequr nga partia, nuk ishte si çdo luftë tjetër pér çlirimin kombëtar në të kaluarën, kur populli luftonte dhe ato mbanin frenat. Udhëheqja e partisë dhe perspektiva e qartë, e shndërrimit të luftës në revolucion popullor ishin shenja ogurzeza pér pasanikët, që shihnin fundin e pushtetit të tyre politik dhe ekonomik, prandaj edhe bëheshin më të egër kundër popullit e më të fëlliçur në tradhëti.

*Pasaniku na u prek:*

*komunizmi na u qep* —do të këndonte me gjëzim e me të tallur bashkë rapsodi popullor, duke zbuluar në dy vargje të mprehtë sikletin e pasanikut dhe gjëzimin e popullit.

Ndërsa njëra palë, klasat shfrytëzonjëse luftonin pér të ruajtur pozitat e tyre ekonomike e politike, pala tjetër — populli luftonte pér çlirimin kombëtar dhe kishte pér ideal «*të fitojmë lirinë* — pér fshatarë e punëtorinë» dhe «*komunist popullin ta sjellim*», pra, kemi një zhvillim të dukshëm të ndërgjegjes e të idealeve klasore, një shkallë të re të nivelit ideologjik të masave punonjëse. Kjo është një nga shenjat më me rëndësi të cilësisë së re, që u arrit në krijimtarinë poetike popullore gjatë luftës, cilësi që erdhi duke u thelluar e duke pushtuar pér herë terrene të reja të jetës e të ndërgjegjes popullore, në pajtim me vetë zhvillimin dhe thellimin e revolucionit. Populli, i zgjuar nga partia dhe me besim tek ajo, e shihte se kish perënduar koha kur «*e merrnin fjalën të tjerë — pashallarë dhe bejlerë*», ndaj edhe deklaronte me siguri e kre-nari:

*S'është koha si qëmoti  
me bejlerë e parësi.*

*Këjo është lufta jonë... , kur populli dik-tonte vullnetin e vet dhe i kanosej beut:*

*mos gabë të zgjatesh shumë,  
se këtu ka një parti,  
të jep këpucët në dorë,  
more beu faqezë... .*

«*Luftha jonë*» s'ishte më, si qëmoti, «*luftë për karrike*», por ishte «*luftë e popullit marë — s'lamë bejlerë, as agallarë... .*» por:

*Neve tokën tonë e duam  
të fshatarit,  
dhe më gjaku mos i pihet  
proletarit.  
Shqipërinë, mal e fushë,  
tok ta kemi,  
të gjithë shokë e vëllezër,  
ne të jemi, — sic kendonte*

Memo Metua që më 1943 dhe tallej me beun, duke e paralajmëruar të qajë «*për ato bahçe — plot burbuqe*» dhe «*për meashe e për kolltuqe*», se në luftë, thotë një tjetër këngë popullore «*mori frenat vegjëlia, — bëri si deshi partia*». Një karakter i tillë i përcaktuar klasor duket sidomos në pasqyrimin e rezultateve të luftës, që nga një anë «*buq' e çobanë i shpëtoi — u hoq zgjedha se na shoi*». dhe, nga ana tjetër «*u vuri drizën në derë*» zengjinëve dhe bejlerëve.

*Dhe ata që kanë mbetë  
fushave bëjnë hendekë*

vënë presh e çkulin qepë — thotë rapsodi, duke na dhënë me këtë pasqyrim konkret idenë e përbysjes së madhe shoqërore që u arrit pas luftës. Ndërsa gjatë luftës njerëzit e popullit kishin për moto: «*ja si të duam vetë — ja po themeli përpjetë*», pas luftës e kuptuan plotësisht dhe deklaruan me zë të lartë: «*komunitazi na shpëtoi*». Mbështetje ndokujt elemente të tillë brendisë së re ideologjike të krijimtarisë popullore e të letërsisë së shkruar të Luftës nacionalçlirimtare mund

t'i duken elementare, të thjeshta e të zakonshme, po, në të vërtetë, ato janë të një rëndësie të madhe historike në përcaktimin e fizionomisë ideologjike të letërsisë sonë popullore dhe mbeten themeli i zhvillimit e i përparimit të tyre të mëvonshëm ideologjik. Në qoftë se atëhere kjo përbajtje e re ideologjike nuk shtrihet gjer në nuanca, një gjë e tillë ishte përcaktuar nga shkalla e zhvillimit të vetë revolucionit, i cili, duke u thelluar, merr gjithnjë e më tepër shtrirje të gjerë dhe gjithnjë e më gjerë reflektohet edhe në ndërgjegjen e popullit, pra, edhe në krijimtarinë letrare e artistike, si shfaqje të kësaj ndërgjegjje. Po, sado në gjërsëi të shtrihet pasqyrimi artistik, themeli mbetet po ai që është shprehur edhe në këngët popullore: pranimi i komunizmit dhe lufta për komunizëm. Në këtë drejtim në krijimtarinë popullore dhe në letërsinë e shkruar të Luftës nacionalçlirimtare u arrit, deri në një farë shkalle, shkrirja e motivit politik me motivin shqëror, bashkimi i frysës patriotike me idetë e demokracisë e të revolucionit. Në periudhën e fundit të luftës dhe sidomos në vjetët e parë pas çlirimtës, kjo shtrirje u bë më e theksuar dhe mori plotësisht karakteristikën e një cilësie të re ideo-artistike.

Edhe heroji i këngëve të Luftës nacionalçlirimtare nuk është heroji i zakonshëm i folklorit të mëparshëm, siç e vumë re, kur folëm për këngët kushtuar dëshmorëve. Ndonëse, edhe në këtë drejtim, janë ruajtur si mbështetje disa elemente të këngëve të mëparshme të trimërisë, sidomos të Luftës së Vlorës, vërejmë se është theksuar karakteri demokratik në përkatësinë klasore të heroit dhe në idealet e tij, ka marrë shtrirje e kuptim më të gjerë heroizmi masiv. Krahas virtyteve tradicionale popullore, në përcaktimin e heronjve kanë marrë vlerë elementet e reja të qëndrimit e të moralit komunist dhe është arritur një shkrirje më organike e luftëtarit dhe e popullit. Heroi i këngëve të luftës është njeriu aktiv e militant, i edukuar nga partia dhe i kalitur në vështirësi e beteja, njeriu i ri — sintezë e traditave të lashta luftarake të popullit dhe i idealeve të reja, që i kalojnë kufitë e realitetit të dikurshëm dhe tentojnë drejt të ardhmes. Ai është një-

riu i sakrificës dhe i vetëmohimit, që në emër të interesave të mëdha kombëtare e popullore, lë mënjanë gjithshka. Për të tillë heronj populli këndon me krenari:

*Pa dëgjoni djemtë ç'thanë:  
— Do ta lëm jetën mënjanë,  
do marëm puçk'e gjordanë,  
do të dalëm partizanë..., ndërsa vetë tipi*

i këtij heroi, duke u vënë përballë fashistëve dhe reaksionarëve, deklaron me mburrje e me bindje:

*S'jam zogist as jam ballist,  
jam shqiptar, komunist!  
Nuk e luej kamën aspak,  
për pa e shkri ket borë me gjak.*

Në detin e gjerë të këngëve popullore janë të shumta këngët për trimat, siç janë edhe më të shumta motivet e trajtuar, po në këto shënime do të ishte e vështirë të përfshi heshin e të cito heshin të gjitha, aq më tepër se qëllimi ka qenë, jo të pasqyrojmë deri në nuanca vlerat e folklorit, se sa të shprehim disa mendime përfizionominë ideo-artistike, që mori ai gjatë Luftës nacionalçlirimtare, i frymëzuar nga ajo dhe i ndikuar nga veprimitaria politike, ideologjike dhe edukative e partisë.

### III

Po a kanë këngët popullore të Luftës nacionalçlirimtare një fizionomi të tyre artistike, që i dallon nga folklori i mëparshëm? Pjesërisht i jemi përgjigjur kësaj pyetje edhe nëpërmjet konstatimeve që kemi bërë përményrën e re të konceptimit dhe të pasqyrimit ideo-artistik të realitetit, përmotivet e trajtuarë, për heronjtë etj, po këtu është çështja për një vështrim të posaçëm të natyrës së tyre artistike të realizimit poetik dhe të mjeteve që përdoren për të arritur këto qëllime, domethënë është fjala thjeshtësisht për anën formale të vlerave të tyre

Të afërta me këngët me motive të përgjithësuara janë edhe këngët popullore qytetare, që, ndonëse të pakta, janë një shfaqje e veçantë e larmisë së këngëve popullore të luftës nacionalçlirimtare. Edhe kur u kushtohen heronjve dhe ngjarjeve autentike, këto këngë, që kanë natyrë të përgjithshme popullore, ndërrojnë prej të tjerave, se ndër to ndihet gjurma e prejardhjes qytetare (mbështetja në folklorin qytetar), e shkollës dhe përgatitjes letrare të autorëve dhe e pavarësisë së tekstit poetik nga shtampa e melodisë, meqë ato janë shkruar jo që t'i përshtaten një tipi të njojur melodie, po që, sipas tyre, të thuret edhe kënga. Të tilla janë këngët për Qemal Stafën, për dëshmorët e Shkodrës, për Emin Durakun, për Dyl e Haxhire Myzirin, për Kajo Karafilin etj. Veç karakterit qytetar të këngëve të tilla, në to, si edhe në këngët me motive të përgjithësuara, kemi të bëjmë me një fazë të ndërmjetme në mes të folklorit të mirëfilltë dhe letërsisë së shkruar, elemente të së cilës i gjejmë edhe në krijimtarinë e autorëve të njojur të këngëve popullore si Shevqet Peçi e, verçanërisht, Memo Metua. E rëndësishme është që këngët e ngritura prej tyre, jo vetëm që u përhapën në popull dhe i bënë jehonë luftës, po ndikuan edhe në vetë zhvillimin e folklorit, ndihmuani që krijimtaria popullore të orientohet më lehtë në tematikën e re edhe të kalonte në një fazë më të lartë të zhvillimit të vet ideo-artistik. Prej një vështrimi krahasonjës do të vërenim, se nga autorët e njojur të këngës popullore të Luftës më afër traditës së mëparshme është Selim Hasani, që e kishte formuar pak a shumë personalitetin e vet më parë, në qendër do të ishte krijimtaria e Shevqet Peçit, që ka një fizionomi popullore më të përcaktuar bashkëkohore edhe në formë, kurse Memo Metua, me gjithë natyrën e thellë popullore të krijimeve, anon gjer diku nga letërsia e shkruar.

Nga sa u përpoqëm të themi në këto shënimë, del se Lufta nacionalçlirimtare ishte një provë e shkëlqyer, jo vetëm e shpirtit liridashës e luftarak të popullit, po edhe e vitalitetit të pashuar të gjenisë së tij krijonjëse. Në luftë e sipër, duke vaditur me gjak rrënjet e lirisë kombëtare e shoqërore, populli poet krijoji vlera artistike që edhe sot,

pas më se një çerek shekulli, të mahnitin me bukurinë e thjeshtë, me mprehtësinë dhe gjallérinë e shprehjes, me konçisionin e mrekullueshëm dhe me konkretësinë përgjithësonjëse, me lidhjen e ngushtë të krijimtarisë me problemet dhe evenimentet e kohës, me përpjekjen për të kapur e pasqyruar në këngë anët më të ndryshme lirike, epike, tragjike, sublime e komike të realitetit, me orientimin e qartë ideor e politik, që ka ruajtur gjithnjë tonin optimist e luftarak të këngëve. Kënga popullore është e madhërishme dhe monumentale me konkretësinë dhe me thjeshtësinë e saj. Përshtypjet e gjalla ngajeta në këngën popullore të duket se zbulojnë vetveti fuqinë poetike të tyre, rapsodi nuk të lë përshtypjen se do të bëjë art. Ai është aq i natyrshëm, sa c'janë të sinqerta e të natyrshme ndjenjat, mendimet dhe shqetësimet e thella patriotike, politike e shoqërore të popullit, që mbart mbi shpatulla barrën e luftës dhe heroizmin e saj. Kjo anë me rëndësi e krijimtarisë popullore (rapsodi i veçantë nuk shpreh thjesht ndjenjat e mendimet e veta, po ngrihet në lartësinë e shprehjes së ndjenjave e të mendimeve të gjithë popullit, nga gjiri të cilit ka dale) — është një shembull i madh për luftën kundër subjektivizmit në letërsi. Po kësh-  
tu, krijimtaria poetike e popullit na provon sa pa vend janë përpjekjet që, duke u nisur nga anët e jashtme të folklorit, pa kuptuar shpirtin dhe natyrën artistike të tij, të krijojnë një poezi të ngarkuar me figura stilistike standarde, gjoja popullore, që e largojnë poezinë nga zbulimi i vlerave poetike të realitetit dhe i japid asaj vetëm një veshje formale e të rënduar me lajle-lule për të fshehur vobektësinë e përshtypjeve ngajeta, cektësinë e ndjenjave e të mendimeve, dobësinë ose edhe mungesën e shqetësimeve të vërteta shoqërore e të frymëzimit, që buron prej tyre. Populli poet është një mësonjës i madh, veçse duhet ditur të mësohet prej tij, dhe një gjë të tillë e kanë arritur e do ta arrijnë ata që e njohin popullin, e duan atë dhe vendosin të ecin në rrugën e tij për t'i shërbyer më mirë, për t'u bërë të dashur për të. Letërsia e realizmit socialist këto synime ka, prandaj është i rëndësishëm për të studimi dhe përvetësimi krijonjës i traditës së pasur popullore.

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Kur flasim për poezinë .....	3
Poemat e para .....	38
Poet novator .....	73
Toka ime, kënga ime .....	129
Shtigjeve të reja poetike .....	172
Kënga e popullit .....	209